

**KUR
TUNDOHEN
BURRAT
E MIRË**



Libra të tjerë nga Bill Perkins

Zgjohe drejtuesin që është brenda teje

*Kur tundohen të rinjtë
(Bill Perkins dhe Rendi Sauthörn)*

Gjashtë beteja që duhet të fitojë çdo njeri

6 rregullat që duhet të shkelë çdo njeri

**KUR
TUNDOHEN
BURRAT
E MIRË**

VERSIONI I PËRDITËSUAR

BILL PERKINS



 **ZONDERVAN™**



eBooks for download
east.om.org/ebooks



Published by arrangement with The Zondervan Corporation L.L.C., a division of HarperCollins Christian Publishing, Inc., under the original English title *When Good Men Are Tempted* by Bill Perkins.

Copyright © 2015 by OM EAST for the Albanian edition. Translated by permission. All rights reserved.

Graphics & Layout: OM EAST



Kur tundohen burrat e mirë

Copyright © 1997, 2007 nga Bill Perkins

Kërkesat për informacion duhet t'i drejtohen:
Zondervan, Grand Rapids, Michigan 49530

Të dhënat e Librarisë së Kongresit

Perkins, Bill, 1949 -

Kur tundohen burrat e mirë/Bill Perkins. Botim i përditësuar

Përfshin referenca bibliografike.

ISBN: 978-0-310-27434-6

1. Bashkëshortët: sjellja seksuale. 2. Bashkëshortët: jeta fetare. 3. Epshi: aspektet fetare – krishterimi. 4. Seksi: aspektet fetare – krishterimi. 5. Seksi në martesë. 6. Udhëzime seksuale për meshkujt.

Botuar në bashkëpunim me agjensinë letrare të Wolgemuth & Associates, Inc. Tërë citimet nga Shkrimi janë marrë nga Bibla, “Diodatti i Ri” (1991-1994). Përdorur me leje. Të gjithë të drejtat janë të rezervuara.

Adresat e internetit (faqet e internetit, blogjet, etj.) dhe numrat e telefonit të shtypura në këtë libër ju janë ofruar si burime. Këto nuk janë ose nënkuptojnë një mbishkrim nga ana e Zondervan-it, gjithashtu nuk garantojmë përmbajtjen e këtyre faqeve dhe numrave gjatë ekzistencës së këtij libri.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem kompjuterik apo transmetohet në ndonjë formë apo mënyrë: elektronike, mekanike, fotokopje, regjistrimi apo në ndonjë tjetër, përveç citimeve të shkurtra në shqyrtime të shtypura, pa leje paraprake nga botuesi.

*Kushtuar Poll Sonders
dhe Fill Shafër*

Ju jeni burra dhe miq të mirë.

Përmbajtja

Hyrje: Një rast vjedhjeje identiteti	9
PJESA E PARË BETEJA.....	13
1. Pse qentë e zhveshur duken aq të veshur?	15
2. Pse gratë e zhveshura duken aq të mira?	23
3. Pse gratë e tjera duken më të mira?	37
4. Fuqia e seksit e mbushur me tabu	53
5. Drithërima e dashurisë së re.....	65
PJESA E DYTË PRANIMI I BETEJËS.....	75
6. Sa i madh është problemi yt?	77
7. Tri mënyra se si mund të humbësh betejën	87
8. Zvarritu në shpellë dhe nxirr ariun jashtë	95
9. Rrok hirin e Perëndisë	105
PJESA E TRETË GJETJA E LIRISË	121
10. Llogaritja e kostos	123

11. Zgjidh pronarin tënd.	133
12. Zbulo veten tënde të re.	145
13. Katër hapa drejt lirisë.	153
14. Ruaj mendimet e tua.	165
15. Prish ciklin e tundimit.	177

PJESA E KATËR TË

JETOSH I LIRË PËR PJESËN TJETËR TË JETËS. 189

16. Katër fazat e miqësisë.	191
17. Çfarë duhet të kërkosh nga një mik?	203
18. Vetëm për burrat e martuar.	217
19. Fjala M.	233
20. Vetëm për gratë.	239
21. Mjete për situata të vështira.	245
22. Një histori (shumë e shkurtër) përfundimtare.	259
Falënderime.	262

Hyrje:

Një rast vjedhjeje identiteti

Rreth pesë vjet më parë një miku im, Dr. Xhastin O’Brajen, ishte në zyrën time dhe më tregoi një nga historitë më rrëqethëse që kisha dëgjuar ndonjëherë.

“Xhon Xhons është një njeri i keq” – tha ai. “Por kur e takova për herë të parë, mendova se ishte një engjëll që do të na ndihmonte mua dhe gruan time, kirurge edhe ajo, të gjenim burimet që na duheshin për të gjetur një kurë për SIDA-n”.

“SIDA-n?”.

“Po” – tha ai. “Ka shumë gjëra politike që ndodhin mbrapa skene, gjëra për të cilat publiku nuk di asgjë. Por unë besoja, dhe ende besoj, që një shkencëtar që njihja, ishte afër zbulimit të një kure. Ai kishte nevojë për para dhe më rekrutoi ta ndihmoja t’i gjente”.

“Dhe këtu hyn në skenë Xhonsi?” – pyeta.

“Po. Ai më ngjalli interes duke përshkruar pasurinë e familjes së tij. Gjithashtu përmendi miq personalë; e kam fjalën për njerëz të njohur në arenën ndërkombëtare. Ai më siguroi se ata do të ishin të interesuar të dhuronin për këtë kauzë”.

“A nuk dyshove?” – pyeta.

“Patjetër” – tha ai. “Prandaj pajtova një ish-agjent të FBI-së për të

kontrolluar të kaluarën e tij.”

“Dhe...?”

“Ai më tha që ky njeri ishte krejt i pastër dhe jashtëzakonisht i pasur”.

“Atëherë çfarë ndodhi?”

“Ai më vodhi me mashtrim. Dhe kur kishte mbaruar punë, gruaja ime dhe unë kishim humbur shtëpitë, makinat, jahtin, reputacionin si kredimarrës, kursimet dhe investimet. Bill, nuk kisha para të bleja as një çyrek bukë”.

“Po tani çfarë po ndodh?” – pyeta.

“Ai është gati për të marrë dënimin dhe do të doja të vije me mua në seancën gjyqësore”.

Në 23 mars 2002, Xhon Robert Xhons, ose Xhorxh Robert Xhons u dënua me dhjetë vjet në burgun federal për krime të shumta, duke përfshirë këtu mbajtjen e një arme zjarri, mashtrim me postën ndërshtetërore, mashtrim financiar, vjedhje dhe përvetësim të pasurisë së tjetrit. Xhon Robert Xhons i vodhi identitetin mikut tim Dr. Xhastin O’Brajen dhe pothuajse gjithçka që ai zotëronte.

Kur po e shihja tek çapitej për të dalë nga salla e gjyqit me këmbët të lidhura me zinxhirë, Xhonsi u kthye nga ne dhe buzëqeshi. “Shihemi në ferr” – i bërtiti që nga ana tjetër e sallës mikut tim. “Do dal. Do ta shohësh. Do të dal”.

Ndërsa mua më kaloi një drithërimë, miku im u kthye nga unë dhe tha: “Do ta mbajë premtimin. Do ta shohësh. Dhe po nuk e mbajti, do të vazhdojë të vjedhë nga të tjerë njerëz që nuk dyshojnë që nga mbrapa mureve të burgut. Vetëm një kompjuter i duhet”.

Nuk më hiqet nga mendja se sa ngjante Xhonsi me çdo njeri tjetër. Megjithatë, ai e kishte mashtruar aq keq mikun tim, sa që atij iu deshën vite për ta rimarrë identitetin e tij si edhe pasurinë e humbur.

Shpesh kur një burrë bie në një mëkat seksual, mendon se çështja thelbësore ka të bëjë me sjelljen. Ai i thotë vetes: *Sikur të ndaloja së flirtuari me femrat ose së lundruari në Internet, do të isha mirë.*

Ekziston një kuptim në të cilin problemi *ka të bëjë me problemin e*

sjelljes, por nuk është kjo çështja thelbësore. Çështja rrënjësore është vjedhja e identitetit.

Kur një burrë i beson Krishtit si Shpëtimtari i tij, Perëndia e bën atë një burrë të ri, një burrë të mirë, në Krishtin. Identiteti që i jepet një burri është kaq i ri sa që e frymëzoi apostullin Pal të shkruante: “Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja” (2 Kor. 5:17). Ky ndryshim është më radikal se ai që e transformon një larvë në një flutur. Ne që e njohim Krishtin jemi nga natyra bij të Perëndisë.

Megjithatë, edhe pse jemi burra të rinj në Krishtin, ne ende na duhet të luftojmë me orekset epshore që banojnë brenda nesh. Këto nuk janë hequr dhe as janë ndryshuar, por ato nuk na përkufizojnë ne. Problemi është që për një pjesë të madhe të jetës sonë ato orekse kanë patur hyrje të lirë në mendjet tona duke ushtruar kontroll mbi mendimet dhe veprimet tona dhe gjatë asaj stine të jetës sonë identiteti ynë përkufizohet nga ato mendime dhe veprime të këqija. Ne e shikojmë veten si burra epshore që kënaqeshim në ushqyerjen e orekseve tona seksuale në çdo mënyrë që dëshironim – ose të paktën kënaqeshim duke fantazuar për këtë lloj sjelljeje.

Nëse si burra të rinj ne i lejojmë ato dëshira epshore të ushtrojnë kontroll mbi mendjet tona, ne përsëri do ta shohim veten jo si burra të rinj në Krishtin, por si burra të shtyrë dhe të kontrolluar nga orekset tona seksuale. Në një farë kuptimi epshi ynë mëkatar do të na ketë vjedhur identitetin.

Një mendësi dhe sjellje e tillë nuk përputhet në karakter me identitetin tonë të ri. Në Krishtin ti je vërtet një burrë i ri dhe një burrë i mirë. Por burrat e mirë tundohen – dhe është thelbësore të dish se si të reagosh kur përballësh me tundimin.

Ky libër nuk bazohet në besimin që nëse ti ke mendimet e duhura dhe shikon në vendet e duhura do të bësh një jetë të pastër. Ai bazohet në idenë që ndërsa kupton se cili je në Krishtin, nuk do ta lejosh epshin të të vjedhë identitetin dhe të të kontrollojë sjelljen. Vërtet, ndërsa kupton identitetin tënd të ri dhe të vërtetë, Perëndia do të të japë fuqinë të jetosh

në një mënyrë që shpreh veten tënde të vërtetë.

Ky koncept është kaq radikal, kaq revolucionar, kaq jetë-ndryshues, saqë po të pushtoi mendjen dhe shpirtin, nuk do të jesh më kurrë i njëjti. Ti po nis një udhëtim që do të të çlirojë përgjithmonë nga vjedhja më e keqe e identitetit dhe do të të çlirojë për të jetuar si një bir i Perëndisë.

PJESA E PARË

BETEJA

1.

Pse qentë e zhveshur duken aq të veshur?

Ky libër lindi në një natë të nxehtë të premtjeje në Teksasin e Jugut ndërsa po ndizja sistemin e spërkatjes së barit. Për shkak të një thatësire të zgjatur, bashkia lejonte ujitjen e barit vetëm midis mesnatës dhe orës gjastë të mëngjesit. Për mua nuk ishte problem se rrija vonë natën.

Ndërsa po ecja në oborrin e pasëm, vura re që dritat e fqinjëve ishin ndezur. Kureshtar se pse ishin zgjuar aq vonë, iu afrova gardhit dhe pashë përmes të çarave. Prisja të shihja një grup njerëzish duke luajtur me letra në shtëpi. Ose të paktën m'u mbush mendja të prisja e të shihja. Por pashë një brune të re e të bukur duke folur në telefon. Kjo nuk do të ishte ndonjë gjë e madhe po që se ajo do të kishte qenë e veshur. Por nuk ishte.

Menjëherë sytë e mi u mbërthyen tek ajo. Adrenalina më vërshoi në trup.

Në atë çast mendja më shkoi tek nata kur po luaja në lisharëse në oborrin e pasmë të shtëpisë ku u rrita në Rosuell, Nju Meksiko. Ndërsa lëkundesha poshtë e lart, në të djathtën time pashë dritën e dhomës së motrës së madhe që u ndez. Pak më vonë një nga shoqet e saj të shkollës

së mesme, me trupin e një perëndeshe, u zhvesh para dritares. Në atë kohë mendova se isha shumë fatlum.

Por atë natë të ngrohtë në Teksas nuk isha fëmijë. Isha një pastor tridhjetë vjeçar, me një grua si yll, një djalë ...dhe...dhe...dhe thashë me vete: *Çfarë po bëj?*

Pasi e sodita për disa sekonda, u largova nga gardhi. Mirë, mund të kishin qenë më shumë se disa sekonda. Por nuk ishte një minutë... patjetër jo një minutë. Nejse, ndërsa po largohesha, u ndjeva i dehur nga bukuria spektakolare e trupit të zhveshur të asaj femre. Dhe nuk mund të mos pyesja veten se pse më ndikonte në atë mënyrë forma e një femre nudo.

Që nga kjo ngjarje kam folur para mijëra burrave në të gjithë botën dhe kam folur personalisht me qindra të tjerë. Kam bërë anketa konfidenciale për të parë se çfarë mendojnë dhe bëjnë burrat. Gjatë këtij procesi kam zbuluar diçka që pa dyshim nuk do t'ju habitë, pra, çdo burrë, i krishterë ose jo, është në betejë personale me epshin.

Ata që e mohojnë praninë e kësaj beteje ose gënjejnë veten ose gënjejnë të tjerët. Ose mund të jenë duke vdekur dhe janë aq keq sa që nuk iu shkon mendja për seks. Por edhe në prag të vdekjes, burrat mund ta kenë mendjen tek seksi. Babai im tetëdhjetë e shtatë vjeçar po fliste për seksin vetëm disa orë para se të vdiste nga pneumonia.

Ajo që dua të them është kjo: nëse je burrë, je krijuar në mënyrë të tillë që të kënaqesh me bukurinë e një gruaje, dhe kjo kënaqje mund ta çojë mendjen dhe trupin tënd në disa vende mëkatore me pasoja të rënda. Dhe kam dyshime që ti po e lexon këtë libër sepse je zënë në kurth në një vend mëkatar dhe do të dalësh ose do një hartë që të orientohesh për të mos shkuar atje. Përpara se të të jap një ndihmë të tillë, dua të flas pak për pyetjen që ngrita natën që pashë atë brunen siç e kishte bërë nëna. Me një fjalë: pse duken aq të këndshme gratë e zhveshura?

Në të vërtetë e shkrova këtë kapitull dhe atë pas këtij pasi kisha mbaruar pjesën tjetër të librit. Ndërsa po kënaqesha me mendimin që kisha shkruar rreshtin e fundit të paragrafit të fundit, më erdhi një mendim. Sa më shumë e bluaja atë mendim, aq më shumë më shqetësonte.

Mendimi erdhi nga vëzhgimi im që shumë burra të krishterë, ndoshta edhe ti vetë, mendojnë se është mëkat të kënaqesh me pamjen e një gruaje të bukur.

Një mendim i tillë përforcohet nga shkrimtarë dhe ekspertë të krishterë të cilët, në përpjekje për t'u bërë thirrje burrave për pastërti seksuale, qortojnë jo vetëm kurorëshkeljen dhe masturbimin e nxitur nga pornografia, por edhe aktin e marrjes së kënaqësisë nga bukuria e një gruaje.

Sapo mbarova së lexuari një libër të njohur të shkruar për të ndihmuar burrat e krishterë që të bëjnë jetë të pastër seksuale. Megjithëse libri jep mendime të dobishme dhe sugjerime praktike, autori të lë përshtypjen që sa herë një burrë kënaqet duke parë një grua – ai dukej se po nënkuptonte çdo grua në çdo situatë – përveç gruas së tij, ka kryer kurorëshkelje, ose të paktën para-kurorëshkelje në zemrën e tij. Në thelb, ai duket se ngul këmbë se magnetizmi që ndjen një burrë për një grua të bukur e cila nuk është gruaja e tij gjithmonë nxitet nga epshi seksual dhe e ushqen atë. Me standarde të tilla kaq supershpirtërore dhe krejt të pamundura, a është për t'u habitur që kaq shumë burra të krishterë jetojnë nën një barrë dështimi dhe faji?

Unë jam i bindur se aftësia jote për t'u kënaqur me bukurinë e një gruaje është dhuratë nga Perëndia. Kjo nuk do të thotë që Perëndia e miraton kullotjen e syve në pornografinë e internetit ose në ijët vërtitëse të vajzave gjysmë të zhveshura që kërcëjnë gjatë një reklame birre. Gjithashtu nuk është mirë të shikosh reklamat e veshjeve të brendshme të femrave në gazetën e ditës, gjë e cila ka qenë një pikëhyrje rituale për mua. Por nuk e pranoj idenë që nëse shëtit në park dhe të kalon afër një vajzë yll është e gabuar të vësh re bukurinë e saj dhe ta shijosh. A do të ishte në rregull ta ndiqje me bishtin e syrit? Apo ta ndiqje pas që të vazhdoje të “shijojë” bukurinë e saj?

Hëmmm... a ke nevojë që t'i përgjigjem unë kësaj pyetjeje? Hajde tani... ti e di ndryshimin midis vështrimit kalimtar të një vajze të bukur dhe ndezjes së videos tënde vizuale dhe kapjes së çdo lëvizjeje të saj për referencë të mëvonshme. Çështja kryesore është që ti të kënaqesh

me bukurinë e një gruaje pa e komprometuar karakterin tënd dhe pa përdorur bukurinë e saj për të ushqyer epshin tënd.

“Në rregull” – mund të thuash ti – “po si ta arrij këtë?”.

Unë jam i bindur se hapi i parë në shtegun e pastërtisë seksuale përfshin të kuptuarit pse qentë e zhveshur duken aq të veshur – dhe më e rëndësishmja – pse femrat e zhveshura duken aq të këndshme. Pasi ta kemi kuptuar dhuratën e shenjtë që na ka dhënë Perëndia, do të kuptojmë pse duhet ta mbajmë atë si diçka të çmuar dhe ta ruajmë të pastër.

***Do të doja ta lartësoja magnetizmin që ndien kundrejt
femrave të bukura në vendin e shenjtë dhe të lartë që besoj se
kishte ndërmend Perëndia.***

Misteri i bukurisë së një gruaje

Kur e pashë për herë të parë trupin e gruas sime, kundrova diçka qiellore. Asgjë në mbarë krijimin nuk krahasohej me bukurinë e lakuriqësisë së saj. Duke qenë tip modest ajo nuk pranonte të rrinte zhveshur në apartamentin tonë... megjithëse i lutesha. Unë thjesht nuk ngopesha me bukurinë e saj të pashoqe të zhveshur. Më kujtohej që ndihesha se nuk duhej t’ia ngulja sytë. Por doja t’ia ngulja sytë.

Evolucionistët e zhveshin misterin nga bukuria e një gruaje. Ata na thonë që ne burrat jemi të tërhequr ndaj grave të zhveshura për shkak të përzgjedhjes natyrore. Ata arsyetojnë që nëse burrave nuk do t’iu dukeshin gratë tërheqëse, ata nuk do të ishin të prirur për t’u riprodhuar. Megjithëse kjo duket me kuptim, ajo nga ana tjetër e redukton magnetizmin seksual thjesht në një përvojë logjike dhe kafshërore. Por nuk është e tillë. Perëndia i krijoi burrat me orekse seksuale. Ai na ka krijuar në mënyrë të tillë që të tërhiqemi ndaj femrave.

Këtu ka më shumë sesa një programim rastësor evolucionar. Libri i Fjalëve të Urta flet për magnetizmin midis një burri dhe një gruaje. Aguri, i biri i Jakehut (disa nga hebrejntë e lashtë kishin emra të çuditshëm),

përshkruan katër gjëra tepër të mrekullueshme për t'i kuptuar. Njëra nga ato ishte mënyra si një burrë do një grua (Fjalët e Urta 30:19). Ai i urtë i lashtë nuk mundej ta deshifronte misterin e magnetizmit midis një burri dhe një gruaje.

Atëherë pra, pse duken aq këndshëm gratë e zhveshura? Përgjigjia mund t'ju zhgënjejë si fjalìa e fundit e një barsaleta shumë të gjatë dhe pa kripë. Sepse ka diçka në lidhje me korrentin që ndjejnë burrat kur shikojnë një grua të bukur që e sfidon të kuptuarit.

Në nivelin më të thellë askush nuk e kupton tërheqjen midis burrave dhe grave.

Është si puna e gjumit. E dinit ju që askush nuk e kupton plotësisht pse njerëzit kanë nevojë të flenë?¹ A nuk ju duket e çuditshme kjo? Studiuesit e kuptojnë çfarë ndodh kur flemë dhe çfarë ndodh kur rrimë pa gjumë. Por askush nuk e di saktësisht pse njerëzit kanë nevojë të flenë.

Në mënyrë të ngjashme, ne nuk e dimë pse gratë e zhveshura u duken kaq të këndshme burrave. Perëndia ka krijuar diçka të mrekullueshme për ty që e sfidon të kuptuarit. Nëse do të mund ta kuptoje si të ishte një formulë matematike tërheqjen që ndjen për një fytyrë dhe formë femërore, nuk do të kishte mister.

Prandaj, nëse dikush të pyet ndonjëherë: “Pse gratë e zhveshura duken kaq të këndshme?” – ti mund t'i përgjigjesh: “Nga ana metafizike ne nuk e dimë”. Kjo patjetër do ta lërë atë gojëhapur.

Pasi e kemi thënë këtë, ka aspekte të përgjigjes që janë po aq të thjeshta sa $2+2=4$. Për shembull, gratë e zhveshura janë të bukura sepse ne rrallë i shohim ato ashtu. E gjithë kjo ideja e lakuriqësisë është një qerasje e veçantë që Perëndia ua ka dhënë vetëm njerëzve. Kafshët, për

1. *Bazat e trurit: Të kuptojmë gjumin*. Ky është një artikull i marrë nga faqja e internetit: Instituti Kombëtar i Çrregullimeve dhe Goditjeve Neurologjike (Botimet NIH nr. 06-3440-c).

shembull, nuk mund të jenë të zhveshura.

Pse qentë e zhveshur duken aq të veshur?

Me kalimin e viteve kam patur disa qen. I fundit ishte një Danez i Madh, 80 kilogramësh. Kur e nxirrja shëtitje njerëzit komentnin për madhësinë e tij dhe më pyesnin për emrin.

“I Madh” – u thosha.

“I madh është” – më përgjigjeshin. “Si e ka emrin?”

“Vërtet i Madh” – u thosha duke i përkëdhelur kokën me dorën e djathtë.

Disi të bezdisur, më pyesnin sërish për emrin.

Në atë kohë mua më kishte kapur e qeshura dhe shpjegoja: “Ky është emri i tij, *I Madh*”.

I vura atë emër sepse i prisja biseda të tilla.

Është e habitshme sa shpejt u lidha me atë Danez të Madh. Në ke qen, ti e kupton se si ata bëhen pjesë e familjes. Ata udhëtojnë në makinë me ne, flenë me ne (I Madhi, jo për atë punë). U flasim sikur të na kuptonin. Me raste djemtë e mi e vishnin Të Madhin me rroba. I vishnin pantallona të shkurtra të kuqe në këmbët e pasme dhe një bluzë të bardhë në këmbët e përparme. I vinin edhe një kapele në kokë dhe syze dielli mbi hundë.

I Madhi dukej i lezetshëm me rroba – ose më mirë të themi qesharak – por e vërteta është se ai nuk kishte nevojë për pantallona e bluzë. Pse? Sepse edhe pa ato ai nuk ishte i zhveshur. Asnjë kafshë nuk konsiderohet ndonjëherë e zhveshur. Mendoje pak. Ke parë ndonjëherë ndonjë qen në rrugë pa pantallona e bluzë dhe ke pyetur veten pse nuk ishte veshur? Patjetër që jo! Dhe asnjë polic nuk i ka vënë gjobë për ekspozim të turpshëm të vetes.

Asgjë nuk mund të jetë e zhveshur në të njëjtin kuptim siç janë të zhveshur njerëzit. As pemët, as gurët, as qentë, as delfinët. Si burra ne nuk jemi kureshtarë për lakuriqësinë e një kafshe apo bime. E si mund të jemi? Ato nuk mund të jenë të zhveshura. Cili burrë ka kërkuar në Internet për foto të qenve të zhveshur? (Po të njihni njeri, mos ma

thoni.) Gratë mund të jenë të zhveshura. Megjithatë janë rrallë. Gratë që shikojmë çdo ditë në punë dhe në komunitetet tona janë të gjitha të veshura. Një grua e zhveshur zbulon atë që është pothuajse gjithmonë e fshehur nga sytë e mashkullit: bukurinë e trupit të saj.

Komediani dhe personaliteti i televizionit Tim Allen ka thënë që nuk do të harrojë kurrë herën e parë që pa një foto të një gruaje të zhveshur. Ai tha: “Në një farë mënyre fotoja ishte si frikësuese ashtu edhe bindëse. Kuptova për herë të parë që, edhe pse duket idiote, tërë gratë janë të zhveshura poshtë rrobave të tyre.... Ky zbulim bëri që të mos kisha më kurrë besim të gratë: ato po e fshehin këtë! Ato e kanë këtë fuqi dhe unë as që e dija. Është poshtë rrobave të tyre!”².

Allan ngre një çështje që shumica e njerëzve arrin ta identifikojë; pra, si mund të ecin gratë çdo ditë dhe të fshehin diçka kaq të mrekullueshme? Dhe si mund të pretendojnë që nuk e dinë se çfarë po bëjnë? Më duken komentet e tij të këndshme dhe të dobishme. Të këndshme sepse shprehin aq hapur atë që shumë burra ndjejnë, por nuk e thonë kurrë; të paktën nuk e shprehin me shkrim. Të dobishme sepse zbulojnë një pjesë të arsyes se pse gratë e zhveshura duken aq të mira: burrat duan të shohin diçka të bukur që u është fshehur.

Faqet e para të Biblës na japin një depërtim shtesë në misterin e tërheqjes së gruas. Në kapitullin e ardhshëm do të shqyrtojmë se pse i bëri Perëndia gratë e zhveshura të duken aq të mira.

2. Tim Allen, *Mos i rri shumë afër një burri të zhveshur* (Nju Jork: Hyperion, 1994), f. 53-54.

PËR DISKUTIM

1. A e mban mend herën e parë që ke parë një grua të zhveshur, qoftë personalisht qoftë në foto? Çfarë ndikimi pati? A e ke ndërmend akoma atë imazh? Nëse po, çfarë do të thotë?
2. Si e zvogëlojnë magnetizimin seksual evolucionistët në një përvojë tërësisht kafshërore? Cili është problemi me një pikëpamje të tillë?
3. Fjalët e Urta 30:18-19 thotë:

*Ka tri gjëra tepër të mrekullueshme për mua,
madje katër, që unë nuk i marr vesh:
gjurma e shqiponjës në ajër,
gjurma e gjarpërit mbi shkëmb,
gjurma e anijes në mes të detit
dhe gjurma e burrit me një vajzë.*

Çfarë mësojmë rreth tërheqjes midis burrit dhe gruas nga këto vargje?

4. Në ç'mënyrë është unike lakuriqësia për njerëzit? Si i ndikon njerëzit fakti që gratë janë zakonisht të veshura? Pse?
5. Si mendon: çfarë besojnë shumica e burrave rreth mënyrës se si mendon Perëndia për tërheqjen seksuale të burrave për gratë? Çfarë të flet kjo ty rreth pikëpamjes së tyre të Perëndisë? A mendon se ata e konsiderojnë Perëndinë në atë mënyrë?

2.

Pse gratë e zhveshura duken aq të mira?

Ndërsa qëndroj në një librari në aeroportin O'Her të Çikagos, sytë e mi shikojnë me ëndje kopertinën e botimit më të fundit të një reviste sporti të cilën e lexoj rrallë. Por më tërhoqi vëmendjen kapaku i revistës *Sporti i ilustruar*. Aty shfaqej fytyra dhe figura e një femre që kishte fituar garën vjetore. Shikoj tinëz anëmbanë duke u siguruar që nuk ka ndonjë klient tjetër, me shpresën që askush nuk po më shikon. Nuk do të doja që dikush që njihja të më shikonte duke marrë këtë botim të revistës *Sporti i ilustruar*.

Po ta keni gjetur, isha duke parë botimin e Qeni më i shëmtuar i Sportit të ilustruar. Çdo vit ai botim i revistës arrin shitjet më të larta. Burrat e blejnë jo vetëm se dëshirojnë figurën banale të kapakut, por ngaqë ata e dinë që revista është e mbushur me foto të qenve të tjerë të shëmtuar që veshin rroba banjo shumë të holla, duke u shtrirë me sensualitet në plazhet ranore të Karaibeve.

Sikur figurat që ma bëjnë me sy në televizor që më ndezin e joshin nga monitori i kompjuterit tim të ishin qenj. Siç e përmenda në kapitullin e mëparshëm, burrat nuk kërkojnë në internet për figura të qenve të

zhveshur. Jo... nuk është kurrë një qen që më tërheq nga një kapak reviste në librari. Pse? Sepse reklamuesit e dinë që qentë janë të mirë për të shitur ushqim për qenj, zinxhirë dhe gardhe pa fije. Por një garë e qenit më të shëmtuar apo madje gara e qenit më të mirë, nuk është arsyeja për shitjen e revistës Sporti i ilustruar. Asgjë tjetër nuk tërheq burrat pas një resiste, ekрани argjendi apo makine faksi se sa prania e një gruaje të bukur.

Disa meshkuj të krishterë nuk e pëlqejnë këtë të vërtetë për veten e tyre. Apo mendon se duhet të mos e pëlqejnë. Megjithatë Perëndia i krijoi gratë që të jenë tërheqëse. A e kuptove? Të lutem lexoje fjalinë në vijim me zë të lartë: *Perëndia i krijoi gratë që të jenë tërheqëse në sytë e mi*. Ajo tërheqje e shenjtë duhet të ngrihet në vendin e saj të duhur. Kjo përfshin kuptimin e gjashtë arsyeve se pse Perëndia i bëri gratë e zhveshura të duken aq të mira.

ARSYEJA E PARË: Për të zëvendësuar vetminë me shoqërinë

Çastin që pashë Sintia Rasëll u shkrija. U shkrija si një copë çokollatë nën diell, u përhap në tavolinë dhe rrodha në dysheme. Në një farë mënyrë arrita të marr formën që kisha para shkrirjes. U ula në tavolinë me zemrën që më rrihte, duke shpresuar të shikoja sytë e saj ngjyrë kafe që shkëlqenin.

Në kohën e ngrënies mendoja për ushqimin e saj të preferuar. Natën ëndërroja për të. Kur shkoja në shkollë ndihesha nervoz duke menduar për të. Në klasë nuk i fola një fjalë. Në praninë e Sintias së re nofulla ngrinte në vend që ta bënte gjuhën të lëvizshme si një... të lëvizshme si një gjuhë akulli. Megjithatë gdhenda një zemër në tavolinë me një shigjetë që e përshkonte dhe me mbishkrimin R+S (përdorja zakonisht emrin tim të dytë, Rendi apo Rendolf).

Që në çastin që pashë atë vajzë me fytyrë engjëjlore në klasë të parë e dija që jeta ime nuk do të ishte e plotë derisa të martohesha me të. Sigurisht, bashkimi ynë nuk do të ishte i tillë. Por që nga ajo kohë ndjeva një boshllëk në zemër që vetëm vajza e ëndrrave të mia do ta

mbushte një ditë.

Adami nuk ka kaluar një përvojë të tillë për të kuptuar se kishte nevojë për një shoqe. Ai jetoi pa vetëdijen e vetmisë së tij, për shkak se nuk u rrit i rrethuar nga vajza të vogla tërheqëse. Ai nuk shkoi në gjimnaz apo kolegji ku shumica e djemve kanë të dashura. Meqë nuk ishte mësuar me shoqërinë e vajzave, ai as mund të shkruante as vlerësonte agoninë e një zemre të vetmuar siç shprehet në muzikën perëndimore kantri.

Gjithsesi, pas çdo dite krijuese, Perëndia pa atë që kishte bërë dhe shpalli: “Është e mirë”. Pas ditës së gjashtë e të fundit, gjatë të cilës bëri Adamin, Perëndia shpalli që vepra e tij ishte “shumë e mirë” (Zanafilla 1:31).

Por kur Perëndia pa që Adami ishte vetëm, ai tha se “nuk ishte mirë” (Zanafilla 2:18). Zoti vendosi pastaj të bënte një ndihmesë të leverdisshme apo që i përshtatej Adamit: një ndihmesë që do ta plotësonte.

Para se Perëndia të bënte këtë, Adami duhet të kuptonte nevojën e tij. Për të realizuar këtë, Perëndia bëri që t’i vinte emër çdo kafshe. Ditë pas dite, muaj pas muaji, kafshët, mashkull e femër, kalonin para Adamit dhe ai u vinte emra. Në fund ai kuptoi që asnjë kafshë nuk i korrespondonte atij. Perëndia ndërhyu sapo Adami kuptoi gjendjen “jo të mirë” të vetmisë. Ai bëri që Adami të binte në gjumë dhe kreu aktin e parë të kirurgjisë. Ai mori një brinjë nga Adami dhe bëri me porosi një shoqe për të.

Perëndia siguroi që sytë, buzët, flokët, gjoksin, kofshët, këmbët, krahët dhe duart të bëheshin ashtu siç donte dhe kishte nevojë Adami. Ashtu si një lëng që mbush gotën, ajo do të boshatiste botën e tij të vetmisë: një vetmi që as prania e Perëndisë nuk mund ta hiqte (ky është një mendim i thellë).

Perëndia, kur mbaroi kryeveprën e tij, e vuri në drejtim të Adamit dhe u zhduk pa u ndjerë. Ndërkohë Adami çohet, fërkon sytë, u çua më këmbë dhe endej përmes kopshtit duke kërkuar një kafshë që nuk kishte emër.

Papritur ajo qëndroi para tij. Pas shumë vitesh kur nuk mund të fliste

me dikë (po flas për një qenie njerëzore këtu dhe jo Perëndinë), të ecte, të qeshte, të ëndërronte, të mbante, të bënte dashuri, Adami vuri re ajkën e krijimit të Perëndisë. Çdo grua do të zbehej para përsosurisë së tij. Ajo ishte pa të meta fizikisht, frymërisht, emocionalisht, psikologjikisht dhe mendërisht. Ajo kishte gjithçka për të cilën kishte nevojë Adami tek një person tjetër. Dhe ajo nuk kishte barra nga lidhje të shkuara. Asnjë hidhësi brejtëse. Asnjë mbresë të shëmtuar. Asnjë keqardhje. Asnjë pritshmëri egoiste. Asnjë borxh te karta e kreditit.

A të jep kjo një ide se pse tërhiqesh ndaj grave të bukura? Ato janë kryevepra e krijimit të Perëndisë të bëra për të zëvendësuar vetminë tënde me shoqërinë e përsosur. Por ato janë edhe diçka tjetër. Një grua plotëson atë që të mungon ty.

ARSYEJA E DYTË: Për të të plotësuar

Perëndia, për të krijuar Evën, mori një brinjë nga Adami. Kur Perëndia i çoi Evën Adamit, ky mori një version të ri e të përmirësuar të asaj që kishte humbur. Pa Evën Adami ishte një Porsh i kuq pa motor apo një avion pa karburant. Ai dukej mirë nga jashtë, por i mungonte diçka. Kur Adami takoi Evën, ai u vu ballë për ballë, gjoks më gjoks, kofshë më kofshë, me pjesën e vet që i mungonte.

Ndërsa Bibla nuk e thotë këtë, mendoj se bukuria e trupit të një gruaje është e lidhur me kërkimin e burrit për plotësi. Në nivelin më të thellë të nënndërgjegjjes së burrit, a ekziston një pjesë e tij që dëshiron të gjejë atë që do ta bëjë atë të plotë? A po kërkojmë atë pjesë që është marrë prej nesh? A po kërkojmë atë pa të cilën do të mund të ndihemi përgjithmonë jo të plotë?

Nuk dua të them me këtë që beqarët nuk mund të gjejnë plotësi. Mbi të gjitha Jezusi ishte beqar dhe jeta e tij ishte e mbushur. Por shumica e beqarëve kanë mësuar të jetojnë me atë që është shpesh një rast i butë i vetmisë, një ndjenjë që ata jetojnë vetëm, që atyre u mungon diçka apo dikush: diçka apo dikush për të cilin janë mësuar të jetojnë edhe pa të.

Mendoj që për burrat ajo ndjenjë vetmie apo mungese është një

nevojë figurative për të gjetur brinjën që u mungon, një nevojë për të zbuluar personin që do t'i bëjë të plotë.

*Në çastin që burri vështron
bukurinë e zhveshur të një gruaje,
ai përjeton,
për një sekondë,
shpresën e të qenit i plotësuar.*

Perëndia i bëri gratë e zhveshura të bukura duke i krijuar për të na plotësuar. Si mund të mos ndihemi të tërhequr si magnet nga ajo që ka fuqinë për të plotësuar atë që mungon në jetën tonë?

ARSYEJA E TRETË: **Në mënyrë që të hysh në lavdinë e saj**

Mike Mason, në librin e tij *Misteri i martesës*, tregon se si trupi i njeriut “zotëron një lavdi që është unike në mbarë botën”¹. Me lavdi ai nënkuptonte “bukurinë frymëzuese”. Trupat tanë, në një farë kuptimi, zbulojnë se kush jemi. Ata janë shprehja fizike e shpirtit dhe frymës sonë. Trupi i një gruaje është më tepër se sa lëkura, kockat, gjaku dhe flokët. Këto janë veli i personit të saj. Çfarë mendimi interesant!

Disa herë në Dhiatën e Vjetër shikojmë se si Perëndia zbulohet me një shfaqje fizike. Ai e bëri këtë kur iu shfaq për herë të parë Moisiut në malin Sinai në një shkurre. Më pas iu shfaq Moisiut dhe izraelitëve në malin Sinai si një re e dendur e mbushur me vetëtimë. Lavdia e Perëndisë ishte aq e madhe në malin Sinai sa që fytyra e Moisiut vezullonte pasi kishte qenë në praninë e lavdisë së Perëndisë.

Teologët iu referohen këtyre shfaqjeve të Perëndisë si “lavdi vezulluese”. Ato zbulojnë fuqinë dhe bukurinë e Perëndisë. Besoj se trupat tanë fizikë kanë lavdinë e tyre vezulluese. Është një bukuri që në

1. Mike Mason, *Misteri i martesës* (Portland: Multnomah, 1985), f. 115.

një farë mënyre na zbulon si kryevepra e krijimit të Perëndisë². Si burra ne nuk lodhemi kurrë së pari bukurinë e një gruaje. Duket sikur duam ta shohim nga çdo kënd dhe, ashtu si Moisiu në mal, futemi në lavdinë e saj. Më e bukura është se pasi burri futet në lavdinë e një gruaje, edhe fytyra e tij ndriçon.

ARSYEJA E KATËRT: Për të të dhënë intimitet

Nuk e di ti, por jam zhveshur para shumë grave. Kur isha në kolegji, para se të takohesha me Sindin, e cila do të bëhej më pas gruaja ime, u zhvesha me sa më shumë shoqe të bukura studente të mundja. E kujtoj me keqardhje atë periudhë të jetës time gjatë së cilës humba balastin frymëror. Por edhe pa një miqësi gjithnjë e në rritje me Krishtin, lakuriqësia nuk ishte kurrë një gjë rastësore për mua. Nëse një vajzë hiqte rrobat në praninë time dhe unë hiqja të mijat, nuk ishte për të krahasuar tatuazhet me njëri-tjetrin.

E vërteta është se lakuriqësia presupozon intimitetin. Presupozon që personi që zhvishet para teje, ka besim te ty. Ato janë gati të lejojnë që të shohësh bukurinë e tyre dhe difektet e tyre. Ne e bëjmë këtë me njerëzit të cilët kemi besim se do të na duan dhe pranojnë: gërvishtjet, lythet, nishanet, lëkurën e qullët, rrudhat, këmbët e thata, kokën pa flokë dhe gjithë të tjerat.

Adami dhe Eva e kishin një intimitet të tillë. Pasi Perëndia i bashkoi: “Njeriu e gruaja e tij ishin që të dy lakuriq dhe nuk kishin turp prej kësaj”. Lakuriqësia e tyre fizike portretizonte lakuriqësinë që ekzistonte në një nivel më të thellë: një nivel frymëror dhe emocional. Adami dhe Eva ishin intim në çdo kuptim të fjalës.

Edhe pse burrat turpërohen nga intimiteti, ata e duan me çdo kusht. Problemi është se jemi programuar të besojmë se njerëzit e vërtetë janë të fortë, të vetëmjaftueshëm dhe të pavarur. Ndërsa tregojmë se jemi

2. Si më sipër, f. 114

të fortë dhe përpiqemi ta mbulojmë, brenda dëshirojmë për një lidhje intime në nivelin më të thellë. Besoj se gratë e zhveshura janë të bukura sepse lakuriqësia e tyre na thotë: “Jam këtu për ty. Jam e jotja. Jam zbuluar për sytë e ty”. Kjo fjali që nuk shqiptohet, apo që shqiptohet, i tregon një burri që ai është i sigurt. I tregon atij që dikush e do. I tregon atij se dikush dëshiron të jetë intim me të.

Diçka që më mërzit për vajzat e bukura, të cilat bëjnë paradë me trupat e tyre lakuriq para syve të padukshëm të internetit, është se japin një iluzion të intimitetit. Pasi fola një mbrëmje në një takim për burra, një mesoburrë m’u afrua dhe më pyeti: “Bill, a mendon se nuk ka problem që shikoj vajza të zhveshura në internet nëse besoj se një ditë do të martohem me të?”.

E pashë atë burrë dhe mendova: Si mund të jesh një person kaq i marrë? Pastaj i thashë: “Mund të të garantoj që asnjë prej atyre vajzave që po shikon, nuk ka për t’u martuar me ty. Motivi i tyre është paraja dhe vëmendja: jo intimiteti. Edhe sikur të donin, Perëndia nuk do që sytë e tu të shikojnë bukurinë e një trupi lakuriq të gruas derisa të bëhet gruaja jote”.

Megjithatë, për shkak se lakuriqësia komunikon një dëshirë për intimitet, këto vajza ushtrojnë një tërheqje të fuqishme për burrat: jo thjesht për shkak të formave të tyre, por për shkak të iluzionit të intimitetit që ofrojnë (do të flas për këtë më vonë).

***Ngaqë lakuriqësia presupozon intimitet,
shikimi i një gruaje lakuriq i jep burrave një
lidhje intime – edhe nëse është sipërfaqësore.***

Perëndia i bëri gratë e zhveshura tërheqëse për burrat duke na programuar në mënyrë të tillë që ta shohim lakuriqësinë si një ofertë intimiteti. Megjithatë, intimiteti i vërtetë mund të ndodhë vetëm në një kuadër të sigurit, në një ambient dashurie dhe besimi.

ARSYEJA E PESTË: Për të siguruar një shok loje seksual për ty

Ngaqë të krishterët i mëshojnë shumë pastërtisë seksuale, disa njerëz mendojnë se Perëndia nuk e miraton seksin... gjithçka që përfshin seksin. Kjo është arsyeja se pse disa njerëz çuditen kur mësojnë se Perëndia nuk krijoi thjesht burrat dhe gratë si krijesa seksuale: ai e bëri seksin për ta shijuar.

Në fakt Perëndia nuk të krijoi thjesht për të shijuar lojën me trupin e zhveshur të një gruaje, por krijoi sheshin ideal të lojës: martesën. Burrat dhe gratë që shkëmbejnë betimet martesore bëjnë një zotim për të patur intimitetin që presupozon lakuriqësia. Vetëm brenda martesës burri mund të shijojë plotësisht trupin e gruas së tij.

Salomoni me siguri e shijoi. Dhe ai nuk ngurroi të shprehte këtë kënaqësi. Në mes të Dhiatës së Vjetër ndodhet libri poetik i Kantikut të kantikëve. Libri përshkruan dashurinë midis Salomonit dhe gruas së tij. Gjuha është aq e mbushur me terma seksualë saqë për vite me radhë teologët preferonin të interpretonin librin në mënyrë figurative se sa të fjalëpërfjalshme. Ata, duke lejuar Salomonin të përfaqësonte Krishtin dhe nusen e tij të re, kishën, mund të shmangnin gjuhën seksuale. Por një interpretim i tillë nuk gjen mbështetje në tekst apo në pikëpamjen e lartë të Perëndisë për intimitetin seksual.

Një kopsht që të ënd

Miku im S. Krejg Glikmen, në librin e tij *Një këngë për të dashurit*, flet për çiftin: “Dashuria e tij konsumohet në një ndër skenat më të druajtura dhe delikate të dashurisë në letërsinë botërore”³. Nuk ka asgjë të ashpër apo të vrazhdë në të folurën e Salomonit. Përkundrazi, ai e krahason nusen e tij me një kopsht dhe burim (v. 12-15). Ai i referohet me dashuri virgjërisë së saj duke thënë se burimi është i kyçur dhe kopshti i mbyllur (v. 12). Askush tjetër nuk është futur në kopshtin e

3. S. Craig Glickman, *Një këngë për të dashurit* (Downers Grove, Ill.: InterVarsity, 1976), f. 21.

saj. Më në fund ka mbërritur nata për një vizitor. Salomoni gëzohet me aromën dhe shijen e dashurisë së saj.

Si përgjigje ndaj shprehjes së tij të kënaqësisë, ajo e fton të vijë në kopshtin e saj (v. 16). Para se të bëjë këtë atij i duket vetja i rrëmbyer nga bukuria e saj dhe e përshkruan me më hollësi. Kopshti i saj është si një parajsë frutash, lulesh, pemësh dhe erëzash aromatike⁴. Ashtu si do të pranonte çdo burrë që ka përjetuar intimitetin seksual me një grua, vendi më intim, ashtu siç vë re Salomoni, është një kopsht i kënaqësisë së madhe.

A është ajo gati për dashurinë e tij? Vërtetë. Salomoni shpalli se burimi i saj është bërë një “pus ujërash të freskëta” (v. 15). Ajo, e ndezur seksualisht, pranon të “hyjë në kopshtin e tij dhe të shijojë frutat e tij të zgjedhura” (v. 16). Shikoni! Nuk duhet një profesor në letërsi që të shpjegojë domethënien e gjuhës së Salomonit.

Një fjalë miratimi

Salomoni, pasi na lejon që të futemi në suitën e tij të muajit të mjaltit, na lejon të dëgjojmë fjalët përfundimtare që u shqiptuan atë natë. Për çudi ato nuk u shqiptuan nga Salomoni apo nusja e tij. Ato u shqiptuan nga Perëndia. Dhe si iu përgjigj krijuesi i bukurisë së gruas kënaqësisë që shijonte çifti? Ai tha: “Shokë, hani, pini; po, dehuni, o të dashur” (Kantiku i kantikëve 5:1).

Ai që i krijoi, burrë e grua, dha miratimin e përzemërt për mbrëmjen e tyre të kënaqësisë seksuale.

ARSYEJA E GJASHTË: Për të të siguar një kapistër seksuale

Perëndia pati si synim që akti i marrëdhënies seksuale të jetë ndër përvojat më të fuqishme dhe të kënaqshme të jetës. Në bashkimin e burrit dhe gruas, të dy bëhen “një mish i vetëm”. Trupat e tyre lidhen

4. Si më sipër, f. 24-25.

së bashku në tërë kuptimin e plotë të fjalës. Gjatë atyre çasteve të kënaqshme burri dhe gruaja bëhen të plotë. Ata janë një i vetëm. Dhe ndihesh mirë.

Ideali i Perëndisë është që ky bashkim të ndodhë brenda sigurisë së martesës. Ideali i Perëndisë që nga fillimi ishte që burri të qëndronte vetëm me një grua gjatë tërë jetës (Zanafilla 2:24). Ndërsa Perëndia bëri gratë e zhveshura të bukura për burrat, ai do që burri të shijojë lakuriqësinë e vetëm një gruaje: gruas së tij.

Pse? Pjesërisht ngaqë shtrati martesor na siguron mënyrën për të kënaqur dhe kontrolluar oreksin tonë seksual. Si krijesa të rëna ajo forcë e fuqishme, nëse nuk kontrollohet, mund të na shtyjë që të kërkojmë vetëkënaqësinë në çdo vend të keq. Asnjë burrë nuk duhet të harrojë që ai mban një kafshë grabitqare me një oreks të paepur. Dhe ndërsa ajo kafshë mund të flejë ndonjë herë, nuk do të reshtë kurrë së qeni e egër.

Kur ishte djalë, duke u rritur në Rosuell, Nju Meksiko, familja jonë kishte disa kuaj që i mbanin në katër hektarë tokë jashtë qytetit. Më herët im atë më mësoi shalën dhe kapistrën. Ndërsa shala më ndihmonte të qëndroja mbi kalë, kapistra më mundësonte të kontrolloja kafshën më mirë e më fort se sa vet unë.

Martesa është si ajo kapistër. Pa të pasionet tona do të dalin jashtë kontrolli: duke lënduar veten dhe të tjerët.

Dalja e kapistrës

Sigurisht, nëse martesat tona do të bëhen sheshi i lojës në të cilën ne shijojmë lakuriqësinë e gruas, ne duhet të tërhiqemi nga gratë tona. Disa vjet më parë po këshilloja një burrë që kishte pesë vjet që ishte martuar. Ai mburrej me gjendjen e tij fizike, dukjen dhe karrierën e tij të shpejtë.

Ndërsa u ulëm përballë njëri-tjetrit në një kafene, ai më tha: “Xhuli nuk më duket më tërheqëse. Ajo nuk më eksiton”.

“Pse po ma thua mua, shoku?” – e pyeta. “Duhet të vizitohesh tek okulisti. Ajo është shumë e bukur”. (E përdor fjalën “shoku” me miq të veçantë).

“Që nga lindja e Xhastinit gjoksi i saj është lëshuar. Dua që të bëjë

operacion gjoksin. Jo ta bëjë shumë të madh. Mbase numër katër”.

“Mua më duket i madh”.

“Ashtu mendon?”.

“Shiko, Xhezon, nuk do të kalojë shumë dhe trupat e ju të dyve do të tregojnë shenjat e plakjes. Nëse futesh në rutinën e kirurgjisë plastike, ajo do të përfundojë me një seri operacionesh të fytyrës, të barkut, të gjoksit dhe procedura lipozuksioni”.

“Po, ne po mendonim të bënim operacion barkun kur ishte në tavolinë. Shiko, ta rregullonim atë”.

“Xhezon” – i thashë. “Nuk po e kupton. Nuk po arsyeton siç duhet”.

“Pse?” – pyeti ai, duke më dhënë leje t’i tregoja atë që kisha për t’i thënë.

“Magnetizmi i një magneti nuk mbështetet në dukjen fizike të magnetit, por në përbërjen e tij. Ajo që ndodhet brenda bën që polet e kundërta të tërhiqen”.

Xhezonit nuk i interesonte. Gruaja e tij bëri operacion gjoksin dhe pastaj ai u ankua se gjoksi i saj nuk “dukej” mirë. Dëgjo, kur një burrë dhe një grua nuk janë më të tërhequr fizikisht nga njëri-tjetri, është një shenjë që marrëdhënia e tyre me Perëndinë dhe njëri-tjetrin është tendosur deri në pikën e ndarjes. Diçka nga brenda kërkon vëmendjen e duhur.

Kur një burrë i kthen kurrizin Perëndisë dhe gruas së tij, betimet martesore e humbasin shpejt fuqinë e tyre. Në vend që të shfrytëzojnë pasionet e tij dhe t’i drejtojnë ndaj gruas së tij, ai nuk arrin t’i kontrollojë. Kur ndodh një gjë e tillë, ai nuk e trajton më gruan e tij si shoqen e tij, e cila e plotëson dhe i siguron intimitet. Ai resht së menduari për të si shoqja e vetme e lojës seksuale e dhënë nga Perëndia apo si kryevepra e Perëndisë trupi i së cilës është lavdia e personit të saj.

Martesa nuk është më sheshi i lojës, por një burg nga i cili ai dëshiron të dalë. Dhe gruaja e tij është një pengesë për kënaqësinë e tij sensuale, dikush që duhet ta ndryshojë për të plotësuar nevojat e tij apo për të shpëtuar prej saj në mënyrë që nevojat e tij të plotësohen nga një grua tjetër apo imazhi i një gruaje tjetër.

Një mendësi e tillë është në kundërshtim me synimin e Perëndisë për burrat. Ai na ka urdhëruar të përqëndrojmë energjitë tona seksuale për të kënaqur gruan tonë: jo veten tonë (do të flas për këtë në kapitullin 18). Si burra ne duhet të kujtojmë që trupat tanë janë për gratë tona: kjo do të thotë që sytë tanë duhet të shikojnë bukurinë e saj të zhveshur dhe të shijojnë vetëm atë (1 Korintasve 7:3-5). Ne nuk duhet t'u lejojmë kurrë syve tanë të shijojnë bukurinë e një gruaje në mënyrë të tillë sa të poshtërojnë gruan tonë.

Ky është ideali që duhet të kërkojmë. Dhe qëllimi i këtij libri është të ndihmojë burrat e mirë, si ty, që do t'i pëlqesh Perëndisë dhe të kesh një jetë të pastër, të zhvillosh një strategji për t'iu bërë ballë tundimeve seksuale. Është shkruar për t'i dhënë një plan që funksionon, me fuqinë e Perëndisë, për të qëndruar të pastër qofsh beqar qofsh i martuar. Atëherë, dhe vetëm atëherë, do të përjetosh llojin e intimitetit dhe kënaqësisë që dëshiron Perëndia për ty për ta gjetur në zemrën dhe krahët e gruas tënde.

Po gratë e tjera?

Sigurisht, ka një problem që na del përpara. Ndërsa aftësia për të shijuar bukurinë e një gruaje është një dhuratë nga Perëndia, është gjithashtu një dhuratë që mund të abuzohet lehtë. Nëse je beqar do të përballesh me tundimin për të shijuar seksualisht bukurinë e gruas para martesës. Dhe nëse je i martuar me një grua të bukur, do të ketë raste kur gratë e tjera do të të duken më tërheqëse. Tërheqja e tyre mund të jetë aq e fortë saqë të largon nga gruaja jote. Gjatë çasteve të tilla do të tundoresh të kërkosh kënaqësi seksuale në vendin e gabuar.

Tani që kuptojmë se pse gratë e zhveshura duken aq të mira (faleminderit, o Zot, për këtë dhuratë), në kapitullin e radhës do të shohim se pse gratë që nuk mund t'i kemi, apo që nuk duhet t'i kemi, duken shpesh më të mira se sa ajo që na ka dhënë Perëndia.

PËR DISKUTIM

1. Si e konsideron Perëndia kënaqësinë seksuale që një burrë shikon te gruaja e tij? Çfarë na thotë Kantiku i kantikëve 5:1 rreth kësaj çështjeje?

*Hyra në kopshtin tim, o motra ime, nusja ime,
mblodha mirrën time me balsamin tim,
hëngra huallin tim me mjaltin tim,
piva verën time me qumështin tim.
Shokë, hani, pini;
po, dehuni, o të dashur!*

2. Pse janë gratë aq tërheqëse për burrat? Rëndit çdo arsye të përmendur në këtë kapitull. Cili vlen në mënyrë specifike për ty?
3. Çfarë qëllimi ka martesë në lidhje me oreksin seksual të burrit? Në ç' mënyrë është martesë mënyra e Perëndisë për të siguruar dhe mbrojtur burrin?
4. Ndërsa mendon për këto pyetje, kërkoji Perëndisë të të ndihmojë të konsiderosh gratë dhe seksin ashtu siç do Ai.

3.

Pse gratë e tjera duken më të mira?

U përpoqa të futesha tinëz në shtëpi pa e zgjuar gruan. Me lëvizje të ngadalta hapa dhe mbylla derën prej xhami. Me lëvizjet e një maceje hajdute eca me majat e gishtave nëpër shtëpi. Hapa me qetësi derën e dhomës së gjumit dhe lëviza si avull në dhomë dhe pastaj në shtrat.

“Pse u vonove kaq shumë?” – pyeti Sindi.

“Pse u vonova kaq shumë?” – pyeta, duke u munduar që të gjeja një përgjigje.

“Këtë po të pyes” – tha ajo.

“Oh, do të thuash se pse u vonova aq shumë për të ndezur sistemin e vaditjes?”.

Ajo, duke u bërë dyshuese, ndezi dritën e natës dhe qëndroi ndenjgur. Mendoj se frymëmarrja e shpeshtë, rrahjet e forta të zemrës dhe zëri i mprehtë tregonte se kishte ndodhur diçka.

“Nuk u largova për shumë kohë” – thashë. “Më pak se një minutë”.

“Më shumë se aq” – tha ajo. Dhe pastaj heshtje ndërsa priste me durim si macja pret miun të dalë nga vrima e tij.

“Uh, pa të shohim... Mendoj se arsyeja se pse u vonova ishte se pashë një grua të zhveshur”. Psherëtiva duke shpresuar se zëri im i butë do të zbuste ndikimin e fjalëve të mia.

“Çfarë do të thuash që pe një grua të zhveshur?” – pyeti ajo me zë kureshtar dhe çuditërisht jo gjykues, edhe pse ishte më i lartë se i imi.

“Shiko,” – i thashë – “pashë një grua të zhveshur kur po rrija te gardhi duke parë nga dritarja e komshiut”.

“Pse po shikoj nga dritarja e komshiut në mes të natës?”.

“Pashë dritën ndezur në shtëpinë e tyre dhe po mendoja se çfarë po bënin” – i thashë.

“Oh” – tha ajo ndërkohë që fiku dritën. “Shpresoj që të mos ndodhë më”.

Ndërkohë që Sindi ra të flejë, unë përjetova përsëri atë përvojë soditëse në mendjen time. Ndërkohë që rrahjet e pulsit kishin kaluar 250 rrahje për minutë, kuptova se si thjesht duke parë atë brune të bukur që kishte vetëm receptorin në veshin e saj të majtë më eksitonte. Dhe eksitimi im më frikësonte sepse e dija që do të ndizja sistemin e vadiqjes çdo natë në pjesën më të madhe të verës.

Kur u ngrit nga krevati të nesërmen në mëngjes e dija që ose do t’u rrefeja vëllezërve ose ta mbaja të fshehtë përvojën e një nate më parë. Çdo të shtunë në mëngjes që të katërt ne takoheshim për të inkurajuar dhe sfiduar njëri-tjetrin si bashkëshortë, etër dhe ndjekës të Krishtit.

Këta burra ishin drejtues frymërorë në kishë dhe unë vlerësoja miqësinë dhe respektin e tyre.

Gjëja e fundit që doja ishte të dukesh keq para tyre. Megjithatë, më tepër se sa refuzimin e tyre, kisha frikë se mos përsërisja gjërat e mia të këqija. Kështu që vendosa që t’u tregoja atyre. Ishte rasti më i mirë që kisha për të mos parë më përsëri lojën me letra të fqinjit tim.

Pas disa minutash bisede për gjëra të përgjithshme, qartësova fytyrën. Tregova historinë time duke u ndjerë si lopa në thertore. Ajo që ndodhi më pas më habiti më tepër se çdo gjë.

Një prej shokëve lëvizi me nervozizëm në karrige. “E di se çfarë ndjen” – tha Xhoi. “Unë i kam vëzhguar komshinjtë për gati dy vjet! Nga kati i dytë i shtëpisë sonë mund të shikoj drejt e në dhomën e tyre të gjumit”.

Kjo më bëri të ndihem më mirë nga njëra anë, por edhe më keq nga

ana tjetër. Por historia nuk ka mbaruar. Sapo mbaroi së foluri Dani, një djalë me mënyrën e të sjellurit si Klark Kent, tha: “Komshija ime është një grua tërheqëse e pamartuar. Zbulova disa muaj më parë që ajo pastron shtëpinë natën lakuriq. Meqë shtëpitë tona janë ngjitur, unë mund ta shikoj qartë atë. Me raste kam fikur dritat dhe e kam parë për dy muaj”¹.

“Me raste?” – e pyeta.

“Një herë në dy javë” – më tha.

“Kur nuk e ke gruan në shtëpi?”.

“Nuk është e vërtetë” – më tha ai. “Ka pasur netë kur i jam afruar dritares kur ajo ka qenë në një dhomë tjetër”.

“Nuk e ke ftuar asnjëherë të kontrolloni uniformën e pastrimit të komshies?”.

“Mbase duhet ta kisha ftuar?” – tha ai.

“Sa herë që shikoja në dhomën e tyre të gjumit, ndihesha i pisët” – tha Xhoi. “Betohesha që nuk do të ndodhte më. E megjithatë shkoja vazhdimisht te dritarja”.

Pasi dëgjova çunat, e dija që isha i zhytur deri në grykë. Nëse ata nuk mund të largoheshin nga shfaqja e një dritareje erotike, si mund të largohesha unë? Por sa më tepër flisnim, aq më tepër e dija se si mund të ruheshin nga tundimet e ardhshme për të shkelur jetën private të një komshieje. (Do të tregoj vazhdimin e historisë më vonë).

Ai takim shërbeu si një zile alarmi. Si një pastor tridhjetë vjeçar kisha jetuar me iluzionin që ndjekësit e përkushtuar të Krishtit e kishin nën kontroll epshin e tyre. Deri atë natë kisha ruajtur me sukses zemrën dhe sytë e mi. Ashtu mendoja edhe për djemtë e tjerë. Megjithatë dy prej djemve më të mirë në kishë kishin një problem të madh; dhe unë e dija që isha në të njëjtën rrugë.

Pasi epshi im seksual doli nga kontrolli, doja të dija sa më tepër

1. Që nga botimi i këtij libri kam marrë letra ku më pyesin për vërtetësinë e kësaj historie. Është e vërtetë, përveç emrit të Xhoit. Unë me Dejvin jemi akoma miq të ngushtë dhe bashkëpunëtor përgjegjës.

të ishte e mundur për mëkatet seksuale. Kam kaluar vite duke lexuar, kërkuar, intervistuar, folur me këshilltarë, në përpjekjen për të kuptuar arsyet për sjelljen kompulsive seksuale, ose siç e quan Bibla: skllavëri të mëkatit. Zbulova se sa më tepër e kuptoja problemin tim, aq më mirë mund ta mbizotëroja. Ky libër është rezultati i përpjekjeve të mia për të zhvilluar një strategji biblike për pastërtinë time seksuale dhe burrave që kam takuar përgjatë viteve. Dhe kjo është një strategji që funksionon për t'i bërë ballë tundimit.

Jam i bindur që për të fituar betejën për pastërtinë, duhet të kuptojmë se pse ne burrat tërhiqemi nga gratë që nuk mund dhe nuk duhet t'i kemi.

Ana e errët

E kupton, apo jo, që tërë burrat janë të mahnitur nga gjërat që janë jashtë normales. Qoftë përvoja, qoftë Bibla e vërteton këtë.

Kur isha djalë, ime më më thoshte vazhdimisht: “Mos ha karamelë para darkës”.

Çfarë shakaje. Nuk më interesonte që karamelët më prishnin oreksin për bukë. Më pëlqenin karamelët para çdo ushqimi që do të vendoste në tavolinë.

Një herë gjeta një kopje të revistës *Playboy*. Prindërit u përpoqën të më bindnin që nuk duhej të shikoja foto të grave lakuriq. Dhe si u përgjigja? U thashë në rregull, por nuk iu binda. Pse? Sepse gratë e zhveshura që pashë te *Playboy* dukeshin më mirë se gratë e veshura. Shumë më mirë.

Pasi u martova një mik beqar më pyeti se si ishte jeta tani që isha martuar. “Shiko” – më tha – “tani që mund të bësh seks sa herë të duash?”.

“Shumë mirë” – i thashë. “Pse, sepse nuk ua hedh syrin grave të tjera. Është njësoj sikur të mos ekzistonin”.

“Me të vërtetë?” – tha ai.

“Jo. Po bëj shaka. Në disa pika është më keq. Sepse e di që nuk do të jem kurrë me një grua tjetër e cila më tërheq më tepër se ajo”.

Mund të imagjinoni se çfarë ndodhi kur ia thashë për herë të parë gruas time. “Atëherë, ti nuk mendon se jam e bukur?” – tha ajo.

“Jo, zemër. Nuk po them këtë”.

“Dukesh sikur po shikon gratë e tjera më tepër se unë?”.

“Më pëlqen të shikoj ty” – i thashë – “por... shiko, e ke parasysht që të pëlqejnë çokollatat?”.

“Nuk ke për ta kaluar kaq lehtë këtë” – tha ajo.

“Jo, e kam seriozisht. Kur vendos të mos hash më çokollatë, a nuk të bën kjo të dëshirosh edhe më tepër kur shikon një bonbone në tas? Kjo nuk ndodh vetëm me mua!” – e sigurova atë. “Tërë burrat janë kështu”.

Edhe dje folëm për të njëjtën temë. “Shiko Tom Krujzin” – i thashë. “Duhet të pranosh që Nikol Kidman është shumë e bukur. Megjithatë e la për Penelop Kruz dhe pastaj më vonë u martua me Kejti Hollms. Dhe Bred Piti la bukuroshen Xhenifer Eniston për Anxhela Zholi dhe kush e di se sa kohë do të zgjasë. Çdo vit ka histori të reja të burrave të famshëm me gra shumë të bukura që i lënë për dikë tjetër”.

“Shiko, ata burra nuk janë të krishterë” – tha ajo.

“Fakti që një burrë nuk është i krishterë nuk do të thotë që ai nuk është burrë. Dhe burrat e rënë kanë të meta duke qenë të tërhequr nga gra të cilat nuk mund t’i kenë”.

Pavarësisht nga ky realitet, e sigurova vazhdimisht Sindin se ajo është për mua gruaja më tërheqëse e jetës time. Por për ta mbajtur atë si numrin një, duhet njohje dhe disiplinë: njohje të vetvetes dhe pse gratë e tjera duken më të mira dhe disiplinë për të bërë zgjedhje që përqëndrojnë energjitë seksuale tek ajo.

Seksi i ndaluar duket më i mirë

Në kapitullin e mëparshëm pamë që Perëndia i krijoi burrat që të gjejnë kënaqësi me bukurinë e gruas. Kjo është e mirë! Është e shëndetshme dhe normale. Por ajo tërheqje kthehet në mëkatore kur vlerësimi ynë për bukurinë e një gruaje kalon në epsh dhe ne nuk e shohim më si person por si trup për t’u përdorur për kënaqësinë tonë. Kalimi nga admirimi,

i cili është një përgjigje e shëndetshme mashkullore, në epsh vijon me një shteg të njohur të nisur nga Adami dhe Eva.

Atyre të dyve u ndodhi diçka që hedh dritë në procesin nga një shikim i padëmshëm në një vendim mëkatar. Ta themi që në fillim, nuk ka asgjë të gabuar në qenësi me frutin e ndaluar (Zanafilla 2:17). Nuk ishte i helmuar apo i kalbur. Përkundrazi, ishte diçka e mirë që Perëndia i tha Adamit dhe Evës ta shmangnin. Pse? Për të vënë në provë gatishmërinë e tyre për t'i shërbyer atij dhe për t'u dhënë atyre një mundësi për të ushtruar vullnetin e tyre të lirë. Perëndia u tha atyre lirinë për të zgjedhur se çfarë do të bënin me jetët e tyre.

Ndonjëherë gjërat e gabuara janë gjëra të mira që janë të paarritshme. Ashtu si narkotikët. Po t'i përdorësh në mjekësi, ato lehtësojnë dhimbjen. Po t'i përdorësh në mënyrë joligjore, mund të çojnë në varësi dhe vdekje. Në raste të tjera gjërat e gabuara janë gjëra të mira të përdorura me tepri: si seksi, alkooli apo ushqimi. Seksi dhe bukuria e grave të zhveshura janë dhurata të mira nga Perëndia. Por seksi tharohet kur përdoret në mënyrë kompulsive apo si varësi.

Mendoj se Adami dhe Eva nuk do ta kishin parë për herë të dytë frutin e ndaluar nëse Gjarpri nuk do ta kishte mashtruar Evën për të besuar se në vend të vdekjes po ta hante, siç kishte premtuar Perëndia, ajo do të bëhej si ai (Zanafilla 3:1-5).

Sapo e hëngri gënjeshtren, e kishte radhën fruti. Sa më tepër e shikonte, aq më i shijshëm i dukej. Edhe pse Eva kishte gjithçka për të cilën kishte nevojë, Satani e mashtroi për të besuar se ajo kishte nevojë të cilat nuk mund t'i plotësonte Perëndia.

A mendon se Satani ka zhvilluar një strategji të re e të përditësuar për të të futur ty në kurth nga ana seksuale? Sigurisht jo. Ai nuk ka ndryshuar skemat e tij gjatë shekujve. Sot ai na mashtron për të besuar se përvojat seksuale që ka ndaluar Perëndia do të na kënaqin më mirë se sa gruaja që ai ka parashikuar për ne.

Ndërsa qejfi i një nate, një tradhti apo masturbimi para ekranit të kompjuterit do të sjellë kënaqësi, kjo kënaqësi nuk do të zgjasë. Salomoni ka thënë: “Sepse buzët e gruas që shkel kurorën nxjerrin

mjaltë dhe goja e saj është më e butë se vaji; por në fund ajo është e hidhur si pelini, e mprehtë si një shpatë me dy presa” (Fjalët e Urta 5:3-4).

Salomoni nuk mohoi bukurinë e grave të tjera, as nuk nënvlerësoi kënaqësinë e ëmbël që të ofron ajo. Adami dhe Eva mbase e pëlqyen shijen e frutit të ndaluar. Por shija e ëmbël e mëkatit u kthye në baltë kur ishte ende në gojë të tyre.

Pas skene

Të gjithë e dimë, të paktën në një nivel intelektual, që kënaqësia e mëkatit është e përkohshme. Por ne jemi ende të cenueshëm ndaj gënjeshtërisë që na thotë se fruti i ndaluar do të na kënaqë. Ne dëshirojmë të shijojmë ëmbëlsinë e tij. Dhe të gjithë ndeshemi me tundimin për të përjetuar seksin tabu për aq kohë sa jetojmë.

Pse gratë, të cilat janë në mënyrë të qartë të paarritshme, janë aq tërheqëse? Një pjesë e përgjigjes më duket pak drithëruese. Shiko, jam i bindur që Satani ka fuqinë t’u japë grave (ose çdo gjëje tjetër) që nuk duhet t’i kemi, një tërheqje ndaj tyre që na josh si mushkonjat nga vrasësi i insekteve. Ai e bëri këtë me Evën dhe e bën këtë edhe me ne. Pas skene luhet diçka frymërore.

Dragoi që është brenda

Ndërsa Satani mund të na tundojë, me patjetër nuk mund të na detyrojë të marrim një vendim të keq. Kjo na takon ne. Dhe kur zgjedhim të dëshirojmë bukurinë e ndaluar në internet apo në punë apo përmes dritares së komshies, vendimi ynë nxitet nga orekset tona egoiste dhe të liga.

Kur mbusha tetë vjeç prindërit më dhanë një pistoletë lodër me ajër. Tyta e saj e ftohtë prej çeliku dhe doreza e saj e gdhendur prej druri i jepnin armës bukuri. Kanaçet, shishet, sinjalet e rrugës, nuk na shpëtonin asgjë.

Pothuajse asgjë. Një pasdite ngrita armën dhe vura në shënjestër një harabel që qëndronte në degën e një shelgu në oborrin pas shtëpisë. Sa po bëhesha gati të tërhiqja këmbëzën, motra ime e madhe, Petsi, vrapoi në kopsht duke tundur krahët e saj e duke bërtitur. Ndërsa zogu po fluturonte larg, ajo më pa dhe buzëqeshi. Nuk tha gjë, por me fytyrën e saj të vetëkënaqur po tallej: “Ha! Ha! Ha! Ha! Ha! Të tregova se kush është shefi”.

Në ato çaste diçka brenda meje mori kontrollin. Ula tytën dhe ia drejtova motrës. Një pamje e tmerruar i zuri vendin vetëbesimit të kënaqur ndërsa u largua me të katra. Mora shënjestër atë pjesë të saj të cilën e mendoja të mbushur mirë dhe mendova “Ulu mbi këtë!” ndërsa tërhoqa këmbëzën. Arma qëllloi në shenjë dhe ajo fërkoj të ndenjurt dhe angulliu. Ajo u fut në shtëpi duke thirrur: “Më qëlluan! Më qëlluan!”. Për një çast të shkurtër po mendoja se çfarë më shtyu të bëja diçka të tillë të marrë, pastaj kuptova që më pëlqeu. Prandaj i qëllova. Unë u ndjeva mirë, por jo ajo.

Kënaqësia ime nuk zgjati shumë, sepse im atë hoqi menjëherë rripin e pantallonave dhe pashë që edhe ai kishte shënjestër të mirë siç kisha pasur unë me armën time. Petsi u gëzua me dhimbjen time dhe bëri festë kur babi më mori dhuratën që më kishte bërë. Kurrë nuk e pashë më armën time çudibërëse. Por ndërsa babi kishte fuqinë të hiqte mjetin që përdora për të bërë keq, ai nuk ishte në gjendje të hiqte anën e errët të personalitetit tim që gëzohej duke bërë të keqen.

Kjo është pjesa tjetër e problemit, apo jo? Nuk është thjesht që kemi një armik frymëror që na nxit të bëjmë të keqen, një pjesë e jona e shijon mëkatin. Të gjithë ne kemi fusha në jetën tonë ku, herë pas here, priremi ndaj mëkateve seksuale. Të krishterët e dinë që duhet të jenë të pastër, por shumë prej tyre përfundojnë duke parë për një kohë të gjatë një vajzë me pak rroba në trup në palestër, duke parë në internet faqe erotike, duke vizituar klube striptizmi, duke flirtuar me një koleg pune apo duke fjetur me të dashurën e tyre.

Ne e dimë se çfarë dëshiron Perëndia prej nesh, megjithatë ne nënvlerësojmë vullnetin e tij. Të veçantat e betejave tona të brendshme

ndryshojnë, por të gjithë ndeshemi me hipokrizinë.

*Një pjesë e jona pëlqen të kapërcejë
vijën morale dhe gjen kënaqësi
në seksin e ndaluar.*

Dhe ne të gjithë kemi premtuar të riformohemi. A nuk kemi premtuar? Sa herë që bëjmë pyetje-përgjigje rreth pastërtisë seksuale me studentë të kolegjit, dikush do të pyesë për masturbimin. U them atyre që kam shkruar një kapitull në librin tim me titull: “Masturbimi: Si ta mundim”. Pasi qeshin me të madhe, u them atyre që me të vërtetë titulli është: “Masturbimi: Rrokja e një teme të nxehtë”².

Sapo të qeshurat zbuten, të gjithë bien dakord që është një zakon i vështirë për t’u lënë. A ka ndonjë të krishterë që nuk i ka premtuar Perëndisë se nuk do të masturbohet më apo të paktën sa më rrallë? Megjithatë mbajtja e atij premtimi me qëllim të mirë funksionon njësoj si të rrinte rosaku pa gagarisur.

Qëllimi im këtu nuk është për të diskutuar temën e masturbimit (do të flasim për këtë më vonë), por për të treguar faktin se tërë burrat kanë bërë premtime për të reformuar sjelljen e tyre të papastër apo kompulsive seksuale dhe nuk ia kanë arritur të mbajnë këtë zotim.

Zgjimi i dragoit

Në rregull, kemi parë që gratë e tjera duken ndonjëherë më mirë. Kemi mësuar edhe që Satani dhe ushtria e tij e keqe ka fuqinë të maskojë objektet dhe përvojat seksuale tabu me një shkëlqim mashtrues që vezullon.. në mënyrë të tillë që zgjon orekset tona mëkatore si monedha ari për dragoin.

Sigurisht dragoi i mëkatit tonë mund të bjerë në gjumë. Kjo më

2. Judson Poling dhe Bill Perkins, *Udhëtimi* (Grand Rapids, Miç.: Zondervan, 1996), f. 3.

ndodhi mua. Ndërsa po ndeshesha me epshin seksual para se të ndiqja Krishtin, sapo iu kushtova Atij, beteja u bë më pak e ashpër. Nuk dua të them që u zhduk plotësisht, por nuk ishte diçka që e mendoja si problem në jetën time.

Dhe pastaj atë mbrëmje që pashë përmes dritares së komshies dragoi doli nga shpella, duke nxjerrë zjarr nga flegrat e tij dhe duke kërcënuar të më pushtonte jetën. Kur ndodh kjo, ne kuptojmë se nuk jemi pronarët e shtëpisë tonë, por është dragoi, ose mund të bëhet së shpejti.

Apostulli Pal, ndërsa vështronte sjelljen e tij, doli në përfundimin: “Por tani nuk jam më unë që veproj, por mëkati që banon në mua” (Romakëve 7:17). Pali, kur i referohet vetes së tij me “unë”, flet për personalitetin e tij kryesor të shpenguar, atë pjesë të tij që kërkonte Perëndinë. Ai foli për atë vend në personalitetin e tij ku banonte Fryma e Perëndisë. Ai iu referua vetes së tij të brendshme që ishte rikrijuar nga Perëndia dhe ishte me të vërtetë një burrë i mirë në Krishtin.

Është vendimtare që ti të kuptosh se ky njeri i ri e i mirë është identiteti yt i vërtetë. Dhe ndërsa ti je një njeri i ri, nuk je i mbrojtur ndaj tundimit. Me të vërtetë, si një njeri ri ti do të përballësh me tundimin çdo ditë.

Pali e dinte se vetja e tij e vërtetë, njeriu i mirë, ajo pjesë e vetes që ishte e bashkuar me Krishtin, nuk po kryente sjelljen e gabuar. Por ishte prirja e tij mëkatore dhe orekset e tij prej dragoi që kishin pushtuar mendjen dhe kishin skllavëruar vullnetin e tij. Pali nuk po justifikonte apo minimizonte sjelljen e tij mëkatore, as po hiqte përgjegjësitë nga vetja.

Ai thjesht po pohonte faktin. Pali i vërtetë, njeriu i ri në Krishtin, burri i mirë në Krishtin, burri që dëshironte të bënte gjërat drejt, nuk ishte ai që po bënte të keqen, por ishte dragoi i epshit të tij mëkatar që e kishte sunduar.

Edhe pse e di që Pali nuk ishte skllav i papastërtisë seksuale, si çdo njeri tjetër ai ishte potencial për skllavërim (Romakëve 7:14-20). Edhe pse e mbajti mëkatin e tij nën kontroll, mëkati përpiquej vazhdimisht të mbizotëronte njeriun e tij të ri. Ai e dinte se dragoi brenda tij kishte

fuqinë ta burgoste. Në fakt ai tha se e dinte çfarë do të thoshte të ishte skllav i mëkatit (Romakëve 7:23).

Rreth grave të tjera

Sigurisht, të gjithë ne kuptojmë që të dish se çfarë të bësh nuk të garanton kryerjen e saj. Në kopsht Eva e dinte se çfarë donte Perëndia prej saj. Po kështu edhe Satani. Në fakt Satani përdori urdhërimin e Perëndisë për ta tunduar. Ai e pyeti Evën: “A ka thënë me të vërtetë Perëndia...?” (Zanafilla 3:1). Ajo pyetje rreth asaj që kishte ndaluar Perëndia ishte vendi i fillimit i atij tundimi.

Disa gjëra nxisin oreksin mëkatar si fjala *e ndaluar*. Sapo dëgjojmë fjalën, ne përjashtojmë menjëherë veten. Për shembull, çfarë dëshiron të bësh në mënyrë instiktive kur po i jep makinës në një rrugë interurbane dhe shikon një shenjë që thotë: “Kufiri maksimal i lejuar i shpejtësisë është 90 km/h”? A buzëqesh dhe thua: “Oh, mirë. Më pëlqen të eci me ngadalë. Jam i gëzuar që shteti më ka ndaluar të eci më shpejt se 90 km/h”? Me siguri nuk jam i gëzuar. Dua të mos bindem. Dua t’i jap shpejt. Mbi të gjitha, arsyetoj, askujt nuk i intereson nëse nuk eci vërtetë shumë shpejt. Dhe me atë lloj arsyetimi e kam përjashtuar veten nga ligji.

*Asgjë tjetër nuk e eksiton dragoin
në shpirtin tonë sa një rregull
që shpall diçka të palejueshme.*

Kjo është mënyra se si mëkati përdor ligjet e Perëndisë për të siguruar sundimin mbi jetën tënde. Ja si funksionon. Do të lexosh fjalët e Jezusit që thotë se nëse shikon me epsh një grua, ti ke kryer tradhti bashkëshortore në zemrën tënde (Mateu 5:28). Kështu thua me vete: “Nuk do ta shikoj më atë vajzë seksi. Nuk do ta shikoj më atë vajzë seksi. Nuk do ta shikoj më atë vajzë seksi”.

A e kupton se çfarë po ndodh? Tërë këtë kohë po shikon atë ç’ka

dëshiron Perëndia të bësh apo të mos bësh, ti po mendon për vajzën seksi që nuk do të shikosh më. Pohimi yt që do t'i bindesh Perëndisë është një shpallje lufte midis njeriut të mirë që është në ty, njeriut të ri në Krishtit dhe dragoit: orekset e tua seksuale. Dhe nëse kjo është shtrirja e planit tënd për betejë, do të humbasësh gjithmonë. Të dish të bësh gjënë e duhur nuk është garanci për sukses.

Asnjë burrë në botën e lashtë nuk kuptonte më mirë Ligjin e Perëndisë se sa mbreti David. Ai ishte një burrë që i kishte të gjitha. Ai kishte pushtuar armiqtë e tij dhe kishte sjellë paqen e Izraelit. Ai kishte një grua të dashur dhe miq të ngushtë. Ai jo vetëm ishte një gjeni ushtarak, por ishte edhe poet. Ai shkroi shumë nga psalmet si shprehje e dashurisë së tij ndaj Perëndisë.

Si shpërblim të besnikërisë së tij Perëndia i premtoi Davidit një mbretëri që do të zgjaste gjithmonë (2 Samuelit 7:16). Në kishte person që dinte të bënte gjënë e duhur, ky ishte Davidi. Dhe ai me siguri e dinte që nuk duhet të flinte me Bathshebën, gruan e Uriahut, hititit, një prej luftëtarëve të tij trima. Ajo ishte me siguri fruti i ndaluar.

Megjithatë, në një kohë kur ai duhet të ishte me trupat e tij në fushën e betejës, Davidi ishte në shtëpi. Pse? Besoj se qëndroi në shtëpi sepse donte të kontrollonte Bathshebën dhe priste një rast që të ishte vetëm me të. Dyshoj se ka thënë me vete herë pas herë që do të ishte e gabuar të vështronte bukurinë e saj të zhveshur. Madje më e keqja të flinte me të. Megjithatë, në vend që të kujdesej për ushtrinë e tij, një natë qëndroi në taracën e pallatit të tij dhe pa Bethshebën të lahej (2 Samuelit 11:1-27). Sa drithëruese duhet të ketë qenë.

Armiku i padukshëm i Davidit kishte bërë atë që nuk kishte bërë Goliathi. Ai kishte reklamuar bukurinë e një gruaje të zhveshur dhe dashuria e saj nxiti dragoin në shpirtin e tij. Ashtu si burrat e tjerë, Davidi donte gruan që Perëndia kishte thënë se ishte e palejuar. Pse? Sepse orekset e tij mëkatore u nxitën nga ideja që ai nuk duhet apo nuk mund ta kishte. Po kështu orekset e tua. Dragoi brenda teje dëshiron një gjë: sundim total të jetës tënde (Romakëve 7:23). Dhe do të përdorë ligjin e Perëndisë për të të skllavëruar.

Kjo është tabu

Ndërsa kam folur me grupe burrash përqark vendit dhe duke folur privatisht me burra të tjerë, kam dalë në përfundimin se shumë djem të krishterë besojnë se po ndeshen në një betejë të humbur kundër epshtit. Kjo është një betejë për të cilën kanë turp të flasin. Pse? Sepse në ambientet e krishtera, mëkatet seksuale janë serioze, ashtu siç duhet të jenë në fakt. Por ai serioziteti i lejueshëm mund të krijojë gjithashtu një frikë për keqkuptim apo refuzim dhe ajo frikë i shtyn shpesh njerëzit në izolim. Me tërë kuptimin e fjalës, mëkati seksual është një temë tabu midis burrave të krishterë.

Ky realitet shton problemin e epshtit. Pornografia, prostitucioni dhe tradhtitë japin iluzionin e intimitetit. Mënyra më e mirë për të luftuar këtë iluzion është me intimitetin e vërtetë apo çiltërsinë, me një person tjetër. Meqë shumica e burrave nuk e kanë atë lidhje miqësore, fuqia e epshtit shtohet. Gratë e tjera bëhen tepër tërheqëse për shkak të iluzionit të intimitetit që sigurojnë.

Përfundimi

“Në rregull” – mund të pyesësh – “cili është përfundimi këtu?”. Më lejo të bëj një përmbledhje dhe pastaj të bëj përfundimin.

Ne e dimë që Perëndia krijoi një mister: për burrat trupi i grave të zhveshura është shumë i bukur. Por ai mister fsheh një rrezik për shkak se burrat i konsiderojnë gratë e tjera, përveç gruas së tyre, tërheqëse. Në fakt mund të jenë gratë që nuk mund t’i kemi më të mira se sa ajo që kemi. Pse? Sepse:

- Forcat e liga frymërore u bëjnë reklamë
- Orekset tona mëkatore tërhiqen nga gjithçka që është e palejueshme
- Ligji i Perëndisë që na urdhëron të largohemi nga imoraliteti nxit epshtin tonë
- Iluzioni i intimitetit është shpesh më tërheqës se sa realiteti

- Ne jemi izoluar nga burrat e tjerë dhe nuk mund të flasim për betejat tona

Shpresoj që tashmë të kesh kuptuar se pse tundohen burrat e mirë. Ata kanë nevojë për një strategji që t’u sigurojë fitoren tundim pas tundimi. Mund të ndodhë që madhësia e betejës tënde mund të të shtyjë të ndjesh se po përballësh me një betejë të humbur. Disa vjet më parë dëgjova një histori që ka në perspektivë betejat tona me tundimin seksual.

Kruajtja e pashërueshme

Na ishte një herë e një kohë një djalosh që u fut në shpellë ndër male për të studiuar me një burrë të urtë. Nxënësi donte të mësonte gjithçka që mund të mësohej. Plaku i urtë i siguroi nxënësit pirgje me libra. Para se të nisej plaku i urtë hodhi pudër që shkaktonte kruajtje në duart e nxënësit.

Plaku i urtë kthehej çdo mëngjes në shpellë për të parë ecurinë e nxënësit të tij. “A ke mësuar gjithçka që duhet të dish?” – pyeti plaku i urtë.

Dhe çdo mëngjes nxënësi i tij përgjigjej: “Jo akoma”.

Plaku i moçëm hidhte pluhur që shkaktonte kruajtje te duart e nxënësit dhe largohej. Çdo ditë për muaj të tërë i urti përsëriste të njëjtën gjë. Një ditë, ndërsa u fut në shpellë, nxënësi doli, kapi çantën me pudër dhe e hodhi në zjarrin që ngrohte shpellën.

“Urime” – i tha plaku i urtë me një buzëqeshje. “E ke mbaruar shkollën. Tani di gjithçka që duhet të dish”.

“Si ka mundësi?” – pyeti nxënësi.

“Ke mësuar që nuk ke pse të presësh derisa të mësosh gjithçka para se të bësh diçka pozitive” – u përgjigj ai. “Dhe ti ke mësuar se si të marrësh kontrollin e jetës tënde dhe të ndalosh kruajtjen”.

Mbase beteja jote me epshin ka krijuar një kruajtje të pareshtuar në shpirtin tënd. Ti e ke kruajtur, duke shpresuar se do të bëhet më mirë. Por nuk është bërë më mirë, por kërkon më tepër vëmendje. Mund t’i

kesh premtuar vazhdimisht vetes dhe Perëndisë që do të angazhohesh në mënyrë efektive. Por kruajtja vazhdon dhe ti nuk mund ta ndalësh.

Në një farë kuptimi ky është qëllimi i këtij libri: për të të ndihmuar ty, personin e ri në Krishtin, burrin e mirë, të marrësh kontrollin e jetës tënde përmes fuqisë së Frymës së Perëndisë dhe të reshtësh së kruajturi. Por qëllimi i librit shkon përtej kësaj. Libri përpiqet të të ndihmojë të bëhesh jo thjesht një burrë që mund t'i bëjë ballë tundimit. Por të të ndihmojë që të zhvillosh identitetin tënd në Krishtin në mënyrë që burri i mirë që është në ty të jetojë, jo vetëm një jetë të pastër që i pëlqen Perëndisë, por një jetë me gëzim të krijuar nga njohuria që zemra dhe pasionet e tua i përkasin vetëm një gruaje.

Pjesa tjetër e këtij libri do të të ndihmojë të kuptosh burrin e mirë që ka krijuar Krishti brenda teje në mënyrë që mendimet dhe veprimet e tua seksuale të dalin prej tij në vend të epshit tënd.

PËR DISKUTIM

1. Çfarë roli kanë forcat e liga frymërore në tërheqjen e burrit ndaj grave të tjera?
2. A ka ndodhur ndonjëherë kur ke mashtruar veten për të besuar se mund të shijosh seksin jashtë martese dhe të dalësh paq nga kjo? Çfarë arsytimi të ka çuar në një mendësi të tillë të shtrembëruar?
3. Cili është ndryshimi midis vlerësimit të bukurisë së një gruaje dhe epshit për të?
4. Në ç'mënyrë të jep shpresë historia e mësipërme rreth burrit me kruajtje?
5. Çfarë dëshiron të nxjerrësh nga ky libër? Si krahasohet përgjigjja jote me dy paragrafët e fundit të këtij kapitulli?

4.

Fuqia e seksit e mbushur me tabu

“Çfarë zhgënjimi” – thashë ndërsa përplasa Oregonian, gazetën më të madhe të Portlandit dhe pastaj e hodha në banakun e kuzhinës.

Disa orë më pas, ndërsa po rrufisja një kafe dopio te Rikardo, një restorant italian, erdhi të më takonte një mik. Pasi kamarieri na mori porosinë dhe i solli një qumësht, miku im më pyeti: “A dëgjove për zjarrin te Dyqani i videove të fantazisë për të rritur?”.

“Sapo lexova për këtë ngjarje këtë mëngjes. Jam i kënaqur që nuk është më, por...”.

“Më vjen keq për djaln që vdiq” – tha Xhoshi para se ta mbaroja fjalinë. “Ishte moshatar me mua. Shkonte tek ai vend për pak qejf dhe mbeti në një dhomë me zjarrin e fuqishëm që i kishte bllokuar rrugën e daljes”.

“Nuk kishte dalje nga pas” – thashë unë.

“Imagjino tmerrin e tij kur vrapoi nëpër atë korridor të ngushtë në fund të ndërtesës të mbushur me tym dhe u ndesh ballë për ballë me murin me tulla” – tha Xhoshi.

“E di për kë më vjen keq?” – pyeta unë.

“Për kë?”.

“Për të ëmën. Ajo i tha gazetarit që ai mbase kishte shkuar në atë

vend disa herë”.

“Sa mirë po të ishte ashtu” – tha Xhoshi.

“Nuk ka lidhje” – thashë me zemërim, jo ndaj Xhoshit, por me marrëzinë e djalit që u dogj. “Tani që ka vdekur, a ka më rëndësi? Kujtesa e saj e fundit për të do të jetë atje ku dhe se si vdiq. Ajo do të kujtojë djalin e saj si një statujë hiri në dyshtemenë e një dyqani materialesh pornografike”.

“Mund të kisha qenë unë në vend të tij” – tha Xhoshi. E pashë për disa sekonda i pështjelluar nga komenti i tij.

“Çfarë do të thuash?”.

“Kam qenë në atë vend... në dhomën ku vdiq ai. Bill, mund të ishte duke lexuar për mua në gazetë këtë mëngjes. Mund të ishe ndërë keq për time më, gruan dhe fëmijët e mi”.

“Mendoj se ke qenë me fat. A do të kthehesh prapë?” – e pyeta.

“Nuk mundem” – tha ai. “Është djegur deri në rrëzë”.

Kishte të drejtë. Por nuk mbaron këtu historia. Bashkia i dha një paralajmërim pronarit për shkeljen e një rregulli kundër zjarrit dhe kompania e tij e sigurimit i dha mjaftueshëm para për të ndërtuar dyqanin. Tani është më i madh dhe më i mirë se më parë.

Po Xhoshi? Disa muaj pasi ishte hapur përsëri dyqani e pyeta Xhoshin nëse kishte shkuar prapë.

“Kam shkuar atje” – tha ai.

“Pse?”.

“Nuk e di. Mbase ngaqë doja të sigurohesha që ai vend kishte një dalje shtesë në rast zjarri. Shiko, për t’u kujdesur për klientët e tjerë”.

“Patjetër”.

“Bill, e urrej atë vend. Sa herë që largohem ndihem sikur kam notuar në një gjiriz. I premtoj Perëndisë që nuk do të kthehem më kurrë. Dhe pas disa javësh kaloj afër, shikoj shenjën dhe nuk mund t’i bëj ballë nxitjes”.

Fjalët e tij më kujtojnë për dy miqtë e mi në Teksas dhe djemtë e tjerë që kam njohur ndër vite të cilët janë zënë në lak nga imazhet tabu të pornografisë së internetit apo vajzave të ndaluara në klubet e natës

apo nga krijimi i një lidhjeje zyre.

Është e lehtë të zihesh në lak në epshin seksual. Dalja nga kjo është një çështje tjetër. Kthetrat e kurthit janë të forta si çeliku dhe dhëmbët e tij të mprehta si brisku. Lajmi i mirë është se mund të çlirohesh dhe të shmangësh zënien në kurth në të ardhmen. Por mbase nuk do të ndodhë pa kuptuar se si funksionon kurthi. Prandaj në këtë kapitull do të shqyrtojmë natyrën kompulsive seksuale, pse janë aq të fuqishme dhe ciklin e tundimit që duhet të prishim.

Epshi i mbushur me tabu

A nuk do të ishte bukur nëse një burrë zgjedh të ndjekë Krishtin, epshi i tij seksual të shkatërrohej me një lazer frymëror? Një djalë më afrohej me raste në ndonjë takim ku flisja dhe më thoshte: “Mendova që në çastin që do të pajtohesh me Perëndinë, betejat e mia me mëkatën do të mbaronin. Mendoj se janë bërë më keq.”

Sigurisht, një arsye se pse kjo është e vërtetë është se para se të bëheshin të krishterë shumë djem nuk u bënëin kurrë ballë dëshirave të tyre seksuale, kështu që nuk ka pasur betejë. Kur u bënë ndjekës të Krishtit, ata futën në një betejë të brendshme për të shuar ato dëshira.

***Fatkeqësisht shumë kisha
krijojnë një ambient ku
lulëzon sjellja kompulsive seksuale.***

Pse? Sepse fshehtësia dhe rreziku rrisin adrenalinën të shoqëruar me mëkate seksuale. Në një farë kuptimi ata veprojnë si një turbinë që injekton epshin e burrit me një dallgë të fuqishme energjie. Ose për ta thënë ndryshe, kishat mund të mbushin me tabu epshin seksual të burrit.

Disa vjet më parë fola në telefon me një autoritet kombëtar në fushën e sjelljes të varur seksualisht. Ky psikolog nuk ishte i krishterë dhe ai nuk e dinte se unë isha i krishterë. E ftova për të qenë pjesë e kërkimit për këtë libër. Gjatë bisedës tonë ai më tregoi diçka që mund t’ju çudisë.

Mua më çuditi.

“Besoj se burrat e krishterë priren më tepër ndaj sjelljes të varur seksualisht se sa çdo segment tjetër i shoqërisë”.

“Pse?” – e pyeta.

“Sepse kishat priren ta bëjnë seksin tabu, sidomos atë që e konsideron sjellje të devijuar seksuale. Sa më e ndaluar të jetë një sjellje, aq më tepër eksitim përcjell kur shkelet tabuja. Meqë shumica e kishave nuk sigurojnë një vend që njerëzit të flasin për sjelljen e tyre seksuale, ata bëhen thjesht të varur”.

Të kishte të drejtë? Askush nuk e di me siguri. Por jam i bindur se gjithnjë e më tepër të krishterë janë të zënë në kurthin e mëkateve seksuale nga sa mund të imagjinojmë. Pjesërisht sepse të zihesh duke bërë diçka që i kalon kufijtë e lejueshëm seksualë sjell pasojat më të mëdha seksuale për një djalë që shkon në kishë se sa për një që nuk shkon.

Gjatë një periudhe prej disa vitesh kam zhvilluar sondazhe në kisha ku mbaja seminare. E bëra këtë të testoja dhe objektivizoja sjelljen seksuale të burrave të krishterë. Qëllimi im nuk ishte të siguroja një studim tërësisht shkencor. Doja thjesht të shikoja se ç’mendonin burrat. Për çudinë time 55 për qind e burrave që u anketuan thanë se hasnin vështirësi apo kishin hasur vështirësi në të shkuarën, me sjelljen kompulsive seksuale.

Ndërsa këta burra mbase po përjetonin një betejë rastësore me pornografinë dhe masturbimin, të tjerë po përballeshin me kompulsione më serioze. Mos krijoni ide të gabuara; ka burra të shumtë që shkojnë në kishë çdo javë, të cilët jetojnë me frikën se mos zbulohen. Kur lajmet e mbrëmjes shfaqin foto të burrave që janë arrestuar se kanë marrë prostituta rrugës, shtangin nga frika. Pse? Sepse mbase para një javë kanë udhëtuar në të njëjtën lagje. Ashtu si miku im, historinë e të cilit e tregova në fillim të këtij kapitulli, ata e dinë se historia e lajmeve mund të ketë qenë edhe për ta.

Vënia e gjithçkaje në rrezik

Seksi është një temë e preferuar e emisioneve tematike të pasdites. Edhe yjet e njohur të lajmeve tregojnë me zell për një burrë që ka sakrifikuar gjithçka për një aventurë seksuale. Pyetja që bëjnë ata është gjithmonë: “Pse e bëre?”.

Pas fiaskos së Bill Klintonit me Monika Levinskin, i shkrova një e-mail producentit Bill O'Rejlli duke i thënë: “Mund t'ju tregoj se pse presidenti Klinton bëri seks me Monika Levinskin në Shtëpinë e Bardhë”. Dy ditë më vonë isha i ftuar në emision Faktori i O'Rejllit. Thelbi i shpjegimit tim ishte që një burrë duhet të rrisë rrisikun për t'i shkuar rrotull dikujt. Çfarë do të ishte më me rrezik për një president se sa të bënte seks me një femër në Shtëpinë e Bardhë?

Një arsye se pse burrat marrin përsipër rreziqe të tilla është ngaqë ata zihen në kurth nga adrenalina. Për të nxitur adrenalinen, ata duhet të rrisin rrezikun. Kur kanë fëmijë, thjesht leximi i revistës Playboy apo lundrimi në internet siguron rrezik të mjaftueshëm. Mbi të gjitha, çfarë do të ndodhte nëse prindërit e tyre do t'i kapnin? Tani që janë të rritur, revistat apo fotot dixhitale në internet nuk sigurojnë rrezik të mjaftueshëm. Ata duhet t'i thonë gjërat hapur. Ata duhet të bëjnë diçka që do t'u kushtojë shtrenjtë nëse kapen.

Burri që ka dobësi gratë

Perëndia na jep një shembull në Fjalën e tij se çfarë mund të ndodhë kur epshi seksual del jashtë kontrolli nga jeta e një burri. Nëse njeh Sansonin (dhe kush nuk e njeh?), e di që ishte i fortë, shumë i fortë. Ai ishte më i shpejtë se Forrest Gamp dhe më i fortë se Roki. Një ditë kapi 300 dhelpra, i lidhi për bishti dhe u vuri zjarrin. Një rast tjetër vrau një luan me duar, pa pasur armë. U kalli datën armiqve të tij kur vrau i vetëm një mijë filistej duke përdorur vetëm nofullën e gomarit.

Sansonin kishte atë lloj force fizike që vjen vetëm nga Perëndia. Ai ishte “Nazireo kushtuar Perëndisë që në barkun e nënes së tij” (Gjyqtarët

13:5). Zoti kishte një qëllim për jetën e Sansonit dhe donte që njerëzit ta dinin këtë. Prandaj Sansoni nuk i priste kurrë flokët e tij të gjatë. Flokët e tij nuk ishin për modë, por një kujtesë për njerëzit për zotimin e tij të plotë ndaj Perëndisë.

Sansoni ia kishte dalë. Ai kishte madhësinë, forcën, famën dhe një miqësi të ngushtë me Perëndinë. Dhe mund të merrte një grua çfarëdo të pamartuar në Izrael (Gjyqtarët 14:3). Megjithatë Sansoni dëshironte seksin tabu. Dhe ky cen i vetëm në karakterin e tij rezultoi rrënimi i tij. Lexoni fjalët e tij të para: “Pashë në Timnah një femër midis bijave të Filistejve; ma merrni për grua” (Gjyqtarët 14:2).

Si iu përgjigjën prindërit e tij ndaj kësaj kërkese? Ata iu lutën të mendohej mirë. Atyre nuk u besohej që ai nuk mund të gjente një grua të perëndishme midis të afërmeve të tij... një grua që do ta miratonte Perëndia. Por Sansoni dëshironte frutin e ndaluar dhe kështu gjeti një vajzë të keqe midis armiqve të tij. Logjika e tij ishte e thjeshtë: “Më pëlqen” (Gjyqtarët 14:3).

Sigurisht, martesë me një grua filistease do të thoshte t’i kthente kurrizin Perëndisë dhe familjes së tij. Nëse ky ishte çmimi, ai ishte gati ta paguante. Edhe pse ishte aq shumë i fortë, Sansoni nuk mund të shpëtonte nga kthetrat e dëshirave të tij seksuale.

Martesa e Sansonit me filisteasen mbaroi në mënyrë tragjike me vdekjen e saj.

Më pas duket se frenoi oreksin e tij seksual për njëzet vjet. Por ndërsa po mbushte dyzet vjet u zgjua oreksi i tij. Ashtu si ariu pas mjaltit, po kështu kompulsionet seksuale të Sansonit e shtynë në krahët e një gruaje tjetër filistease, Delila.

Pasi ishte shuar oreksi i tij për seksin tabu, ai refuzoi të ndalej derisa të merrte atë që donte. Dhe çmimi ishte shumë i lartë. Ai humbi flokët, një simbol i miqësisë së tij me Perëndinë. Ai humbi forcën. Ai humbi reputacionin si një luftëtar i fuqishëm dhe i perëndishëm. Dhe kur filistenjtë kuptuan dobësinë e tij, i nxorën sytë, për të mos parë më kurrë ndonjë prej grave të tyre. Më në fund ai vdiq midis filistejve.

*Nga historia e Sansonit
zbulojmë se çfarë ndodh
kur burrat e mirë tundohen
pa një plan për fitore.*

Cikli i tundimit

Ana pozitive e historisë së Sansonit është se mund të zbulojmë se si ra dhe se si të shmangim një djegie të tillë. E kam ndarë rënien e tij në katër faza të ciklit të tundimit ose atë që psikologët e quajnë cikli i “varësive”.

FAZA E PARË: Shqetësimi

Ashtu si një burrë pa forma dhe mbi peshë është më tepër i prirur për atak zemre, po kështu Sansoni ishte në kulmin për të kryer një mëkat serioz seksual. Ai sapo kishte mbushur dyzet vjeç dhe kishte arritur majën. Ai kishte shtypur filistejtë dhe kishte sunduar Izraelin për njëzet vjet. Ashtu siç u ndodh shpesh burrave që arrijnë një sukses të tillë, atij i mungonte një vizion për pjesën tjetër të jetës, diçka për të shuar zjarrin e tij. Dhe kështu u mërzit. Nuk kaloi shumë dhe mërzitja degradoi në një gjendje të lehtë depresioni.

Burri më i fortë i botës, duke mos pasur një armik për të pushtuar, u bë i cënueshëm ndaj diçkaje që do t’i ndryshonte humorin, ta bënte të ndihej më mirë. Dhe asgjë nuk mund të ndryshonte humorin e tij se sa një grua e bukur, sidomos një grua filistease seksi. Si ajo që shijoi njëzet vjet më parë. Mendoj se vetëm me mendim i ka vërshuar adrenalina për t’i ngritur humorin. Shumë shpejt ai kalon orë të tëra duke ëndërruar për aventurat e tij të hershme seksuale. Ai fantazon për një natë eksituese me një nga prostitutat në Filisti.

Më në fund udhëton për në Gaza. Ai mund të arsyetonte thjesht se si “po kontrollonte si venin punët”. Menjëherë u fut në zonën me drita të kuqe. Kur u kthye në shtëpi kishte energji të reja për fantazitë e tij

seksuale. Tani kishte parasysh fytyrat dhe pamjet e grave që kishte parë. Tani ai mund të imagjinonte hollësitë e joshjes së tyre. Shqetësimi është i lehtë për t'u minimizuar. Mbi të gjitha duket tepër i padëmshëm. Çfarë dëmi do të ketë po të mendosh thjesht të bësh seks me një grua tërheqëse dhe që është gati? Shiko, një vajzë në palestër, në punë apo në kishë? Ndërsa ky arsyetim mund të duket i vlefshëm, nuk duhet të harrojmë që mendimet tona janë farat që mbijnë dhe rriten në veprime që janë të vështira për t'u eliminuar. Dhe ne nuk duam të harrojmë që Jezusi dënoi tradhtinë bashkëshortore në zemër (Mateu 5:28).

FAZA E DYTË: **Ritualizmi**

Ritet janë aktivitete që vënë në praktikë fantazitë tona. Ato janë procesi që ne kryejmë vazhdimisht para se të vëmë në veprim kompulsionet tona. Kur diçka na eksiton, ne e bëjmë në mënyrë të përsëritur. Ne e bëjmë ritual.

Për Sansonin ritualet mund të ishin kthimi në Gaza apo flirtimi me prostitutat: diçka për ta shtyrë sa më afër veprimin për të ndërjetuar e eksitimit seksual. Do të imagjinoja Sansonin duke luftuar me ndërgjegjen e tij. Nuk është për t'u çuditur! Ai ishte udhëheqësi frymëror i Izraelit. Si i justifikonte ai veprimet e tij? Mbase thoshte me vete që gratë judease nuk ishin aq eksituese për një burrë si ai. Dhe përveç të tjerave, me prirjen seksuale të dhënë nga Perëndia, si mund të priste që një grua ta kënaqte atë?

Mund ta ketë bindur veten se nuk po bënte gjë të gabuar; mbi të gjitha nuk kishte pasur marrëdhënie seksuale me këto gra. Teknikisht nuk kishte kryer tradhti bashkëshortore. Por a nuk po i afrohej sa më afër caktit? Ashtu si djemtë sot që kalojnë nga shqetësimi te ritualizmi i kompulsionet të tyre seksuale.

A të bën të mendosh ky diskutim nëse ke rituale edhe ti? Mbase është kanali televiziv që shikon natën apo shfletimi i një reviste në një librari apo vendosja e disa fjalëve në motorrin e kërkimit në kompjuter apo flirtimi me një grua tërheqëse në punë.

Është thelbësore që të dish që sapo të fillosh një ritual, do të veprosh në bazë të kompulsioneve seksuale. Kjo është e sigurt.

FAZA E TRETË: Hedhja në sulm

Në fund, gjatë njërës prej udhëtimeve të tij, Sansoni e kapërceu cakun. Ai fjeti me një prostitutë filistease (Gjyqtarët 16:1). Pasi i rezistoi dëshirës për një kohë të gjatë, pasi luajti me idenë për muaj apo vite, u dorëzua. Sansoni, duke qëndruar në krahët e asaj gruaje, u ndje i gjallë, më i gjallë se shumë vite më parë. Ai kishte rifituar gjallërinë e dashurisë së re. Dhe për të pasur një ndryshim të tillë humori të fuqishëm duhej të shfrenonte epshin e tij dhe ta linte të lirë.

FAZA E KATËRT: Turpi

Pavarësisht se sa e madhe kënaqësia, ndërgjegjja e tij filloi ta akuzonte. Si mund të flejë me një prostitutë një njeri i Perëndisë? Si mund të vinte në rrezik reputacionin e tij? Si mund të injoronte miqësinë e tij me Perëndinë?

Gjyqtarët 16:3 na jep një ide rreth ndjenjave të tij pasi fjeti me një prostitutë. Sansoni ishte futur në dhomën e saj me guxim në mes të ditës. Atij nuk i interesonte se kush e pa. Por pasi ishte kryer akti, ai rrëshqiti tinëz në errësirë, duke shpresuar që askush të mos e shikonte. Dhe ndërsa Sansoni mund të largohej nga prania e asaj gruaje, ai nuk mund të shpëronte nga turpi i tij.

Përsëritja e aktit

Pas asaj nate të vetme me prostitutën, Sansoni mbase u betua të qëndronte larg Gazës. Mbase edhe ti ke bërë një betim të ngjashëm pasi je masturbuar ndërsa ke parë diçka porno në dhomën e një hoteli apo duke vizituar faqe pornografike në internet. Nëse është kështu, atëherë e kupton turpin që ndjeu Sansoni. Dhe mund të dish gjithashtu që kur

kthehet dhimbja e mërzitjes, depresionit apo stresit, po kështu kthehet shqetësimi për seksin, prirja jote për të kryer rituale dhe rënia jote e sigurt në mëkate seksuale e pasuar nga një valë e re turpi.

Kjo i ndodhi Sansonit. Pasi kaloi cakun dëshirat e tij seksuale u shtuan dhe përsëritja që më e lehtë. Kjo është arsyeja se pse u kthye në Gaza dhe fjeti me Delilën.

Historia e akteve seksuale të Sansonit ilustron rrezikun e përsëritjes së ciklit prej katër fazave të tundimit. Kur cikli përsëritet:

- Dëshira për seks rritet
- Dëshira për rrezik rritet
- Dëshira për t'i bërë ballë dobësohet

***Ashtu si një shakullimë vdekjeprurëse
që vë përtokë edhe burrin më të fortë,
cikli i tundimit do të të tërheqë poshtë.***

Më vonë do të tregoj një strategji për të prishur ciklin e tundimit. Ky plan është kaq i rëndësishëm saqë jam i bindur se do t'i sjellë fitoren burrit të ri, burrit të mirë, pra, ty herën tjetër që do të tundohesh.

Para se të kalojmë te ky plan, ne duhet jo vetëm të kuptojmë ciklin e tundimit, i cili shpjegon atë që bëjmë, por duhet të kuptojmë se *pse* mbërthehemi nga mëkatet seksuale. Nëse je gati të bësh këtë zbulim, shfleto faqen.

PËR DISKUTIM

1. Në ç'mënyrë kishat dhe grupet e krishtera krijojnë një atmosferë që shton problemin e epshit seksual?
2. Në ç'mënyrë gratë e tjera krijojnë iluzionin e intimitetit? Nga se ndryshon ky iluzion nga intimiteti i rrallë?
3. Si mund të jetë ndihmë për një burrë lidhja e tij me gruan dhe burra të tjerë për të trajtuar atë iluzion?
4. Cilat janë katër fazat e ciklit të tundimit? Si mund të jetë i rrezikshëm ky cikël kur një burrë futet në të?
5. Çfarë janë ritualet? Cilat janë të tuat?
6. Ashtu si Satani magjeps bukurinë e një gruaje e cila i kalon caqet, po kështu Perëndia mund t'i mundësojë një burri të shohë bukurinë e gruas së tij. Kërkoji Perëndisë të të ndihmojë në këtë drejtim.

5.

Drithërima e dashurisë së re

Feniksi është sa i bukur në dimër po aq i shëmtuar në verë.

Në dimër moti është i thatë, i butë e me diell dhe shumë më i mirë se sa shiu në Portland, Oregon, ku jetoj. Një kaleidoskop i luleve të shkretëtirës qesh me diellin dimëror që nuk ndriçon kurrë, por që nuk djeg kurrë. Lulet gazmore tunden nga era që lëviz me shaka kërcëjtë e tyre. Njerëzit që veshin bluza dhe xhinse me ngjyra të hapura hanë në tryezat përjashta që janë të rrumbullakta dhe mbështeten në gurë të sheshtë model spanjoll që vijnë nga Nju Meksiko. Çadrat e oborrit nuk duhen, sepse të gjithë e duan diellin dhe mirëpresin ledhatimin e butë në fytyrat dhe krahët e tyre. Të gjithë janë të lumtur. Dhe ata qeshin, sepse janë më mirë se sa ata njerëz të mjerë që jetojnë në zonat tmerrësisht të akullta të botës... sidomos Miçigani verior dhe Nju Jorku verior.

Ky është Feniksi në dimër. Dita kur jam këtu është verë. Dielli buzëqesh i djallëzuar ndaj luleve arrogante dhe tashmë të fishkura. Nxehtësia përcëlluese e mesditës i largon fytyrën e qeshur çdokujt që nuk mund apo nuk do të udhëtojë në vende të lumtura në veri kur është freskët, rriten lulet dhe njerëzit ulen jashtë dhe hanë në oborre me kalldrëm. Era e nxehtë përplas kokërriza tepër të nxehta të pluhurit të kuq te makinat, shenjat dhe muret dhe i detyron njerëzit të veshin

mantele të bëra me Kevlar: materiali i përdorur në armatura.

Jam në Feniks në verë dhe nuk ngjan me Feniksin në dimër. Çdo krijesë është ose brenda, duke u përpjekur të futet brenda, duke vdekur apo e vdekur.

Lajmi i mirë është se më dhanë një “çmim të mirë për periudhën e verës” në hotel. Lajmi i keq është se jam me depersion. Por pastaj shikoj që televizori im kap katër mijë kanale. Mbase katërqind. Sido që do të jetë... ka shumë për të kaluar kohën. Dhe kështu qëndroj i ulur në një dhomë të thjeshtë me ajër të kondicionuar, me mure të bardha, tapet me xhufka e që mban era duhan, me grilat e ulura e duke kërkuar kanale.

Dhe tani shikoj një figurë që shton rrahjet e zemrës... një kërcimtare shumë e bukur, me forma të përsosura dhe e veshur pjesërisht. Tërhiqem prej saj ashtu si natën që vështrova komshien nga dritarja. Nuk e fik televizorin. Nuk e stakoj nga priza, por rri ulur dhe kontrolloj kanalet.

Ndërsa cikli i tundimit, të cilin e pamë në kapitullin e mëparshëm, shpjegon se çfarë bëjnë burrat, nuk shpjegon pse janë mbërthyer nga masturbimi kompulsiv apo aktivitete të tjera seksuale. Zbulimi i “pse-së” nuk është i lehtë, sepse gjëra të ndryshme bëjnë që burrat të bëhen kompulsiv nga ana seksuale. Megjithatë ka të paktën katër rryma të zakonshme të mendësisë së shtrembëruar në çdo histori të kompulsimit seksual.

“Mund të rikrijoj rrëqethjen e dashurisë së re”

Duke kujtuar atë përvojë kuptoj se pse më ndikoi aq fuqishëm. Para atij momenti në Arizona mund të mbaja mend vetëm që kisha parë një foto të vetme pronografike në njëzet vitet e shkuara. Kisha ruajtur sytë e mi aq me kujdes saqë refuzoja të lejoja që ndonjë figurë erotike të kalonte portën. Ashtu si një eks i dyfishtë uiski për një antialkoolist, ajo që pashë ishte një goditje e fuqishme.

Kur u ktheva në Portland e diskutova përvojën time me grupin e vëllezërve. Në atë kohë po kërkoja një ide përtej bukurisë së trupit të zhveshur të gruas për të shpjeguar atë që kisha frikë se mos bëhej një

kompulsion seksual. Po përjetoja disa emocione të fuqishme dhe doja të eliminoja burimin e tyre. Ndërsa shokët e mi po flisnin për përvoja të ngjashme që kishin kaluar, kuptova që ndjenjat që përshkruam të gjithë ishin si ato të një adoleshenti të magjepsur. Dukej sikur shikimi i pornos rikrijonte rrëqethjen e dashurisë së re.

Qeshëm ndërsa flisnim rreth dashurisë sonë të parë. Ka diçka për dashurinë e parë të burrit që e bën të veçantë. E kuptoni se çfarë dua të them? Puthja e parë me pasion. Përkëdhelja e parë e... kuptoni se çfarë dua të them. Dashuria e re zgjon ndjenjat dhe emocionet e pakontrolluara që ishin të reja dhe të papjekura. Kjo hapi një botë të re dhe të pazbuluar.

Sigurisht, dashuritë e para zgjasin rrallë. Unë u ndava me të dashurën time dhe më vonë u takova me Sindin. Ramë në dashuri dhe përjetova edhe një herë tjetër gazin e magjepsjes apo dashurisë apo sido që ta quash. Gjatë kohës së ardhjes rrotull isha i dehur në dashuri.

Dhe jam i bekuar sepse pas shumë viteve martesë e duam akoma njëri-tjetrin. Dashuria e pjekur është më e thellë dhe më e vërtetë se sa dashuria e re. Por rrallë siguron “rrëqethjen e dashurisë së re”. Në fakt, ndërkohë që e urrej ta pranoj, ka raste kur ndjej po aq dashuri romantike për Sindin sa edhe për ndonjë prej motrave të mia.

Shumë djem mendojnë se ndjenjat e dashurisë romantike janë masa e vërtetë e dashurisë. Për rrjedhojë, për shkak se ato kanë rrallë ndjenja të tilla për gratë e tyre, ata dalin në përfundimin se nuk kanë rënë fare në dashuri. Me kalimin e kohës ata ndihen si të vdekur emocionalisht si një kufomë. Dhe pastaj papritur shohin një figurë pornografike në monitorin e kompjuterit të tyre. Apo një kolege të bukur dhe që flirton me ta duke vendosur një dorë në shpatull dhe u kërkon të dalin për drekë. Papritur ata përjetojnë një ringjallje emocionale. Rrëqethja e zgjatur dhe pothuajse e harruar e dashurisë së re u kthehet përsëri. Ashtu si një adoleshent që do të kalojë cakun dhe të puthë të dashurën e tij për herë të parë, ata ndihen të eksituar, nervozë dhe të gjallë.

Atëherë, pse tërhiqesh nga faqet pornografike apo lidhjet e palejueshme? Sepse zbulon se si mund të përjetosh përsëri, pavarësisht moshës apo gjendjes civile, rrëqethjen e dashurisë së re. Por ja problemi.

Ligji i pikës së ngopjes¹

Burrat që eksitohen nga pornografia zbulojnë se ajo gjë që i ndez aq shpejt do të bëhet rutinë. Shikimi i një vajze me të brendshme i çon shpesh në figura të tjera, të cilat të çojnë në shikimin e videove. Kjo ndodh ngaqë mëkatet seksuale përfshijnë ligjin e pikës së ngopjes. Që do të thotë se duhet gjithnjë e më tepër stimul për të pasur të njëjtën shkallë kënaqësie. Kujtoni atë puthje të parë dhe se sa shpejt doje të shkoje nga buzët te gjoksi. Mëkatet seksuale janë progresive, sepse çdo përvojë duket më pak eksituese se ajo që vjen më parë apo ajo që një burrë shpreson se do të vijë më pas.

Sapo një burrë e ka joshur një femër, ai e ka vendosur flamurin. Ajo është e tij, të paktën për momentin. Gjuajtja apo ndjekja ka mbaruar. Nëse je beqar, kam lajme zhgënjyese për ty. Shumë burra të martuar e konsiderojnë jetën e tyre seksuale të mërzitshme. Pse? Sepse kanë arritur kulmin e përshkallëzimit me gratë e tyre. Nuk ka sfida. Nuk ka më terren të ri për të zbuluar. Edhe në martesat më të mira, me seksin më të mirë të mundshëm, burrat ndeshen periodikisht me ndjenja të tilla.

Përvoja ime në Feniks më eksitoi si tërheqja ime e vitit të parë për Sintia Rasell, dashuria që ndjeva për zemrën time të gjimnazit dhe dashuria e çmendur që kisha për Sindin. Dhe ashtu si një fëmijë i dashuruar doja më tepër. Sigurisht hasa një rrezik të madh. Për të pasur të njëjtat emocione, duhet të kaloja në hapin tjetër. Drithërima e dashurisë së re mund të ishte e imja, por duhet të shikoja figura më të qarta. Në fund edhe ato u bënë të mërzitshme dhe për të gjallëruar drithërimën, duhet të bëja diçka më të palejueshme dhe të rrezikshme.

Fatmirësisht e ndala procesin para se të shkonte më tej. Por jo të gjithë bëjnë atë zgjedhje. Gjuetia për dashuritë e reja përfshin ligjin e pikës së ngopjes që tërheq burrat të rrisin në mënyrë progresive rrezikun.

1. Term ekonomik: i referohet pikës në të cilën niveli i të ardhurave apo dobive të përfituara fillon të bëhet më i vogël se sasia e parave apo energjive të investuara (*shënim i përkthyesit*).

Kur gratë më pyesin: “Pse burri im është kaq i tërhequr nga pornografia?”, unë i pyes ato: “A e mban mend si adoleshente kur re për herë të parë në dashuri? A e mban mend se sa mirë ndiheshë kur ishte me të dashurin? A e mban mend se si doje të ishe me të në çdo kohë?”.

Shumica e grave buzëqeshin dhe më thonë që e mbajnë mend. “Kështu ndihet edhe burri yt për pornografinë” – u them atyre. “I jep atij drithërimën e dashurisë së re”.

“Identifikimi i vjedhjes”

Burrit që është në kërkim të kënaqësisë së palejueshme i ndodh diçka e keqe. Imazhi i tij për veten ndryshon, ose e konsideron veten siç e shikonte para se të bëhej i krishterë. Nëse po rritet frymërisht, atëherë ai po fillon ta konsiderojë veten si një burrë të ri në Krishtin. Ai, pra, burri i ri dhe i mirë që e ka ndryshuar Perëndia, mbrohet nga fuqia e Perëndisë përmes Frymës së Shenjtë. Por sapo ka filluar të masturbojë para ekranit të televizorit, vizitojë klube striptize apo të tradhtojë gruan me gra të tjera, ai çliron mëkatën e tij me orekset e tij epshore dhe shumë shpejt mendimet dhe veprimet e udhëhequra nga epshi përcaktojnë personin e tij. Në një farë kuptimi mëkati i tij i ka vjedhur identitetin e burrit të ri e të mirë që e bëri Perëndia kur besoi në Krishtin.

Kjo ndjenjë e urrejtjes të vetes dhe turpi prodhon një nivel të rritur dhimbjeje emocionale për të cilat ai burrë duhet të punojë shumë për t’i nënshtruar. Diçka është e sigurt: pasi një burrë i është dhënë për një kohë të mjaftueshme kompulsioneve të tij seksuale, ai humb pamjen e burrit të ri që është bërë në Krishtin dhe e shikon veten, jo si një bir i Perëndisë, por si një njeri vdekatar.

Fatkeqësisht sapo e konsideron veten në këtë mënyrë, vënia në praktikë është e lehtë. Mbi të gjitha ai mund të thotë: “Kështu jam”. Sjellja e tij seksuale është në përputhje me vetëvlerësimin e tij të ulët, i cili mbështetet në dëshirat e mendimeve dhe sjelljeve të tij të ulëta mëkatore.

Këto ndjenja të të qenët i padenjë mund të ushqehen nga përvojat

dhe kujtimet e fëmijërisë. Në Dhiatën e Vjetër Perëndia paralajmëroi vazhdimisht izraelitët që ai do të kujtonte mëkatet e etërve ndaj fëmijëve të tyre (Eksodi 20:5; Numrat 14:18). Kjo është më tepër e dukshme në fushën e kompulsioneve seksuale.

Nuk e konsideroj paralajmërimin e Dhiatës së Vjetër sikur ka një prirje të trashëguar ndër breza që duhet të lidhë, si një zinxhir i pashkëputur, sjelljen e një burri me atë të të atit. Por mendoj se babai modelon sjelljen seksuale që do të priret të ndjekë i biri. Shumë burra, të cilat kanë luftuar me pornografinë, më kanë thënë se e panë në fillim ndërsa po lexonin një revistë që i përkiste të atit, gjyshit, xhaxhait apo ndonjë anëtarit të familjes. Shpesh ata masturbohen ndërsa shikojnë figura erotike. Më vonë ata ndihen fajtorë dhe të turpëruar dhe i thonë vetes se janë të këqinj. Jo vetëm tërheqja ndaj pornografisë vazhdon edhe kur je i rritur, por edhe turpi.

Disa burra vuajnë nga abuzimi seksual si fëmijë. Edhe pse nuk kanë bërë asgjë të keqe, mund të kenë një ndjenjë të thellë pislleku dhe turpi emocional që shkakton frikën se mos ata do të mund t'i braktisin. Një arsye se pse kanë frikë braktisjen është për shkak se prindërit që kanë abuzuar me ta mund t'i kenë kërcënuar të largohen po të tregonin sekretin e tyre. Kërkuesit Eist dhe Mandel vënë re se brenda familjeve në të cilat ka ndodhur incesti, "Kërcënimet të tmerrshme nga prindërit për braktisje ishin teknika më e shpeshtë e përdorur nga prindërit për të kontrolluar apo bllokuar fëmijët e tyre"².

Djemtë që kanë frikë braktisjen ndihen të padëshiruar. Është e lehtë për ta të mendojnë se nëse janë të padëshiruar, ata duhet të jenë të këqinj. Dhe burrat e këqinj bëjnë gjëra të këqija... gjëra të këqija seksuale.

"Askush nuk më donte nëse do të më njihnin me të vërtetë"

Ngaqë burrat ndihen të sigurt me mua, më tregojnë shpesh gjëra për

2. H. Eist dhe A. Mandel, "Trajtimi familjar i sjelljes së incestit të vazhdueshëm", *Procesi familjar* (1967) 7:216.

të cilat kanë turp. Pasi dëgjoj një rrëfim të dhimbshëm, i pyes shpesh: “A ia ke treguar ndonjë tjetri?”. Shpesh ata më përgjigjen thjesht: “Jo”.

Kur i pyes për arsyen, më thonë që ata nuk kanë miq, qoftë edhe gruan e tyre, që mund ta përballojë. Ata e ruajnë për vete për të shmangur refuzimin. Ata nuk mund të imagjinojnë që dikush të dojë një person kaq të papastër, të ndotur dhe të shturur. Ndjenja të tilla mund të bëjnë që një burrë të dalë në përfundimin:

- Njerëzve realë nuk mund t’u zihet besë
- Njerëzit realë nuk do të plotësojnë nevojat e tyre
- Njerëzit realë shkaktojnë refuzim dhe dhimbje

Meqë burra të tillë ndihen të padenjë për dashuri nga njerëzit realë, ka kuptim që ata të priren drejt iluzionit të dashurisë. Në kontrast me vuajtjen e shkaktuar nga njerëzit realë, pornografia dhe masturbimi siguron kënaqësi pa rrezikun e refuzimit. Figurat në internet nuk i zhgënjëjnë kurrë. Ato japin gjithmonë një ndryshim humori. Ato sjellin gjithmonë kënaqësi. Ato japin gjithmonë iluzionin e intimitetit.

“Seksi është nevoja më e rëndësishme”

Burrat që janë rritur në familje abuzive ndonjëherë i drejtohen masturbimit si mjet i edukimit të vetvetes. Në një botë me dhimbje ata gjejnë diçka që i bën të ndihen më mirë. Shpesh natyra kompulsive apo zakonore e masturbimit pasqyron dhimbjen emocionale që po vuajnë. Sa më e madhe dhimbja emocionale, aq më e fortë tërheqja për t’u masturbuar. Djemtë e barazojnë kënaqësinë seksuale me dashurinë, kujdesin dhe sigurinë. Të rriturit, sa herë që përjetojnë dhimbje, i drejtohen menjëherë kënaqësisë seksuale si mjet i përballimit dhe i mbushin vetes mendjen se janë në rregull.

Për burra të tillë nuk ka asgjë tjetër më të rëndësishme në jetë se sa seksi. Ata nuk janë lidhur me prindërit e tyre kur janë rritur, ata janë lidhur me kënaqësinë seksuale. Djem të tillë vendosin nevojën e tyre

për seks mbi nevojat, dëshirat e gruas së tyre. Seksi është i pari para Perëndisë dhe punës. Nuk ka asgjë më të rëndësishme se sa seksi, sepse seksi heq dhimbjen dhe e zëvendëson me kënaqësi.

Dalja nga kurthi

Nuk e kam hasur kurrë të dobishme të jepet një formulë për pastërtinë seksuale dhe të thuhet: “Thjesht ndiq udhëzimet”. Kur mësova për herë të parë që tërhiqesha nga mëkatet seksuale, doja të kuptoja arsyen. Doja të zbuloja se si u shtrembëruan mendimet e mia në mënyrë që t’i ndreq. Shpresoj që ndërsa po lexon këtë kapitull, dhe të mëparshmin, të kesh fituar një kuptim më të mirë të sjelljes kompulsive seksuale dhe me të mendësinë e shtrembëruar. Por mund të pyesësh se sa serioz është probemi yt. Dhe mund të duash të dish se si mund të gjesh çlirim.

Në kapitullin e ardhshëm do të zbuloni fushën e veprimit të problemit tuaj dhe do të mësoni se si mund të çliroheshi nga kurthi, se si të shpëtoni shpirtin dhe të ndërmerreni hapin e parë duke lejuar burrin e mirë brenda jush të bëjë një jetë në liri.

PËR DISKUTIM

1. Si përfshihet ligji i pikës së ngopjes në papastërtinë seksuale? A të vjen ndërmend ndonjë rast kur ke përjetuar këtë?
2. 2Në ç' mënyrë krijon përvoja seksuale jashtë caqeve iluzionin e një dashurie të re? Çfarë duhet të bëjë një njeri për të mbajtur të gjallë këtë iluzion?
3. Pse një burrë i mbërthyer nga seksi i papastër ndjen se të tjerët nuk do ta donin po ta njihnin me të vërtetë?
4. Kur një burrë mendon se është i padëshiruar si tërhiqet ai të veprojë nga ana seksuale?
5. Lexo Psalmin 32 dhe reflekto se si Perëndia trajton njeriun që rrëfen mëkatet e tij (Davidi kishte kryer tradhti bashkëshortore dhe vrasje). Shkruaj disa nga vëzhgimet e tua. Çfarë të sugjeron trajtimi i Perëndisë që i bëri Davidit rreth përgjigjes së Tij kur i rrëfen mëkatet Atij?

*Lum ai
të cilit i kanë falur shkeljen,
ai të cilit i kanë mbuluar mëkatën!*
*Lum ai njeri
të cilin Zoti nuk e padit për paudhësi
dhe në frymën e të cilit nuk ka vend mashtrimi.
Ndërsa po heshtja,
kockat e mia treteshin midis rënkimeve
që kisha tërë ditën.
Sepse ditë e natë
dora jote rëndonte mbi mua,
fuqia ime i përngjante thatësisë së verës.*

Para teje pranova mëkatin tim,
 nuk e fsheha paudhësinë time.
 Thashë: “Do t’ia rrëfej
 shkeljet e mia Zotit”,
 dhe ti e ke falur
 paudhësinë e mëkatit tim.
 Prandaj çdo njeri i përshpirtshëm do të të thërrasë
 në kohën që mund të gjendesh;
 edhe sikur ujërat e mëdha të vërshojnë,
 ato nuk do të arrijnë deri tek ai.
 Ti je vendi im i strehimit,
 ti do të më ruash nga fatkeqësia,
 ti do të më rrethosh me këngë çlirimi.
 Unë do të të edukoj dhe do të të mësoj rrugën,
 nëpër të cilën duhet të ecësh;
 unë do të të këshilloj
 dhe do ta mbaj syrin tim mbi ty.
 Mos u bëni si kali dhe si mushka
 që nuk kanë mend,
 goja e të cilëve duhet të mbahet me fre dhe me kapistër,
 përndryshe nuk të afrohen.
 Të shumta janë dhembjet e të pabesit,
 por ai që ka besim tek Zoti do të rrethohet nga mirësia e tij.
 Gëzohuni tek Zoti dhe ngazëlloni, o njerëz të drejtë;
 lëshoni britma gëzimi, ju të gjithë, o njerëz me zemër të drejtë.

PJESA E DYTË

PRANIMI I BETEJËS

6.

Sa i madh është problemi yt?

Kur isha fëmijë im atë nuk mburrej kurrë për notat e tij. Mendoj ngaqë nuk e kishte mbaruar kurrë shkollën e mesme. U rrit në një familje me nëntë fëmijë në një fermë në perëndim të Teksasit. Ai mësoi në moshë të hershme që kishte një talent për të shkaktuar dhimbje trupore te njerëzit. Talenti i tij mbase vinte nga krahët e tij si herkuli që iu zhvilluan kur ishte djalë ndërsa milte lopët çdo mëngjes. Edhe pse nuk luajti futboll profesional, luajti futboll me shkollën derisa u bë njëzet vjeç. Ai tha se në atë kohë shkolla zgjaste më shumë sepe duhet të lije orët për të punuar në fermë.

Edhe pse nuk e mbaroi kurrë shkollën e mesme apo nuk luajti futboll profesional, ai ishte një boksier profesionist dhe nxorri shumë para duke u shitur sigurime jete naftëtarëve dhe fermerëve të Teksasit perëndimor. Ata e pëlqenin stilin e tij të vrazhdë.

Sido që të jetë, jua thashë këtë që të kuptoni se pse kur isha fëmijë nuk u kushtova vëmendje detyrave të shtëpisë dhe pse nuk i jepja rëndësi sjelljes në klasë dhe pse më pëlqente të zihesha dhe pse dukej se zihesha gati çdo javë.

Babai mburrej për natyrën time jo të qetë. Ai rrallë më pyeste se si ia kaloja në shkollë, por donte të dinte gjithmonë nëse isha futur në

ndonjë zënkë (nëse nuk e keni kuptuar akoma, im atë kishte disa vlera të çuditshme). Ai kishte qejf të mburrej se sa fëmijë i fortë isha. Kujtoj që fliste me miqtë e tij rreth aftësive të mia në zënkat në rrugë. Ai mburrej se si mund të fshikulloja një fëmijë i cili do të më vriste nëse do të ziheshim. Sigurisht, e kuptoja që më mungonte shpejtësia, forca dhe goditja e fortë që e bënte tim atë një luftëtar mizor. Unë e dija që përpiqesha të ndeshesha me fëmijë të cilët mund t'i mundja.

Në moshë të hershme mësova nga im atë: “Mos hiq dorë asnjëherë. Lëri edhe të të hedhin poshtë, por mos hiq dorë. Nëse të gjuajnë, edhe pse të të nxerrin sytë, kafshojnë veshin, kafshojnë hundën apo të mos jesh në gjendje të ndeshesh: mos hiq dorë”.

Të vetmen ndeshje që humba në shkollë, e humba para se të humbisja sytë, hundën, veshin apo të thyeya ndonjë kockë. Por nuk hoqa dorë derisa të dija me siguri që nuk kishte mundësi tjetër për të fituar. Atëherë dhe vetëm atëherë i dorëzohesha një force më të madhe.

Sigurisht, shumica prej nesh nuk do të kapitullonin derisa të dinim se jemi të mundur apo të shikojnë se mposhtja vjen aq shpejt dhe e sigurt si një tren me shpejtësi. Kjo është një arsye se pse shumë djem presin derisa sjellja e tyre seksuale të bëjë që bota e tyre të shkatërrohet para se të pranojnë se po ndeshen me një armik që nuk mund ta mposhtin.

Raporti informues

Duke pasur këtë realitet në mendje, mund të shikosh se pse është thelbësore të kapësh armikun tënd para se të futesh përsëri në ring. Duhet të dish se sa mbizotërim po ushtrojnë mbi jetën tënde kompulsionet seksuale. Për të të ndihmuar në një aspekt të tillë, kam përgatitur një raport informues që ka të bëjë me katër pyetje. Ato kanë si qëllim të të ndihmojnë të përcaktojnë seriozitetin e problemit tënd. Nëse nuk do të jesh plotësisht i sigurt, mos u shqetëso për t'iu përgjigjur pyetjeve, sepse nuk do të vlejë për ty. Mund të kalosh në kapitullin tjetër. Nga ana tjetër, nëse ke një problem, duhet ta njohësh dhe ta pranosh. Pse të presësh derisa të humbësh një sy, një vesh apo të thyesh një kockë për ta

pranuar se po ndeshesh me një kundërshtar që nuk mund ta mposhtësh vetëm?

1. A është sjellja jote sekret?

A po bën gjëra për të cilat refuzon t' u thuash të tjerëve? A ke frikë nëse ata që ndodhen afër teje mësojnë se çfarë po bën, do të të refuzonin apo nuk do të të pranonin (pra, *hapur* dhe me një *emocion të fortë*) veprimet e tua? A po tregon gënjeshtër për të mbuluar sjelljen tënde? Nëse është kështu, po e izolon veten nga ata që do dhe po futesh në një lidhje tepër të varur me një objekt apo përvojë. Dhe po e bën pa marrë seriozisht në konsideratë pasojat afatgjata të veprimeve të tua.

2. A është sjellja jote abuzive?

A krijon sjellja jote seksuale dhimbje (emocionale apo fizike) për vete dhe të tjerët? A është degraduese apo shfrytëzuese ndaj të tjerëve? A shikon porno ku shfrytëzohen vajzat e reja?

A je duke bërë gjithnjë e më tepër akte abuzive? A ndjen kënaqësi kur shikon të tjerët që abuzohen në ndonjë mënyrë? Nuk po flas thjesht për të parit e emisioneve me përmbajtje erotike. Abuzimi mund të ndodhë kur nevojat financiare apo injoranca e një gruaje të re e bën atë një kandidat kryesor për ata që janë në industrinë e pornografisë për ta përdorur si përfitim. Një grua e tillë po abuzohet.

3. A përdoret sjellja jote për të eliminuar ndjenjat e dhimbshme?

A janë veprimet e tua seksuale një përpjekje për të ndryshuar humorin tënd se sa të shprehë dashuri? A masturbohesh apo kërkon ndonjë rrugëdalje tjetër seksuale kur je me depresion, i mërzhitur apo i zemëruar?

Përdorimi i masturbimit për të fshirë dhimbjen apo për të krijuar një ndryshim humori, mund të nxisë një varësi seksuale.

4. A është sjellja jote pa një zotim apo kujdesje të vërtetë?

A po zëvendëson iluzionin e intimitetit të siguruar nga pornografia

dhe masturbimi apo ndonjë formë tjetër të sjelljes mëkatore seksuale, në vend të intimitetit të vërtetë që sigurohet nga një marrëdhënie e shëndetshme?¹

Nëse i je përgjigjur po qoftë edhe njëres prej pyetjeve, je duke zhvilluar një betejë të gjatë në jetën tënde. Sigurisht, mbase e di tashmë këtë. Mbase ajo që kërkon të dish është se në çfarë raundi je... sa të rrahura ke ngrënë².

Në çfarë raundi je?

Për shkak se qëllimi i këtij kapitulli është të të ndihmojë të vlerësosh situatën tënde të tashme, ti jo vetëm duhet të dish nëse ke një problem, por duhet të dish gjithashtu se në çfarë grade është. Përmes kërkimit kam zbuluar që beteja me imoralitetin seksual mund të zgjasë deri në pesë rraunde. Është një betejë që nuk përfundon kurrë në një vend nëse arrin deri në raundin përfundimtar.

RAUNDI I PARË: NXEMJA

Raundi i parë përshkruan burrat që kanë zbuluar kohët e fundit se eksitohen shumë nga gjëra si shikimi i pornografisë apo shkuarja nëpër klube striptizmi. Nëse je në këtë raund, atëherë jeta jote është nën kontroll. Ti po argëtohesh me përvojat e tua të reja seksuale dhe po mban punën në rregull dhe gjithçka duket mirë me gruan apo të fejuarën.

Megjithatë, ti e di se ke duruar disa goditje të forta dhe magjepsja jote me pornografinë, klubet e striptizmit apo telefonatat erotike, edhe pse jo kompulsive, është e rrezikshme. Të shqetëson frika që epshi yt i zgjuar seksual do të pushtojë jetën tënde.

Në raundin e parë një burrë zakonisht nuk do t'i tregojë askujt, sepse

1. Patrick Carnes, I dalë nga hija (Mineapolis: CompCare, 1983, f. 160.

2. Si më sipër, f. 27.

mendon se e ka betejën në kontroll. Ai mendon se nuk ka pse të rrezikojë duke mërzhitur të shoqen apo të prishë reputacionin e tij kur nuk është futur ende në telashe. Nëse je në shërbesë, prijra për të mbuluar gjurmët mund të duket e domosdoshme, sepse puna jote mund të jetë në rrezik.

RAUNDI I DYTË: Shfaqja e dragoit

Gjatë raundit të dytë epshi i burrit ka filluar të ushtrojë kontrollin e saj dhe nuk mund t'i bëjë ballë nxitjeve të tij seksuale. Ai përfshihet në mënyrë kompulsive në gjëra të tilla si masturbimi, pornografia, homoseksualizmi apo zvogëlimi i marrëdhënieve heteroseksuale.

Kur një burrë mbërrin në raundin e dytë, gjëja më domethënëse që ndodh është shfaqja e asaj që psikologët e quajnë personaliteti i varur³. Nga ana biblike ai është bërë skllav i mëkatit (Romakëve 6:16). Më parë përpiquej të mbante epshin e tij nën kontroll, tani ka dalë nga zinxhiri. Epshi i një burri, ashtu si një dragua i egër, është zgjuar nga dremitja e tij dhe kërcënon t'i përpijë jetën. E përjetova këtë natën që pashë nga dritarja e komshies. Kjo më kujtoi herën e parë që piva shumë marjuanë. Pas disa thithjesh, u futa në një botë të kotë në të cilën kërkova të futesha më vonë.

Ka diçka rreth atij qejfi fillestar që njerëzit duan të përjetojnë përsëri. Në mënyrë të ngjashme një burrë që futet në raundin e dytë zgjon dëshirat e fuqishme dhe emocionin e dëshirave të tij epshore për të rikrijuar atë përvojë fillestare. Kur futemi në raundin e dytë çlirohet pjesa e varur e personalitetit tonë dhe mos krijo ide të gabuara për të, bisha kërkon mbizotërim të plotë të jetës tënde.

RAUNDI I TRETË: Shfaqja e shkelësit të ligjit

Nëse një burrë arrin në raundin e tretë, ai ka ndër marrë një hap më

3. Craig Nakken, Personaliteti ngjitës (Nju Jork: Harper & Row, 1988), f. 24.

të madh dhe më të rrezikshëm. Tani sjellja e tij përfshin viktimat dhe shkel ligjin. Veprimtaria e tij përfshin prostitucionin, ekzibicionizmin, vëzhgimin, telefonatat e turpshme dhe prekjen e një personi në mënyrë intime pa pasur pëlqimin e tjetrit. Shumicën e kohës ai konsiderohet më tepër si njeri i bezdisur se sa një kriminel, por sjella e tij bezditëse mund të shkaktojë dhimbje të thelle emocionale ndaj viktimave të tij.

Tërë burrat e mirë arrijnë raundin e tretë. Zor se kalon një javë pa lexuar në lajme historinë e një politikani, mësuesi, atleti profesionist apo ylli Hollivudi që shkon me një prostitutë apo ndërmerr një hap të padëshiruar seksual. Nëse harxhon pak kohë për të kujtuar vitin që shkoi, dyshoj se mund të kujtosh emrin e një drejtuesi të lartë të krishterë sjellja seksuale ilegale e të cilit rrënoi shërbesën e tij dhe lëndoi rëndë familjen e tij.

RAUNDI I KATËRT: **Shfaqja e kriminelit**

Kur një person ka mbërritur në raundin e katërt, nuk është më shkelës i ligjit, po është një kriminel i vërtetë që kryen krime të rënda kundër viktimave të tij. Përdhunimi, incesti dhe ngacmimet e fëmijëve ndodhin në këtë nivel.

RAUNDI I PESTË: **Goditja fatale**

Tani e di se në çfarë raundi je. Ndërsa shumica e njerëzve do të preferonin të shmangnin realitetin sa më tepër të jetë e mundur, do të vijë në fund çasti i së vërtetës. Do të ndodhë diçka që do të të detyrojë të pranosh që jeta të ka dalë jashtë kontrollit. Një ndodhi do të të vërë me shpatulla pas murit me një forcë të tillë sa që do të mendosh nëse do të dalësh ndonjëherë nga ai pozicion.

- Do të lësh në mënyrë aksidentale një imazh pornografik në ekranin e kompjuterit dhe dikush në punë do t'ia thotë pronarit.
- Një prej fëmijëve të tu do të gjejë vendin ku fshihen videot

pornografike.

- Një polic mund të vijë në vendin e punës për shkak se komshiu të ka spiunuar si një person që pëlqen të shikosh të tjerët të zhveshur.
- Gruaja jote do të largohet sepse ke një lidhje tjetër.
- Këshilltari i shkollës do të telefonojë sepse të kanë raportuar te agjensia e kujdesit të fëmijëve se ke prekur atje ku nuk duhet fëmijën e komshiut.
- Ndonjë gazetar investigues do të futet në dhomë dhe do të padisë në televizion.

Për Sansonin çasti i së vërtetës erdhi afër fundit të jetës së tij. I verbuar nga epsi e zuri gjumi në prehrin e Delilës ndërsa berberi filiste i preu flokët. Pak pasi i ra përtokë fija e fundit e flokut, dhe me të, fuqia e Perëndisë në jetën e tij, armiqtë e Sansonit u futën në ring. Ai, i izoluar nga Perëndia, nuk mund t’i kundërsulmonte. Kampioni i Izraelit u bë i verbër dhe lolo pa flokë që zbaviste armiqtë e tij, filistejtë (Gjyqtarët 16:20-21).

Shumë njerëz besojnë se historia e Sansonit përfundon tragjikisht. Nuk është kështu. Edhe pse zgavrat e syve pasqyronin plagët e shëmtuara dhe zinxhirët e fortë mbanin të sigurt kyçet dhe noçkat, flokët e Sansonit filluan të rriteshin. Ajo frazë e vetme flet shumë për gjendjen frymërore të ish-kampionit. Autorit të librit të Gjyqtarëve nuk i interesonte dukja e Sansonit. Atij i interesonte miqësia e tij me Perëndinë. Fakti që floku i tij po rritej, tregonte se miqësia e tij me Perëndia po gjallërohej, rritej, duke u bërë përsëri e fortë. Zoti e fali Sansonin dhe e përdori për herë të fundit. I fuqizuar edhe një herë nga Perëndia, heroi i Judës rrëzoi një tempull të populluar të filistejve, duke shkatërruar më tepër armiq me vdekjen e tij se sa kur ishte gjallë.

Sansoni mësoi në kurrizin e vet atë që duhet të dijë çdo burrë: Perëndia është Perëndia e një shansi të dytë, të tretë e të katërt. Ai nuk heq kurrë dorë nga ne. Pavarësisht se në çfarë raundi je apo sa grushte ke marrë, apo sa herë ke rënë përtokë pa ndjenja, Perëndia nuk do të të braktisë kurrë. Ai është në qoshen tënde. Por për të përjetuar hirin e tij,

duhet të njohësh nevojën tënde. Duhet t'i drejtohesh atij dhe të tjerëve për ndihmë. Kjo nuk është e lehtë. Mbase kupton që ke një problem, por beson ende se mund ta trajtosh vetë. Siç e përmenda në fillim të këtij kapitulli, djemtë urrejnë të pranojnë disfatën.

Nëse ajo që ke lexuar deri tani në këtë kapitull nuk të ka bindur që po ndeshesh në një betejë të humbur kundër një kundërshtari të pamëshirshëm dhe shtypës, mbase disa fjalë nga Bibla do të të ndihmojnë. Në kapitullin e ardhshëm do të zbulosh se si veproi një njeri i madh i Perëndisë në betejën e tij kundër mëkatit. Ide: Ai nuk fitoi derisa kuptoi se nuk mund të fitonte vetëm.

PËR DISKUTIM

1. Pse është ide e mirë të njohësh se sa serioz është problemi yt dhe deri në ç'pikë ka arritur?
2. Cilat janë katër gjërat që tregojnë se një burrë ka një problem serioz? Ndërsa kontrollon këta tregues, çfarë mëson për veten?
3. Çfarë karakterizon çdo raund të një mëkati seksual? Në çfarë raundi je? Pse?
4. Çfarë e bën raudin dy aq të rrezikshëm?
5. Pse duhet të shmangësh raundin pesë?
6. Çfarë na thotë akti përfunditar i Sansonit për Perëndinë? Si të ndikon kjo ty?

7.

Tri mënyra se si mund të humbësh betejën

Nuk arrija të besoja që miku im, një burrë i zgjuar, i shkolluar dhe profesionist, do të bënte një deklaratë të tillë mendjelehtë. Si inxhinier naftë ai fitoi shumë para duke parashikuar problemet para se të ndodhnin në vendet e nxjerrjes së naftës në vende si Teksas, Luiziana, Alaska dhe Amerikën e Jugut. Ai është një lloj personi që e ka idenë se çfarë mund të shkojë keq, e megjithatë, ai thjesht më tha: “Bill, nuk mendoj se mund të kryej një mëkat seksual serioz, si për shembull, tradhti bashkëshortore”.

Nuk e kisha idenë se çfarë e shtyu të bënte papritur një shpallje të tillë qesharake; ne as që po flisnim për seksin. Kështu që e pashë për një çast për të parë nëse po bënte shaka. Kur ruante stilin prej stoiku e një prifti që drejton një funeral, e dija që nënkuptonte biznesin.

“Nëse ajo që po thua është e vërtetë” – i thashë – “atëherë je më i perëndishëm se Davidi: njeriu më i perëndishëm në Dhiatën e Vjetër; më i fortë se Sansoni: njeriu më i fortë në Dhiatën e Vjetër; dhe më i mençur se Salomoni: njeriu më i mençur në Dhiatën e Vjetër”.

Miku im m’i nguli sytë për një kohë të gjatë, duke qenë i pasigurt se çfarë të thoshte. Më në fund ngriti me gisht syzet e tij me skelet briri

mbi hundën e vet me kokëza, anoi kokën e tij të shëndoshë djathtas dhe tha: “Nuk e kisha menduar asnjëherë kështu”.

Në fakt deri në atë moment edhe unë nuk e kisha menduar. Megjithatë sa më tepër mendoj për të, aq më tepër dyshoj që, nëse Davidi, Sansoni apo Salomoni mund të na flisnin sot, ata do të ngulnin këmbë që ne nuk duhet të nënvlerësojmë kurrë fuqinë e epshit seksual dhe mbase mund të na nxisnin të mos besonim për asnjë çast që ne mund t’ia kalonim, kontrollonim apo mposhtnim epshin tonë seksual sapo ai të ketë filluar të ndikojë në jetën tonë.

Qëllimi i kapitullit të mëparshëm ishte t’ju ndihmonte në vlerësimin e seriozitetit të problemit tuaj dhe përcaktimin se sa ka përparuar. Në këtë kapitull dua që të merrni në konsideratë tre mendime biblike nga apostulli Pal, mendime që shpjegojnë se pse metodat që mund të kesh përdorur për të kontrolluar epshin nuk po funksionojnë mirë. Ose, për ta parë nga një këndvështrim tjetër, këto janë mendime që do t’ju tregojnë për tre mënyra për të humbur gjithmonë betejën kundër epshit seksual.

PLANI I PARË PËR TË DËSHTUAR NË BETEJË: **Mposht epshin tënd**

Nëse je i shkurajuar sepse ke shkelur vazhdimisht premtimin tënd për të ndalur sjelljen tënde seksuale kompulsive dhe mëkatore, atëherë merr zemër. Apostulli Pal e ka kuptuar gjendjen tënde të vështirë. Ai u tha romakëve: “Në fakt unë e di se në mua domëthënë në mishin tim nuk banon asgjë e mirë, sepse, ndonëse e kam dëshirën për të bërë të mirën, nuk ia gjej mënyrën. Në fakt të mirën që unë e dua nuk e bëj; por të keqen që s’dua, atë bëj” (Romakëve 7:18-19).

Pali, ashtu si ne, ndeshej me mëkatën. Dhe ashtu si ne e mblidhte mendjen për të mos kryer më mëkat. A ia arriti? Jo! Atëherë, nëse apostulli Pal nuk mund të mposhte orekset e tij mëkatore, a do të mundeshim ne?

Le ta zëmë se e ke mbledhur mendjen se do të arrish tërë ditën të mos dëshirosh një grua. Rrugës për në punë sytë e tu tërhiqen nga një modele me të brendshme që të përshëndet nga një reklamë rruge. Ti thua

me vete se nuk do të shikosh, por epshi yt mbizotëron dhe ti ndjen një nxitje të butë dhe të kënaqshme adrenaline dhe endrofine.

Pak çaste më vonë ndërsa ndalon në një kryqëzim, një vajzë e re që ka veshur minifund, shumë të shkurtër, vjen drejt teje duke të mbuluar pamjen. Ti thua përsëri me veten: “Nuk dua ta shoh”, por shikimi të bën të ndihesh mirë. Kështu që nuk ia ndan sytë derisa drita e semaforit bëhet jeshile dhe shoferi pas teje i bie borisë duke prishur ekstazën tënde.

Në punë një shok mburret për një vajzë të bukur me të cilën ka fjetur mbrëmë. Ti e di që nuk duhet të dëgjosh hollësitë, por ti i dëgjon.

Ndërsa porosit drekën, kamarierja me fund të shkurtër dhe me dekolte të hapur... e ke parasysh, apo jo? Megjithatë, ajo të shkel syrin dhe ti nuk dëshiron të flirtosh, por flirtimi duket i mirë dhe mbi të gjitha, jot shoqe nuk është me ty. Sa herë që kamarierja të afrohet, ti shikon elementët e saj më të mirë dhe ajo të shikon me një buzëqeshje lozonjare.

Kur kthehesh në zyrë zbulon që një shok të ka dërguar një foto erotike. Ti e di që nuk duhet ta hapësh. Thua me vete jo. Por fuqia e epshit tënd është shumë e fortë dhe kështu ti hap foton dhe lejon epshin tënd të zhytet në ngrohtësinë e bukurisë së saj.

Rrugës për në shtëpi ndalon te dyqani i ushqimeve dhe as që përpiqesh të heqësh sytë nga imazhet e modeleve gjysmë të zhveshura që zbukurojnë revistat te banaku.

Kur mbërrin më në fund në shtëpi, ulesh në një divan dhe ndez televizorin. Ndërsa kontrollon kanalet, ti e di se cilat kanale duhet të shmangësh. Por nuk ka asnjëri në shtëpi dhe nuk mund t’i bësh ballë nxitjes për të kërkuar pak mish të ekspozuar femre.

Në rregull, mund të shtiresh dhe të pretendosh që je aq frymëror saqë nuk ke vënë re kurrë një femër të bukur. Por në botën reale përgjigju këtyre pyetjeve: Me nivelin e lartë të stimulimit erotik me të cilin përballësh përditë, a beson se mund të frenosh epshin tënd i vetëm? Sa i suksesshëm ke qenë në të shkuarën? Dhe nëse e shkuara është një tregues i së ardhmes, sa me sukses do t’ia dalësh nesër dhe ditët në vijim?

PLANI I DYTË PËR TË HUMBUR NË BETEJË: **Reformo epshin tënd**

Tani mund të jesh duke menduar: “Mbase nuk mund ta mposht epshin tim, por me siguri mund ta reformoj. Mund ta bëj veten më të mirë”.

Siç e përmenda më herët, flas ndonjëherë me të krishterë të rinj që mendojnë se duke u bërë ndjekës të Krishtit, do të thotë që problemi i epshit të tyre zgjidhet. Mendojnë sikur Jezusi të përdorte një shkop magjik mbi ta dhe, fap, ai heq orekset e tyre mëkatore.

Ata, kur zbulojnë se problemi i tyre me epshin duket më keq se më parë, vendosin se do të studiojnë më tepër Biblën dhe do të luten më tepër. Për çudinë e tyre kjo as nuk e zgjidh problemin e tyre.

Ata, të patrembur, vendosin të mësojnë përmendësh vargje si Jobi 31:1: “Unë kisha bërë një besëlidhje me sytë e mi; si mund ta fiksoja, pra, shikimin mbi një virgjëreshë?”. Dhe ata i kanë premtuar Perëndisë dhe vetes që nuk do të shikojnë me epsh ndonjë grua apo imazhin erotik të një gruaje. Dhe e dini se çfarë ndodh? As kjo nuk funksionon. Në fakt, asnjë prej ushtrimeve të tyre frymërore nuk u siguron një fitore afat-gjatë. Atëherë, ashtu si shumë djem të krishterë, ata heqin dorë. Ose vazhdojnë të përpiqen dhe dështojnë, duke pretenduar ndërkohë që e kanë epshin e tyre seksual nën kontroll, ashtu si djemtë e tjerë të krishterë.

Lexo fjalët e Palit. Te Romakëve 7:10-11 ai ka thënë: “Urdhërimi që duhej të më drejtonte dret jetës, u përdor në mënyrë të qartë për të më zënë në kurth, duke më hedhur kokëposhtë”¹.

Orekstet tona epshore janë aq të këqija sa që përdorin urdhërimet e Perëndisë për të na tunduar. Ashtu si një shkop që përzien pisllekun që është grumbulluar në fund të një ene me ujë, ligji i Perëndisë trazon epshin tonë. Ashtu siç kemi parë, gratë që janë të hedhura, duken më të mira. Perëndia thotë “mos” dhe epshi ynë thotë “bëje”. Perëndia thotë “bëje” dhe epshi ynë thotë “mos”.

1. Eugene H. Peterson, *Mesazi* (Colorado Springs: NavPress, 1993, 1994, 1994), f. 375.

*Përpjekja për të reformuar epshin tonë
është si ta kthesh një qen në person.*

Për trembëdhjetë vjet një qenush spanjoll që quhej Pampkin hijeshonte familjen tonë. Gjatë atyre viteve i mësova Pampkinin të gjitha llojet e trukeve. Ai u bindej urdhërave të zakonit si ulu, shtrihu dhe rrotullohu. E trajnova gjithashtu të kapërcente një rreth, të mbyllte derën, të rrinte ulur mbi këmbët e pasme dhe të shtrihej si i ngordhur kur e gjuaja me një pushkë imagjinare.

Megjithatë, pavarësisht nga trajnimet e mia, nuk mund ta ndaloja Pampkinin të sillej si qen. Ai bënte gjithmonë gjëra që bëjnë qentë. Ai hante jashtëqitjet sikur të ishin biftek. Ai u mbante erë prapanicave të qenve të tjerë sikur të ishin trëndafila. Ai bënte urinën në trotuare. Pavarësisht se sa mirë e trajnova Pampkin, ai mbetej përsëri qen. Përfundimi është ky: qeni mbetet qen.

Në mënyrë të ngjashme, mëkati mbetet mëkat. Oresket e tua seksuale nuk largohen apo përmirësohen kur futesh në kishë. Ato nuk ndryshojnë kur beson në Krishtin. Mund të shkosh në kishë, lexon Biblën, lutesh çdo ditë dhe madje drejton një shërbesë pa reformuar, sado pak, oresket e tua mëkatore.

Pali e shpreh në këtë mënyrë: “Në fakt unë e di se në mua domëthënë në mishin tim nuk banon asgjë e mirë, sepse, ndonëse e kam dëshirën për të bërë të mirën, nuk ia gjej mënyrën” (Romakëve 7:18).

Kur bien nën sundimin e mishit tonë, ajo pjesë e personalitetit tonë që kërkon kënaqësi larg Perëndisë, jemi në gjendje të bëjmë gjithçka të keqe, qofshim besimtarë ose jo. Ne, kur kontrollohemi nga epshi ynë dhe jo Fryma e Perëndisë që vepron te njeriu i ri, nuk mund të kryejmë më vepra të mira njësoj si një qen leshator nuk mund të flasë frëngjisht apo një kone të flasë spanjisht.

Atëherë një djalë që mendon se mund të reformojë epshin e tij, po mohon thelbin e mishit të tij. Ai po mohon mëkatin që banon brenda tij.

Kjo nuk do të thotë se nuk mund të rritesh si besimtar. Me siguri natyra jote frymërore, ana jote e re, njeriu i mirë që është në ty, mund të

rritet në Krishtin. Por në mish, në prirjen e natyrshme tënde mëkatare, nuk do të përmirësohesh.

PLANI I TRETË PËR TË HUMBUR NË BETEJË: **Mos e ushqe epshin**

Një prej problemeve që kam me shumë programe rekuperimi është se theksi i tyre parësor vihet mbi të qenët i përmbajtur apo i përkorë. Ata mendojnë se çelësi për të mposhtur mëkatet seksuale është për të ndaluar sjelljen. Ata e bëjnë planin e tërë për pastërtinë seksuale të qëndrohet rreth “mos të parit”. Shiko, nuk dua që të më keqkuptoni. Ne nuk mund të kontrollojmë epshin tonë nëse nuk reshtim së rrokuri imazhe erotike apo gra seksualisht tërheqëse. Por nëse mund të bëjmë vetëm këtë, nuk do të funksionojë. Ose do t’i kthehemi sjelljes për të cilën po mundohemi aq shumë të shmangim ose të ndërrojmë varësitë. Për shembull, epshi ynë do të transferohet nga seksi te alkooli dhe nëse reshtim së piri, do të zhvendoset te blerja, puna apo bixhozi.

Është e pamundur të mos ushqejmë epshin tonë deri në vdekje. Deri në ditën që do të jemi me Zotin dhe mëkati të mos mbretërojë në ne, do të ndeshemi me mishin dhe epshin që krijon. Mendoj se e përcjell këtë ide në poemën e mëposhtme.

Dragoi

*Gjeta një dragua në hapat e mia
të vogël e të shkathët.
Të lutem qëndro për pak.*

*Çdo ditë do të bëjmë shëtitje.
Mjeshtër e manar.
Ç’janë këto djersë të ftohta?*

*Dhe pastaj pashë që mbante një zinxhir
të gjatë e të lig.
Nuk kam një limë.*

*Gjeta një dragua në hapat e mia,
armik me zemër të rreme
që nuk të lëshon kurrë.*

Dragoi në shpirtin tënd, njeriu i vjetër dhe i keq, do të refuzojë të largohet. Për pak kohë mund ta injorosh. Më vonë mund të ngulësh këmbë se nuk të sundon më. Por nëse shpreson të shpëtosh nga kthetrat e tij, duhet të pranosh fillimisht praninë e tij dhe të pranosh që nuk ke fuqinë për të shpëtuar nga zinxhirët e tij.

Shpresoj që të jesh i lodhur së luftuari në një betejë të humbur. Burra të tjerë, si Pali, ishin të lodhur. Ai thërret me dëshpërim: “Oh, njeri i mjerë që jam! Kush do të më çlirojë nga ky trup i vdekjes?” (Romakëve 7:24).

Nëse një person aq frymëror si Pali kuptoi se po ndeshej në një betejë të humbur kundër mishit dhe dëshirave të tij të këqija, a nuk është koha që edhe ti të arrish në të njëjtin përfundim? E di që heqja dorë nga beteja nuk është e lehtë. Por heqja dorë nga beteja me forcat e tua, është hapi i parë drejt fitores.

Në bazë të asaj që ke lexuar deri tani, shpresoj të kesh kuptuar që dhurata e mrekullueshme që Perëndia të ka dhënë për të vlerësuar bukurinë e një gruaje të zhveshur, mund të shtrembërohet nga epshi yt dhe shpresoj të kesh një kuptim të qartë të shkallës së problemit tënd.

Shpresoj të besosh se nuk mund të sigurosh fitoren kundër epshit tënd pa një plan që të lejon të çlirosh njeriun e ri dhe të mirë që është brenda teje duke përdorur fuqinë e Perëndisë.

Një pjesë vendimtare e atij plani përfshin trajtimin e dëmit që ka hequr shpirti yt në duart e epshit tënd të shfrenuar: dëmtim që njeriu yt i vjetër, mishi yt mëkatar, do të përdorë për të shkaktuar më tepër dëm, i cili mund të shtyjë në sjellje seksuale më kompulsive. Në kapitullin e ardhshëm do të shikojmë atë dhimbje dhe se si Perëndia mund të shërojë plagët që e kanë shkaktuar.

PËR DISKUTIM

1. Pse nuk mund të mposhtësh apo reformosh epshin tënd?
2. A ke mbërritur në fazën kur e di se nuk mund ta mposhtësh epshin i vetëm? Nëse jo, pse jo? Nëse po, pse?
3. A je përpjekur të mposhtësh orekset e tua epshore? Si ka funksionuar? Pse?
4. Në ç'mënyrë je përpjekur për të reformuar epshin tënd? A funksionoi? Pse jo?
5. Pse nuk mund të shuash orekset e tua epshore?
6. Cila është përparësia kur e di se nuk mund të mposhtësh epshin me përpjekjet e tua?

8.

Zvarritu në shpellë dhe nxirr ariun jashtë

Në rregull, po qëndroj para katërqind nxënësve të shkollës së mesme në Kaliforninë veriore, duke dhënë një mesazh me titull: “Pesë idetë e gabuara rreth seksit”. Edhe pse nuk i kujtoj më pesë idetë e gabuara, njësoj siç nuk kujtoj pesë fituesit e fundit të kampionatit të bejzollit, kujtoj diçka që ndodhi gjatë diskutimit.

Ajo gjë më habiti sepse natyra e temës shtyu nxënësit të dëgjonin me atë vëmendje të përqendruar që ia rezervojnë normalisht grupit të tyre të preferuar. Megjithatë ndërsa po flisja disa nga fëmijët qeshnin në mes apo në fund të një fjalie ashtu sikur të kisha thënë një barsaletë.

Unë thoja për shembull: “Qielli është blu” dhe ata qeshnin. Ose thoja: “Perëndia dëshiron më të mirën për ty” dhe ata qeshnin.

Pastaj kuptova se pse po qeshnin.

“Oh, mos!” – thashë me vete. “Kam dyqanin hapur”.

Isha atje me duart në xhep, me dyqanin hapur, duke folur për seksin. E dija menjëherë që sapo nxënësit panë humorin në atë situatë, ata nuk mund të mbanin të qeshurën. Duke ndjerë pështjellimin dhe sikletin tim, shumë nxënës të tjerë morën pjesë në atë gallatë.

Dyshoj se kupton që njerëzit kanë më tepër frikë të flasin në publik se sa për lartësitë, buburrecat, humbjen financiare, sëmundjen, torturën dhe madje vdekjen. Si mendon atëherë se do të reagoje shumica e burrave, pasi kanë mposhtur frikën e të folurit dhe trajtimin para një audience prej katërqind njerëzve, jo, jo njerëzve, por para nxënësve të shkollës së mesme, nëse kuptojnë që çdo nxënës në sallë po shikonte dyqanin e tyre të hapur ose duke qeshur ose duke e mbajtur të qeshurën?

Duke u përpjekur të largoja sikletin dhe ndreqja situatën, u përpoqa me moskokëçarje të kontrolloja zinxhirin. Por si mund ta bësh një gjë të tillë para katërqind fëmijëve që po shikojnë? Me siguri nuk doja të kapja zinxhirin nga frika se mos dukesh sikur po realizoja një imitim para jurisë të Majkëll Xheksonit. Pastaj më erdhi një ide e shkëlqyer: “Do të mbaj Biblën para dyqanit në mënyrë që të mos shikojnë brenda”.

Marr këtë pozicion, por nuk shkon mirë, hiç mirë. Fëmijët vazhdonin të qeshnin vend e pa vend.

Kur mbarova së foluri, ndërsa të gjithë ulën kokat dhe mbyllën sytë dhe unë u luta, u largova nga turma dhe kontrollova zinxhirin. Hëm... ishte i ngritur. Kisha duruar turpin nga sikleti më kot. Pastaj më erdhi një mendim i tmerrshëm: Po sikur të kishin qeshur për diçka që do të shkaktonte edhe më tepër siklet? Shiko, nuk jam paranoiak, por në atë çast ndjeva se do ta zbuloja shpejt të vërtetën që do të shkaktonte poshtërim të gjatë.

Pas takimit një grup nxënësish u mblodhën rreth meje dhe më bënë pyetje si: “A mund të vërtetosh ekzistencën e Perëndisë? A ekzistojnë jashtëtokësorët? Si e zgjidh konfliktin midis mirësisë së Perëndisë dhe origjinës të së keqes?”.

Pasi kalova disa minuta duke iu përgjigjur secilës prej atyre pyetjeve me hollësi, duke përdorur fjalë që nuk i kuptonin dhe nuk mund t'i argumentonin, thashë: “Tani, kam një pyetje për ju”. Ai pohim u tërhoqi vëmendjen më tepër se çdo gjë tjetër. “Pse po qeshnit gjatë fjalimit?”.

“Oh” – tha një vajzë e lezetshme gjashtëmbëdhjetë vjeçare, duke qeshur nën hundë – “për shkak të theksit tënd teksan”.

Psherëtiva aq shumë i lehtësuar sa që ndjeva që shfryrja e ajrit mund

të më rrëzonte si një jastëk me ajër.

“Je e sigurt?” – e pyeta. “Po, jam e sigurt” – tha ajo.

“Oh” – thashë.

Turpi toksik

Edhe pse sikleti nuk është i rehatshëm, nuk është ndonjë gjë e madhe dhe zakonisht shkaktohet kur bën diçka para dikujt për të lënë përshtypje. Shiko, si të pengohesh, të nxjerrësh ushqimin, të harrosh emrin e dikujt apo të dalë në shesh çorapja me vrimë. Turpi i shoqëruar me një siklet të tillë është i shëndetshëm. Na kujton ne që jemi njerëz dhe që të qeshim me gabimet tona.

Por ka një turp tjetër që është toksik. Është si një mbetje radioaktive e ruajtur në 177 fuçi të groposura përgjatë lumit Kolumbia në veriperëndim. Disa nga fuçitë rridhnin material radioaktiv vdekjeprurës në tokë i cili u përhap në lumë. Perëndia nuk projektoi shpirtin njerëzor të shërbejë si një fuçi turpi. Në fund turpi toksik do të rrjedhë duke shkatërruar ndjenjën e respektit për veten dhe do të minojë aftësinë e njeriut për të lidhur miqësi të forta.

Ky turp helmon identitetin tonë si burra, sepse mbështetet në besimin që ne kemi braktisur Perëndinë dhe veten. Dhe është ndryshe nga faji. Faji merret me sjelljen... ajo që kemi bërë. Është një ndjenjë e dhimbshme e veprimeve tona. Nëse kam thënë një gënjeshtër, ndërgjegjja ime më mundon për shkak të veprës së keqe. Ndjenja e një ndërgjegjeje fajtoresh është e shëndetshme, ashtu si dhimbja e shkaktuar nga një përplasje e kohës apo lëndimi i gishtit. Na nxit të ndërmarrim veprim terapeutik për të lehtësuar shërimin dhe parandaluar veprimin për të mbrojtur veten në të ardhmen.

Turpi shkakton një dhimbje më të thellë e më të dëmshme se sa faji, sepse shkaktohet nga mënyra se si shohim veten, se sa një akt specifik. Na mashtron duke e parë veten se si kemi qenë një herë e një kohë në vend të asaj që jemi në Krishtin. Ndryshe nga faji që nxit hapa pozitivë që stimulojnë rritjen dhe nxisin një ndjekës të Krishtit të kujtojë që

është një njeri i ri, turpi vepron si një infeksion i patrajtuar që helmon shpirtin dhe gjymton sjelljen tonë. Ngaqë ai nuk pëlqen atë që është, një njeri i turpshëm reziston të zbulojë veten ndaj të tjerëve dhe vetes. Kjo shprehja e fundit duket e çuditshme, apo jo? Por e vërteta e hidhur është se ai ka frikë të shohë veten nga afër, sepse nuk e pëlqen atë që shikon. Me të vërtetë ai mund të urrejë atë që shikon¹. Ajo që nuk kupton është se ka frikë të shikojë mëkatin e tij dhe dëshirat e veprimet e këqija që prodhon. Është dragoi mëkatar në shpirtin e tij që ai urren.

Disa vjet më parë djali ynë i madh, Rajani, ndjeu një gjendër në testikulin e tij të majtë. E shoqja, kirurge, bëri një analizë të shpejtë dhe tha: “Ke kancer në testikul”².

Edhe pse ky është një lajm që asnjë burrë nuk do të donte ta dëgjonte, të paktën kishte një farë lajmi të mirë, pra, që kanceri në testikul është një ndër format më të kurueshme të kancerit të burrat. Në fakt, nëse kapet shpejt norma e kurimit arrin 100 për qind. Rajanit, disa javë pas zbulimit fillestar, i hoqën testikulin dhe bëri një seri trajtimesh me rreze.

Rimëkëmbja e tij po shkonte mirë dhe një ditë më merr mua në telefon dhe më thotë: “Baba, pata një ndërlikim të papritur pas operacionit”.

“Çfarë është, bir?”.

“Kur eci, anon pak djathtas”.

Si rezultat i operacionit ai kishte dëgjuar disa histori të pazakonta rreth kancerit. Më e çuditshmja kishte të bënte me një djalosh, të cilit i ishte rritur testikuli sa një top sfungjeri. Pas këmbënguljes së nënës, e cila mund të shikonte diçka të mufatur te pantallonat, më në fund shkoi te doktori. Fatkeqësisht kishte kaluar shumë kohë dhe vdiq nga kanceri.

Kur Rajani më tregoi atë histori, pyesja veten se pse ai njeri injoronte

1. John Bradshaw, *Shërimi i turpit që të lidh* (Deerfield, Fla.: HCI; 2005), f. 12-13.

2. Kanceri në testikul është i kurueshëm. Rajani nuk ka më kancer dhe është babai i një fëmijë që nga koha e operacionit. Burrat e rinj kanë një rrezik më të lartë për të pasur kancer në testikul. Kanceri në testikul është kanceri më i shpeshtë midis moshave njëzet deri njëzet e katër, në vend të dytë moshë nga tridhjetë e pesë në tridhjetë e nëntë dhe në vend të tretë moshë nga pesëmbëdhjetë në nëntëmbëdhjetë. Nëse ndjen diçka të pazakontë, bëj një vizitë te doktori.

një ndryshim kaq të dukshëm dhe jo të shëndetshëm në trupin e tij dhe pastaj më ndodhi mua: ai mbase i mbushi vetes mendjen se problemi ose nuk ekzistonte ose do të zgjidhej pa kujdesin mjekësor. Kjo mendësi e tillë zhgënjyese bëri që të shmangte dhimbjen e përballjes me të vërtetën rreth vetes: ai kishte kancer. Por ai e çoi drejt vdekjes.

Burrat veprojnë kështu me turpin toksik që ndodhet brenda shpirtit të tyre. Ata refuzojnë të përjetojnë dhimbjen mendore dhe emocionale që do të krijohej nga një shqyrtim i thellë dhe i menduar i zemrës së tyre. Atëherë, ashtu si ai burrë që nuk bëri gjë me atë testikul të stërmadh, po kështu ata nuk bëjnë gjë për turpin e tyre toksik duke shpresuar se do të përmirësohet. Por nuk përmirësohet. Ai rritet si një tumor vdekjeprurës në shpirtin e tyre.

Një burrë që refuzon të shqyrtojë veten largohet nga Perëndia dhe njerëzit e tjerë. Por ai zbulon gjithashtu që një objekt seksual, apo një imazh ose përvojë, mund të zëvendësojë menjëherë dhimbjen dhe vetminë e tij me kënaqësi dhe një iluzion intimiteti. (Kjo fjali e fundit është e rëndësishme dhe mund ta lexosh përfundi disa herë dhe të kuptosh mirë domethënien).

Fatkeqësisht çdo shikim në një faqe interneti pornografike, çdo shkuarje në një dyqan videosh pornografike, çdo marrëdhënie seksuale brenda një nate, dhe çdo lidhje e palejuar shërben vetëm për të krijuar një ndjenjë më të madhe të padenjësise, turpit dhe urrejtjes së vetes. Ky turp dhe dhimbje e shtuar rrit nevojën për të ushqyer në mënyrë mëkatore oreksin seksual për të shuar dhimbjen dhe zëvendësuar ndjenjat e vetmisë me intimitet të rreme.

Unë, ngaqë nuk jam rritur në qytetin mistik të Lumturisë, ku të gjithë dhe çdo gjë është e përsosur, kur mbusha njëzet vjeç kisha bëra shumë gjëra për të cilat më vinte keq. Ajo që më mundonte më tepër ishte paaftësia ime për të marrë vazhdimisht mendime të mira morale. Besoja se kisha shumë punë për të bërë, por e konsideroja veten të kalbur që në rrënjë. Atëherë si e përballova turpin tim? Pija drogë dhe shkoja pas vajzave për të shuar dhimbjen e vetmisë dhe lëndimit tim. Problemi është ky: sa më tepër zhytesha në drogë dhe seks, aq më tepër turp ndjeja

dhe doja më tepër drogë dhe seks për t'u ndjerë në rregull.

Kur u bëra një ndjekës i përkushtuar i Krishtit, stili i jetës time ndryshoi. Por ndjenjat e mia të turpit nuk u larguan si një ëndërr e keqe kur zgjohesh. Kujtoj që nuk doja të kisha fëmijë vite me radhë pasi u martova sepse kisha frika se do të rriteshin dhe do të ishin si unë. E konsideroja veten plot me të meta dhe, edhe pse nuk drogohesha dhe nuk shkoja pas vajzave, besoja se epshi im një ditë do të zgjohej dhe do të çohej nga shtrati si Rip Van Uikli³.

Shko në shpellë

Trajtimi i ndjenjave të tua të turpit është si të futesh në një shpellë me një ari që fle gjumë. Frika është gjëja më e vogël që shpreson të kalosh. Por nëse kap ariun, mund edhe të gjakosesh. Ariu mund të përdorë putrat e tij për të të ndarë më dysh dhe nofullën e tij për të të shtypur kafkën. Ngaqë shumica e burrave ndihen të pazotë që të mundin një bishë të tillë të rrezikshme, ata shmangin shpellën e errët dhe ariun që fshihet atje.

Ndërsa frika mund të na mbrojë nga rreziku real, ajo ka gjithashtu fuqinë të na pengojë për të mos u përballur me të vërtetën rreth vetes. A nuk i ndodhi kjo Adamit dhe Evës? Para Rënies ata “ishin që të dy lakuriq dhe nuk kishin turp prej kësaj” (Zanafilla 2:25). Çfarë pohimi?! Ata nuk kishin se çfarë të fshihnin nga njëri-tjetri. Adami dhe Eva përjetonin intimitetin me Perëndinë dhe njëri-tjetrin.

Mendoj se personalitetet e tyre apo shpirtrat e tyre, kishin një cilësi kristalore që u mundësonte të shikonin njëri-tjetrin dhe nuk ndodhi kurrë që Adami të mbyllej që të mos lejonte Evën të shikonte mendimet dhe ndjenjat e tij më të thella. Ai nuk kishte asgjë për të fshehur.

Pastaj u fut mëkati në skenë. Gabimet e tyre jo vetëm që i bënë të

3. Rip Van Uikli është një histori e shkurtër nga autori amerikan Uashington Irving, më 1819. Personazhi kryesor, pasi shkon në një pyll, pi një substancë të ofruar nga vendasit dhe pas kësaj e zë gjumi dhe zgjohet pas njëzet vjetësh. Kur kthehet në fshatin e tij, gjithçka kishte ndryshuar. (*shënim i përkthyesit*).

vuajnë fajin, por u bënë me të çara frymërore. Shpirtat e tyre një herë e një kohë të përsosur kishin tani një të metë të ligë, si lëkura pa njolla e një foshnje që preket nga një damkë e nxehtë, duke lënë një plagë të shëmtuar dhe të dhimbshme që kthehet në një të çarë të pakëndshme dhe të pandjeshme. Por faji i tyre kishte depërtuar më thellë poshtë lëkurës. Kishte lënë shenjën e tij të fshehur në shpirtin e tyre.

Me fjalë të tjera, ndryshoi rrënja e pemës. Rrënja nuk ishte më e mirë dhe e shëndetshme; tani ishte e ligë dhe e sëmurë. Thelbi i karakterit të tyre ndryshoi. Ata u bënë mëkatarë nga zemra.

Si reagues ndaj atij realiteti? Ata patën frikë nga Perëndia. Ata patën frikë se ai do të shikonte që gabimi i tyre kishte shkaktuar mëkatën: kishte ndryshuar thelbin e qenies së tyre. Ata patën frikë se ai do të shikonte dragoin e shëmtuar në shpirtin e tyre dhe do t'i refuzonte. Kështu u mbuluan në përpjekje për të fshehur të metat e tyre para Perëndisë dhe njëri-tjetrit. Sa e tmerrshme të shikojë një damkë të shëmtuar në zemrën e tyre një herë e një kohë të përsosur, të shikojë një dragua të tmerrshëm të zvarritej rreth shpirtit të tyre një herë e një kohë të pastër, të ndjeje pemën, rrënjët, trungun, degët dhe gjithçka, që ishte shkatërruar. Gara e tyre për të fshehur tregon se sa pak kemi ndryshuar gjatë mijëvjeçarëve.

*Ashtu si Adami, pasi mëkatoi
edhe ne ulim grilat
në mënyrë që askush të shikojë atë që kemi bërë
dhe kush jemi bërë.*

Ata, kur Perëndia i ballafaqoi, nuk thanë: “Ke të drejtë. Faleminderit që na tregove gabimin tonë”. As që bëhet fjalë! Ata shmangën përgjegjësinë duke i drejtuar gishtin dikujt tjetër. Adami fajësoi Evën dhe Eva fajësoi gjarpërin.

Ashtu si Adami dhe Eva edhe ne përpiqemi me forcë të mbulojmë mëkatën tonë dhe tërë kujtimet e zakonet e turpshme që ka prodhuar. Ne, të kontrolluar nga mishi ynë, kërkojmë që të fajësojmë dikë apo diçka për atë që jemi dhe për atë që kemi bërë. Fatkeqësisht, për aq kohë

sa ia arrijmë të fshehim turpin tonë, ne mbetemi skllëvër të dragoit që banon në shpirtin tonë.

Fatmirësisht Perëndia nuk lejoi Adamin dhe Evën të qëndronin të fshehur. Ai i kërkoi dhe i tërhoqi, bashkë me fajin dhe turpin e tyre, në dritë. Ai nxorri në dritë atë të cilën ata ishin përpjekur aq fort ta fshihnin. Atëherë, dhe vetëm atëherë, ata gjetën intimitet të përtërirë me të dhe me njëri-tjetrin.

Armiku i vërtetë

Sigurisht, ne e dimë për diçka që nuk bëri Adami dhe Eva. Ne e dimë që ata ishin personazhet kyç në betejën midis të mirës dhe së keqes, një betejë midis Perëndisë dhe Satanit. Çështja e vetme që kishte rëndësi ishte kush siguronte mbizotërimin e shpirtave... e mira apo e keqja.

Satani pëlqen të përshpërijë në vesh: “Nëse e merr vesh dikush atë që ke bërë, ata do të të refuzojnë. Mbaje të fshehtë. Nëse nuk e marrin vesh, nuk ka për të të lënduar”.

Ti, ngaqë beson këtë gënjeshtër, fjalët e tij të mbajnë të lidhur pas turpit, si një i burgosur i lidhur me një njeri të vdekur, dhe ti e di, ose mendon se e di, që njerëzit do të të shmangin ashtu siç bëjnë me një kufomë. Nuk është për t’u çuditur që ndihesh i padenjë dhe i frikësuar nëse të tjerët marrin vesh se kush je me të vërtetë. Nuk është për t’u çuditur që një frikë e tillë refuzimi e nxitur nga turpi bën që të vlerësoh më tepër fshehjen se sa miqësinë tënde me Perëndinë.

Fatkeqësisht situata është më e keqe nga sa mendon. Më kujton doktorin që telefonoi një pacient dhe i tha: “Xhon, kam një lajm të keq dhe një lajm shumë të keq. Kë do të parin?”.

“Më thuaj lajmin e keq”.

“Mora rezultatet e analizave dhe të mbeten dy ditë jetë”.

“E tmerrshme” – tha Xhoni. “Prit një minutë: cili është lajmi shumë i keq?”.

“Duhet të të telefonoja që dje” – tha doktori.

Lajmi i keq është se ti mund të vuash nga një formë turpi toksike që

të bën të fshihesh nga Perëndia dhe njerëzit e tjerë, duke ulur dhimbjen tënde me imoralitet seksual. Do të tregoj për lajmin shumë të keq në kapitullin tjetër.

PËR DISKUTIM

1. Si mund të jetë i mirë sikleti për ne? Si ndryshon nga turpi?
2. Si ndryshon faji nga turpi?
3. Pse turpi është i rrezikshëm për shpirtin e njeriut?
4. Pse një njeri i turpshëm nuk dëshiron të shikojë me vemendje vetveten?
5. Si i përshëndeti Perëndia Adamin dhe Evën pasi mëkatuan? Si i ndihmoi kjo?
6. Çfarë mendon se bën Perëndia pasi ti mëkaton? Si të ndihmon kjo?
7. Cila ishte beteja e vërtetë në të cilën u përfshi Adami dhe Eva? Çfarë do të thotë kjo për ne? Meqë je në Krishtin, kush do të fitojë përfundimisht betejën për shpirtin tënd? Si të ndikon sot kjo e vërtetë?

9.

Rrok hirin e Perëndisë

Lajmi shumë i keq është se pas manisë tënde me imoralitetin seksual fshihet një idhull dhe pas idhullit vjen rrotull një demon.

Është e lehtë të mohosh apo injorosh këtë të vërtetë sepse pririmi të mendojmë për një idhull si një lloj shëmbëllyre guri apo metali në formën e një njeriu, si Buda i shëndoshë. Por idhull është çdo gjë mbi të cilën vendosim besimin përveç Perëndisë për të plotësuar nevojat tona më të mëdha.

Te 1 Korintasve 10:19-20 apostulli Pal thotë: “Çfarë them, pra? Se idhulli është diçka? Apo se ajo që u është flijuar idhujve është diçka? Jo, por them se gjërat që flijojnë johebrenjtë, ua flijojnë demonëve dhe jo Perëndisë; tani unë nuk dua që ju të keni pjesë me demonët”.

Pali ç’maskoi idhujt e lashtë paganë dhe zbuloi një demon të shëmtuar. Ata që u ofronin sakrifica shëmbëlltyrave të gurta po adhuronin demonin pas idhullit. Kjo e vërtetë është mjaft drithëruese nëse do të flitej në novelat e Stefën Kingut. Por kjo nuk është trillim. Është Fjala e besueshme e Perëndisë. Kur një njeri i jepet një objekti epshi seksual, ai po përqafton idhullin që është pas atij objekti. Ai po banon së bashku me një frymë të ndyrë. Siç e thashë edhe më parë, besoj se kjo është një arsye se pse mëkatet seksuale ushtrojnë një fuqi

të tillë ndaj njeriut.

Rrokja e hirit të Perëndisë

Ne, kur refuzojmë të shkojmë në shpellë, të rrokim mëkatin tonë, me tërë kujtimet dhe zakonet e tij të turpshme, prej veshësh, dhe ta nxjerrim në dritë, do të pësojmë një tragjedi më të madhe. Jona tha: “Ata që jepen pas kotësive të rreme braktisin vetë burimin e hirit të tyre” (Jona 2:8).

Mund ta jetoja jetën time dhe të humbisja shumë gjëra që nuk do të sillnin asnjë ndryshim. Gjëra si hedhja me parashutë, hedhja me litar nga një lartësi, udhëtimi përçark botës, luajtja golf me një president apo marrja pjesë në kupën e kampioneve. Por ka diçka në këtë jetë që nuk dua ta humbas, sepse nëse e humbas e kam çuar jetën kot. Si? Duke humbur raste të panumërta për të rrokur hirin e Perëndisë. Por më e rëndësishmja në jetë nuk dua të humbas hirin e Perëndisë.

Nuk dua të jem si fëmija që futi dorën në vazon e shtrenjtë. Kur nuk mund ta nxirrte, ai vrapoi duke thirrur tek e ëma. Ajo, kur pa të birin duke tundur krahun si mulli ere në përpjekje për të çliruar dorën nga vazoja, gati sa nuk i ra të fikët... jo ngaqë kishte frikë për të birin, por ngaqë kishte frikë për vazon.

Mamaja, pa shkaktuar panik, asaj mund t’i binte të fikët, por nuk do të shkaktonte panik, gjeti një shishe me detergjent të lëngshëm dhe derdhi pak te dora e të birit. Ajo mbante vazon dhe i tha të birit: “Tërhiqe fort”. Ai murruriti e rënko; fryu e shfryu, tërhoqi e tërhoqi, por nuk mund të hiqte dorën.

Situata u bë e nderë. Pasi dora e djaloshit ishte brenda vazos për vetëm dhjetë minuta, i ati futet në derën kryesore të shtëpisë. Ai vlerësoi menjëherë situatën, u përpoq pa sukses të tërhiqte dorën dhe tha: “Më duhet t’ia pres dorën”.

Sapo dëgjoi këtë shprehje, djali filloi të rënkonte në mënyrë të pakontrolluar.

“Sa për të qeshur” – i tha e shoqja të shoqit me një ton që nënkuptonte: “Je gomar dhe abuzon emocionalisht me fëmijët”.

Ai e tha si shaka. “Në rregull, nuk do t’i pres dorën” – tha ai. “Do të thyej vazon”.

“Mbase mund t’ia presësh dorën” – psherëtiu gruaja me një ton që nënkuptonte: “Mund të bëj edhe unë shaka”.

Pak më vonë babai lidhi me butësi grykën e vazos duke shpresuar të thyejë përgjatë ngjitjes së vazos. Por ajo u copëtua në 236 432 çifëla të mprehta.

Fillimisht mamaja ndjeu një zhgënjim të madh. Pastaj pa diçka që hidhte poshtë çdo lloj arsyeje dhe e bëri të vinte në dyshim zgjuarsinë e birit të saj, i cili vetëm një orë më parë dukej si një fëmijë tepër i zgjuar dhe i talentuar.

Djali rrinte me grushtin e fiksuar mbi tavolinën ku ishin çifëlat e shpërndara të vazos. “Grusht e kishe dorën tërë kohën që po përpiqeshim të ta nxirrnin nga vazoja?” – pyeti ajo.

Toni i pyetjes së saj bashkë me një shikim të sertë e bëri djalin të gëlltitej si një zhabë. [Në atë çast e ëma mendoi për raportet e fundit të mediave rreth zhabave të shumta në zonën Altona të Hamburgut që gëlltisnin gazra dhe shpërthenin, duke nxjerrë të përbrendshmet e tyre deri në një metër distancë]¹. Ajo bëri menjëherë dy hapa pas dhe po shikonte lotët që po i rridhnin të birit në faqe.

“Pse nuk e hape dorën?” – e pyeti ajo.

Djali shpësjelloi gishtërinjtë e tij të mbuluar me sapun duke zbuluar një monedhë argjendi. Ai e pa dhe tha me dënësë: “Kisha frikë se mos humbisja monedhën”.

Ta them me sinqeritet, nuk e besoj këtë histori. Dua të them, si mund të jetë ky djalë kaq budalla? Nuk mendoj ashtu. Megjithatë, edhe pse nuk mendoj se një fëmijë mund të jetë aq budalla, nuk do të etiketoja të marrë një burrë të rritur si ty apo si unë. Ashtu si ai djalë, ne sakrifikojmë hirin e Perëndisë kur shtrëngojmë një objekt epshi. Perëndia thotë: “Lëshoje dhe do të marrësh hirin tim. Mbaju fort dhe do të përdorësh

1. “Misteri i zbulimit të zhabave”, BBC News (27 prill 2005).

fuqinë e hirit tim në jetën tënde”.

Megjithatë ti nuk ke pse të humbasësh hirin e Perëndisë. Mund të lëshosh idhullin që po mban, por duke bërë një gjë të tillë do të të duhet diçka më shumë se thjesht të hapësh gishtërinjtë. Së pari duhet të nxjerrësh jashtë shpellës dhe në dritë gjithçka për të cilën turpërohesh.

Pastaj duhet ta lësh të lirë. Sapo të bësh këtë, do të zbulosh se ke lëshuar gjithashtu objektin e manisë tënde seksuale dhe të nisësh rrugën e pastërtisë seksuale.

Apostulli Gjon foli për dobitë e të jetuarit në dritë kur tha: “Por, po të ecim në dritë, sikurse ai është në dritë, kemi bashkësi njeri me tjetrin, dhe gjaku i Jezu Krishtit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat” (1 Gjonit 1:7). Pastërtia ndodh kur nxjerrim mëkatin tonë në dritën e pranisë së Perëndisë.

Mjaft luajte topadjegësi

Nxjerrja e turpit në dritë do të thotë që duhet të reshtim së luajturi topadjegësi me të vërtetën përsa i përket vetes tonë. Në fillim të shekullit loja filloi të luhej shumë. Dyshoj se kjo është për shkak të filmit me të njëjtin titull me aktorët Vins Von, Kristin Tejllor dhe Ben Stiller.

Kur isha fëmijë më pëlqente të luaja topadjegësi. Por unë nuk luaja thjesht për hir të lojës. Unë e zotëroja lojën.

Në atë kohë shokët e klasës mendonin se unë isha i destinuar për në podiumin e nderit. Me anë të lojës tregoja shpejtësinë, shkathtësinë, forcën dhe guximin tim. E vërteta prekëse është se klasa e nëntë ishte viti më i mirë i jetës time... nga ana atletike.

Gjatë atij viti arrita majën e aftësive të mia atletike. Kujtoja që bleva një bluzë futbollit disa numra më të madhe në mënyrë që të më bënte edhe pas një apo dy vjetësh. Por nuk u zgjata më. Nuk u bëra më i shpejtë se aq. E kam akoma atë bluzë të bardhë në dollap dhe e mbaj mend që më rrinte si një qese patatinash. Sa herë që e shoh trishtohem për shkak të ëndrrave të prishura që më përcjell. Po të kisha qenë më i madh, më i shpejtë, më i fortë, më i gjatë dhe një kundërpërgjigje më

të lartë ndaj dhimbjes mund të kisha qenë një mbrojtës i kombëtares.

Sido që të jetë, në kulmin e jetës time atletike, unë nuk isha thjesht i mirë në lojën e topadjegësit, por isha fantastik. Isha i shpejtë si vetëtimë dhe shmangia gati çdo top që më gjuanin. Nëse nuk e shmangia, e kapja dhe e hidhja, jo ‘e hidhja’ është fjala e gabuar, e përplasja topin ndaj kundërshtarit dhe ai dilte nga loja. Oh, kujtimet e venitura të madhështisë fëminore.

Edhe pse nuk e ke luajtur këtë lojë apo ke vite që nuk e ke luajtur, është një lojë tjetër në të cilën je i zoti: topadjegësi frymëror. E di që tingëllon banale, por kjo është e vërteta. Shumica e djemve janë ekspertë në shmangien e përgjegjësive duke ia hedhur atë dikujt apo diçkaje tjetër. Duke shmangur përgjegjësinë ne shpresojmë të shmangim vuajtjen që ndodh kur shohim dhe përqafojmë anën tonë mëkatore.

M. Scott Peck, në librin e tij “Njerëzit e gënjeshtres”, përshkruan njerëzit që i kushtohen ruajtjes së një dukje pastërtie morale. Ata janë të vetëdijshëm për të keqen e tyre, por përpiqen me zell të shmangin këtë vetëdije. Ai përkufizon një person të lig si dikush që “angazhohet vazhdimisht në fshirjen e evidencës së të keqes së tyre nën rrogazin e vetëdijes së tyre”².

Fatkeqësisht meqë njerëzit e këqinj duan të shmangin apo të maskojnë të ligën e tyre, përfshihen zakonisht në kisha³. Pse? Sepse duke veshur rrobën e aktivitetit fetar mund t’i mbajnë të fshehtë vetes dhe të tjerëve natyrën e vërtetë të shpirtit të tyre.

Dy miqtë që përmenda në historinë hyrëse të këtij libri kishin veshur kostumet solemne të perëndishmërisë së tyre. Ata kishin drejtuar grupe të vogla dhe kishin shërbyer në këshillin e kishës pa pikasur askush që ata po shikonin fshehtëzi një komshi nga dritarja e shtëpisë së tyre. Disa burra bënë një jetë të dyfishtë për dhjetra vjet.

2. M. Scott Peck, *Njerëzit e gënjeshtres* (Nju Jork: Simon & Schuster), f. 76.

3. Si më sipër, f. 76.

Përballja me sekretet e pista

Sigurisht, si mëkatarë jemi në gjendje të bëjmë pothuajse gjithçka. Çështja është: Çfarë do të bëjmë për prirjen tonë ndaj të keqes? A do të vazhdojmë t'i shmangemi të vërtetës apo do ta lemë të na përplasat në fytyrë? Nëse e lëmë të na godasë, nëse e lejojmë që e vërteta të na gozhdojë, atëherë duhet të shikojmë të fshehtat e pakëndshme rreth familjes dhe vetes tonë. Të fshehtat që përdor mëkati ynë për të krijuar turpin që nxit shumicën e sjelljes tonë kompulsive seksuale:

- Të fshehtat rreth abuzimit fizik dhe seksual.
- Të fshehtat rreth alkoolizmit dhe zënkat e vrazhda familjare
- Të fshehtat rreth varësive tona dhe pasojave të rënda që rrjedhin prej tyre
- Të fshehtat për të metat për të cilat nuk flet kurrë
- Të fshehtat për sjelljen tënde seksuale

Të fshehtat si këto janë burimi i turp-it tënd. Ato janë arsyeja se pse beson se nuk do të dojë askush nëse do ta marrin vesh. Ato janë arsyeja se pse i mban të tjerët, edhe ata më të afërmit, në distancë.

Merr përsipër përgjegjësinë

Është e rëndësishme të kuptosh që ato sekrete nuk janë justifikime. Ato nuk justifikojnë sjelljen tonë. Ato janë thjesht e vërteta e hidhur rreth të shkuarës dhe së tashmes tonë. Ato janë mendime dhe kujtime që ushqejnë ndjenjat tona të turp-it. Ne jo vetëm duhet të përballemi me ato sekrete, por duhet të identifikojmë si dhe kur kemi fajësuar të tjerët për problemet tona.

Disa vjet më parë, ndërsa po bëja një intervistë të drejtpërdrejtë në radio, një telefonues tha: “Mendoj se kishat duhet të bëjnë diçka për mënyrën se si vishen gratë e reja”. Pastaj përshkroi me shumë hollësi se si gratë e reja, duke theksuar fjalën e reja, visheshin në kishën e tij saqë

mendova se po gulçiste në telefon. Me një trazim dhe ngacmim gjithnjë e në rritje tha: “Pse këto vajza vijnë në kishë duke veshur minifunde dhe dekolte. Mund të shikosh kraharorin e tyre të hapur. Atyre u duhet thënë që të mbulohen”.

Pasi e mbylli telefonin dhe dëgjonte radion e tij, mendoj se do të ketë mbetur i çuditur nga përgjigjja ime. I thashë atij: “Kur kisha fillon të lejojë veshjen, atëherë të jesh i sigurt që njerëzit jashtë kishë nuk do të futen më në derë. Thjeshtësia është karakteristikë e pjekurisë. Ndërsa një grua rritet frymërisht, Fryma e Perëndisë do ta shtyjë atë të vishet me thjeshtësi”.

Pasi thashë atë pohim hyrës shtova: “Por, zotëri, problemi i vërtetë nuk është se si vishen gratë në kishën tënde. Është paaftësia jote për të kontrolluar se ku të shikosh. Nuk do të jesh kurrë në gjendje të kontrollosh se si vishen gratë përqark teje. Por ti mund të kontrollosh se ku zgjedh të shikosh”.

Ai, duke fajësuar gratë e reja në kishën e tij për veshje jo të hijshme, hiqte nga vetja fajin. Ne duhet të kuptojmë që

gratë që vishen në mënyrë sugjestionuese nuk duhet të fajësohen për

sjelljen tonë seksuale shkatërrimtare,

prindërit tanë nuk duhet të fajësohen,

gratë tona nuk duhet të fajësohen

ata që bëjnë pornografi, prostitutat dhe kërcimtarët nuk duhet të fajësohen.

Atëherë kë duhet të fajësojmë? Shiko në pasqyrë. Ai që shikon në pasqyrë është përgjegjës që të ka futur në telashe. Kjo është e vërteta shqeto që duhet të rrokësh. Është ai që zgjedh të lejojë mëkatin, mishin dhe orekset e tij kafshërore të kontrollojnë mendimet dhe veprimet e tij.

Dhe ngaqë ai burrë në pasqyrë është një burrë i ri në Krishtin, një burrë i mirë në të cilin banon Fryma e Perëndisë, nuk pse të jetojnë me atë gënjeshtër.

Tri lista

Kalo pak kohë tani apo kurdo të gjesh një vend të qetë e pa të bezdisur njeri. Në tri fletë letër shkruaj listat e mëposhtme:

- *Lista numër një*: Identifiko çdo të fshehtë të turpshme që mund të të vijë ndërmend.
- *Lista numër dy*: Identifiko çdo justifikim, shfajësim (diçka që justifikon apo e bën të duket në rregull atë që ke bërë) dhe arsyen e rremë për veprimet e tyre në vend të arsyes së vërtetë që ke dhënë për sjelljen tënde.
- *Lista numër tre*: Identifiko ata njerëz që ke fajësuar për situatën tënde të tashme.

Bërja e këtyre listave është vendimtare. Të mundëson identifikimin e atyre kujtimeve që ke fshehur, të cilat i ke përdorur për të ushqyer turpin tënd. Të mundëson mos lejimin e mishit tënd të të mashtrojë për të fajësuar rrethanat dhe njerëzit e tjerë për problemet e tua. Sapo të kesh bërë listat, je gati për hapin e radhës.

Thuaji Perëndisë

Deri tani vetëm ti i ke parë gjërat e tua. Tani është koha që t'ia tregosh dikujt tjetër. Të inkurajoj t'ia paraqesësh Perëndisë meqë ai di tashmë për atë lloj që je dhe që ke bërë.

Askush nuk e ilustron më mirë se çfarë duhet të bësh se sa djali plangprishës (Luka 15:11-32). Ai ishte personi që kishte arsye për të pasur frikë refuzimin. Ai, duke pritur me padurim të plotësonte orekstat e tij epshore, kërkon pjesën e tij të trashëgimisë së të atit. Duhet të ketë qenë një bisedë interesante.

“Baba, a do të ma japësh tani pjesën time të trashëgimisë?”.

“Do ta marrësh kur të vdes unë”.

“E dua tani”.

“Bir, do ta marrësh kur të mos jem më unë”.

“Po, por, baba, ti dukesh mirë me shëndet dhe unë nuk mund të pres aq gjatë”.

“Si e ke planin?”.

“Të largohem nga ty aq më tepër të jetë e mundur që të bëj atë që dua”.

“A e kupton se çfarë po thua?”.

Kështu i ati shiti gjysmën e pasurisë së tij dhe ia dorëzoi paratë birit të tij.

Ajo shumë e madhe parash e bëri atë djalë shumë popullor në “vendin e largët”. Çfarë jete qejfi duhet të ketë bërë. Shtëpia e tij tejmbushej me miq, gra të bukura, verë dhe gra edhe më të bukura. Ai pagoi për çdo fantazi që mund të imagjinojë një burrë.

Pastaj i mbaruan paratë dhe miqtë e braktisën. Nuk ka si të gjendesh larg nga shtëpia pa miq, pa para dhe pa punë. Ai, i dëshpëruar, gjeti një punë për të ushqyer derrat. Është e çuditshme se si një stomak bosh mund të shtyjë një njeri të ulet me derrat e të hajë darkë.

Pastaj ra në llumin e stallës së derrave. Nga ajo pikë epërsie shtëpia dukej shumë më mirë dhe ushqimi i babait dukej më i shijshëm. Pastaj kuptoi se askush prej shërbëtorëve të babait nuk hante me derrat.

Duhe të jesh tepër i dëshpëruar të kthehesh në shtëpi te babai të cilin e ke pështyrë, por ngaqë erdhi në vete, kuptoi se i përkiste shtëpisë ku ishte babai. Edhe po të kishte një punë si një prej shërbëtorëve, ai duhej të kthehej tek i ati. Ai, i mbushur me turp, u drejtua për në shtëpi. Në çdo hap ai shqyrtoi edhe një mëkat tjetër që kishte kryer kundër babait të tij.

Arsyeja se pse Jezusi e tregoi atë histori ishte të edukonte drejtuesit e lashtë fetarë se si i konsideron Perëndia mëkatarët që kthehen në shtëpi. Mëkatarët si ty dhe unë. Burrat që kanë kryer disa mëkate serioze seksuale pyesin veten se si do të përgjigjet Perëndia nëse kthehen tek ai.

Perëndia të do

Ajo që nuk dinte djali plangprishës ishte se i ati mbante një sy nga

rruga që të çonte në shtëpi. Ditë pas dite ai lutej për kthimin e birit të tij. Ditë pas dite ai shikonte atë rrugë, duke shpresuar të shikonte ecjen plot besim të të birit duke shkuar drejt tij. Shiko, kur djali plangprishës u largua, ai mori me vete një pjesë të zemrës së të atit dhe për aq kohë sa qëndroi larg, i ati jetoi pa atë copë të zemrës. Dhe ai e dinte përsëri atë pjesë.

Mendoj se një prej dhimbjeve më të mëdha me të cilën jeton babai i djalit plangprishës shkaktohet nga frika se do të jetojë pa të birin. Jo, më keq se kaq. Ai brengoset për vdekjen e të birit ashtu sikur të kishte vdekur. Është një pikëllim i zgjatur që ka fuqinë të ngadalësojë kalimin e kohës, e vjetëron personin dhe krijon një trishtim që të shoqëron si hije.

Kush është ai i marrë që mendon se një baba i tillë do ta dojë më pak djalin e tij vetëm se ka mëkatuar? Megjithatë djali plangprishës mendoj një gjë të tillë dhe po kështu mendojnë shumica e njerëze. Por në çastin që babai pa djalin e tij, atë të cilin e mendoj të vdekur, ishte gjallë dhe po ecte drejt tij, ai zbriti në rrugë për ta takuar. Para se i biri të mund të shqiptonte rrëfimin e tij, i ati e përqafoi dhe e puthi.

Jezusi dëshiron që ne të dimë se Perëndia ka ndjenja për njerëzit si ty dhe unë, njerëz që i kanë kthyer kurrizin dhe kanë bërë gjëra të marra dhe mëkatore.

Perëndia të pranon

Nuk është për t' u çuditur që djali plangprishës nuk priste një zyrë komode dhe një makinë në dispozicion kur të kthehej. Ai do të ishte i lumtur me pastrimin e banjove. Por i ati bëri atë që nuk e priste. Ai e riktheu në një pozicion nderi dhe ndikimi.

Kur një burrë ka humbur vitet e jetës së tij është e natyrshme që të ndihet i keqardhur. Jo thjesht për shkak të dëmit të shkuar që ka bërë, por për shkak se ka sakrifikuar të ardhmen e tij. Ai është i sigurt se Perëndia do të hedhë në koshin e plehrave. Ai e di se jeta e tij do të jetë një histori me potencial të porealizuar. Mbi të gjitha si do të mund të përdorte Perëndia një person me një të shkuar të tillë të ndyrë.

Në vend të një dore të tendosur, babai i djalit plangprishës i dha të birit një rrobë, një unazë dhe sandale, sepse ai e pranoi atë plotësisht: pa asnjë kusht. Ai do të merrte nderin, autoritetin dhe punën e një biri.

Për shkak se kam bërë më shumë gjëra të këqija se të tjerët, jam mirënjohës që Perëndia përdor burra të rënë. Mbase kjo është arsyeja se pse historia e mohimit të Pjetrit ndaj Jezusit më frymëzon. Jezusi, pasi informoi Pjetrin që ai do ta mohonte se e njohte për tri herë, tha: “Por unë jam lutur për ty, që besimi yt të mos mpaket; dhe ti, kur të jesh kthyer, forco vëllezërit e tu” (Luka 22:32).

Dyshoj se ato fjalë patën një kuptim të veçantë për Pjetrin kur u ndje më vonë si një kockë e thyer. Ai duhet të ketë gjetur shpresë në faktin se Jezusi jo vetëm parashikoi mohimin e tij, por edhe pendimin dhe dobinë e tij të ardhshme. Perëndia i do djemtë plangprishës si ty dhe unë. Ai pëlqen të marrë burra të rënë dhe ta bëjë pjesën tjetër të jetës më të mirën e jetës së tyre.

Perëndia feston miqësinë tënde

Çfarë gostie! I ati përgatiti një gosti, solli një grup muzikor dhe ftoi të gjithë ata që njohte. Pse? Sepse djali të cilin mendonte se kishte vdekur ishte kthyer i gjallë në shtëpi.

Sa ndryshe do të kishte qenë skena e gostisë nëse djali nuk do të ishte kthyer kurrë në shtëpi ngaqë kishte frikë nga refuzimi i të atit. Jeta e Jezusit e bën të qartë që Perëndia pranon mëkatarët dhe feston miqësinë e tyre.

A e ke parasysh atë listën për të cilën të inkurajova të bëje disa faqe më parë? Atë për të cilën shpreson të mos e shohë njeri? Atë që mendon se Perëndia do të rrudhë vetullat? Shiko, në çastin që ia tregon Perëndisë, ai do të japë sinjalin për të nisur festimin në qiell me konfeta, drita vezulluese dhe bilbila festash. Nuk ka asgjë tjetër që t'i japë më tepër kënaqësi se sa miqësia me ty dhe asgjë tjetër nuk do t'i japë më tepër gëzim se sa paraqitja jote e mendimeve dhe kujtimeve të turpshme në dritën e pranisë së tij në mënyrë që ai të të falë, pastrojë dhe përgatisë

për të të përdorur në të ardhmen.

Pranoje veten siç bën Perëndia

Sigurisht shërimi nga mendimet dhe kujtimet e turpshme nuk do të ndodhë gjatë një nate. Akoma do të ndeshesh me frikën e refuzimit dhe braktisjes. Meqë mund t'i përsërisësh gjërat, mund të të pushtojnë mendimet e dënimit të vetvetes. Mund të thuash me vete: “Është e padobishme. Nuk arrij që ta zgjidh këtë problem” ose “Ja, pra, e bëre përsëri! I ke rrëfyer mëkatin Perëndisë dhe ke bërë përsëri të njëjtën gjë. Nuk vlen për gjë!”.

Herën tjetër që të dëgjosh zërin që të pëshpërin ato mendime, ndalu dhe thuaji vetes: “Këto mendime nuk vijnë nga Perëndia. Ato janë gënjeshtër. Ato përshkruajnë njeriun tim të vjetër. Ato mohojnë identitetin tim si njeri i ri në Krishtin”. Kujto, një prej roleve kryesore të Satanit është të padisë njerëzit e Perëndisë dhe t'i sakatojë me faj e turp (Zbulesa 12:10).

Pasi i ke thënë këtë vetes, duhet të zgjedhësh të neutralizosh gënjeshtren me të vërtetën. Duhet t'i thuash vetes: “Perëndia më do pa kushte. Ai më ka bërë një njeri të ri në Krishtin. Pranoj dashurinë e tij dhe identitetin tim të ri. Unë e dua veten”.

Sa herë që gënjeshttrat rreth vetes fillojnë të futen në kokë, thuaji vetes këtë. Nëse je vetëm, thuaje me zë të alrtë. Thuaje shpesh! Për vite me radhë i ke thënë vetes që je një person i tmerrshëm. Perëndia po transformon mendjen dhe karakterin tënd, por do të duhet pak kohë që të mësohesh me identitetin tënd të ri. Megjithatë, nëse flet me zell me veten në këtë mënyrë, do të fillosh ta shohësh veten ndryshe dhe ndërsa e shikon veten ashtu siç të shikon Perëndia, mendimet dhe veprimet e tua do të ndryshojnë.

Ne, ngaqë kuptojmë se shumica e dashurisë është me kushte, kemi studiuar dhe praktikuar që ta bëjmë veten më të dashur. Ne bëjmë atë që mundemi që të bëhemi më të mirë, të vijmë erë më të mirë dhe të dukemi më të mirë. Ne përpiqemi të veshim kostumin e suksesit që i thotë botës

se jemi të denjë për respektin dhe dashurinë. E kuptoni se çfarë dua të them: makina, veshje, shtëpi, pushime, zyra dhe çdo lloj lodre.

Sido që të jetë, ka kuptim meqë jetojmë në një lloj bote me mendësinë “fito respektin dhe dashurinë time”, ne do të përpiqemi të fitojmë dashurinë e Perëndisë. E vërteta është se nuk mund të bëjmë asgjë për ta bërë veten më të pëlqyeshëm para Perëndisë. Ai nuk do të donte më tepër nëse do të ishte i përsosur. Dhe ai nuk do të të donte më pak ngaqë nuk je. Ai të do ashtu si je. Nëse refuzon të besosh se ai të do, po e quan Perëndinë gënjeshtar. Je duke nënkuptuar që ti mund të përcaktosh vlerën tënde më mirë se Perëndia. Vetëm një i marrë do të mendonte një gjë të tillë. Oh po, e kam thënë tashmë që këta njerëz janë ndonjëherë të marrë. Atëherë, kur të vijnë mendime të tilla, kujto që një mendësi e tillë është idiotësi dhe jo e vërtetë.

Jezusi dëshiron të kuptojmë realitetin e dashurisë pa kushte të Perëndisë. Jam i bindur se pse natën para se të vdiste u lut që të gjithë besimtarët të jetonin në unitet që bota të dijë, dhe kjo fjali më heq trurin sa herë e lexoj: “që ti më ke dërguar dhe *që i ke dashur, ashtu si më ke dashur mua*” (Gjoni 17:23, fjalët më të pjerrëta nga autori). A e kuptove fjalinë e fundit? Jezusi tha që dëshiron të dimë se Perëndia na do po aq sa do edhe atë. Perëndia Atë të do po aq sa do Jezusin. Ai të do ty, djalin e tij me të meta, po aq sa do edhe djalin e tij të përsosur.

Të thuash: “Pranoj dashurinë e Perëndisë dhe identitetin tim të ri”, neutralizon zërin e gënjeshtërt të mëkatit tënd që ushqen ndjenjat e tua të turpit. Sa herë që përsërit atë fjali, je i lidhur me dashurinë e Perëndisë. Dhe dashuria e tij të ka transformuar dhe do të vazhdojë të bëjë një gjë të tillë.

Sistemimi i shtëpisë tënde

Procesi i ndryshimit vetjak ndodh gjatë rrjedhës së jetës tonë sepse duhet një jetë e tërë për të filluar të kuptojmë se kush jemi si njerëz të rinj në Krishtin. Tani që ke nxjerrë të fshehtat e tua të turpshme në dritë, hapi tjetër ka të bëjë me vendimin se kujt do t’i shërbesh: epshit tënd

me orekset e tij prej dragoi apo Krishtit.

PËR DISKUTIM

1. Si mund të jetë mëkati seksual një formë idhujtarie? Çfarë thotë apostulli Pal se fshihet pas idhullit? Si ndikon tek ty kjo e vërtetë?
2. Si luajnë burrat topadjegësi frymëror? Pse e luajnë këtë lojë?
3. A e luan ti këtë lojë?
4. Cilat janë të fshehtat në jetën tënde të cilat dëshiron t'i mbash të fshehura? A i ke thënë ndonjëherë ndokujt për to? Si mendon se do të përgjigjesh po t'u tregosh?
5. 1 Gjonit 1:9 flet se si Perëndia do të përgjigjet nëse i tregojmë mëkatet atij. Vargu thotë: “Po t'i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi”. Cilat janë dy gjërat që do të bëjë Perëndia kur ia rrëfen atij?
6. Paraqiti para Perëndisë tri listat që ke bërë. Rrëfeja mëkatet e tua atij.
7. Cili është rezultati i rrëfimit tënd?
8. Si ndikon tek ty njohja se Ati yt qiellor të do, të pranon dhe bën festë për miqësinë e tij me ty?

PJESA E TRETË

GJETJA E LIRISË

Llogaritja e kostos

Zakonisht bëja ski në ujë me këmbë zbathur. Më shtohet adrenalina e kur rrëshqisja përgjatë ujit të butë si pasqyrë me shpejtësi të madhe. Më pëlqente të përdorja thembrat për të krijuar pas meje shatërvanin prej dy metër të lartë. Shijoja sfidën e kryerjes së trukeve si nisjen poshtë ujit, kapërcimin e valëve, rrëshqitjen me një këmbë të vetme apo kryerjen e një rrotullimi. Më pëlqenin të gjitha këto gjëra që i bëja këmbëzbathur. Nuk më pëlqente të rrëzohesha me kokë në ujë ndërkohë që ecja me gjashtëdhjetë kilometra në orë. Kjo nuk më pëlqente.

Një ditë një mik m'u afrua dhe më tha: “A mund të më mësosh të bëj ski me këmbë zbathur?”

Meqë ai dinte se si të bënte zigzage i thashë: “Pa problem”.

“Me të vërtetë?”

“Po, nëse je gati të biesh vazhdimisht me kokë ndërsa garon në ujë me shpejtësi gjashtëdhjetë kilometër në orë”.

“Mund ta bëj këtë” – tha ai.

Buzëqesha. Do të ishte interesante. Mendova të vija në provë vendimin e tij me dy shuplaka të forta në faqe, por në vend të kësaj thashë: “Fjala kyçe që mund të mos kesh dëgjuar mirë në kushtin tim ishte fjala ‘vazhdimisht’”.

Përplasja e tij e parë më fytyrë që përjetoj ishte skuqja e fytyrës, pastrimi i hundëve, mufatja e syve dhe largimi i entuziazmit. Ndërsa po sillja varkën përçark, ai tha me vështirësi se donte që ta provonte edhe një herë.

Në përplasjen e dytë shkuli flokët, grisi rrobat e banjos dhe i shkoi hunda pas koke. Të paktën kështu i dukej atij.

“Mbase mund ta provosh më vonë” – i thashë në përpjekjen për të vënë në vend dinjitetin e tij.

“Po, më vonë”.

Sigurisht, nuk e provoi më. E dija që nuk do ta provonte përsëri. Por me kalimin e kohës u mësova shumë djemve të bënin ski këmbëzbathur. Janë ata që nuk heqin dorë edhe pse janë përplasur shumë herë me fytyrë.

Më e bukura është se djemtë që nuk hiqnin dorë nuk janë më tepër atletikë, të guximshëm apo më pak të prirur të ndjejnë dhimbjen se sa djemtë që hoqën dorë. Ndryshimi i vetëm tek ata burra është zotimi. Ata e kanë mbushur mendjen, para se të futen në ujë, që do të bëjnë ski këmbëzbathur dhe përfundimisht ia kanë dalë. Djemtë e tjerë e pëlqejnë idenë e të bëri ski këmbëzbathur, por vetëm nëse nxënia është e shpejtë, e lehtë dhe pa dhimbje.

Kur i mësoja një shoku të bënte ski këmbëzbathur, përpiqesha gjithmonë ta bëja të qartë që në fillim se sa dhimbje ke kur rrëzohesh në liqen me shpejtësi të madhe. Meqë nuk dua që të dështojnë, u jap zemër të llogarisin koston para se ta provojnë.

Në mënyrë të ngjashme dua që të marrësh në konsideratë koston e pastërtisë morale.

“E dua” – thua ti.

“Por do të lëndoje nëse ndryshon mënyrën se si mendon dhe jeton”.

“Në rregull”.

“Do të heqësh dorë nga diçka që të jep kënaqësi”.

“Në rregull”.

“Do të kërkojë një rishikim të plotë të mënyrës se si konsideron veten dhe se si vepuron”.

“Përsëri në rregull”.

“Do të biesh me fytyrë”.

“E di”.

“Do të biesh më shumë se një herë”.

“Nuk më intereson. Dua pastërtinë”.

A nuk i ngjan kjo mënyrës se si flasim nëse unë dhe ti do të ishim ulur përballë njëri-tjetrit në një lokal. Nëse punët janë kështu, atëherë para se të marrësh zotimin, dua që të llogarisësh koston. Një gjë e tillë është vendimtare për suksesin tënd afatgjatë.

Llogaritja e kostos

Kur shikoj domethënien e fjalës rëndesë, has që është pak më tepër e ndërlikuar nga sa mendoja. Rëndesa: “Forca natyrale e tërheqjes ushtruar nga një trup qiellor, si Toka, ndaj objekteve në apo afër sipërfaqes së saj, me prirjen për t’i tërhequr drejt qendrës së trupit”¹. Mendoja se do të lexoja diçka të tillë: “Rëndesa është ajo që i bën gjërat të bien”. Ose “Rëndesa është forca pas shprehjes: ‘Çfarë ngjitet lart, bie poshtë’”.

Ndërsa ke dëgjuar për rëndesën, dyshej se ke dëgjuar atë që psikologu dhe autori Abraham Tuerski e quan “ligji i rëndesës njerëzore”. Ai, në librin e tij *Mendësia e varur*, shkruan: “Një person bie nga një gjendje që duket se është një ankth më i madh në një gjendje që duket se është një ankth më i vogël dhe asnjëherë anasjelltas”².

Me pak fjalë, Tuerski debaton se njerëzit zgjedhin gjithmonë rrjedhën e veprimit që prodhon më pak dhimbje. Me fjalë të tjera, një dëshirë për të shmangur dhimbjen ushtron një forcë rëndese në shpirtin e njeriut që e tërheq në drejtimin e dhimbjes më të vogël dhe kënaqësisë më të madhe.

Kur lexova për herë të parë ligjin e rëndesës njerëzore të Tuerskit, mendova se donte të thoshte që njerëzit e vetëm që iu largohen

1. Fjalori Trashëgimor Amerikan i gjuhës angleze, botimi i katërt (Nju Jork: Houghton Mifflin, 2006).

2. Abraham Twerski, *Mendimi ngjites* (San Francisco: Harper & Row, 1990), f. 79-80.

kompulsioneve dhe varësive janë ata jetët e të cilëve janë në rrëmujë totale, ata që kanë humbur gjithçka. Por kjo nuk është domosdoshmërisht e vërtetë. Çdo njeri mund të gjejë liri nga mëkati seksual, por do ta bëjë një gjë të tillë nëse dhimbja e vazhdimit të sjelljes së tij është më e madhe se dhimbja e ndalimit. Dhimbja e vazhdimit mund ose të prodhohet nga humbja e gjithçkaje që ai vlerëson ose duke përjetuar humbje më pak domethënëse dhe duke soditur humbjen e gjithçkaje tjetër.

Miqtë e mi që mësuan të bënin ski këmbëzbathur duruan dhimbjen fizike sepse u bindën se dhimbja e dështimit ishte më e madhe se sa dhimbja e rënies. Ata duruan goditjen e forcës së ujis me fytyrën në shpejtësi të lartë, sepse imagjinonin kënaqësinë e suksesit.

Megjithatë kur kishin atë përfytyrim suksesi, atyre u duhej akoma të bënin një hap besimi. Ata duhet të kushtoheshin dhe të vendosnin një këmbë në ujë dhe pak më vonë të ngrinin njëren këmbë nga skitë dhe ta vendosnin në ujë. Ata ndërmorën atë hap duke e ditur shumë mirë se ishin vetëm hap e mbyll sytë larg përshëndetjes së ujit me fytyrën e tyre.

Mësuesit e sotëm të skive përdorin një mjete për të ndihmuar njerëzit të mësojnë ski me këmbë zbathur. Një prej tyre është një shufër metali që vendoset anash varkës. Personi që bën ski mbahet te shufra, prek lehtë ujin me kurriz dhe kur varka arrin shpejtësi të lartë, ai pozicionon këmbët në ujë dhe bën ski me këmbë zbathur. Shufra e metalit zvogëlon rëniet, por askush nuk mëson të bëjë ski këmbëzbathur pa përjetuar dhimbjen.

Në mënyrë të ngjashme ka gjëra që mund të bësh për të zvogëluar gjasat për të rënë në mëkate seksuale (do t'i shqyrtojmë këto në kapitujt e fundit). Por nuk do të jesh kurrë i pastër pa një gatishmëri për të larguar periudhat e shqetësimit. Meqë është kështu, duhet t'i kushtohesh Perëndisë dhe një procesi që do të nxisë pastërtinë.

Ose mund të presësh, ashtu si djali plangprishës, derisa të arrish fundin e stallës së derrave. Ose mund të ushtrosh urtësi duke kërkuar të kuptosh pasojat e mëkateve të tua seksuale nëse nuk gjen liri. Si mund ta bësh një gjë të tillë? Edhe një herë, nuk do të ndodhë nëse rrit dhe pret që të vijë zbulimi nga qielli. Një kuptim i tillë nuk do të na vijë

vetvetiu. Por mund ta fitosh nëse do të kalosh pak kohë dhe ndjekësh udhëzimin tim prej trajnuesi.

Bëj një listë

Kujtoj që po lexoja një libër nga një pastor i mirënjohur, Xhej Denis, rreth arritjes dhe ruajtjes së pastërtisë seksuale. Në faqe hyrëse të librit ai përshkruan mendimet dhe ndjenjat e tij pasi tradhtoi të shoqen. Nuk prisja një rrëfim të tillë kaq të çlirët. Në fakt u trondita që kishte kryer tradhti bashkëshortore.

U ula dhe lexova me vëmendje ndërsa përshkruante kur po i jepte makinës në vendin e tij të preferuar... një vend ku takohej shpesh me Perëndinë... një vend ku kishte udhëhequr një grup dishepullizimi për burra. Ndërsa lotët i rridhnin në faqe, ai sjell ndërmend kur i tregoi të shoqes. Ajo i kishte qenë afër në kohë të mirë e të keqe. Ajo bëri vetëm një pyetje të thjeshtë: “Pse?”.

Pastaj mendoi t’ia tregonte të birit dhe kishës së tij. Si do të ndikonte kjo tek pikëpamja që kishte i biri për të dhe Perëndinë? Si do të ndikonte kjo tek ata që drejtonte dhe ata që kishte drejtuar për te Krishti?

Pastaj ndodhi çudia më e madhe. Ai tha se nuk ka ndodhur gjë, sepse nuk kishte pasur një lidhje jashtë martesore. Ai shpjegoi se e kishte shkruar atë histori vite më parë për t’i kujtuar vetes për çmimin e lartë që do të paguante nëse do të tradhtonte të shoqen³³.

Ajo histori më hoqi trurin. Kalova nga agonia emocionale te gëzimi i papritur ndërsa imagjinoja atë duke jetuar në një mundim aq të madh dhe pastaj të kuptoja që nuk kishte ndodhur asgjë. As atij as mua.

Ja si është puna: si burra nuk na vjen ndërmend një datë apo takim i rëndësishëm, por zor se harrojmë fytyrën dhe trupin e një gruaje seksi që kemi parë në të shkuarën. Ne mund të kujtojmë me rezolucion të lartë çdo element të fytyrës dhe formave të saj. Por imagjinata e pasojave

3. Jay Dennis, *Zbutja e mendimeve të tua private* (Grand Rapids, Miç.: Zondervan, 2002), f. 17-18.

të mëkateve seksuale pushton mendjen tonë, ashtu si duhani i tepërt. Prandaj është e dobishme të bëhet një listë. Ngjitet në kujtesën tonë çfarë do të ndodhte nëse do të bënin të pamendueshmen. Duke pasur këtë parasysh, kalo disa minuta dhe bëj një listë pasojash nëse vazhdon sjelljen tënde të dëmshme seksuale. Ose mbase nuk je duke ndjekur një rrugë të tillë. Nëse është kështu, atëherë ndiq shembullin e pastorit dhe gjithsesi bëj një listë. Lista jote duhet të përfshijë pasojat që ke vuajtur tashmë dhe një skenar të ardhshëm i rastit më të keq. Përdor listën më poshtë dhe shto pika të tjera nëse është e nevojshme.

Pasoja e dhimbshme Nëse ndjek shtegun e mëkateve seksuale

1. Për martesën time:
2. Për familjen time:
3. Për punën time:
 1. Për shëndetin tim:
 2. Për reputacionin tim:
 3. Për imazhin e vetes:
 4. Për financat e mia:
 5. Për të ardhmen time:

Pasojat e dhimbshme nëse ndaloj

1. Mërzitje
2. Durimin e dhimbjeve emocionale në vend që ta zvogëloj dhimbjen me seks
3. Durimin e një dëshire të madhe për përvoja seksuale shkatërrimtare
4. _____
5. _____

Shpresoj që duke bërë këto lista dhe përfytyrimi i dhimbjes nëse vazhdon në mëkatin tënd është më i madh se sa dhimbja për ta ndaluar. Këto lista kanë synimin që të të ndihmojnë të thuash: “U mbush kupa. Mjaft më. Dua çlirim, edhe nëse duhet të duroj dhimbjen për ta gjetur”.

Sapo të kesh bërë këto dy lista, bëj një listë të tretë, e cila përshkruan dobitë e pastërtisë morale.

Dobitë e pastërtisë

1. Për marrëdhënien time me Perëndinë:
2. Për gruan time:
3. Për fëmijët e mi:
4. Për shëndetin tim:
5. Për reputacionin tim:
6. Për miqtë e mi të ngushtë:
7. Për imazhin tim të vetes:
8. Për financat e mia:
9. Për të ardhmen time:

Kalo një kohë për të plotësuar këto lista. Përdor pasojat dhe dobitë e sugjeruara si pikë nisjeje. Shto të tjera sipas rastit.

Ndërsa shqyrton këto lista, do të bëhet e qartë se cila zgjedhje do të zgjedhë dobinë më të madhe.

Fatkeqësisht kur kemi të bëjmë me mëkatën seksual, ne burrat nuk jemi gjithmonë të logjikshëm. Ne veprojmë si burri që po hapte një kanal gjatë një dite të nxehtë vere në Teksas. Pasi kishte punuar për disa orë, një shok i tha: “Pse jemi këtu duke thyer mesin për një pagë minimale, ndërsa presidenti i kompanisë merr një pagë me gjashtë shifra duke ndenjur në një zyrë me ajër të kondicionuar?”.

“Do të shkoj ta zbuloj” – tha burri, duke hedhur lopatën. Ai shkoi drejt ndërtesës së zyrave ku ishin suitat e drejtuesve të kompanisë. Për pak minuta po qëndronte para presidentit të kompanisë. “Pse merr aq shumë para duke bërë pothuajse asnjë punë, ndërsa unë hap kanal dhe fitoj shumë pak?”.

Presidenti i kompanisë i dha një buzëqeshje miqësore dhe tha: “Eja këtu dhe do të ta tregoj”. Pastaj vuri dorën e tij pas murit prej tulle dhe tha: “Godite dorën time me grusht”.

Punëtori mori vrull dhe iu lëshua dorës së presidentit me tërë fuqinë

që kishte. Ndërsa grushti i tij po afrohej për të goditur dorën, presidenti e hoqi dhe grushti i punëtorit u përplas pas murit. Ndërsa po bërtiste nga dhimbja, presidenti tha: “Prandaj unë jam presidenti dhe ti je gërmues”.

Punëtori u kthye te shoku i tij i cili e pyeti: “Çfarë të tha?”.

“Do të ta tregoj” – i tha punëtori ndërsa ngriti dorën para fytyrës së tij. “Godite dorën me sa forcë të kesh”.

Zor se ka njeri më... hëm, duket që fjala i marrë po shfaqet shpesh, megjithatë ne burrat mund të jemi po aq të palogjikshëm në lidhje me epshin. Ne do t'i bëjmë gjërat që krijojnë dhimbje të paimagjinueshme për vete dhe për ata që i duam. Po të sfidoj t'i bësh ballë nxitjes për të genë i palogjikshëm. Shiko çmimin e mëkateve seksuale dhe dobitë e pastërtisë dhe bëj një zotim për të ndaluar sjelljen tënde seksuale shkatërrimtare. Ose nëse nuk je i përfshirë në mëkate seksuale, bëj një zotim për t'i shmangur.

Sapo të kesh bërë atë zotim, je gati për kapitullin tjetër. Kthe faqen për të zbuluar se çfarë është.

PËR DISKUTIM

1. Kontrolllo dy listat e pasojave për vazhdimin apo ndalimin e sjelljes tënde seksuale shkatërrimtare. Ndërsa lexon listën, përpigu të përfytyrosh pasojat e çdo vendimi. Kërkoji Perëndisë që të të bëjë të aftë të shikosh qartë pasojat nëse vazhdon në mëkat.
2. Shkruaj një histori në një faqe duke përshkruar se çfarë do të thotë për ty po t'ia tregosh gruas, fëmijëve dhe miqve. Nëse takohesh me një grup, trego atë që ke shkruar me ta.
3. Si të ndikon tani thjesht mendimi i pasojave kaq të tmerrshme?
4. Tani kontrolllo listën që pohon dobitë e pastërtisë. Tregoja atë listë grupit tënd. Kërkoji Perëndisë të të ndihmojë që të shikosh bekimet që rrjedhin nga të pasurit një jetë të pastër seksuale.
5. Falëndero Perëndinë që me fuqinë e tij je në gjendje të vazhdosh përpara si një njeri i ri në Krishtin.

Zgjidh pronarin tënd

Jam njëzet e një vjeç dhe jam në apartamentin e një shoku. Po pijmë drogë. Kam dalë me Sindin, nusen time të ardhshme, prej tre muajsh. Kur jemi bashkë, unë jam zoti Djali i Mirë i Krishterë. Po shkon në drejtimin e tij nga ana frymërore, por më pëlqen të pi drogë.

Çelsi thith marjuanë dhe e mban tymin në mushkëri. Flokët e saj të gjatë e bjondë i varen mbi shpatulla. Të bardhat e syve të saj janë skuqur. Pas dhjetë apo më shumë sekoda ajo nxjerr me ngadalë tymin që ngjan me një këngë të Grejtfull Ded. Ajo më shikon dhe më thotë: “Kush të njeh më mirë, Bill, unë apo Sindi?”

Çështja është e vjetër. Takohe me Çelsin çdo dy javë për disa orë. Ajo më njeh shumë pak. Me Sindin kalojmë shumë orë së bashku që kur jemi takuar. “Sindi” – i them.

Çelsi i përgjigjet përgjigjes sime, meqë e pret një të tillë. “Sindi nuk e njeh këtë anën tënde. Apo jo?”

Komenti i saj më lë pa fjalë. E vështroj për pesë apo mbase dhjetë sekonda.

“E kupton se çfarë dua të them?” – më pyet ajo.

E kuptova se çfarë donte të thoshte. Po bëja dy jetë të ndryshme.

Kalon një orë. Mendja më kthjellohet. I hipi Ostin Helit tim të kuq

3000 kubik dhe nisem për në shtëpi. Qetësoj veten dhe ajri i freskët i pranverës më shpurpurit flokët. Por është Fryma e Perëndisë që prek zemrën time. Rreth mesnate udhëtoj drejt jugut në rrugën Lamar dhe kaloj urën Taun Llejck në Ostin. Në mes të urës shikoj një degëzim në rrugën e jetës time. Në të majtë është jeta e hedonizmit dhe materializmit, një jetë me një përkushtim gjysmëzemre ndaj Perëndisë. Në të djathtë shtrihet një rrugë pastërtie: një jetë e përkushtuar tërësisht Perëndisë.

Ndjen Perëndinë që më tërheq në shpirt. Duhet të marr një vendim. Çfarë vendim të marr? Nuk mund të vazhdoj të ndjek të dyja rrugët. O njërën o tjetrën. Lotët më rrjedhin në faqe. Në atë çast u përkushtova të ndjek Perëndinë për pjesën tjetër të jetës time. Nuk do të pij më drogë. Nuk do të fle më një grua derisa të bëhet gruaja ime. Para atij çasti e kisha pranuar Krishtin si Shpëtimtarin tim. Me atë vendim ai u bë Zoti im.

Në kapitullin e shkuar pamë rëndësinë e zotimit për një jetë në pastërti. Në këtë kapitull do të shqyrtojmë vlerën e zotimit të jetës tonë ndaj Perëndisë.

Nuk mendoj se është një proces me dy hapa. Nuk është se marrim një zotim pastaj një tjetër. Ato ndodhin në mënyrë spontane. Kur një akrobat është gati të kërcejë, ai po merr dy zotime. Ai zotohet të lëshojë litarin dhe të rrokë shokun që e kap. Pa këto dy zotime ai do të bjerë. E njëjta gjë është e vërtetë për ne. Ne duhet të lëmë mëkatin tonë dhe të kthehemi te Perëndia. Në këtë kapitull ne do të zbulojmë, tani që do të lëshojmë litarin, se si mund të rrokim duart e Perëndisë.

Fundi i izolimit

Për shkak se epshi është një problem frymëror, ai na izolon nga ajo që jemi në Krishtin, vetja jonë e vërtetë, nga Perëndia dhe nga njerëzit. Sa më tepër qëndron mëkati i shfrenuar, me tërë orekset e tij epshore, aq më tepër të izoluar do të jemi nga ana frymërore. Epshi, kur kontrollohen plotësisht jetën tonë, na ndalon që të lidhemi me Perëndinë apo njerëzit e tjerë. Epshi ynë kërkon të mbysë njeriun e ri në ne, personalitetin tonë

të vërtetë, dhe të shkatërrojë jetën tonë frymërore.

Në fazat e hershme të mëkatit seksual, objekti i epshit tonë (idhulli dhe demoni pas tij) duket se ushqen jetën dhe sjell realizim në qenien tonë të brendshme. Nxitja e pornografisë apo një lidhje jashtë martesore gjallëron dhe e bën burrin të ndihet i gjallë. Por ndërsa mëkati seksual rritet, kjo ushqyerje del që është një mirazh. Kjo është arsyeja se pse epshi na konsumon, duke ndodhur një tharje frymërore.

***Që të ndodhë liria dhe shërimi,
duhet të lidhemi me Perëndinë
dhe të kujdesemi për jetën tonë frymërore:
për njeriun e ri, njeriun e mirë që jemi bërë
përmes identitetit tonë me Krishtin.***

Gatishmëria jonë për të kapur një idhull në formën e një objekti seksual tregon nevojën tonë për Perëndinë. Zbulon urinë në shpirtin tonë për diçka jashtë vetes. Shën Agustini shkroi rreth kësaj urie shekuj më parë: “Zemrat tona u bënë për ty, o Zot, dhe ato nuk gjejnë paqe derisa të gjejnë prehje në ty”.

Perëndia dëshiron të të japë këtë prehje. Ai dëshiron të përjetosh bashkimin me të në mënyrë që të rritesh frymërisht. Kjo është arsyeja se pse Pali na nxit të paraqesim trupat tanë te Perëndia si një flijim i gjallë (Romakëve 12:1).

Një zgjedhje logjike

Për vite me radhë dukej sikur sa herë që shikoja dikë që i kushtoj Perëndisë, ndodhte në një sfod ndryshimi emocional. Pas një mesazhi të fuqishëm dhe prekës pastori sfidonte njerëzit të dilnin para dhe t’i kushtonin jetët e tyre Krishtit. Dhe njerëzit dilnin para. Me raste një miku im e pranonte sfidën.

Në kampe të rinjsh pas një javë të ngjeshur me informacion frymëror, fëmijët nxiteshin t’i kushtonin veten Perëndisë dhe shumë prej tyre, me

lot, bënin një gjë tët illë.

Nuk kaloi shumë për mua të dilja në dy përfundime. I pari, Perëndia mund të përdorë dhe përdor emocionet tona për të na tërhequr te vetja. I dyti, ka një grackë të mundshme me vendimet frymërore të shtyra nga emocionet. Pra, kur emocionet që nxisin vendimin kalojnë, po kështu mund të kalojë edhe zotimi. Kjo më kujton për dikë që bën një blerje impulsive dhe pastaj më vonë përjeton keqardhjen e blerësit.

Jam mirënjohës për përvojat e forta fetare që kam pasur. Disa prej tyre më kanë shtyrë në një zotim më të thellë te Perëndia. Përvoja që pata atë natë në Oston ndërsa po i jepja makinës mbi urë ishte shumë emocional. Por shumë nga zotimet afatgjata që i kam bërë Perëndisë kanë ardhur si rezultat i të menduarit saktësisht të asaj që donte Perëndia të bëja dhe pastaj marrja e vendimit, me anë të hirit të Perëndisë.

Mendoj se kjo është qasja që iu kushtua apostulli Pal. Kur nxitë romakët për të paraqitur trupat e tyre si fli e gjallë te Perëndia, ai tha se një akt i tillë ishte një shërbesë “e mençur” (Romakëve 12:1). Në gjuhën origjinale “e mençur” do të thoshte “e mbështetur në logjikë”.

Para se t’i kërkonte atyre të bënin atë zotim, Pali filloi nxitjen e tij: “Ju lutem, pra, o vëllezër, nëpërmjet dhembshurisë së Perëndisë...”. apostulli përdori fjalën “prandaj”, sepse donte që lexuesit e tij të merrnin në konsideratë gjithçka që u tha atyre në njëmbëdhjetë kapitujt e parë. Në ato kapituj ai shpjegon që mëshira e Perëndisë na siguron faljen, pranimin, lirinë nga epshi, një të ardhme të mrekullueshme dhe fuqinë për një jetë fitimtare. Dhe sigurisht, mëshira e Perëndisë na ka identifikuar me Krishtin në mënyrë që ne të jemi njerëz të rinj në të.

Duke pasur parasysh atë që ka bërë Perëndia për ne përmes Krishtit dhe duke pasur parasysh gjithçka që ka bërë për ne në Krishtin, a ka kuptim që t’i kushtohemi tërësisht atij? A meriton pornografia vëmendjen tonë? Po një prostitutë? Një lidhje e palejuar? Sigurisht jo! Vetëm Perëndia meriton përkushtimin tonë dhe vetëm ai mund të ushtrojë mëshirën e tij në jetët tona në mënyrë të tillë sa që të na nxisë t’i kushtohemi vetëm atij në dashuri. A e rroke kuptimin e fjalisë së fundit? Është mëshira e Perëndisë që na ka ndryshuar tashmë dhe është

mëshira e tij që na bën t'i kushtohemi tërësisht atij.

Sigurisht, orekset tona epushore do të kundërshtojnë mëshirën e Perëndisë. Ato do të pëshpërisin gënjeshtër në veshët tanë që mund të bëhen pengesa të fortifikuara për të mbajtur larg mirësinë e Perëndisë. Është thelbësore që të njohësh këto pengesa në mënyrë që të lejosh mëshirën e Perëndisë për t'i kaluar.

PENGESA E PARË: **“Duhet t'i vë gjërat në rregull”**

“Nuk jam gati t'i kushtohem Perëndisë” – do të thuash.

“Pse jo?”.

“Sepse jam i dhënë pas pornos”.

“Atëherë?”.

“Shiko, nuk mund t'i kushtohem Perëndisë derisa të resht së pari faqe pornografike në internet”.

“Dëgjo, Perëndia nuk kërkon të rregullohesh dhe pastaj të kthehesh tek ai. Ai dëshiron të shkosh tek ai në mënyrë që të shërohesh”.

Është një realitet i thellë që Perëndia të do ashtu siç je. Është fuqia e tij që do të të ndryshojë, jo vetja jote. Jezusi krahasoi miqësinë tonë me të me shermendin dhe hardhinë: ne jemi shermendët dhe ai është hardhia (Gjoni 15:1-8). Puna e shermendit është të qëndrojë në hardhi dhe të japë frut. Është përgjegjësia e hardhisë të prodhojë frut. Në mënyrë të ngjashme të jetuarit e një jete të pastër seksuale është fruti i një miqësie me Perëndinë, jo kushti paraprak.

Një person bëhet i krishterë duke i besuar Krishtit për t'i falur mëkatet dhe për t'i dhënë jetën e përrjetshme. Krishti vdiq në kryq për të paguar ndëshkimin për mëkatet tona dhe u ngjall prej së vdekurish për të na siguruar për jetën e përrjetshme. Gjëja e vetme që mbetet për ne është të besojmë në të. Besimi ynë çliron fuqinë e tij të pafund për të na shpëtuar.

Besimi jo vetëm na lidh me Perëndinë, por është edhe çelësi për të rritur miqësinë me të. Si ndjekës të Krishtit ne duhet t'i kushtohemi Perëndisë dhe t'i besojmë për të na ndryshuar. Besimi ynë na përfshin

në forcën e tij të pakufijshme (Efesianëve 1:15-23). Kjo do të thotë që ti nuk ke pse të përmirësohesh para se t'i kushtohesh Perëndisë. Në fakt, nëse po pret një gjë të tillë, kurrë nuk do t'i kushtohesh Perëndisë, sepse nuk ke për ta pastruar jetën plotësisht.

PENGESA E DYTË: “Tu kushtova më parë Perëndisë dhe nuk funksionoi”

Kjo fjali më kujton për një mik që filloi një dietë dhe më vonë u ankua që nuk funksionoi për të.

“Pse jo?” – e pyeta.

“Sepse kur haja më pak ushqim, më merrte uria”.

“Mos prisje që dieta të të hiqte urinë?”.

“Eh, jo. Por nuk prisja të isha aq i uritur”.

“Mbase nëse e provon prapë dhe i qëndron rigoroz, uria jote do të shuhet më vonë”.

“Jo” – më tha ai – “nuk funksionoi për mua”.

Sigurisht, përkushtimi ndaj Perëndisë nuk do të heqë orekset e tua seksuale ashtu si dieta nuk hoqi urinë e këtij burri për ushqim. Është e kuptueshme që një djalë të mendojë apo të paktën të shpresojë, që kur t'i kushtohet Perëndisë, Zoti do të heqë dëshirat e tij epshore. Kur mbetet epshi, mund të dalë në përfundimin se Perëndia e ka braktisur dhe përkushtimi frymëror nuk funksionon. E vërteta është se Perëndia nuk e heq epshin tonë: ai na jep udhëzimet dhe fuqinë që na duhet për ta kontrolluar.

Ndërsa Perëndia na ka bërë njerëz të rinj në Krishtin, ne shpesh lejojmë orekset tona frymërore për të kontrolluar jetët tona. Rritja ndodh ndërsa kuptojmë identitetin tonë në Krishtin dhe jetojmë në përputhje me jetën e re. Por ashtu si një fëmijë në rritje e sipër do të bjerë kur mëson të ecë, po kështu edhe ne. Në fakt, të rriturit rrëzohen rrallë. Zotimi ndaj Perëndisë funksionon sepse na lejon të përfshihemi në hirin e tij i cili ndryshon mënyrën se si mendojmë dhe veprojmë.

PENGESA E TRETË: “I jam kushtuar Perëndisë në të shkuarën dhe nuk kam pse ta përsëris”

Ashtu si zotimet e martesës, edhe akti ynë fillestar i përkushtimit ndaj Perëndisë ndodh vetëm një herë. Por ashtu si zotimet e martesës, ai mund të përsëritet: dhe duhet të përsëritet nëse i ke kthyer kurrizin Krishtit dhe je duke jetuar në imoralitet seksual.

Për disa vjet kam kryer disa ceremoni martesore për çiftet e martuar që po përsërisnin betimet e tyre. Në disa raste ata e bëjnë këtë për t’u ndarë formalisht me një incident tradhtie. Ata nuk mund të rimartohen, meqë janë tashmë të martuar, por mund të përsërisin zotimin e tyre ndaj njëri-tjetrit.

Ndonjëherë njerëzit duhet ta bëjnë këtë me Perëndinë. Ata duhet të përsërisin aktin e tyre të zotimit si një mënyrë formale për t’i thënë Perëndisë dhe vetes që ai është Zoti dhe Mësuesi i tyre.

PENGESA E KATËRT: “Jam i padenjë”

“Kam bërë gjëra shumë të këqija. Nuk e meritoj në asnjë mënyrë dashurinë e Perëndisë” – thua ti.

“Ti ndihesh i padenjë dhe i pazoti të ndryshosh. Vërtetë?”.

“Po, është e vërtetë”.

Shiko, duhet të dish që ti nuk je i denjë për dashurinë e Perëndisë dhe nuk mund të ndryshosh veten. Nëse kërkon ndonjë provë biblike, kontrollo Romakëve 3:9-20; 7:23-24 dhe Jakobi 2:10. Por ti je si gjithë të tjerët. Në fakt Bibla është e mbushur me histori burrash beteja me mëkatin e të cilëve tregoi se ishin të padenjë dhe njerëzorë. Shiko emrat e mëposhtëm:

Jakobi gënjeu.

Moisiu vrau.

Sansoni fjeti me një prostitutë.

Davidi kreu tradhti bashkëshortore dhe vrasje.

Pjetri mohoi Jezusin.

Mos u gënje: edhe burrat më të admiruar në Biblën e kanë shkelur.
Jeta e krishterë nuk ka të bëjë me të qenët i përsosur

*dhe të merituarit e favorit të Perëndisë.
 Ka të bëjë me ndërmarrjen e disa hapave,
 pengesave, ngritjeve,
 dhe ndërmarrjen e disa hapave të tjera.*

Me shpresë me kalimin e kohës nuk do të pengohemi shpesh apo biem rëndë. Por diçka është e sigurt: pavarësisht se sa të pastër jemi, ne kurrë nuk do të meritojmë favorin e Perëndisë. Dhe kurrë nuk do të jemi në gjendje të ndryshojmë veten. Duke qenë kështu gjërat, ne duhet t'i kushtohemi Atij që na do gjithsesi dhe ka fuqinë të na ndryshojë.

NDËRMERR HAPIN E BESIMIT: **Kushtojtu Perëndisë**

Nëse dëshiron t'i kushtohesh Perëndisë, të nxis ta bësh këtë gjë tani. Mbase do të të ndihmojë fakti ta imagjinosh veten si djali plangprishës që kthehesh tek Ati. Ndërsa afrohesh, e shikon duke qëndruar te porta kryesore e shtëpisë së madhe. Ti e njeh menjëherë. Çasti që mezi e ke prituri ka ardhur. Për të kaluar nervozizmin, ti përsërit atë që do të thuash.

Kur je afër rreth njëqind metra, ai e kupton që je ti. Ai largohet menjëherë nga dera dhe lëshohet drejt teje. Ndërsa afrohet, ti ndjen zemrën që të rreh. Paprituri ai ndodhet përballë teje, duke buzëqeshur. Menjëherë ai të përqafton.

Tani është koha që t'i tregosh Atit tënd qiellor atë që ke bërë gabim. Shpreh brengën tënde. Thuaji që je gati t'i kushtosh jetën. Thuaji që po e bën këtë sepse dëshiron t'i shërbesh atij në vend të epshit tënd. Ti dëshiron të jetosh sipas njeriut të ri të cilin e ka formuar, jo njeriun e vjetër, që ka qenë i drejtuar nga epshi.

Duke vepruar kështu, ti po vendos jetën tënde në duart e tij. Ndryshe nga flijimi i kafshëve të ofruara nga judenjtë e lashtë, ti po paraqet veten te Perëndia si një fli e gjallë. Ti po i jepesh atij për të përdorur

trupin tënd. Ti po thua: “Ja Zot, të jap mendjen time, sytë dhe veshët e mi, duart dhe këmbët e mia. Do t’i jap ty të gjitha mendimet dhe veprimtaritë e mia seksuale. Ato të përkasin ty dhe do të kushtohen për të të shërbyer ty”.

Një vepër e tillë jo vetëm është e arsyeshme, por është tepër frymërore. Ti duhet të jetosh jetën për të dhe ta lejosh të jetojë jetën e tij përmes teje.

Një krizë besimi

Sapo t’i jesh kushtuar Perëndisë, do të ndodhin dy gjëra. Së pari, duhet të jesh në dijeni për ndryshimet që duhet të ndodhin në jetën tënde. Më 21 gusht 1971 unë me Sindin ishim përballë njëri-tjetrit, duke shkëmbyer betimet e martesës dhe thamë: “Po”. Më vonë u futëm në një apartament të vogël në Rrugën Sidar, në Oston, Teksas.

Nuk kaloj shumë kohë para se të kuptonim se duhet të ndryshonim të dy që martesja jonë të funksiononte. Duhet t’i tregoj dashurinë time duke i dhënë makinës më ngadalë, të isha më i ndjeshëm, të dëgjoja më mirë, t’i shkruaja poezi, të bëja xhiro me të, të shikoja më pak televizor, t’i jepja makinës më ngadalë, të hiqja dora nga disa aktivitete sportive, t’i jepja makinës më ngadalë, të flija më pak, dhe, oh po, harrova, t’i jepja makinës më ngadalë. Kjo është një listë me tetë gjëra specifike që mund të bëja për të forcuar martesën tonë. Bëra një listë edhe për Sindin: të dilte lakuriq dhe të përgatiste për të ngrënë.

Një gjë e ngjashme ndodh kur i kushtohemi Krishtit. Perëndia tregon fusha të jetës tonë që duhet të ndryshojnë. Edhe pse është e vërtetë që Perëndia na pranon ashtu siç jemi, është po aq e vërtetë që ai nuk na lë në atë gjendje. Zoti do t’ju tregojë mendime dhe veprime që duhet të ndryshojnë nëse do të jesh i pastër seksualisht. Ai do të tregojë gjëra që nuk mund të jenë të pranishme në jetën tënde nëse do t’i afroresh atij.

Por do të ndodhë edhe diçka tjetër. Ndërsa sodit këto ndryshime, do të përjetosh një krizë besimi. Do të përballesh me dilemën ose beson te Perëndia ose je i dashuruar me idenë e besimit te Perëndia.

Gjatë kohës kur je zhytur në epshin tënd, po i beson vetes për të plotësuar nevojat e tua për intimitet dhe kënaqësi. Ti po beson tek një objekt, person apo një përvojë (dhe demonit pas tij) për të kënaqur dëshirat e tua. Do të jetë e dhimbshme nëse e braktis. Të bësh një gjë të tillë do të jetë si të përplasesh me ujin me fytyrë ndërsa ecën 60 kilometër në orë. Do të të dhëmbë. Gjithçka që është brenda teje do të kërkojë të kënaqë edhe një herë epshin tënd.

Në atë pikë do të përballesh me një krizë besimi. A do t'i besosh Perëndisë për të plotësuar nevojat e tua apo do t'i plotësosh vetë? A do t'i bindesh Perëndisë apo jo? Nuk mund t'i biesh rrotull krizës së besimit.

Në mbarë Biblën, sa herë që Perëndia thirrte një burrë, ai duhet të vendoste nëse i besonte ose jo Perëndisë për t'u kujdesur për të. Për Abrahamin kjo do të thoshte të linte vendlindjen e tij dhe të udhëtonte në një vend të panjohur. Ai e bëri këtë sepse i besoi që Perëndia do të kujdesej për të. Më vonë ai ofroi Isakun si flijim sepse besoi se Perëndia do ta ngjallte atë prej së vdekurish (Hebrenjve 11:17-19).

Perëndia të ka bërë thirrje për t'iu kushtuar tërësisht atij. Duke bërë një gjë të tillë, je duke thënë se beson që Perëndia do të të mbrojë dhe sigurojë për ty. Ajo vepër zotimi do të sjellë ndryshim në mënyrën se si mendon dhe vepron dhe do të çojë në një moment që do të të shtyjë të vendosësh: “A mund të plotësojë Perëndia nevojat e mia apo do t'i drejtohem seksit për t'i plotësuar?”. Do të hasësh këtë pyetje sa herë që tundohesh, shikosh apo vepros në një mënyrë që shuan oreksin tënd seksual jashtë vullnetit të Perëndisë.

Natyrisht ti po e lexon këtë libër sepse dëshiron të jesh i pastër. Shumë burra i kushtohen Perëndisë dhe pastaj bien në mëkat sepse nuk kanë një njohje të qartë të identitetit të tyre të ri dhe ndryshimet që Perëndia dëshiron të ndodhin në ta, në mënyrë që të ruajnë epshin nën kontroll. Si burrë që dëshiron të jetë i pastër, duhet të dish përshtatjet që Perëndia dëshiron prej teje. Në pjesën tjetër të këtij libri ne do të shqyrtojmë disa porosi biblike që Fryma e Perëndisë do të përdorë për të riformuar mënyrën se si mendon dhe jeton.

Mund t'ia dalësh!

Është ora 5:30 e mëngjesit dhe çohem nga shtrati. Jam shtatëmbëdhjetë vjeç dhe jetoj me prindërit në Timberline Drive në Rollingud Istejts, fare pak jashtë Ostinit. Vesh një palë xhinse të shkurtra, vesh një bluze me krahë të shkurtra, fus këmbët në një palë sandale dhe dalë jashtë për te makina: një Pontiak bardhë e zi i 56-s... një model i vjetër që dridhet si matrapik kur arrin 120 kilometër në orë, duke shkundur pluhurin nga tapiceria dhe tavani dhe duke mbushur kabinën e makinës me kokrriza pluhuri. Njëzet minuta më vonë futem në parkingun e molit ku qëndrojnë skafer. Shoku po më pret.

Hipim në skaf dhe fus çelësin në kuadër. Rrotulloj çelësin dhe motorri 150 kuaj fuqi fillon të gurgullojë dhe era e tymit të gazit shpërndahet në ajër. Liqeni i mëngjesit ngjan i qetë si xham dhe si pasqyrë pasqyron pemët larg bregut.

Në mes të liqenit fik motorrin dhe i shpjegon shokut se çfarë duhet të bëjë për të bërë ski me këmbë z bathur. “Vendos këmbën e majtë në ujë dhe ano prapa derisa të mendosh se je duke rënë. Në rregull?”.

“Në rregull” – thotë ai.

Ndjej ngazëllimin dhe frikën e tij. “Dhe pastaj shtrihu edhe më” – i them. “Nëse bie me kurriz, nuk do të vritesh. Nëse bie me fytyrë, ndryshon puna”.

Por sigurisht kjo ka ndodhur shumë vjet më parë. Ose kështu më duket. Tani nuk po flasim për skitë. Por ndërsa shkruaj këto fjalë, kam një ndjenjë të ngjashme ngazëllimi. Je duke nisur një ecje që do të përfshijë rrezikun dhe dhimbjen. Por premtion gjithashtu shpërblimet e mëdha. Jam nervoz kur hedh hapin e parë jashtë skafit dhe i zotohesh Krishtit dhe mezi pres që të lexosh pjesën tjetër të librit, sepse edhe ti e di që ai përkushtim pa drejtim është një plan për disfatë. Në pjesën tjetër të librit do t’ju jap një strategji që do t’ju ndihmojë të jetoni i pastër në pjesën tjetër të jetës... ose të paktën ditë pas dite.

Kam besimin që, me anë të hirit të Perëndisë, ti mund t’ia dalësh.

PËR DISKUTIM

1. Romakëve 12:1-2 thotë: “O vëllezër, po ju bëj thirrje, nëpërmjet dhembshurisë së Perëndisë, ta paraqisni trupin tuaj si fli të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer te Perëndia, që është shërbesa juaj e mençur. Dhe mos u konformoni me këtë botë, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes tuaj, që të provoni se cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullneti i Perëndisë”. Lexo këto vargje disa herë. Thuaju disa burrave t’i lexojmë me zë të lartë. Si e përshkruan Pali këtë akt zotimi në vargun një? Çfarë do të karakterizojë një burrë që ka bërë këtë zotim?
2. Për cilat nga pengesat për zotim të paraqitura në këtë kapitull ke hasur kohën më të vështirë për t’i kaluar? A i ke kaluar? Nëse po, si i ke kaluar?
3. A je gati ta bësh Krishtin zotin tënd? Nëse jo, pse? Kërkoji Perëndisë të të ndihmojë të heqësh çdo pengesë që të pengon t’i kushtohesh atij. Nëse je gati, atëherë mund ta bësh një gjë të tillë tani duke bërë një lutje të ngjashme: “O Atë, pranoj që mëshira jote më ka shtyrë të besoj në Krishtin. Mëshira jote më ka falur dhe më ka bërë një njeri të ri në Krishtin. Dhe tani, si përgjigje ndaj mëshirës tënde, po të kushtohem ty. Vendos gjithçka që jam dhe shpresoj para teje. Kërkoj që të më shndërrosh mendjen dhe ta bësh mendjen time që të vërtetojë se sa i mirë është vullneti yt. E bëj këtë lutje në emër të Krishtit. Amen”.
4. Nëse ke kushtuar, apo rikushtuar, jetën tënde në Krishtin, thuaji një mik. Do të të ndihmojë ty dhe inkurajojë atë.

Zbulo veten tënde të re

Më 8 korrik 1947 një anije kozmike u përplas jashtë Rosuellit, Nju Meksiko. Ndërsa përplasja e UFO-s njihet nga të gjithë, vetëm disa e dinë që para se të vdiste, jashtëtokësori i vetëm i mbijetuar arriti të ruante një mbulesë të vetme në një të çarë afër vendit të përplasjes.

Gjatë viteve të gjithë më thoshin: “Ti je i çuditshëm” ose “Je krejt ndryshe”, ose “Je nga një planet tjetër”. Ata madje qeshnin për faktin që isha rritur në Rosuell.

Sigurisht i quaja ato komente si tallje miqësore deri ditën që shkova me avion në Albuquerk dhe mora me qira një makinë duke udhëtuar treqind kilometër në juglindje drejt vend të përplasjes jashtë Rosuellit. Kur shkova në atë vend kuptova që ishte vendi i shkëlqyer për përplasjen e një anijeje kozmike jashtëtokësore: një vend i humbur. Përveçse mund ta shikonte një punëtor ferme, askush tjetër nuk do ta kishte ditur.

Sido që të jetë, ndërsa qëndroja në mes të një fushe të shkretë, i rrethuar nga shkëmbinj dhe barishte të thata, një rreze drite më rrëmbeu. Më ra të fikët para se të identifikoja burimin e dritës.

Kur u zgjova nën një kaçube barishteje të thatë, kisha një libër në dorë. Nuk mund të ishte më shumë se dyqind faqe i madh dhe peshonte më pak se gjysmë kilogram. Libri quhej Kupto identitetin tënd të huaj.

Mendova se libri dukej pa lidhje meqë kisha lindur dhe isha rritur në Nju Meksiko dhe nuk mund të vërtetoja qytetarinët time amerikane. Pastaj kujtoj gruan që më tha: “Mendoj se UFO-t duhet të kenë depozituar një vezë që është ngrohur për dy vjet. Kjo duhet të shpjegojë... hëm... ekzistencën tënde”.

Hapa me kureshtje librin dhe shfletova faqet e tij. Nëse isha me të vërtetë jashtëtokësor, shpresoja për një zbulim rreth identitetin tim që do të më çonte në një vend si kështjella e vetmisë së Supermenit, e cila është 200 kilometra drejt jugut të polit gjeografit të veriut. Ky është një vend i bukur me kristale të mëdha dhe ku babai i Supermenit, Jor-Eli, iu shfaq në formën e një hologrami.

Unë kisha vetëm një libër, fatmirësisht për mua, shkruar në anglisht dhe jo një tekst jashtëtokësor. Sido që të jetë, kam kaluar vite duke studiuar librin për të kuptuar fuqitë e mia unike jashtëtokësore kështu mund t’i përdorja për dobinë e së vërtetës, drejtësisë dhe Stilit Amerikan (fatkeqësisht, motoja e Supermenit është ndryshuar nga “Stili Amerikan” në shprehjen për të qenë i paanshëm politikisht “Tërë ato gjëra”).

E vërteta është se unë jam një jashtëtokësor. Por identiteti im i huaj nuk ka rrjedhur nga një jashtëtokësor që ka lënë një vezë në një kodër në Nju Meksiko. Nga rrjedhur nga Perëndia kur më dha Frymën e tij dhe më bëri një krijesë të re në Krishtin (2 Korintasve 5:17). Pjetri u tha lexuesve të tij që ata ishin “të huaj dhe shtegtarë” (1 Pjetrit 2:11) dhe se ata kanë një “trashëgimi” që ruhet për ta në qiell (1 Pjetrit 1:4). Pali u tha filipianëve: “...qytetaria jonë është në qiej” (Filipianëve 3:20).

***Është një realitet frymëror që nëse njeh Krishtin,
je një jashtëtokësor që po viziton këtë botë.***

Ti je një i huaj këtu.

***Ti je me të vërtetë një njeri i ri,
një njeri i mirë, në Krishtin.***

Çelësi ndaj pastërtisë morale dhe seksuale gjendet në identitetin tënd të ri. Përfundimisht, kur ndonjë prej nesh bie në mëkat seksual,

ndodh ngaqë kemi lejuar mishin tonë të vjedhë identitetin tonë duke menduar dhe vepruar vazhdimisht me pasionet e tij mëkatore. Ne duhet të pranojmë kur ndodh kjo dhe zgjedhim të veprojmë në një mënyrë që pasqyron jetën tonë të re në Krishtin.

Nëse e vërteta e këtij kapitulli futet në mendjen tënde, ajo ka fuqinë të të ndryshojë rrënjësisht për mirë. Shiko, një takim me Jezun Krishtin shndërron gjërat gjenetike të shpirtit tënd. Nëse kalon pak kohë dhe studion librin që shpjegon identitetin tënd të ri, trashëgiminë dhe fuqinë e re ndaj mishit tënd, do ta shikosh veten sipas perspektivës së Perëndisë. Kur ndodh diçka e tillë, do të jetosh si një njeri i ri, njeriu i mirë, që je në Krishtin.

Çështja është kjo: kur i beson Krishtit, ti bëhesh një njeri i ri dhe do të duhet pak kohë për të kuptuar identitetin tënd të ri. Sa më tepër kupton se kush je, aq më tepër do të jetosh si biri i Perëndisë: një i huaj për këtë botë.

Ashtu siç e përmenda në kapitullin e kaluar, sapo t'i kushtohesh Krishtit, Perëndia do të të tregojë rrugët që duhet të ndryshosh dhe asnjë ndryshim nuk është më i rëndësishëm se sa mënyra se si e shikon veten.

Ti je i pranuar pa kushte

Pranimi pa kushte i Perëndisë është i vështirë për t'u kuptuar. Ti mund të habitesh se si mund të anashkalojë ai tërë gjërat e tmerrshme që ke bërë. Në fakt ai nuk i anashkalon. Përkundrazi, Jezusi vdiq në kryq për të paguar për to.

Kur e dëgjova për herë të parë këtë mesazh u çlirova shumë. Ndërsa po rritesha familja ime shkante rrallë në kishë dhe kur shkonim, ndihesha si i huaj si peshku pa ujë.

I ndaja njerëzit në dy kategori: të mirët dhe të këqinjët. Me siguri bëja pjesë te kategoria e të këqinjve, por besoja në Perëndinë dhe pyesja se si mund ta njihja atë. Miqtë e mi fetarë u përpoqën të më ndihmonin. Disa më thanë që duhej të shkoja në kishë. Të tjerë thanë që duhet të reshtja së thënë fjalë të pista, së mashtruar, vjedhuri dhe zënuri. Mbase

mund të më kenë thënë të ndryshoj edhe ngjyrën e syve. Unë nuk mund të ndryshoja sjelljen e keqe ashtu siç nuk mund të jetonte peshku pa ujë.

Por u përpoqa. Frekuentova kishën dhe m'u duk e mërzitshme. Kujtoj që shihja rreth e qark dhe pyesja veten se si mund të rrijë dikush duke dëgjuar predikime kaq të mërzitshme. Mendova ndoshta pastori i shiste predikimet e tij në farmaci për të ndihmuar njerëzit që vuanin nga pagjumësia. Përfundimisht dola në përfundimin se kishte diçka që nuk shkonte në mua.

U përpoqa të reshtja së thëni fjalë të këqija. Në fakt, një vit unë me mikun tim Ben Smith hoqëm dorë së foluri keq për kreshmë.

“Çfarë është kreshma?” – e pyeta unë.

“Është dyzet ditë para Pashkës” – tha ai.

“Atëherë pse duhet të heqim dorë nga diçka për këtë?”.

“Ka të bëjë me identifikimin me Krishtin që agjëroi në shkretëtirë për dyzet ditë. Ne e bëjmë për ta bërë Perëndinë të lumtur”.

“Nga çfarë duhet të heqim dorë?” – e pyeta.

“Mallkimet” – tha Beni.

Kështu bashkë me Benin shkuam në shkollë të hënën në mëngjes të vendosur që të mos thoshim fjalë të pista për dyzet ditë. E di që pastërtia e buzëve të mia u bënte përshtypje miqve të mi. Deri në atë moment unë mallkoja aq shumë sa që duke eliminuar ato fjalë nga fjalori im, nuk më mbetej shumë për të thënë.

Gjithçka po shkonte mirë deri në pjesën e tretë të orës së fiskulturës. Po luanim hokej në bar dhe kujtoj që po vrapoja me të katërta drejt topit për ta quajtur me shkopin tim. Në të njëjtën kohë Virxhil Ljuis po vraponte drejt topit nga ana tjetër. Në vend që të godiste topin, vërviti shkopin e tij duke goditur me tërë forcë kërcirin tim të majtë. Në më pak se dhjetë sekonda më ka dalë nga goja çdo fjalë e ndyrë e mundshme që njihja. Dhe më e keqja, iu sula Virxhilit dhe i rashë turinjve me grusht.

Në atë çast kuptova atë që duhet të dija prej kohësh: nuk do isha kurrë aq i mirë sa t'i pëlqeja Perëndisë. Kështu që mund të kuptoni se pse u çlirova, si student i vitit të parë në kolegji, kur zbulova se Perëndia donte vetëm që una të besoja në të. Ai thjesht donte që të mbështetesa

në Birin e tij për falje. Sapo kuptova që Jezusi pagoi për mëkatet e mia përmes vdekjes së tij dhe më ofroi jetën e përjetshme përmes ringjalljes së tij, unë besova (Romakëve 4:5; 10:9-10; Efesianëve 2:8-9). I besova Krishtit si Shpëtimtari im.

Ajo që më mahnti më tepër ishin ndryshimet e menjëhershme që ndodhën në jetën time. Zakonet me të cilat isha ndeshur për vite me radhë u zhdukën si rroba të ndotura dhe të leckosura. Me të vërtetë reshta së thëni fjalë të pista. Shiko, them ndonjëherë ndonjë fjalë të pisët, por jo si më parë. Disa nga ndryshimet ishin aq rrënjësore sa që shpresoja që epshi im të ishte problem i së shkuarës.

Katër hapa drejt lirisë

Me të vërtetë e kisha gabim. Kur epshi im u zgjua nga gjumi pasi kisha besuar në Krishtin, më frikësoi. Në këtë moment gjeta, në shkrimet e Palit, disa mendime që ndryshuan mënyrën se si trajtoja orekset e mia epshore. Dhe në kapitullin tjetër do të tregoj disa hapa specifikë që na jep Pali për të siguruar çlirimin tonë nga epshi.

PËR DISKUTIM

1. Ngaqë pastërtia seksual rrjedh nga identiteti yt i ri në Krishtin, është e rëndësishme që ta njohësh atë. Duke pasur këtë parasysh, a ke arritur në një pikë në jetën tënde kur edhe po të vdesësh e di me siguri që do të shkosh në parajasë? Nëse do të shkoje atje dhe Perëndia të pyeste: “Pse duhet të të lejoj të futesh brenda?”, çfarë do të thojë?
2. Nëse iu përgjigje pyetjes së fundit duke thënë diçka tjetër ndryshe nga: “Besoj se Krishti vdiq për mëkatet e mia dhe u ngjall prej së vdekurish dhe i kam besuar vetëm atij për faljen dhe jetën e përjetshme”, ti mund të mos e njohësh Krishtin. As veprat e mia as ritet fetare nuk do të na çojnë në qiell.
3. Efesianëve 2:8-9 thotë: “Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush”. Sipas këtyre vargjeve, cila është ajo gjë që duhet të bëjë një person për t’u shpëtuar nga mëkati i tij dhe pasojat e tij? A do të doje t’i besojë tani Krishtit si Shpëtimtari yt? Nëse po, a do ta bëjë këtë me një lutje të tillë: “O Atë, të falënderoj që më do. Pranoj që kam mëkatuar kundër teje. Besoj se Jezu Krishti vdiq për mëkatet e mia. Besoj se ai vdiq në vendin tim dhe u ngjall prej së vdekurish. Tani po i besoj vetëm atij për faljen dhe jetën e përjetshme. Amen”.
4. Nëse i ke besuar Krishtit si Shpëtimtari yt, 1 Gjonit 5:11-13 thotë: “Dhe dëshmia është kjo: Perëndia na dha jetën e përjetshme dhe kjo jetë është në Birin e tij. Ai që ka Birin, ka jetën; ai që nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën. Jua shkrova këto gjëra juve që besoni në emrin e Birit të Perëndisë, që të dini se keni jetën e përjetshme dhe që të besoni në emrin e Birit të Perëndisë”. Sipas këtyre vargjeve, a mund ta dijë një person me siguri se ka jetën e përjetshme? Nëse po,

si? A e ke tani sigurinë? Nëse po, tregoji një miku.

Katër hapa drejt lirisë

“Le ta themi shkoqur” – tha Xhoni. “Po më thua se Perëndia i ka falur mëkatet e mia, apo jo?”.

“Po”.

“Dhe pavarësisht se çfarë bëj në të ardhmen është e falur sepse Krishti u ndëshkua për mëkatet e mia të shkuara e të ardhshme, apo jo?”.

“Po, vërtetë”.

“Besoj se ka një problem të madh në atë që po thua”.

“Çfarë?”.

“Shiko, nëse mëkatet e mia të ardhshme janë falur tashmë, çfarë do të më pengojë mua për të bërë gjëra të këqija?”.

“Çfarë e pengon një flutur të zvarritet si krimb?”.

“Hë?”.

“Më dëgjove, apo jo? Çfarë e pengon një flutur të zvarritet si krimb?”.

“Shiko, ajo ka ndryshuar. Ajo nuk është më krimb. Ajo është flutur dhe nuk mund të bëjë atë që bënte zakonisht. Përveç të tjerash, pse të zvarritesh kur mund të fluturosh?”.

“Ti iu përgjigje vetë pyetjeve të tua?”.

“Si ka mundësi?”.

“Kur beson te Krishti, Perëndia të ka ndryshuar në zemër për t’u

sjellë ndryshe nga ana e jashtme. Ai të ka bërë një krijim të ri... një njeri të ri. Ti nuk je më një krimb, por je flutur. Pse të zvarritesh në pisllek kur mund të fluturosh?”.

Kam pasur biseda të panumërta si kjo. Njerëzit me mend, të cilët kuptojnë faljen e plotë që ofron Perëndia përmes Krishtit, duan të dinë se çfarë do të frenojë mëkatit e tyre. Nëse hiqet frika e ndëshkimit, çfarë do të pengojë një burrë nga zhytja në çdo fantazi epshore?

Pali, kur shkroi letrën e tij ndaj kishës në Romë, e dinte se disa do të thoshin që mesazhi i tij i shpëtimit të plotë me anë të besimit nxit shkelje të ligjit. Kritikët e tij argumentonin që nëse Perëndia fal lirisht të tërë ata që besojnë në Krishtin, nuk ka asgjë që mund të parandalojë njerëzit së shuari orekset e tyre më të ulta. Pali thotë që një mendësi e tillë nuk arrin të kuptojë realitetin frymëror.

*Perëndia ka ndryshuar
tërësisht natyrën e njeriut.
Ai ka kthyer krimbat
në flutura.*

Të gjithë ata që besojnë në Krishtin janë identifikuar me të në vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen e tij. Ky realitet frymëror formon bazën e identitetit tonë të ri. Gjithçka që është e vërtetë për Krishtin (përveç attributeve të tij hyjnore që nuk mund të transferohen si gjithëdija, kudondodhja dhe plotfuqia) vlen edhe për ne. Ne jemi në Krishtin, si faqja e një libri. Ajo që është e vërtetë për një libër, është e vërtetë edhe për faqen. Ajo e vërtetë formon hapin e parë që duhet të ndërmarrësh drejt lirisë nga mëkati.

HAPI I PARË: Mëso se kush je në Krishtin

Siç e përmenda më herët, Jezusi krahasoi miqësinë tonë me të si shermendi me hardhinë. Jezusi, kur u lut natën para se të kryqëzohej,

tha: “Tani unë nuk lutem vetëm për ta, por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre, që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne, që bota të besojë se ti më ke dërguar” (Gjoni 17:20-21). Ndërsa Zoti po fliste për unitetin midis besimtarëve, ai po pranonte pozicionin tonë në të.

Pali u tha galatasve: “Unë u kryqëzova bashkë me Krishtin dhe nuk rroj më unë, po Krishti rron në mua; dhe ajo jetë që tani jetoj në mish, e jetoj në besimin e Birit të Perëndisë, që më deshi dhe dha veten për mua” (Galatasve 2:20). Pali i vjetër, gjithçka që ishte para se të takonte Krishtin, vdiq në kryq. Tani ai ishte një person i ri: i bashkuar me Krishtin në jetën e tij të ringjallur.

Shkoja shpesh Star Trekun: Hapësira e Largët Nëntë. Në fakt nuk jam i sigurt nëse kam humbur një episod të serive trillim-shkencë. Një prej karaktereve të mi të pëlqyer ishte toger Xhaxia Daks, një grua e re tërheqëse dhe e shkëlqyer, e cila dukej si gratë e tjera. Shiko, ajo dukej si gratë e tjera përveç një shiriti të dekoruar që i kalonte nga njëra anë e fytyrës dhe trupit. Këto shenja e identifikonin si një anëtarë të Trillit, një racë unike në të cilën disa njerëz ishin mysafirët e një race tjetër që jetonin dhe bashkohen me ta.

Xhaxia ishte mysafirja e një qenie treqind vjeçare, Kurson Daksi. Xhaxhia, pa humbur identitetin apo personalitetin e saj, përfitonte nga përvoja dhe njohja e Kurson Daksit. Të dy u lidhën së bashku në atë mënyrë sa që u bënë me të vërtetë një person tërësisht i ri.

Në një farë kuptimi, kjo ndodhi kur u bëmë ndjekës të Krishtit. Fryma e Perëndisë së gjallë vjen për të banuar me ne. Në mënyrë të mistershme Fryma e Perëndisë ndërhyr në tonën dhe ne bëhemi një person i ri (2 Korintasve 5:17). Kjo do të thotë që në planetin Tokë ka dy specie unike dhe të ndryshme: bijtë e Adamit dhe bijtë e Perëndisë.

Ngaqë jemi njerëz të rinj, një krijim krejt i ri, do të ishte mungesë konsekuente për ne të jetonim siç jetonim më parë. Nuk është se kemi përshtatur një filozofi të re fetare që na mëson të përpiqemi të bëjmë jetë më të mira. Ne jemi transformuar. Në Krishtin njeriu unë i ri ka lirinë nga pushteti i mëkatit dhe orekset e tij epushore (Romakëve 6:1-

14). Pali shkruan: “Aspak! Ne që jemi të vdekur për mëkatin, si do të jetojmë akoma në të?” (Romakëve 6:2). Është e rëndësishme të vëmë re që Pali nuk thotë që mëkati ynë, orekset tona epshore, kanë vdekur. Ai thotë që ne kemi vdekur.

Meqë askush prej nesh nuk ka vdekur fizikisht, Pali duhet t’i referohet një lloj tjetër vdekjeje: një vdekje frymërore. Ai mësoi që tërë ata që besojnë në Krishtin janë të identifikuar frymërisht me të në vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen e tij. Perëndia na tërhoqi disi përmes hapësirës dhe kohës dhe na vendos në Krishtin gjatë kryqëzimit dhe ringjalljes së tij. Nuk është se ne humbëm individualitetin tonë, por në ne banon Krishti. Gjithçka që është e vërtetë për të është e vërtetë për ne.

Ky koncept ka fuqi për të ndryshuar jetën, sepse përshkruan realitetin frymëror. Të përshkruan ty si një person tjetër.

Shiko për një minutë ndërlikimet e kësaj të vërtete. A ka mëkati pushtet mbi Krishtin? Sigurisht jo! Meqë është kështu, ai nuk ka pushtet mbi ty. Pali dëshiron që të kuptojmë se ka mungesë konsekuence nëse lejojmë orekset tona epshore të kontrollojë jetët tona, meqë ne kemi vdekur dhe jemi ngjallur me Krishtin. Ne jemi njeriu i ri, i identifikuar me Krishtin. Zoti i ngjallur i gjithësisë jeton në ne!

Në shtëpinë ku u rrita në Rosuell kishim pemë mollësh të egra në oborrin pas shtëpisë. Një ditë mora një mollë nga pema dhe e kafshova. Vendim i keq! Prisja diçka të ëmbël, por në fakt m’u hidhërua goja. E nxorra menjëherë mollën dhe shpreha neverinë time me një breshëri fjalësh të ndyra.

I jam mirënjohës David Nidhemit, i cili përdorte pemën e mollës së egër si një ilustrim të gjallë të asaj që ndodh kur një person bëhet i krishterë. Pasi shijova frutin e hidhur kuptova se pse e përdorte për të përfaqësuar natyrën tonë thelbësore para se të besonim në Krishtin. Apostulli Pal shkruan te Efesianëve 2:3: “Ndërmjet të cilëve edhe ne dikur jetuam në lakmitë e mishit tonë duke i plotësuar dëshirat e mishit dhe të mendjes, dhe ishim prej natyre bij të zemërimit, ashtu si edhe të tjerët”.

Ashtu si një pemë molle e egër që prodhon mollë të tharta, të cilat

janë të destinuara për prishje, po kështu natyra e ligë prodhoi vepra mëkatore që rezultuan në mjerim dhe vdekje.

Por supozo që një ditë im atë, i lodhur nga frutat e tharta të mollëve të egra, të bënte një prerje diagonale përqark tringut të njëres prej pemëve. Dhe pastaj të merrte një copë të njomë kërcelli, të prerë sipas të njëjtës formë diagonale nga një pemë tjetër dhe ta vendoste te pjesa e prerë në tring. Më pas ai mbështolli dhe taposi kërcellin dhe lidhi atë me një mbajtëse. Para se të largohej ai vendosi një etiketë te një prej degëve të reja që shkruante: “Mollë golden e shijshme”.

Në muajt në vazhdim do të shfaqeshin sythas sipas vijës së prerjes. Më në fund ata do të lulëzonin dhe nuk do të prodhonin mollë të egra, por golden të shijshme. Nuk do të ishte më një pemë molle e egër, as një pemë molle e egër e përzier me golden të shijshme. Do të ishte një pemë molle golden e shijshme. Kjo do të ishte identiteti i saj i ri.

Por pema kishte ende disa probleme me identitetin. Pse? Sepse poshtë shartimit rriteshin filizat që thithnin lëndën ushqyese. Dhe nëse nuk priteshin, ato bënin mollë të egra. Por ato filiza dhe frutat e tyre ishin uzurpatorë që meritonin vetëm një gjë: prerjen.

Tim eti i duhej të punonte me zell sepse filizat poshtë shartimit donin të rriteshin. Nëse nuk arrinte t’i hiqte, ato do t’ia merrnin frymën pemës në atë mënyrë sa që identiteti i saj i vërtetë nuk do të shihej, duke qenë i rrethuar nga filizat e egër poshtë shartimit.

Por edhe nëse do të ndodhte kjo gjë, im atë nuk do të ndryshonte etiketën. Pse? Sepse natyra thelbësore e pemës do të mbetej pemë e shijshme golden. Filizat e egër duhej të priteshin sepse nuk përfaqësonin më identitetin e vërtetë të pemës¹.

Historia ilustron atë që Pali na mëson te Romakëve 6. Në momentin që ke besuar te Krishti, vetja jote e vjetër është prerë, është kryqëzuar. Ajo që ke qenë si natyrë, “bir i zemërimit”, nuk ekziston më. Në këtë moment ti je një njeri i ri, një pemë golden e shijshme. Ti je me të

1. David Needham, *E drejta e birnisë* (Mostrat, Ore.: Multnomah, 999), f. 82-84.

vërtetë një njeri i ri!

Por siç e di, rrënja dhe baza e trungut të vjetër mbetet në ty. Nuk ka ndryshuar fare. Molla e vjetër e egër brenda teje përpiket të rrisë filizat e egër që do të prodhojnë mollë të egra. Por pavarësisht se sa mollë të egra, mëkate seksuale, shfaqen në jetën tënde, si natyrë ti je një njeri i ri.

Ti je çliruar nga pushteti i epsheve të tua seksuale. Dy herë në gjashtë vargjet e parë të atij kapitulli Pali përdor fjalën di. Hapi i parë për të kuptuar identitetin tënd të ri përfshin njohjen. Ti je një njeri i ri, sepse je bashkuar me Krishtin dhe orekset epushore të njeriut tënd të vjetër nuk kanë më pushtet mbi ty ashtu siç nuk kanë mbi të. Ai është molla golden e shijshme që është shartuar në ty, duke ndryshuar identitetin tënd.

HAPI I DYTË: Beso se jeton me Krishtin

Ti, për shkak se je sunduar nga mishi yt dhe epsi i tij për një kohë të gjatë, mund të mos *ndjesh* që pushteti i tij është shkatërruar. Mund të *ndihesh* si një mollë e egër. Mund të mos *ndihesh* si një njeri i ri në Krishtin: një mollë golden e shijshme. Pavarësisht se si *ndihesh*, duhet të dish që Krishti ka shkatërruar pushtetin e njeriut të vjetër me orekset e tij mëkatore. Ti nuk ke pse t’u jepesh dëshirave të tua epushore. Filizat e egër nga trungu i pemës nuk duhet të rriten në jetën tënde dhe të përcaktojnë identitetin tënd.

Duke ditur që pushteti i mëkatit është shkatërruar, na mundëson të jetojmë sipër tërheqjes për poshtë të epushit. Duke besuar se ne “do të jetojmë me të” (Romakëve 6:8), na mundëson të ecim përpara në jetën tonë. Është besimi ynë në Krishtin që çliron pushtetin e pakufizuar për të prodhuar mollë golden të shijshme në jetët tona.

Jezusi të ka thirrur të kesh miqësi me të. Tërë fuqia dhe fitorja e tij të përkasin ty tani. Kjo e vërtetë është kaq reale saqë Pali nxit besimtarët: “Kështu edhe ju, konsideroheni veten të vdekur për mëkatën, por të gjallë për Perëndinë, në Jezu Krishtin, Zotin tonë” (Romakëve 6:11).

Mund të mos mendosh se ke besim të mjaftueshëm. Por ke në fakt.

Ti ushtron besim të mjaftueshëm çdo ditë për të çliruar fuqinë e Krishtit përmes njeriut tënd të ri.

Dyshoj se ke një makinë të parkuar në garazh, rrugë apo parking. Poshtë kofanos së asaj makine ka një motorr. Pothuajse çdo ditë ti hipën në atë makinë, fut çelësin në kuadër dhe ndez motorrin.

Ky aktivitetet përfshin besim në makinë, çelës dhe motorr. Ka raste kur makian është e pistë dhe nuk duket se mund të të çojë diku. Në raste të tjera nuk je në terezi për të shkuar gjëkund. Por pavarësisht se si duket makina apo se si ndihesh ti, nëse makina është në gjendje pune dhe ti ndez kuadrin, motorri do të ndizet. Makina do të të çojë atje ku do ti.

Fuqia e Krishtit nuk do të vlejë derisa ta kuptosh. Kjo ndodh duke ditur se gjithçka që është e vërtetë për të është e vërtetë për ty dhe duke i besuar atij për të jetuar jetën e tij përmes teje.

HAPI I TRETË: Jepju Perëndisë

Edhe pse di se si të ndezësh makinën, mund të jesh më pak i sigurt se si të përdorësh fuqinë e Perëndisë. Pali na jep udhëzime të veçanta kur na thotë që t'ia japim gjymtyrët e trupit tonë Perëndisë si “As mos i jepni gjymtyrët tuaja në shërbim të mëkatit si mjete paudhësie, por tregoni veten tuaj te Perëndia, si të gjallë prej së vdekurish, dhe gjymtyrët tuaja si mjete drejtësie për Perëndinë” (Romakëve 6:13).

Në çastin që tundoresh për të parë pornografi, të kërkosh në internet foto erotike, të flirtosh me një kolege apo të shkosh në një klub zhveshjeje, je duke marrë një vendim në bazë të asaj që e konsideron veten. Nëse e konsideron veten si skllav të mëkatit, duke mos qenë i zoti për t'i thënë jo dëshirave të tua seksuale, pema e egër që është në pjesën e poshtme të pemës, do t'u bindesh me shumë mundësi urdhërave të pemës së egër dhe do të prodhosh mollë të egra: mendime dhe veprime epshore.

Nëse e konsideron veten si të çliruar nga pushteti i mëkatit, do ta paraqesësh veten si skllav i Perëndisë dhe do të largohesh nga ai tundim.

Do të prodhosh mollë golden të shijshme sepse ti je një pemë molle golden e shijshme.

Si e ushtron besimin tënd te makina? Ti futesh në të, ndez motorrin dhe i jep. Me fjalë të tjera, besimi yt tregohet nga veprimet e tua. Në mënyrë të ngjashme ti ushtron besim në Krishtin duke iu drejtuar atij kur tundohesh dhe duke besuar në të për fuqinë që ke nevojë për t'iu bindur.

Herën tjetër kur epshi të të psherëtitijë në vesh, ktheji kurrizin dhe shiko Krishtin. Mos u përball me epshin tënd vetëm. Mos i bëj ballë duke thënë: “Nuk mund ta dëgjoj”. Po kthehu te Perëndia dhe thuaj: “O Atë, të falënderoj që më ke çliruar nga orekset e mia epshore. Të falënderoj që më ke dhënë fuqinë e Jezusit. Tani po i besoj atij që më bën të jetoj sipas identitetit tim të vërtetë dhe të përjetoj fitoren mbi mëkatit”.

Le të supozojmë që po bën stërvitje në palestër dhe kalon afër një vajzë tërheqëse që ka veshur një kostum që nxjerr në pah elementët e saj më tërheqës. Ti e shikon dhe duket mirë. Ti dëgjon epshin tënd që po të kërkon të vazhdosh ta shikosh bukurinë e saj apo ta ndjekësh pa u vënë re. Nëse thua me vete: “Nuk do të shikoj”, ka shumë gjasa që do të vazhdosh të shikosh.

Por thuaj: “O Atë, të falënderoj që jam një njeri i ri... një njeri i mirë në Krishtin. Tani po i besoj fuqisë së Jezusit që të më bëjë të hedh sytë nga ana tjetër”.

Kjo strategji funksionon nëse është një vajzë seksi në palestër, një kolege tërheqëse dhe që flirton me ty, një foto në kompjuter apo një grua që shikon duke ecur në rrugë. Nëse përpiqesh të luftosh kundër epshit tënd me fuqinë tënde, do të humbasësh. Është shumë e fortë. Në vend të kësaj lejoji Krishtit të luftojë për ty.

Kur isha në klasë të nëntë, Ron Kompton, një nxënës i klasës, më përçmonte. Roni dukej si gjigant. Ai ishte një burrë midis djemve. Ai ishte njëqind e nëntëdhjetë centimetra i lartë dhe peshonte njëqind kilogram. Unë ishte vetëm njëqind e gjashtëdhjetë e tetë centimetra i lartë dhe peshoja gjashtëdhjetë kilogram. Grushti i Ronit ishte pothuajse sa koka ime.

Një natë në një mbrëmje Roni mbërriti vonë. Ai, kur zbuloi që isha atje, kërkoi të më kapte. Për pak minuta po më fliste me fjalë të pista dhe po më godiste. Unë si idiot e lejova të më gjuante në oborrin para shtëpisë, ku më tha se do të më vriste.

Unë rashë në gjunjë dhe fillova të qaja si foshnjë ta bindja Ronin të më rrihte në vend të butë dhe do ta bëja këtë nëse do të kisha menduar se do të më shpëtonte.

Ne ishim në oborr të rrethuar nga rreth tridhjetë fëmijë, të cilët po na nxisnin të vazhdonim. Papritur u dëgjuan frenat gozhdë të një makine. Pas pak u përplas një derë dhe dikush thirri: “Kompton!”

E njoha zërin. Ishte miku im më i mirë, Majk Tempëll. Majku ishte djali i vetëm në qytet që ishte më i madh dhe më i zoti se sa Ron Kompton. Majku, para se të mbaronte shkollën e mesme, qe mbrojtës për dy vjet rresht në skuadrën kombëtare të futbollit. Më vonë në kolegj luajti futboll për shtetin e Oklahomës. Ai ishte një djalë i fortë dhe kishte qejf të zihej.

Majku bëri rrugë në mes të turmës, shkoi te Komptoni, e shtyu dhe i tha: “Kompton, nëse do ta prekësh Perkinsin, do të kalosh mbi trupin tim përpara!”

Ndjeva një valë guximi dhe iu drejtova Ronit: “Pikërisht, Kompton” – i thashë – “dhe mos e hiq nga mendja!”

Roni filloi të qaravitej se si nuk e kishte kuptuar që unë dhe Majku ishim shokë. Ai i siguroi mikut tim që nuk do ta mërziste më.

Më pëlqen kjo histori, sepse ilustron se si ndeshet Jezusi për mua. Nuk kam pse të vuaj më nga disfatat poshtëruese.

Ne besojmë se Krishti na ka çliruar nga mëkati dhe epshi. Bashkimi ynë me të është burimi i vetëkontrollit tonë. Ne duhet të besojmë që jemi të identifikuar me të dhe se ai është burimi i fitores tonë. Ne duhet të pranojmë fitoren e tij në mendjet dhe shpirtat tanë.

HAPI I KATËRT: Mos i lër terren epshit

Fitorja ndaj epshit seksual nuk vjen vetëm se e dimë që jemi të

identifikuar me Krishtin dhe kemi fitoren në të. Beteja kundër epshit nuk fitohet vetëm nga të kuptuarit. Nuk sigurohet gjithashtu ngaqë kemi të mundur fuqinë e Krishtit. Ne duhet të jemi të zellshëm në refuzimin tonë për të mos i dhënë epshit terren në jetën tonë.

Pali ka shkruar: “A nuk e dini ju se nëse e tregoni veten shërbëtorë të atij që i bindeni, jeni shërbëtorë të atij që i bindeni, qoftë mëkatit për vdekje, qoftë dëgjësës për drejtësi?” (Romakëve 6:16).

Është e lehtë të besosh atë gënjeshtër që thotë: “Mëkati ynë i vogël nuk do të lëndojë. Një shikim te fotot e gazetës nuk do të bëjnë asnjë dëm: ato nuk janë erotike. Një shikim i shkurtër në faqet pornografike në internet nuk do të bëjnë dëm; çfarë dëmi do të ketë vetëm një vështrim i shkurtër? Një bisedë flirtuese nuk do të ketë rëndësi, ne jemi thjesht miq që po bëjmë shaka”.

Mesazhi i Palit është i qartë: “Në asnjë mënyrë, shoku! Një mëkat i vogël çon në skllavërim”. Përfundimisht do të drejtohesh nga zgjedhjet e tua të cilat do të jenë pronari yt. Nëse i jep epshit tënd një ushqim të lehtë, një shikim të tepruar apo një buzëqeshje flirtuese, kjo do të përcaktojë jetën tënde. Do të bëhet pronari yt. Nga ana tjetër, nëse i jepesh Krishtit, ai do të jetë pronari yt.

Tre elementët e fitores

Para se të vazhdojmë, do të doja të përmblihdhja atë që kemi mësuar në këtë kapitull. Ka tre elementë të rëndësishëm që do të të ndihmojnë ty si njeri të ri të përjetosh fitoren ndaj epshit seksual. Do të jetë e dobishme për ty t’i lexosh këto me zë të lartë derisa t’i kesh mësuar. Sapo t’i kesh mësuar përmendësh, përsëri shpesh me zë të lartë.

Perspektiva

Jam një njeri i ri. E shikoj ndryshe epshin tim seksual. Jam i bashkuar me Krishtin dhe fuqia e mëkatit tim dhe orekset e tij seksuale janë mposhtur. Nuk kam pse t’u bindem më urdhërave të tyre.

Herën tjetër që do të tundohej për të kryer edhe mëkatin më të vogël seksual, do të falënderoj Perëndinë që më ka çliruar nga kjo gjë. Do të

mendohem rreth faktit se jam në Krishtin dhe gjithçka që është e vërtetë për të është e vërtetë për mua. Jezusi nuk do të më braktisë në tundimet me të cilat përballem dhe me të nuk do të bie.

Prania

Nuk jam i vetëm në betejat e mia. Ekziston Dikush brenda meje që njeh dobësitë e mia dhe më pranon siç jam: Jezu Krishti, Shpëtimtari im. Herën tjetër që do të ndihem i vetëm, do të kujtoj që Krishti është me mua. Në vend që t'u drejtohem përvojave seksuale për të plotësuar nevojën time për intimitet, unë do t'i drejtohem Krishtit.

Fuqia

Unë kam fuqinë e Krishtit të ngjallur që jeton në mua. Unë nuk kam pse të argumentoj apo ndeshem me orekset e mia epushore. Nuk kam pse të zotohem për t'u bërë ballë josheve të tyre. Kur tundohem mund t'i drejtohem Krishtit dhe t'i besoj atij për të më pajisur me fuqinë e tij të ringjalljes.

Perspektiva, prania dhe fuqia janë tre elementët përbërës të njeriut të ri që është në ty. Por të jetosh i lirë duhet një element tjetër. Në kapitullin e radhës do të të jap një strategji që ka si synim për të të ndihmuar që të jetosh i lirë për pjesën tjetër të jetës. Dhe besoj se ajo që do të lexosh të jetë informacioni më i dobishëm në këtë libër.

PËR DISKUTIM

1. Çfarë lloj identiteti të ri ke marrë kur i ke besuar Krishtit? Si e shpjegon ilustrimi i mollës së shijshme golden identitetin tënd të ri? Çfarë përpiqen të bëjë pjesa e poshtme e pemës? A përcaktojnë identitetin tënd të ri në Krishtin filizat e egër? Çfarë e përcakton?
2. Çfarë hapash mund të ndërmarrësh në mënyrë që të përjetosh fitoren ndaj orekseve të tua epshore? Kontrolllo me saktësi atë që do të thuash me vete sa herë që njeriu i mirë që është në ty do të tundohet herën tjetër për t'u joshur nga një femër.
3. Pse është e rrezikshme t'i lësh terren epshit në jetën tënde? Si mund të parandalosh një gjë të tillë që të mos ndodhë?
4. Cilët janë tre elementët frymërorë të fitores ndaj epshit seksual? Si mund të të ndihmojë secili prej tyre?

Ruaj mendimet e tua

Bie zilja e telefonit i cili ndodhej në komodinën pas tavolinës time. E marr dhe sekretarja më thotë që personin që kisha lënë takim në orën 3 kishte ardhur. Kontrollon kalendarin... Kisha shënuar emrat Xhej dhe Xhuli Xhonson. Hëm... emrat e tyre janë aliteracion. Ndoshta u kanë vënë emrat fëmijëve të tyre Xhon, Xhezon, Xhejn dhe Xhenet Xhonson.

Hap derën dhe ata futen brenda. Ulen afër njëri-tjetrit në kolltukun dysh të kuqërremtë me kurriz nga muri matanë tavolinës time. Unë ulem në kolltukun tek ngjyrë kafe që është anës kolltukut dysh.

Ndihem pak i çuditur, sepse Xhuli është një prej grave më të bukura që më kanë parë sytë. Flokët e saj bjondë janë prerë shkurt, vetëm pak poshtë veshëve të saj. Lëkura e saj pa të meta është ngjyrë ari dhe nxjerr në pah sytë blu të çelët. Këmbët e saj, me atë që mund të shoh, janë të gjata dhe të holla.

Shikoj Xhejin dhe pyes veten: *Si ka arritur ta marrë?*

Bëj pyetje të përgjithshme dhe zbuloj se si e ka marrë. Xheji është i zgjuar, mendjemprehje dhe ka sukses në biznes.

Më në fund nxjerr në pah problemin e tyre. “Cili është problemi më i madh me të cilin ndesheni?”

Ata shikojnë njëri-tjetrin. “Ne nuk bëjmë kurrë seks” – thotë Xhulie.

Xheji nuk është në siklet me deklaratën e saj. Ajo është gati të shpërthejë në lot.

“A mund të flasim vetëm?” – kërkon Xheji. “Vetëm për një minutë”.

“Ka problem për ty?” – pyes Xhulin.

Ajo mohon me kokë dhe del jashtë.

“Si është puna?” – pyes Xhejin.

“Nuk doja ta thoja këtë në sy të Xhulit, por sinqerisht e kam më të lehtë të masturboj se sa të bëj seks me Xhulin. Kështu heq një barrë të madhe”.

Sa mirë që nuk arrin të më lexojë mendjen. Pyes veten se si një burrë e konsideron barrë të madhe të bëjë seks me një grua të bukur si Xhuli.

Hamendësoj një shprehje dhe ton jo gjykues. “A e di Xhuli që ti e bën vetë?”.

“Jo, do të vihesha në siklet po t’ia thoja”.

Flasim edhe për disa minuta dhe pastaj Xhuli futet në dhomë. Pyes veten se sa e lënduar dhe e vetmuar duhet të ndihet ajo.

Flasim për një orë rresht dhe pastaj largohen. Mezi pres çdo seancë. Takohemi disa herë të tjera dhe pastaj një ditë marr një telefonatë të papritur nga Xhuli. “Nuk mund të vijmë sot” – thotë ajo. “Shpresoja që të vije ti te shtëpia jonë”.

“A është Xheji aty?”.

“Jo. Atij iu desh të dilte jashtë qytetit... një vendim i çastit të fundit nga pronari. Ai do të kthehet nesër. Shpresoja që ne të dy të takoheshim bashkë. Vetëm”.

Zemra ime rreh dhe ndjej një emocion të ngrohtë që më përshkon trupin. Marr vendimin. “Xhulie, nuk do të të takoj më as ty as Xhejin. Do të marr në telefon Xhejin dhe do t’i jap emrin e një terapeuti. Mendoj se disa nga çështjet tuaja kërkojnë një këshilltar me më përvojë se sa unë”.

Mbyll telefonin dhe vendos fytyrën në tavolinë.

Nuk do ta takoj më Xhulin apo Xhejin. Ndërsa mendohem rreth asaj përvoje që ka ndodhur disa vjet më parë, më kujtohet përsëri që tundimi na godet atëherë kur nuk e presim. Me siguri unë nuk po e prisja një

tundim të tillë.

Disa tundime, si ai me Xhulin, marrin formën e grave prej mishi e gjaku. Të tjerë marrin formën e figurave dydimensionale në ekranin e kompjuterit apo të televizorit. Për burrin që ndeshet me tundimin për të shkuar me gra të tjera, rënia e vlerave seksuale të shoqërisë e shton këtë betejë. Pse? Sepse shumë më tepër gra janë të gatshme të përfshihen në sjellje që konsideroheshin më parë të gabuara.

Në lidhje me tundimin dixhital, është përkeqësuar në vitet e fundit. Shiko statistikat e mëposhtme:

- Të ardhurat nga industria e seksit dhe pornografisë, në 12 miliardë dollarë, në SHBA janë më të mëdha se sa tërë kampionatet e sporteve të marra së bashku. Shitjet e pornografisë në mbarë botën raportohen të jenë 57 miliardë dollarë. Për ta krahasuar, Mikrosofi, i cili shet sistemin operativ që përdoret në shumicën e kompjuterave në botë (përveç programeve të tjera) raportoi 36.8 miliardë dollarë shitje në 2004¹.
- 33 për qind e klerit ka pranuar se ka parë një faqe interneti me përmbajtje të hapur seksuale. Nga ata që kanë parë një faqe pornografike, 53 për qind ka parë faqe të tilla “disa herë” në vitin që shkoi dhe 18 për qind i ka parë faqet me përmbajtje të hapur seksuale nga dy herë në muaj deri në më shumë se një 1 herë në javë².
- 47 për qind e familjeve kanë thënë se pornografia është një problem në shtëpinë e tyre³.

Nëse je një burrë që jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk mund t’i shpëtosh tundimit seksual: veç nëse je në koma dhe dikush

1. *Media për familjen e sigurt.*

2. Nga sondazhi i *Krishterimi sot* (2000).

3. Nga sondazhi i *Përqendrimi te familja* (1 tetor 2003).

po ta lexon ty këtë libër. Erotizmi është ngado. Ajo për të cilën burrat udhëtonin përgjatë qytetit për ta gjetur në një kinema të vogël me dritare të errësuar, ofrohet tani në privacinë dhe rehatinë e shtëpisë së tyre. Dhe e tërë kjo bëhet në një ambient në të cilin na thuhet se është e shëndetshme të përfshihesh në orekse seksuale: të tëra, në çfarëdo lloj mënyre.

A nuk do të ishte fantastike të bëje një lutje dhe ta shikoje veten të rrethuar nga një pengesë e padepërtueshme, një sistem mbrojtjeje që do të parandalonte çdo foto të papastër sensuale që të mos futet në sytë e tu? Ndërsa një sistem i tillë nuk ekziston, kjo nuk do të thotë që ne nuk mund të mbrohemi nga tundimi. Ne mundemi. Por do të kërkonte një sistem mbrojtjeje vetjake që do të ruajë pastërtinë tënde, një sistem që do të të mundësojë që të identifikosh dhe shmangësh situatat e vështira të ofruara nga shoqëria jonë e pushtuar nga seksi. Dhe do të thotë të vendosësh që më përpara se si do të përgjigjesh kur të tundohesh.

Tundimi ndjek gjithmonë të njëjtën rrugë

Fatmirësisht cikli nga mendimi te mëkati ndjek gjithmonë të njëjtën rrugë. Unë e quaj këtë “ciklin e tundimit” dhe sa herë që mëkaton nga ana seksuale, ti e ndjek atë. Prandaj ky kapitull, dhe tjetri, janë vendimtarë. Brenda faqeve të tyre do të fitosh një njohuri të ciklit të tundimit dhe do të zhvillosh një strategji për ta shmangur.

Kemi parë tashmë që ne kemi orekse epshore që janë të pushtuara me një gjë: kënaqësi seksuale me çdo kusht. Sapo shfaqet epshi i një burri, çdo ndjenjë e së drejtës dhe së gabuarës fillon të shuhet. Burrat do të sakrifikojnë gjithçka për një çast kënaqësie seksuale. Mjafton të pyesësh disa nga djemtë që u kapën në programin investigativ të NBC-së për mëkatet seksuale *Kape grabitqarin*. Tregtarë, mësues, trajnerë dhe madje pastorë janë futur të gjithë në dhomën e karremit duke u hequr si një vajzë katërbëdhjetë vjeçare me të cilën ata flisnin në rrjet. Ata


ndodhen atje me synimin për të pasur seks me atë vajzë minorene. Në disa raste ata rrëfejnë se kanë parë shfaqje të mëparshme të programit. Çfarë do të tërhiqte burrat të bëjnë diçka të tillë të marrë? Përgjigjja është e thjeshtë: epshi i pafrenuar seksual.

Betimi ynë për t'iu kushtuar Perëndisë humbet kuptimin në mendjen tonë sapo kontrollohet nga epshi. Pse? Sepse burri kontrollohet nga mishi i tij nuk është në gjendje t'i bindet Perëndisë. Pali thotë të njëjtën gjë kur shkruan: “Në fakt mendja e kontrolluar nga mishi është armiqësi kundër Perëndisë, sepse nuk i nënshtrohet ligjit të Perëndisë dhe as nuk mundet. Prandaj ata që janë në mish nuk mund t'i pëlqejnë Perëndisë” (Romakëve 8:7-8).


Në kapitullin e mëparshëm shqyrtoam identitetin dhe natyrën e re që kemi për shkak se jemi në Krishtin (2 Korintasve 5:17). Pamë që për aq kohë sa besojmë që Krishti jeton brenda nesh, fuqia e orekseve tona mëkatore bie, pema e egër është nën kontroll, filizat e egër priten dhe ne veprojmë si mollë të shijshme golden. Problemi është se beteja për mbizotërim zhvillohet brenda nesh. Orekset tona mëkatore dhe epshore, trangu i mollës së egër dhe rrënjët e saj, ndeshen kundër natyrës sonë të re për të kontrolluar vullnetin tonë dhe për të drejtuar trupin tonë. Sapo u hapim krahun orekseve tona, ato do të mbizotërojnë jetën tonë.

Për të parandaluar një gjë të tillë duhet të pranojmë që epshi ynë na sulmon gjithmonë mendjen tonë në të njëjtën mënyrë. Fatmirësisht për ne, Jakobi, vëllai nga nëna i Jezusit, na ka paraqitur planin e betejës kundër Armikut. Sapo të kuptojmë planin, mund të formojmë një strategji për ta mposhtur.

Më parë paraqita katër fazat e ciklit “të varësisë”



Tani do të shikojmë “ciklin e tundimit” siç e shikon Jakobi. Fazat e tundimit që përmend ai janë:



Këto katër faza janë paralel me ato që përdorin psikologët sot për të përshkruar ciklin “e varësisë”. Jakobi, duke shkruar dy mijë vjet më parë, përcaktoi ciklin me të cilin ndeshemi sot. Ai nxit lexuesit e tij të jenë në dijeni të ciklit në mënyrë që ta shmangin.

FAZA E PARË: **Shqetësimi/Joshja**

Jakobi shkruan: “Por secili tundohet i udhëhequr dhe i mashtruar nga lakmia e vet” (Jakobi 1:14). Në gjuhën origjinale fjalët “i udhëhequr” dhe “i mashtruar” janë terma peshkimi. Ato flasin për një peshk që tërhiqet nga vendi i tij ku është fshehur dhe joshet nga një karrem

tundues.

Atëherë, si reagon peshku ndaj tundimit?

Si del nga vendi i tij i sigurt.

Ai noton përqark karremit.

Ai bindet që nuk ka rrezik.

Ai bindet që nuk do ta zënë.

Ai thotë me vete se mund të marrë karremin dhe të shmangë gremçin.

Në rregull, peshqit nuk mendojnë, por nëse do të mendonin, do të mendonin në këtë mënyrë. Kjo me siguri përshkruan mënyrën se si mendojnë burrat. Satani apo një prej demonëve të tij na vë përpara syve një foto sensuale. Ata mund të përdorin artikullin e një gazete, figurën e një reklame, adresën joshëse në internet, një skenë sensuale në televizor apo një koleg që flirton. Për shkak se këto frymëra të ndryra kanë fuqinë për të theksuar një objekt në mënyrë që të ketë një tërheqje të mbinatyrshe, objekti i dëshirës sonë merr një bukuri shtesë.

Në një çast dëshira jonë e pshorë psherëtin: “Duket bukur, apo jo? Nuk ka problem po të mendosh se sa bukur duket ajo. Çfarë do të doje të bëje me të”.

Me pak kundërshti ne dëgjojmë dhe besojmë gënjeshtat e ephshit tonë. Ne bindemi që mund të luajmë mendërisht me karremin dhe të mos na kapë gremçi. Ne verbohemi nga rreziku i gremçit dhe dorës që mban shkopin.

Për shkak se shqetësimi përfshin vetëm mendjen tonë, është e lehtë të minimizojmë dëmin që shkakton. Dhe kështu ne fantazojmë për fotot e shkuara që kemi parë në internet. Ne ëndërrojmë me sy hapur për vajzën me të cilën kemi bërë seks në të shkuarën. Ne zhveshim me mendjen vajzën seksi që kemi parë në palestër.

Kjo është faza e ciklit në të cilën duhet të ndërmarrësh një veprim agresiv. Duhet të ndalosh menjëherë së ëndërruari me sy hapur për pornon, klubet e zhveshjes, lidhjet e shkuara, apo çfarëdo lloj gjëje tjetër që nxit ephshin tënd. Nëse nis të fantazosh, fillo të mendosh menjëherë

për diçka tjetër. Nëse nuk e shmang ciklin e tundimit tënd në këtë moment, do të vazhdash në fazën tjetër. Kur të arrish atje mëkati fizik është i pashmangshëm.

Kur Satani tundoj Jezusin në shkretëtirë, Zoti nuk e mendoj ofertën dy herë, edhe pse tundimet kishin të bënin me fusha të një nevoje të madhe. Për shembull, Jezusi nuk kishte ngrënë për dyzet ditë kur Satani e nxiti të kthente gurët në bukë. Jezusi mund të kishte arsytuar: “Pse jo? Mbi të gjitha uria është një nevojë njerëzore e lejueshme dhe unë kam fuqinë të bëj bukë nga gurët”.

Zoti mund të kishte marrë në konsideratë sugjerimin e armikut të tij. Por nëse lexon historinë të Mateu 4, do të vësh re që nuk ka hendek midis tundimit të Satanit dhe përgjigjes së Zotit. Jezusi citon menjëherë Shkrimin dhe qorton sulmin e Satanit. Ai nuk lejoi kurrë mendjen e tij të luante me tundimin.

Një përgjigje e tillë kërkon vigjilencë mendore. Pjetri na nxiti: “Ngjeshni ijët e mendjes suaj, rrini zgjuar dhe mbani shpresë të plotë në hirin që do vijë mbi ju në zbulesën e Jezu Krishtit. Si bij të bindur, mos iu përshtatni lakmive të mëparshme kur ishit në padijen tuaj” (1 Pjetrit 1:13-14).

Një plan veprimi për shqetësimin

Ndërprerja e tundimit në fazën e joshjes kërkon përgatitje, vetëkontroll dhe përqëndrim të Krishti. Si mund t’ia arrish kësaj? Dy gjëra do të të ndihmojnë për të forcuar mendjen tënde.

E PARA: Mendo thellë për vargjet biblike

*Ajo që i thua vetes në çastin
e tundimit është thelbësore nëse do të çlirosh
mishin tënd dhe të besosh në Krishtin për fitoren e tij.*

Siç e thashë në kapitullin e shkuar, mos thuaj me vete: “Nuk mund

të mendoj për këtë. Nuk do të mendoj për këtë”. Në çastin që mendon në këtë mënyrë, ti je duke nxitur mishin tënd. Je duke u përqëndruar në atë që nuk duhet të mendosh se sa për atë që duhet të mendosh.

Nëse dikush do të më thoshte që mos shikojë elefantët e bardhë dhe unë do të përsërisja me vete: “Nuk do të mendoj për elefantët e bardhë, nuk do të mendoj për elefantët e bardhë”, çfarë jam duke bërë? Po mendoj për elefantët e bardhë.

Nëse them me vete: “Nuk do të mendoj për atë vajzën në punë, nuk do të mendoj për atë vajzën në punë”, çfarë po bëj? Po mendoj për atë vajzën në punë. Jam duke ushqyer epshin seksual dhe jo njeriun e ri që është në mua.

Duhet t’i mësoj t’i them vetes në çastin e tundimit: “Të falënderoj, o Zot, që më shpëtove nga kjo gjë. Tani po të besoj ty që të jetosh në mua jetën tënde. I besoj Fjalës tënde të pastrojë mendjen time”.

Sapo kam bërë këtë lutje, unë zgjedh të mbush mendjen me pjesë nga Bibla në vend të figurave erotike. Ashtu si Jezusi, edhe ne duhet të përdorim Shkrimin për të nxjerrë në shesh gënjeshtërën e tundimit. Kam parë që të mësuarit përmendësh i pjesëve të mëdha të Biblës më jep një përqendrim të sigurt mendor kur tundohem. Në kohën kur shikoj një apo dy paragrafë, fryma ime, njeriu im i ri, njeriu i mirë që është në mua, forcohet dhe mendja ime pastrohet.

Arsyeja se pse kjo funksionon kaq mirë është për shkak se Perëndia përdor Biblën për të nxjerrë në shesh rrezikun e karremit. Peshkut karremi i duket diçka reale. Ai jep iluzionin e ushqimit të vërtetë. Në mënyrë të ngjashme objekti i epshit tonë na jep iluzionin e intimitetit. Na premtion kënaqësinë duke mbushur boshllëkun e zemrave tona. Mendimi thellë rreth së vërtetës së Shkrimit na ndihmon të shikojmë iluzionin ashtu siç është. (Në kapitullin 13 kam paraqitur disa vargje të dobishme).

Ka një arsye tjetër se pse mendimi thellë rreth Shkrimit na ndihmon të ndërpresim ciklin. Mendjet tona mund të mendojnë vetëm rreth një gjëje në një moment të caktuar. Për aq kohë sa je duke parë vargje biblike, mendja jote shpërqendrohet nga mendimi apo veprimi tundues

dhe fryma jote forcohet.

E DYTA: Nëse je i martuar, mendo për gruan tënde

Përqendrimi i mendjes te gruaja jote do të forcojë njeriun e ri që është në ty. Nëse gruaja jote ka humbur një farë bukurie të rinisë, atëherë mendo për të kur e kishte atë bukuri. Te Fjalët e Urta 5:18-19 Salomoni thotë kështu:

***Qoftë i bekuar burimi yt
dhe gëzohu me nusen e rinisë sate.
Drenushë e dashur dhe gazelë hirplotë,
sisët e saj le të të kënaqin kurdoherë,
dhe qofsh vazhdimisht i dhënë pas dashurisë që ke për të.***

Edhe kur gjoksi i saj të fillojë të bjerë me kalimin e moshës, burri duhet të gëzohet me gruan e rinisë së tij. Ai duhet të kënaqet me gjoksin e saj. Ti, duke u gëzuar mendërisht me gruan tënde, do të përqendrosh energjitë e tua seksuale në të. Jo në ndonjë tjetër.

Sigurisht, nëse e ke ushqyer epshin tënd me foto të papastra, do të të nxisë të kthehesh tek ato figura mendore.

Është e pamundur të theksosh mjaftueshëm rëndësinë e mbajtjes së mendjes të pastër. Jezusi tha: “Por unë po ju them se kushdo që shikon një grua për ta dëshiruar, ka shkelur kurorën me të në zemrën e vet” (Mateu 5:28). Nuk besoj se Jezusi nënkuptonte që mendimi për kryerjen e tradhtisë bashkëshortore është po aq i keq sa edhe vetë tradhtia. Po besoj se nënkuptonte që burri që mendon për të do të realizojë me shumë gjasa aktin kur t’i jepet mundësia. Mendoj se një prej arsyeve se pse refuzova ftesën e Xhuli Xhonsonit është sepse, ndërkohë që shijoja bukurinë e saj, nuk fantazova kurrë për të.

***Te Luka 6:45 Jezusi tha:
“Njeriu i mirë e nxjerr të mirën nga thesari i mirë***

*i zemrës së vet; dhe njeriu i mbrapshtë nxjerr
të mbrapshta nga thesari i keq i zemrës së vet,
sepse goja e njerit flet nga mbushullia e zemrës”*

Zoti e bëri të qartë që veprimet e mira rrjedhin nga mendimet e mira dhe veprimet e këqija rrjedhin nga mendimet e këqija.

Mendoj që do të çuditesh se sa shpejt do ta pastrojë Perëndia mendjen tënde nëse do të mendosh thellë për Fjalën e Tij dhe gruan tënde (nëse je i martuar). Ne kujtojmë gjithmonë atë që përsërisim dhe nëse resht së përsërituri fotot e papastra erotike dhe përvojat seksuale të së shkuarës, me kalimin e kohës kujtimet do të shuhën.

Ndërsa mendimi thellë për Shkrimin dhe gruan tënde do të të ndihmojë shumë me shqetësimin, mund të jesh duke kërcitur gishtat tani duke menduar: *E kam provuar këtë. Nuk funksionon.*

Nëse po ndodh kjo në mendjen tënde, e kuptoj. Në fakt, nëse e vetmja gjë që bën është pastrimi i mendjes tënde, me shumë gjasa do të biesh përsëri në mëkate seksuale. Nuk dua që me këtë të ul rëndësinë e përqendrimit të mendimeve të tua në atë që është e mirë. Ti nuk bën një jetë të pastër pa mendime të pastra. Por nëse nuk e ke pasur nevojë për diçka tjetër, atëherë nuk mendoj se Jakobi do të kishte përshkruar fazën tjetër të ciklit të tundimit.

Në kapitullin e radhës do të kuptosh atë fazë dhe do të zhvillosh një plan për ta shmangur.

PËR DISKUTIM

1. Si kanë ndryshuar vlerat kulturore të vendit tonë në njëzet vitet e fundit? Si të ka ndikuar kjo ty?
2. Pse zotimet e tua të përkushtimit nuk vlejnë fare nëse mendja jote kontrollohet nga epshi?
3. Cilat janë katër fazat e ciklit të “varësisë/tundimit”?
4. Pse është e lehtë për ne të zvogëlojmë rrezikun e shqetësimit (joshjes)?
5. Pse duhet të ndërmarrësh veprim agresiv në fazën e shqetësimit?
6. Çfarë veprimi specifik do të ndërmarrësh në këtë fazë në të ardhmen?
7. Çfarë do të thuash saktësisht kur të tundoresh? Krahaso atë me lutjen e shkurtër në faqen 176.

Prish ciklin e tundimit

“Bill, kam një lajm shumë të mirë” – tha Sindi. “Do të bëhemi me fëmijë!”.

Për çudinë time ndjeva një valë ngazëllimi. Mund të çuditesh se pse do të më çudiste diçka e tillë. Në fakt përgjigjja më çon në një përvojë traumatike që pata kur ishte tetë vjeç. Një ditë motra ime më e madhe, Uanda, solli në shtëpi foshnjën e saj të porsalindur. “A do ta mbash?” – pyeti ajo.

“Sigurisht” – i thashë.

Ajo filloi të më jepte fëmijën, por pastaj ngurroi. “Duhet të jesh i sigurt dhe ta mbash kokën e tij në mënyrë të sigurt” – më tha ajo. “Muskujt e qafës së tij nuk janë zhvilluar ende dhe nëse nuk ia mban kokën, mund të bjerë në një krah dhe të thyejë qafën dhe të vritet apo paralizohet”.

“Oh” – i thashë.

Përsëri ajo filloi të ma jepte dhe përsëri ngurroi. “Dhe duhet të jesh i kujdeshëm të mos i vendosësh gishtat në majë të kokës së tij. Kockat e kokës nuk janë forcuar ende dhe nëse shtyp atë pjesë të kokës së tij, gishtërinjtë e tu mund t’i futen në tru dhe ta vrasin. Ose mund të mos jetë në gjendje të flasë apo ndonjë gjë e ngjashme”.

“A je i sigurt se dëshiron ta mbash?” – më pyeti ajo.

“Sigurisht” – i thashë.

Uanda më dha djalin e saj dhe u ndjeva si një akrobat ndërsa përdrodha dorën për të mbajtur kokën e tij. Po të mos kishte përmendur atë gjënë e majës së kokës nuk do të më kishte shkuar kurrë në mendje. Por duke qenë kureshtar se sa e butë do të ishte koka e tij, përdora majën e gishtërinjve për të shtypur me butësi majën e kokës. Me dukej mjaft e fortë, por nuk do ta provoja më fort.

Po shijoja momentin kur papritur një shpërthim djathi të shkrirë: si diçka e mbushur me qumësht doli nga goja e tij dhe mbi tërë bluzën time. Sapo ndodhi kjo, e lëshoi edhe nga poshtë. I neveritur ia dhashë motrës: “Ja ku e ke, merre”.

Që prej asaj përvoje nuk i mbaja më fëmijët. Mendoja se ishin të lezetshëm, si një lloj bomboneje, por nuk më pëlqente t’u rrija shumë afër. Nuk është e lehtë të harrosh atë lloj përvoje traumatike.

Atëherë, kur Sindi më tregoi se po priste një fëmijë, mund të kuptoni se pse u habita me gëzimin tim.

Pa harxhuar kohë bëmë një listë me gjërat që kishim nevojë: krevat, perde, lëkundëse, pelena, mbështetëse për të ndërruar pelenat, abazhur nate. Ishim aq të varfër në atë kohë saqë të varfërit na mbështesnin. Atë që nuk morëm si sende të përdorura apo në festën e foshnjës, e morëm te shitjet e gjërave të dorës së tyre.

Për nëntë muaj ishim të përqendruar të bëheshim gati për anëtarin e ri të familjes sonë. Për nëntë muaj u lutëm, luajtëm, pikturoam, bëmë pazar, lexuam dhe folëm. Çdo mendim ishte përqendruar në një gjë: lindja e bebit tonë.

Ndoqëm madje edhe një kurs për lindjen në mënyrë natyrale të foshnjës. Më pëlqente roli im. Qëndroja afër Sindit dhe gulçisja si qen. Ideja ishte që nëse ajo përqendronte vëmendjen e saj tek frymëmarrja ime dhe gulçonte njësoj si unë, do ta shpërqendronte dhe do të zvogëlonte dhimbjen e lindjes së fëmijës. Për çudi funksionoi. Nuk ndjeva dhimbje. Fatkeqësisht Sindi nuk ishte aq me fat kur në orën dy të natës më 5 korrik 1976 shkuam me shpejtësi në spital. Kishim shpresuar për një

lindje natyrale, por pas disa orësh dhimbjeje, dhimbje për të dhe jo për mua, doktori doli në përfundimin që fëmija duhet të lindte me operacion.

Më duket interesante që kur Jakobi kërkoi një ilustrim për ciklin e tundimit, vendosi të përdorte lindjen e një fëmije. Jakobi, pasi përshkruan fazën e joshjes së ciklit, ndryshon figurë. Ai nuk përdor më terminologjinë e një peshkatari, por flet për procesin e lindjes. Ai shkruan: “Pastaj lakmia, pasi mbarset, pjell mëkatin dhe mëkati, si të kryhet, ngjiz vdekjen” (Jakobi 1:15).

Në këtë fazë po fillojmë të krijojmë mendimet tona. Fara e aktit është mbjellë në mendjet tona dhe po rritet. Në fakt sapo procesi arrin këtë fazë, akti është po aq i papërballueshëm sa edhe lindja e një fëmije pasi gruaja është ngjizur.

Ashtu si një çift që përgatitet për ditën e lindjes, edhe ne përqendrojmë vëmendjen tonë në realizimin e menjëhershëm të aktit mëkatar. Ne jemi të gëzuar për atë që do të ndodhë së shpejti. Sigurisht, ndryshe nga një prind që e pret, ne nuk blejmë krevat dhe lodra të tjera e mjete për kujdesin prindëror. Por ka gjëra që bëjmë për t’u përgatitur për lindjen. Psikologët i quajnë zakone. Këto janë aktivitete që kryejmë para se të kryejmë akte seksuale. Ato shprehin dhe nxisin eksitim tonë seksual. Dhe sapo fillojmë ta bëjmë zakon, ne do të kryejmë aktin seksual.

Ajo që i bën zakonet aq tinëzore është që, si një fetus i porsa ngjizur, ato nisin shumë të vogla. U deshën vite për mua të zbuloja që zakoni fillestar për mua ishte shikimi i reklamave në gazetën e mëngjesit. Fotot e modeleve me rroba banjo apo të brendshme dukeshin krejt të padëmshme. Nuk ishin me siguri porno.

Por ashtu siç rritet fetus, po kështu edhe zakonet. Sapo lejoja mishin tim të ushqente pasionet e tij epshore me një pickim pamor nga reklama e gazetës, donte më tepër. Menjëherë filizat e egër lulëzonin dhe kontrolloja fotot në disa prej kapakëve të DVD-ve në Blockbuster. Duhet javë apo madje një muaj apo dy, por ndërsa ndërjegjija ime ngurtësohej gjithnjë e më tepër, zakonet degjeronin dhe përfundoja duke parë vajzat me tanga në internet: të veshura, por disi. Pastaj kapërceja cakun dhe shikoja figurat që ishin tërësisht pornografike.

Nëse ke probleme me gratë prej mishi e gjaku, jo fotot dixhitale, atëherë progresi do të jetë ndryshe, por përfundon me zotimin tënd ndaj mëkatit seksual. Mbase zakoni yt fillestar përfshin flirtim me një kolege të lezetshme. Më pas i kërkon të hani drekë bashkë. Nga ajo pikë marrëdhënia përshkallëzohet derisa ju të dy përfundoni në shtrat bashkë.

FAZA E DYTË: **Ritualizimi/Ngjizja**

*Nuk ka asgjë më të rëndësishme
nëse kërkon çlirim nga epshi seksual
se sa identifikimi i zakoneve që pararendin
një episod kryerje akti.*

Disa nga zakonet që më kanë përmendur burrat përfshijnë:

- Shikimi i internetit
- Shikimi i revistave në një dyqan
- Përdorimi i syve për t'u kënaqur me gratë tërheqëse
- Vizita e klubeve të zhveshjes
- Leximi i reklamave personale
- Kërkimi në një videotekë
- Telefonata ndaj një të dashure të shkuar
- Kërkimi i kanaleve televizive
- Shkuarja te lagjja me drita të kuqe
- Telefonata e numrave 0900 thjesht për informacion
- Dalja për drekë me një të njohur
- Oh po, shikimi i reklamave në gazetë

Secili prej nesh ka zakone. Prishja e ciklit të tundimit kërkon që ti të identifikosh dhe të shpëtosh nga çdo ritual në jetën tënde. Edhe nëse mbijeton njëri, pavarësisht se duket shumë i padëmshëm, do të të çojë në mëkat seksual. Kalo disa minuta dhe kontrollo listën më sipër. Në një copë letër shkruaj të gjitha zakonet e tua shtesë që nuk ndodhen në listë.

Sapo të kesh mbaruar listën, përcakto saktësisht se çfarë hapash do të

ndërmarrësh për të shpëtuar në mënyrë të pamëshirshme nga çdo ritual. Më pas shkruaj planin tënd në faqen nën ritualin.

Përmenda në kapitullin e mëparshëm se sa mirë do të ishte nëse mund të luteshim dhe të rrethoheshim menjëherë nga një mburojë që mund të mbrojë sytë tanë nga figurat sensuale. Meqë nuk ekziston një mburojë e tillë ne mund të mbrojmë veten.

Jezusi na tha t'i kërkojmë Perëndisë “mos lejo të biem në tundim” (Mateu 6:13). Zoti nuk po thotë që nëse nuk i kërkojmë Perëndisë diçka të tillë, ai do të na tundojë. Perëndia nuk mund të mëkatojë as nuk mund të tundojë dikë për të mëkatuar. Por ne duhet t'i kërkojmë vazhdimisht Perëndisë të na largojë nga tundimi. Me pak fjalë duhet të lutemi: “O Atë, mos më jep kurrë rastin për të mëkatuar kur kam dëshirën, apo dëshiroj të mëkatoj kur kam rastin”. Pse? Sepse kur ndeshet rasti me dëshirën për të mëkatuar, shumica e burrave do të bëjnë një zgjedhje të keqe.

Edhe pse mund të mos jemi kurrë në gjendje të kontrollojmë dëshirat tona, ne mund të kontrollojmë zakonisht ambientin tonë. Ne mund të eliminojmë rastet për të mëkatuar. Ne mund të heqim zakonet seksuale nga jeta jonë në mënyrë që kur epshi ynë kërkon një shkarkohet seksualisht, të mos gjendet asnjë.

Ne mund të shmangim gjithashtu situatat që janë të mbushura me tundime. Është vendimtare që të bëjmë zgjedhje të tilla ato herë kur jemi të fortë.

***Me pak fjalë, kur jemi të fortë
ne duhet të marrim vendime për të mbrojtur veten
në kohët e dobësisë.***

Njoh një burrë që hoqi televizorin nga shtëpia. Si një masë tjetër si refuzoi të shikonte televizor pas orës 10 të darkës nëse nuk ishte gruaja e pranishme.

Një mik tjetër që udhëton shpesh refuzon të ndezë televizorin në dhomën e tij. Duke mos ndezur televizorin, ai shmang ritualin e kërkimit

të kanaleve.

Një burrë që shkonte më përpara me prostituta, më tha që bën një rrugë të gjatë për në punë për të mos u futur në lagjen me drita të kuqe.

Kam një mik që më tha që rruga për në shtratin e një gruaje fillon gjithmonë me kërkimin e grave tërheqëse kudo ku shikon. Atij i bëhet mani kërkimi dhe shikimi i grave. Në fakt i bëhet aq mani saqë i transferon në kompjuterin e tij. Ai thotë se duhet të ruajë sytë që të mos vështrojnë gratë e lezetshme gjatë ditës.

Disa vjet më parë u regjistрова te Covenant Eyes, një kompani që shet programe kompjuterike që ruan një histori që nuk fshihet në çdo faqeje që kam hapur në internet. Pastaj identifikon çdo faqe dhe ia dërgon me e-mail listën një partneri të përgjegjshëm. Kam zbuluar se jam po aq i sigurt në internet pa përgjegjësi siç është një burrë me këmbë druri në një zjarr në pyll.

Disa djem e mbledhin mendjen para se të shkojnë në palestër për të bërë stërvitje që nuk do të shikojnë vajzat seksi. Unë zgjedh të bëj stërvitje në atë pjesë të ditës kur nuk ka fare.

Njoh burra që janë lojtarë që duhet të shmangin flirtimin me gratë. Atyre u pëlqen të gjuajnë dhe e dinë që sapo të fillojnë të flirtojnë, kanë aftësinë për t'i çuar gratë në shtrat. Kështu që ata ruajnë marrëdhëniet e tyre të punës me gratë mbi baza të pastra profesionale. Në ambiente shoqërore ata janë miqësore, por jo flirtues.

Ka shembuj të këtyre hapave agresivë që duhet të ndërmerren për të përmbajtur epshin tonë.

Ndërsa bën listën tënde dhe përgatitesh për të prishur zakonet e tua, prit që orekset e tua epshore të kundërshtojnë, sidomos nëse ke kryer akte seksuale.

Epshi yt mund të mos shfaqet si dragua flakëdhedhës që shkatërron jetën tënde. Mund të duket po aq i pafajshëm si edhe një kotele. Do të të lusë të vazhdosh zakonin: atë që pëlqen më shumë. Do të të premtojë që nuk do të të kërkojë më tepër. Do të përpiqet të të bindë që veprime të tilla nuk janë të domosdoshme. Do të të psherëtitijë ty që:

“Nuk do të dëmtojë po të shikosh vajzat seksi në punë”.

“Nuk ke nevojë për një person tjetër përgjegjës të të kontrollojë në internet”.

“Nuk ka asgjë të keqe të bësh pak flirtim”.

“Nuk ka pse t’ua heqësh sytë vajzave që përdridhen në reklamat e birrës”.

Ti duhet të paraprish kërkesat e epshit tënd dhe t’i refuzosh për të të mos diktuar planin tënd të veprimit. Bëj listën e zakoneve që ushqejnë epshin tënd dhe shpëto në mënyrë të pamëshirshme nga to. Nëse nuk shpëton, faza tjetër do të ndodhë me patjetër.

FAZA E TRETË: **Veprimi/Lindja**

Pas ngjizjes vjen natyrshëm lindja. Akti që është ëndërruar dhe planifikuar do të realizohet. Karremi joshës do të shijohet. Nëse nuk prish ciklin në fazat e eksitimit apo ngjizjes, zor se do të jesh në gjendje të pengosh veten që të mos kryesh aktin. Ashtu siç më thoshte shpesh një miku im: “Po e vure këmbën në një rrëpirë, me siguri do të rrëzohesh”. Dhe po ramë, rezultati është me të vërtetë i dhimbshëm.

FAZA E KATËRT: **Turpi/Vdekja**

Lindja e djalit tonë të parë ishte diçka fantastike. Pasi e morën Sindin në sallën e operacionit, prita afër dhomës së infermiereve. Zona e pritjes kishte një tavolinë me katër karrige në çdo anë në mes të një zone katërkëndore. Meqë ishte dita pas katër korrikut 1976, revistat në tavolinë kishin të gjitha si titull kryesor festën e ardhshme dyqindvjetore të kombit tonë.

Po prisja vetëm pesëmbëdhjetë apo njëzet minuta kur u ndez altopalanti që ishte sipër banakut të dhomës së infermiereve. Dëgjoja një foshnjë që qante në sfond ndërkohë që infermierja tha: “Z. Perkins, je babai i një djali katër kilogramsh”.

Fjalët nuk mund të shprehnin gazin që ndjeva në ato çaste. Nuk e kisha idenë që lindja e një djali do të më ndikonte aq thellë.

Jakobi dëshiron që lexuesit e tij të dinë që mëkati premtion një gëzim të tillë. Por nuk e jep asnjëherë. Foshnja është gjithmonë i porsalindur. Kam pasur miq që kanë humbur një fëmijë. Nuk ka dhimbje më të madhe për një prind se sa vdekja e një fëmije. Dëshpërimi bëhet më i keq sepse vjen pas muajsh përgatitjeje, ëndrrash dhe shpresash gëzimi. Në vend që të kishin jetë në duart e tyre, prindërit mbanin një kufomë pa jetë.

Një herë m'u afrua një burrë pasi kisha folur për këtë temë: "Bill, a do të thuash që fëmija im vdiq ngaqë kisha kryer një mëkat seksual?".

Pasi i shprehja keqardhje për vdekjen e fëmijës, e sigurova: "Jakobi nuk po thotë kështu. Ai nuk po thotë që mëkatet tona do të bëjnë që të na vdesë fëmija. Ai po thotë që kur mëkati lind, fëmija është gjithmonë i vdekur. Mëkati nuk sjell jetë, por vdekje".

Gjatë çasteve të shqetësimeve dhe ritualizimeve ne përfytyrojmë kënaqësinë që do të na sjellë akti mëkatar. Ashtu si prindërit që presin të bëhen me fëmijë, ne përgatitemi për lindjen e aktit. Por kur kemi realizuar aktin, pasi është venitur kënaqësia fillestare, na mbetet vdekja dhe turpi.

Jakobi nuk përton të shkruajë: "Pastaj lakmia, pasi mbarset, pjell mëkatin dhe mëkati, si të kryhet, ngjiz vdekjen" (Jakobi 1:15). Kur kryejmë aktin, rezultati është gjithmonë dhimbje dhe turp.

- Në vend të jetës, epshi jep vdekje.
- Në vend të gëzimit, epshi sjell turp.
- Në vend të kënaqësisë, epshi sjell dhimbje.
- Në vend të intimitetit, epshi sjell izolim.

Sjellja seksuale mëkatore çon gjithmonë në dëshpërim. Pyet mbretin David. Pas marrëdhënies së tij të palejueshme me Bathshebën, ai i vrau të shoqin, Uriahun. Më vonë fëmija që rezultoi nga kjo marrëdhënie vdiq.

Pyet Sansonin. Pas marrëdhënies së tij me Delilën humbi shikimin dhe sakrifikoi pozicionin e tij prej drejtuesi në Izrael.

Pyet burrat emrat e të cilëve shfaqen në gazetë çdo javë, burra që kanë sakrifikuar familjet dhe reputacionin e tyre për shkak se nuk i kanë thënë jo epshin të tyre.

Por vazhdo më tej. A ke vepruar në mënyrë mëkatore nga ana seksuale dhe a u ke shpëtuar pasojave? Mbase për pak kohë.

Por përfudimisht përjeton humbje. Askush nuk u shpëton pasojave të mëkateve seksuale. Kur kryejmë aktet seksuale, paguajmë një çmim të lartë. Por ne nuk kemi pse të mëkatojmë. Ne mund të përmbajmë epshin tonë dhe vazhdojmë jetën duke prishur ciklin në fazat e tij të hershme.

I pajisur për të ndihmuar të tjerët

Do të ishte e lehtë për ty të pyesësh se çfarë të mire do të ketë nga betejat e tyre me epshin seksual. E kuptoj si ndihesh. Hedh vështrimin pas në pjesë të jetës time me keqardhje të pastër. Disa herë dëshiroj t'i fshij nga kujtesa si pjesë të një kasete.

Por kuptoj që përvojat e mia, betejat dhe dështimet, kanë thelluar varësinë time ndaj Perëndisë. Ato më kanë ndihmuar të kuptoj vuajtjen dhe betejat që kanë përjetuar burrat e tjerë. Pali shkruan: “Bekuar qoftë Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i të mëshirëve dhe Perëndia e çdo ngushëllimi, i cili na ngushëllon në çdo shtrëngim tonin, që, nëpërmjet ngushëllimit me të cilin ne jemi ngushëlluar nga Perëndia, të mund të ngushëllojmë ata që janë në çfarëdo shtrëngimi” (2 Korintasve 1:3-4).

Falënderoj Perëndinë që përmes Birit të tij ai na pranon ashtu siç jemi. Ai shikon dështimet tona dhe gjithsesi na do. Por bën edhe më tepër. Ai na mbështjell me mburojën e ngushëllimit të tij dhe na shëron plagët. Pastaj na mundëson që t'u ofrojmë të njëjtën mburojë ngushëllimi dhe shërimi të tjerëve.

Kjo e vërtetë na çon në një vend të rëndësishëm. Ndërsa gjen ngushëllim në Perëndinë dhe kërkon të prishës ciklin e tundimit, duhet të ndërmarrësh një hap tjetër. Në fakt, jam i bindur se pa të, nuk do të jesh në gjendje të qëndrosh gjatë. Duhet të lidhesh me burra të tjerë.

Duhet t'u ofrosh atyre ngushëllimin dhe inkurajimin e Zotit dhe duhet t'i lejosh të të mbështesin ndërsa përpiqesh të bësh një jetë të pastër. Në kapitullin e radhë do të zbulosh se si ta bësh këtë.

PËR DISKUTIM

1. Çfarë është rituali apo zakoni?
2. Çfarë zakonesh specifike ke?
3. Pse është e rrezikshme të lejosh qoftë edhe një ritual në dukje i padëmshëm në jetën tënde?
4. Çfarë do të bësh në mënyrë specifike për të shpëtuar nga zakonet apo ritualet e tua?
5. Cili është gjithmonë rezultati i mëkatit seksual?
6. Si mund të përdorë Perëndia dobësinë tënde për të ndihmuar të tjerët?

PJESA E KATËR

**TË JETOSH I LIRË
PËR PJESËN TJETËR
TË JETËS**

Katër fazat e miqësisë

Nëse ke parë ndonjëherë emocionin *Përmirësimi i shtëpisë*, atëherë e di që Tim Alen është një burrë komik. Ajo që mund të mos dish është se ai shkoi në burg për shitje droge. Si e konsideron ai kohën pas hekurave? Pasi mendoi thellë për këtë pyetje, ai tha: “Burgu ishte gjëja më e keqe dhe e më e mirë njëkohësisht që më ka ndodhur”¹.

Alen, në librin e tij më të shitur *Mos i rri shumë afër një burri të zhveshur*, tregon për një përvojë që pati në burg. Ngjarja ndodhi menjëherë pasi ishte futur në një birucë me dhjetë djem të tjerë. Gjëja e parë që vuri re për birucën ishte tualeti në mes të dhomës. Ai mbase e vuri re atë në fillim se natyra po e thërriste. Ai tha se pa nevojtoresh, pastaj tavanin, pastaj nevojtoresh, pastaj dhjetë djemtë në birucë. Donte të largohej. Por dera ishte e mbyllur.

Ai mblodhi mendjen që nuk do ta përdorte atë nevojtoresh. Në asnjë mënyrë! Si mund të ulej atje me dhjetë djem të tjerë që po e shikonin? Më në fund ai shkruan: “Sado të treten gjërat, teprica duhet të dalë jashtë. Po ecja i druajtur drejt nevojtoresh. U ktheva dhe u ktheva te

1. Allen, *Mos rri shumë afër*, f. 84.

ndenjësjë, por e dija që nuk ishte gjë e mirë. Isha i zotuar. U ula dhe papritur tërë burrat filluan të vinin drejt meje. Më hyri frika.

“Nuk kam pse ta bëj. Akoma kjo më heq trurin.

Ata u vunë në formën e një gjysmë rrethi rreth meje duke më kthyer kurrizin”. Pse e bënë një gjë të tillë? Alen tha: “Sepse edhe ata ishin burra. Ishte një zbulim i madh. Këta nuk janë thjesht dështakë si unë, por janë burra. Ata e bëjnë këtë që të kesh pak intimitet dhe askush nuk mund të shikojë nga jashtë”².

Ajo fjali e fundit është shumë e thellë, sepse përshkruan atë që ka nevojë çdo njeri. Ne na duhen miq që kuptojnë frikën tonë dhe na ofrojnë mbrojtje, burra që do të jenë si mburojë gjatë kohës sonë kur jemi të cenueshëm dhe kemi turp.

Sa keq që duhet të shkonte në Aleni për të zbuluar gatishmërinë e burrave për të mbrojtur njëri-tjetrin, për t’i dalë për zot njëri-tjetrit. Për shkak se shumica e burrave nuk janë të detyruar për marrëdhënie të tilla të ngushta, ata nuk e zbulojnë kurrë këtë. Ndërsa kam folur me burra, kam zbuluar se shumica e tyre mendojnë se betejat e tyre me epshin seksual janë personale. Ato janë private. Ato janë të turpshme. Si shkuarja në nevojto; nuk është diçka që burrat e tjerë duan të shikojnë.

Ne ndihemi rehat duke folur me burra rreth gjërave të parëndësishme si loja e golfit, gjendja e makinës sonë apo pushimet e fundit. Por ne kundërshtojmë së foluri për betejat dhe dështimet tona vetjake. Megjithatë na duhen miq me të cilët të tregojmë mëkatet tona më të errëta dhe triumfet tona më të mëdha, miq të cilat mund të na ndihmojnë të mos biem kur tundohemi dhe të na ngrejnë kur biem, miq që mund t’i mbështesim kur janë në nevojë.

Davidi dhe Jonathani kishin atë lloj miqësie. Davidi vajtoi pas vdekjes së Jonathanit: “Unë jam në ankth për ty, o vëllai im Jonatan; ti ishe shumë i dashur për mua, dashuria jote për mua ishte më e mrekullueshme se dashuria e grave” (2 Samuelit 1:26).

2. Si më sipër, f. 86-87.

Ky pohim befasues shpreh një të vërtetë të njohur nga çdo njeri. Pra, ka aspekte të miqësisë së burrave që nuk u ngjajnë dhe janë më të mira se sa ajo që përfshijnë burrat me gratë. Burrat e dinë që miqësi të tilla janë të mundura, por ata nuk dinë se si t'i shprehin.

Në këtë kapitull dua të shqyrtoj procesin nga miqësitë e cekta në miqësi më të mira. Dhe dua që të zbulosh se si mund të kesh miqësi të ngushta me burra të tjerë. Miqësitë që do të të ndihmojnë të rrenjosësh identitetin tënd në Krishtin dhe të të inkurajojnë të bësh një jetë të pastër seksuale.

Një proces të cilin mund të mos e kesh menduar kurrë

A ke pyetur ndonjëherë se si miqësia rritet nga një njohje në punë apo kishë deri në atë pikë sa je gati të japësh jetën për atë djalë? Nuk e kisha menduar kurrë. Në fakt, nuk do ta mendoja për së dyti, apo hiç fare, po të mos qe libri që lexova nga Dr. Herb Goldberg me titull *Rreziqet e të qenit mashkull*.

Goldberg, në librin e tij, identifikon atë që ai e quan katër fazat e të qenit shok³. Në fakt fjala “shok” nuk përdoret shumë nga burrat në kohën e sotme. Goldberg e pëlqen termin sepse flet për rininë dhe spontanitetin. Ai beson që kjo, kur kombinohet me pjekurinë e të rriturve, përmban potencialin për “kulmin e miqësisë mashkullore”⁴. Sipas tij një shok është miku më i mirë... një burrë me të cilin ndihesh rehat dhe i çlirët, një burrë që e do si vëlla, një mik për të cilin do të sakrifikojë gjithçka.

Pyetja që i përgjigjet Goldbergu është: “Si bëjmë shokë?”. Mendimet e tij na ndihmojnë të dimë se pse kemi kaq pak dhe çfarë duhet të bëjmë, apo jemi gati të heqim, për të pasur një të tillë.

3. Ruajta konceptin e Dr. Goldbergut, por ndryshova emrat e fazave të miqësisë.

4. Herb Goldberg, *Rreziqet e të qenit mashkull* (Nju Jork: New American Library, 1976), f. 133.

Miqtë që shkëmbejnë favore

Fillimisht burrat lidhen me burra të tjerë që mund t'i ndihmojnë. Është diçka e ngjashme:

“Hej, Xho, a do të më japësh pak trapanin?”.

“Sigurisht dhe kur të vish ta marrësh, a e ke problem të më japësh atë pajisjen e re elektrike që bleve dje? Do të lustroj makinën sot pasdite”.

Në punë shkëmbimi i favoreve përfshin kujdesin ndaj klientit të përgjegjësit për shitjet, mbulimi i gabimit të një miku dhe ndihma për suksesin e secilit. Për shkak se dobitë janë të larta dhe kostoja emocionale e ulët, shumica e miqësive të meshkujve mbeten në këtë fazë: dhe për aq kohë sa të dy burrat përfitojnë, miqësia rritet. Kur mbaron dobia e dyanshme, miqësia zhduket.

Ndonjëherë një miqësi që shkëmben favore në punë mund të përfundojë keq. Kjo ndodh kur një burrë përdoret nga një tjetër dhe nuk merr gjë mbrapsht apo kur lihet mënjanë si një kazan bosh pasi e kanë përdorur. Një prej mësimëve të dhimbshme që kanë përjetuar disa burra në punë është se kur kanë humbur punën, kanë humbur edhe miqtë e tyre më të mirë të punës. “Mendova se ishim miq të mirë” – do të thonë ata. “Bënim shaka çdo ditë. Ndonjëherë edhe dilnim bashkë pas pune”.

Dhe ata ishin miq... miq që shkëmbejnë favore. Ajo që pak burra kuptojnë është se dobia e dyanshme e miqësisë shërbente si ngjithësi që i mbante bashkë. Hiq ngjithësin dhe miqësia nuk ekziston më.

Mbi dhjetë vjet më parë u largova nga kisha ku isha pastor për nëntë vjet. Edhe pse qëndrova në komunitet, rrallë i shoh miqtë e mi të kishës. Në bazë të vëmendjes që më kanë kushtuar pas largimit tim, unë mund të kisha vdekur dhe do të isha varrosur. Jo, nuk është e saktë. Po të kisha vdekur, ata do të kishin ardhur te varrimi im. Miqtë që shkëmbejnë favore mund të mos të të marrin në telefon, por do të marrin pjesë në varrimin tënd.

Nuk po i gjykoj këta njerëz. Mbi të gjitha ne të gjithë jemi njësoj. Dyshoj se disa prej tyre kanë pyetur veten se pse nuk u kam bërë kurrë një telefonatë. Nuk është se nuk i pëlqej apo përpiqem t'u shmangem. Kur ndeshemi përballë njëri-tjetrit në supermarket apo në ndonjë vend

tjetër, sillemi gjithmonë me mirësjellje. Por meqë nuk kemi më një arsye për të qendruar të lidhur, ne nuk lidhemi.

Para se të lexoja librin e Goldbergut mendoja gjithmonë se zhdukja e papritur e miqve të kishës time dukej e çuditshme dhe pastaj kuptova se ishte vizioni dhe shërbesa jonë e përbashkët në kishë që na mbante së bashku.

Nëse mendon për këtë, shumica e miqve tanë janë mbase njerëz që të bëjnë një favor ndërkohë që ti u bën një favor. Por Goldbergu tregon se nga këto miqësi të dobive të dyanshme mund të dalë një lloj tjetër miku.

Miqtë e argëtimit

Këta miq janë djem me të cilët futemi në zoën e meshkujve. Interesi ynë i përbashkët për golfën, tenisën, gjuetinë, peshkimin, rregullimin e makinave të vjeta apo stërvitja e fëmijëve tanë na bën që të takohemi rregullisht. Aktiviteti siguron ambientin e sigurt ku lidhemi. Meqë miqësia rrotullohet rreth aktivitetit, nuk ka nevojë për afërsi. Diçka e çuditshme për miqtë e argëtimit është ajo që mund të ndodhë nëse je i sëmurë dhe mungon në aktivitet.

“U ktheva” – i thua pjesës tjetër të grupit. “Më vjen keq, mungova herën e kaluar”.

“Mungove herën e kaluar?” – thotë njëri prej tyre.

“Po, u sëmura. Por solla Xhekun të më zëvendësonte”.

“Ah, po. As nuk e vura re që nuk ishe. Mirë je?”.

“Po, jam mirë” – thua ndërsa rregullon topin.

Miqtë e argëtimit zor se i merr malli për njëri-tjetrin për aq kohë sa dikush tjetër i zëvendëson dhe rrallë diskutojnë diçka më të rëndësishme se sa loja e fundit e futbollit. Edhe pse duket e çuditshme, burrat mund të luajnë golf së bashku për vite me radhë dhe të mos e njohin kurrë njëri-tjetrin.

Miqtë e ngushtë

Por diçka tjetër mund të nisë nga miqtë e argëtimit kur dy burra

kanë një ngjasim të natyrshëm, pra, nëse u pëlqen shoqëria me njëri-tjetrit. Në këtë rast ata mund të bëhen miq të ngushtë. Kur ndodh diçka e tillë, ata mund të mos bien dakord pa menduar se duhet ta kenë drejt. Ata mund të luajnë dhe nuk ka rëndësi se kush humbet, edhe pse të dy duan të fitojnë. Miqtë e ngushtë janë burra që kremtojnë me sinqeritet sukseset e njëri-tjetrit. Ndryshe nga miqtë e favoreve reciproke apo të argëtimit, këta lloj miqsh japin ndihmë kur është e nevojshme. Ata mund t'i japin njëri-tjetrit para apo makinën apo mund të na çojnë në aeroport.

Nëse qëndroni për një kohë të gjatë miq të vjetër, do të kesh rastin që për një mik të bëhesh më tepër se një mik.

Shokë për kokë

Miqësia më e thellë midis burrave arrihet rrallë, sepse vijon një krizë. Shumë prej nesh kujtojnë kur ishim fëmijë se bëheshim miq më të mirë me një djalë pasi ishim zënë. Në mënyrë të ngjashme bëhemi shokë për kokë me një burrë vetëm pasi miqësia jonë i ka mbijetuar krizës që ka kërcënuar ta shkatërrojë.

***Shokët për kokë janë miq
të cilët i kanë mbijetuar
krizës së lidhjes.***

Miq që shkëmbejnë favore

▼
Miq të argëtimit

▼
Miq të ngushtë

▼
Një krizë e godet miqësinë

▼
Shokë për kokë

Çarja krijohet shpesh nga një akt pandjeshmërie apo mos respekti

që, si një plagë thike, shkakton dhimbje të thellë. Ky akt u heq maskën të dy burrave dhe nxjerr në pah tehet e mprehët dhe gërvishtjet që nuk ishin parë më herët. Dobësia e qartë e miqve të ngushtë të një kohe duket si një lyth në majë të hundës së tij. Të dy burrat janë të plagosur dhe përballen me tundimin për të braktisur njëri-tjetrin. Në fakt kjo është gjëja më e lehtë për t'u bërë.

Në këtë pikë miqësia lëkundet gati për t'u zhdukur. Dy burrat largohen dhe nuk janë më miq të ngushtë, ose angazhohen gjatë krizës dhe bëhen shokë për kokë. Rritja ndodh kur ata dalin në përfundimin se miqësia është më e rëndësishme se sa plagët e tyre. Kjo ndodh kur secili e shikon dobësinë te miku i tij dhe vendos të qëndrojnë prapëseprapë miq.

Burrat që kalojnë këtë krizë futen në një miqësi që ka një besim të thellë. Ata e dinë që shoku i tyre i ka parë në pikën më të dobët dhe e pranon ashtu siç është. Bëhet një miqësi në të cilën disa herë secili shërben si mësues, nxënës, ngushëllues, ndreqës, trajner dhe inkurajues. Tani ata e dinë se kanë një mik që do të jetë krahë tyre pavarësisht se çfarë do të ndodhë.

Ja se si e përshkruan Goldbergu miqësinë:

Ka një ndjenjë ngrohtësie dhe mirëkuptimi e ngushëllimi të ndjeshëm kur një person është i dobët, vepron si i marrë apo është i cenueshëm. Në këto raste një shok fiton stabilitet dhe kujdesje nga tjetri. Ka një ndarje të gëzuar e të dyanshme burimesh, si materiale ashtu edhe emocionale. Elementi konkurrues është i parëndësishëm dhe fitorja e njërit bëhet fitorja e tjetrit. Dimensioni i miqësisë prej vëllai është ajo e cila njëri kujdeset për tjetrin, duke e mbrojtur nga përdorimi⁵.

Disa vjet më parë unë me mikun tim të ngushtë, Bob Boboskin, hasëm një krizë që kërcënoi miqësinë tonë. Pas vdekjes së të ëmës ai

5. Si më sipër, f. 136-137.

u mbush me trishtim. Unë, duke mos qenë tip i ndjeshëm, nuk e kisha idenë se vdekja e saj e kishte lënduar aq thellë. Kur Bobi m'u drejtua për mbështetje, e dëgjova e u luta dhe pastaj menjëherë ndryshova temë. Ai mbeti i çuditur nga pandjeshmëria ime dhe e mbylli telefonatën shumë shpejt.

Kur e kontaktova ditën tjetër, ai më tha që kishte nevojë të rrinte pak vetëm. Ai tha se i duhej kohë për të kapërcyer dhimbjen e tij. Më vonë përpjekjet e mia për ta kontaktuar hasën rezistencë. Duke hedhur vështrimin pas e dija që në historinë e miqësisë sonë nuk isha i përgatitur për diçka të tillë. Në të shkuarën ai i kishte kaluar humbjet me pak emocion dhe unë nuk kisha kaluar kurrë një humbje personale që mund ta kisha si një pikë emocionale reference.

Ndërsa miqësia jonë kishte mbijetuar pas disa pengesave të vogla, u binda gjithmonë e më tepër se kjo ishte një mur çeliku e jo një pengesë e vogël. Gjatë vitit të ardhshëm vendosa që pavarësisht se sa shpesh nuk ma varte mua, unë nuk do të largohesha.

Një vit pas vdekjes së të ëmës, u ulëm në zyrën e tij. “Faleminderit që nuk ke hequr kurrë dorë nga unë” – tha Bobi. “Jam treguar i ashpër me ty, megjithatë ti nuk më braktise”.

Për herë të parë në një vit të tërë ai m'u përgjigj. Falënderoj Perëndinë që askush prej nesh nuk u dorëzua, sepse jemi miq të ngushtë më tepër se më parë. Në të shkuarën ai kishte parë pandjeshmërinë time, por nuk vuajti kurrë prej kësaj. Kam parë aftësinë e tij për t'u larguar nga njerëzit, por nuk e kam ndjerë kurrë vetë.

Për shkak të kësaj krize pamë momentet më të vështira të njëri-tjetrit. Megjithatë nuk e braktisëm njëri-tjetrit. Ne kaluam krizën e miqësisë tonë dhe mbetëm përsëri miq.

Sapo miqtë e ngushtë bëhen shokë për kokë, ata kanë një miqësi pa role. Çdo njeri ndihet i sigurt për t'u sjellë si qesharak dhe i marrë po ashtu edhe si serioz dhe i pjekur. Ai mund të jetë vetvetja pa frikën e refuzimit. Ai mund të tregojë hapur dështimet dhe fitoret e tij, sepse e di që është pranuar në mënyrë të pakushtëzuar.

Kjo përvojë ndryshoi jetën time. E di tani që nëse dikush ka vuajtur

nga vdekja e një të afërmi, tërë energjitë e mia duhet të përqendrohen në dëgjimin dhe kujdesjen në vend të ndjekjes së programit tim. Dhe që prej asaj kohe, Bobi, i cili largohej kur mërztëj, nuk silllet më ashtu. Kur e pyeta pse, ai tha: “Nuk u tërhoqa më, sepse ti the që të lëndon”.

*Shokët përvetësojnë dobësinë e miqve të tyre
dhe ndryshojnë se shikojnë dobësitë e tyre.*

Shokët ndërtues

Shumica e djemve kujtojnë se çfarë do të thotë të kesh një shok kur kanë qenë fëmijë. Por si të rritur, burrat flasin për nevojën e tyre për një grup përgjegjësie për t’i ndihmuar të mbajnë premtimet që i kanë bërë Perëndisë dhe grave të tyre. Ata perceptojnë një grup përgjegjësie si një vend kur flasin se si po shkojnë gjërat në jetën e tyre. Ata nuk e konsiderojnë si disa shokë që mblidhen se e duan njëri-tjetrin.

Meqë shumica e grupeve fillojnë në faqën e “shkëmbimit të favoreve”, ky perceptim nuk duhet të na çudisë. Burrat mblidhen së bashku në grupet e përgjegjësive sepse është dobidhënese në mënyrë reciproke për këdo që është i pranishëm. Ata nuk takohen sepse e pëlqejnë njëri-tjetrin. Ata mund të mos e njohin njëri-tjetrin.

Fillimisht një burrë merr pjesë duke pasur në mendje qëllimet më të mira. Ai dëshiron të jetë i pastër seksualisht. Ai dëshiron të jetë i hapur për jetën e tij. Ai dëshiron të vijë në çdo takim.

Por është e vështirë të takohesh me një grup djemsh që nuk i do shumë mirë. Është e vështirë të jesh i hapur me burrat tek të cilët nuk ke krijuar besim akoma. Është e vështirë të mbështetesh te burrat e tjerë kur dëshiron të dukesh i fortë.

Nëse bie në mëkat, ai do të dëshirojë të mos vijë në takim. Në këtë mënyrë ai mund të ruajë imazhin e tij të perëndishmërisë. Fatkeqësisht ai mund të mos kthehet kurrë. Edhe më keq akoma, askush mund të mos interesohet për të.

Por dikush duhet të interesohet për të. Ai ka nevojë për një mik që t’i shkojë pas. Po kështu edhe ti. Ti ke nevojë për disa miq të ngushtë

me të cilët ndihesh i sigurt. Miqtë do të jenë pranë teje pavarësisht se çfarë thua apo bën. Miqtë do të të ndihmojnë të kalosh betejat e tua. Miq që do të të mësojnë dhe ngushëllojnë. Dhe miq për të cilët do të bësh të njëjtën gjë.

Janë ato lloj miqësish që vënë në funksionim përgjegjësinë, sepse burrat interesohen për njëri-tjetrin. Ata do të të kontaktojnë sepse të duan, duan që ti të përparosh. Dhe ti ndihesh njësoj për ta.

Miqësi të tilla nuk mund të krijohen pas një apo dy takimesh. Kujto, duhet kohë për të kaluar nga miqtë që shkëmbejnë favore te shokët për kokë. Dhe rruga mund të jetë me pengesa. Por, ashtu siç kam reflektuar për llojin e burrave që dua të kem miq dhe llojin e burrit që dua të jem, kam identifikuar katër gjurmë vendimtare që do të shqyrtojmë në kapitullin e radhës.

PËR DISKUTIM

1. Cilat janë katër fazat e miqësisë mashkullore? Çfarë e karakterizon secilën prej tyre?
2. Cili është kalimi që shtyn burrat nga miq në shokë për kokë? A kujton raste kur ke pasur një miqësi që nuk e ka bërë këtë kalim? A ke miqësi që nuk i mbijetoi kalimit? Cili ishte rezultati?
3. Pse burrat kanë nevojë për shokë?
4. Sa kohë duhet të bëhesh shok për kokë? Pse?
5. Çfarë mund të bësh për të ruajtur miq të ngushtë? Çfarë plane ke për të bërë një gjë të tillë?

Çfarë duhet të kërkosh nga një mik?

Në një takim për burra në Nju Jork u ula në rreshtin e parë dhe po dëgjoja ndërsa autori, edukatori dhe psikologu Dr. Rod Kuper fliste për rëndësinë e të pasurit miq të ngushtë. Për të ilustruar këtë pikë ai tregoi një histori rreth një djali afrikano-amerikan që njihte.

Ai tha që djaloshi ndihej i ngazëllyes kur u fut te bojskautët. Entuziazmi i tij ishte i justifikueshëm kur një ditë në fund të një marshimi të gjatë drejtuesi i skuadrës së tij tha: “Do t’ju shpërblej ju djema duke ju çuar në pishinë”.

Pak më vonë anëtarët e bojskautit u rreshtuan te dera e pishinës për të paguar tarifën e hyrjes. Kur ishte radha e djaloshit të zi për të paguar, punonjësi i pishinës e ndaloi: “Çuni, a je i zi apo thjesht ke marrë shumë reze dielli?”.

Djaloshi, i vënë në siklet, nuk tha asgjë.

“Meqë nuk jam i sigurt” – tha punonjësi – “nuk mund të notosh këtu. Kjo është një pishinë private për njerëz të bardhë”.

Drejtuesi i bojskautëve e nxiti djaloshin të kthehej në shtëpi, por pjesa tjetër e fëmijëve tha që nëse ai nuk do të lahej në pishinë, edhe ata nuk do të laheshin. Kështu të gjithë shkuan në një pishinë publike.

Kjo ndodhi i bëri shumë përshtypje djaloshit. Ai ishte rritur duke

besuar se lëkura e zezë ishte një pengesë. Për të pasur sukses ai duhet t'i bënte gjërat më mirë se të tjerët, thjesht për të kompensuar ngjyrën e tij të lëkurës.

Kështu ai fëmijë u bë i mirë, shumë i mirë. Ai i binte trombës dhe u bë trombisti më i mirë i shkollës së mesme në Ohajo. Ai doli ndër pesë më të mirët e klasës së tij. Ai shkoi në kolegji dhe, përsëri, ishte ndër të parët në fushën e tij. Akoma kishte një shqetësim për veten sepse përpiqej vazhdimisht të mohonte atë pjesë të vetvetes. Ai interpretonte mirë, por nuk mund t'i afrohej dikujt, sepse mund ta refuzonin se ishte zezak. Ai u zemërua gjithashtu sepse u ndje i vetmuar. Ai ishte një zezak duke u përpjekur t'ia dilte në një botë të bardhë.

Ai mendoi se të shkuarit në seminar do ta ndihmonte ngaqë do të ishte me besimtarë të tjerë, por edhe atje e ndoqi fryma e paragjykitimit, meqë ishte një prej tre zezakëve të vetëm në konvikt. Pavarësisht faktit se ndihej vetëm dhe i zemëruar prirja e tij për përsosuri spikati si predikuesi më i mirë në klasën e tij: ai fitoi çmimin si predikuesi më i mirë.

Pas seminarit u zhvendos në Hjuston, Teksas, ku filloi shërbesën e tij të parë. Një ditë, pothuajse “rastësisht”, u takua me një pastor, një burrë i bardhë. Ky burrë foli hapur për betejat dhe fitoret e tij. Pasi ishin bërë miq të ngushtë, pastori mori një risk të madh përsipër. Në fakt ai vendosi tërë miqësinë në tavolinë dhe hodhi zarat. Ai i tha mikut të tij zezak se mund të shikonte se mentaliteti i tij i performancës e shtynte të mbulonte ngjyrën e tij. Ai tha se e admironte faktin që ishte zezak.

Pastaj Rodi u tregoi dëgjuesve identitetin e atij burri afrikano-amerikan. Ai po fliste për veten. Dhe mikun i tij isha unë.

Ai vazhdoi të thoshte: “Një ditë Billi më ftoi për darkë. Ai më uli, vuri duart në shpatullat e mia, më pa drejt e në sy dhe tha: ‘Rod, falënderoj Perëndinë për ngjyrën tënde. Nuk është një pengesë. Perëndia nuk ka bërë gabim. Falënderoje tani për atë që je: përfshi edhe ngjyrën tënde’”.

Rodi, ndërsa vazhdonte me mesazhin e tij, tha: “Ndeshesha e përpëlitesha dhe pastaj shpërtheva në lot. Më pas ula kokën dhe thashë: ‘Të falënderoj, Jezus, që më ke bërë kështu siç jam, për gjithçka që jam’. U çova dhe u përqaftuam dhe vazhdova të qaj. Në fund e pranova

veten ashtu siç isha: gjithçka që isha. Pastaj Billi tha: “Të dua, Rod”.

Në atë pikë të mesazhit Rodi ndaloi, drejtoi gishtin nga unë dhe tha: “E dua atë njeri. Të dua Bill Perkins”.

Kur Rodi shqiptoi ato fjalë, fillova të qaj, atje te rreshti i parë në takimin e burrave në Nju Jork¹.

Unë dhe Rodi kemi qenë miq prej një kohe të gjatë dhe ai e di se sa borxhli më është: jam i bindur se shërbesa ime e tashme ekziston për shkak se ai hapi derën për mua.

Përgjatë viteve kemi pasur shumë beteja, por me anë të hirit të Perëndisë, kemi mbajtur njëri-tjetrin. Ndërsa mendoj për veçoritë që unë dhe Rodi pamë te njëri-tjetri dhe se çfarë kërkojmë te burrat e tjerë, e kam kufizuar në katër më të rëndësishmet. Besoj se këto janë tiparet që duhet të kërkohesh tek një burrë me të cilin shpreson të bëhesh një ditë shok për kokë. Këto janë tiparet që duhet të zhvillosh tek vetja në mënyrë që të jesh një mik i mirë për burrat e tjerë.

TIPARI I PARË I MIQËSISË: Një besim i guximshëm në Perëndinë

Nuk ka miqësi më të mirë që gjendet në faqet e Biblës se sa ajo e Jonathanit dhe Davidit. Ndodhia e parë e regjistruar e dy burrave që takohen ndodhi pasi Davidi vrau Goliathin. Jam i bindur se ishte besimi i guximshëm i Davidit që tërhoqi Jonathanin.

Ndërsa Jonathani ishte djali i mbretit Saul, ajo që e spikati nuk ishte linja e tij mbretërore, por besimi i tij i guximshëm. Para betejës historike tek për tek e Davidit me Goliathin, Jonathani dhe armëmbajtësi i tij kishin kapur dhe mundur njëzet filistej. Para betejës Jonathani i tha ndihmësit të tij: “Asgjë nuk e pengon Zotin të sigurojë shpëtimin me shumë ose me pak njerëz” (1 Samuelit 14:6).

Fjalët e Jonathanit ishin të ngjashme me ato që Davidi i drejtoi

1. Rod Cooper tregon gjithashtu një pjesë të historisë së tij në librin *Mendja e dyzuar* (Grand Rapids, Miç.: Zondervan), f. 19-20.

Goliathit kur tha: “Ti po më vjen me shpatë, me shtizë dhe me ushtë; kurse unë po të dal në emër të Zotit të ushtërive, Perëndisë të ushtrisë së Izraelit që ti ke fyer. Pikërisht sot Zoti do të të dorëzojë në duart e mia” (1 Samuelit 17:45-46).

Jonathani, kur dëgjoi Davidin dhe pa besimin e tij heroik, e dinte që ai ishte personi që donte të kishte mik. Dhe vendosi të bënte gjithçka që mundej për të çuar përpara miqësinë.

***Për shkak se beteja jote për pastërti
është në thelb një betejë frymërore,
ti ke nevojë për shokë besimi i të cilëve
do të rrisë standardet për ty.***

Ti ke nevojë për persona që do të të sfidojnë dhe ngushëllojnë. Prandaj duhet të kërkosh shokë që i janë kushtuar Krishtit. Ata nuk kanë pse të jenë të përsosur dhe nuk do të jenë të tillë, por duhet të kenë një pasion për t’u bërë më të fortë.

Zotimi i tyre do të të shtyjë të ndërmarrësh hapat e nevojshëm për të siguruar pastërtinë tënde. Përmenda më herët që pasi pashë komshien e zhveshur që po fliste në telefon, i rrëfeva atë që kisha bërë grupit të vëllezërve të së dielës në mëngjes. Kur dy prej tyre thanë që kishin parë komshien për një kohë të gjatë, e dija që duhet të ndërmerrja një hap të guximshëm përndryshe edhe mua do të më ndodhte e njëjta gjë.

Pas takimit shkova te shtëpia e komshiut dhe i rashë ziles. Nuk i kisha takuar asnjëherë sepse i kishim shtëpitë në kurriz të njëri-tjetrit. Duke dashur të qëndroja besnik pa implikuar veten, apo pa më qëlluar, sajova të thoja diçka që do të mbronte reputacionin tim dhe gjithashtu do të hiqte çdo tundim.

Pasi i rashë ziles, komshiu hapi derën. “Po” – tha ai.

“Përshëndetje. Jam Bill Perkins dhe jetoj nga ana tjetër”. U qetësova pak kur pashë që nuk po mbante një sharrë dhe nuk kishte vënë një kokore hokeji. “Dua të të lajmëroj për një rrezik të mundshëm që mund të kemi në lagje”.

Kjo tërhoqi vëmendjen e tij.

“Dy javë më parë një komshi i kishte thënë gruas se kishte parë një burrë që po përgjonte nga dritarja e saj një natë” (po, kjo kishte ndodhur në të vërtetë).

“Tallesh?”.

“Nuk tallem”.

“E çuditshme”.

“Ashtu mendova edhe unë. Gjithsesi, u shqetësova kur vura re qenin të lehte kur e lëshoj natën. Nuk kam parë askund në kopshtin tim, por nuk dua ta përdor këtë për të prishur intimitetin tënd. Po mendoja mbase të mbash grilat e ulura gjatë natës”.

“Faleminderit që ma tregova” – tha ai. “Kam dy vajza adoleshente dhe vetëm një javë më parë njëra prej tyre doli në verandë për banjëdielli. Në çastin që doli jashtë pa një burrë duke parë nga dritaret tona. Ai kapërceu gardhin dhe vrapoi tutje. Do t’i ul grilat natën që ç’ke me të”.

Kjo ishte një vizitë e vështirë e megjithatë i vuri fre epshit tim. Por bëri më shumë se kaq. Më siguroi një mundësi për të sfiduar miqtë e mi të ndërmerrnin një veprim të ngjashëm, të cilin e bënë më pas. Falënderova Perëndinë që pasi u larguam nga takimi me shokët, ndërsa u ndjeva i fortë, ndërmora veprim agresiv për të mbrojtur veten nga çastet e dobësisë së ardhshme.

Pa grupin tim të vëllezërve, miq të cilëve mund t’u rrëfehëm, nuk e di se çfarë mund të kishte ndodhur. Përfundimisht, ishte pasioni ynë për Krishtin që shtynte secilin prej nesh të ndërmernte atë hap të vështirë dhe ishte miqësia jonë që na jep guxim.

TIPARI I DYTË I MIQËSISË: **Besnikëria**

Në një farë pike në një miqësi duhet të bësh një zotim për t’i qëndruar besnik mikut pavarësisht kostos. Jonathani e bëri këtë me Davidin. Ai bëri një besëlidhje me të që mbështetej në mirëkuptimin dhe marrëdhënien e dyanshme (1 Samuelit 18:1-4). Ata u betuan se do të qëndronin miq të vërtetë dhe besnikë për tërë jetën.

Si simbol i zotimit të tij, Jonathani i dha Davidit një dhuratë të çmuar. Jonathani, ngaqë ishte princ, ishte një prej pak burrave në Izraelit që kishte shpatë. Ai i dha Davidit jo vetëm këtë, por edhe harkun, rripin, rrobën dhe tunikën. Jonathani i dha Davidit zotërimet e tij më të çmuara. Duke bërë kështu ai po thoshte: “Gjithçka që kam është e jotja”.

Fol për devotshmërinë! Edhe pse ti dhe unë nuk kemi shpatë, hark dhe rrip, ne kemi diçka me vlerë të madhe që mund t’ia japim një shoku: kohën. Nuk ka asgjë që mund të japësh që vlen më tepër se koha jote. Kam vënë re që nuk kam pse ta jap në sasi të madhe përnjëherësh, por duhet të bëj telefonata javore, dërgoj e-mail-e për të parë se si po ia kalojnë dhe të jem në dispozicion nëse duan që të flasim me dikë. Duhet të jem gati të lë për ta gjithçka që po bëj.

Një ditë u përballa me diçka që nuk mendoja se do të më ndodhte. Pavarësisht nga fakti që drejtoja një kishë që po rritej me shpejtësi, këshilli i drejtuesve tha që mendonin se ishte koha që unë të vazhdoja programin. Disa prej tyre besonin se shërbesa ime e të shkruarit po më shpërqendronte nga kisha.

I shkatërruar emocionalisht mora në telefon njërin prej shokëve të mi. Pasi treguam disa shakara, thjesht sa për t’u shtensionuar, ai më tha: “Do të vij të të marr në mëngjes dhe do të kalojmë ditën bashkë”.

“Por unë mendoja se ti do të fluturoje për në San Diego për të përfunduar atë marrëveshjen e qendrës tregtare” – iu përgjigja.

“Po, do të shkoja, por jo tani” – tha ai. “Më doli diçka më e rëndësishme”.

Këtë lloj besnikërie tregojnë shokët për njëri-tjetrin.

Jonathani e bëri këtë për Davidin në dy mënyra.

E para, ndërhyri për të. Kur babai i Jonathanit, mbreti Saul, po përpiquej të vriste Davidin, princi i ri foli më të atin për pafajësinë e Davidit. Më vonë ai e ndihmoi Davidin të arratisesh nga zemërimi i mbretit (1 Samuelit 19:1-7; 20:1-42).

Shokët mbrojnë njëri-tjetrin.

E dyta, e inkurajoi Davidin në Zotin. Vrasësi i gjigantit, i lodhur nga ndjekja e pamëshirshme e mbretit Saul, u fut në dëshpërim. Davidi dhe

banda e tij e burrave, duke kërkuar strehë, u fshehën në një shpellë në kodrat e shkreta të Zifit.

Jonathani e dinte që miku i tij ishte i brengosur dhe e dinte se ku ta gjente. Jonathani, pa marrë parasysh zemërimin e të atit, shkoi në praninë e Davidit dhe i dha shpresë. Princi i tha mikut të tij: “Mos ki frikë... Sauli, ati im, nuk do të arrijë të të shtjerë në dorë; ti do të mbretërosh mbi Izraelin dhe unë do të jem i dyti pas teje. Vetë Sauli, ati im, e di këtë” (1 Samuelit 23:17).

Ai takim i shkurtër ishte hera e fundit për Davidin që do të shikonte të gjallë mikun e tij. Por çfarë takimi! Jonathani kujtoi Davidin që Perëndia një ditë do ta bënte mbret. Duke thënë kështu Jonathani e siguroi mikun e tij se pavarësisht situatës së tashme, qëllimi i Perëndisë për jetën e tij do të realizohej.

Shokët inkurajojnë miqtë e tyre në Zotin.

Ruajtja e pastërtisë morale është një betejë e përditshme. Është një betejë që kërkon besnikëri. Kur ndjej që një prej miqve të mi po fshihet në një shpellë, unë shkoj e kërkoj. Kur ata ndjejnë që unë po tërhiqem, ata vijnë e më kërkojnë. Pse? Sepse tërheqja është shenja e parë që një burrë po fillon të dorëzohet. Në momente të tilla ne duhet të ndjekim shembullin e Jonathanit. Ne duhet të kujdesemi për shokët tanë dhe t’i forcojmë në Zotin dhe ne duhet t’i lejojmë që edhe ata të bëjnë të njëjtën gjë për ne.

Pyetja është, si mund ta bëjmë këtë në fushën e pastërtisë seksuale?

TIPARI I TRETË I MIQËSISË: Një qëllim i përbashkët

Disa vjet më parë, ndërsa po shijoja drekën me një mik, e pyeta: “Si ia bën me pornon kur je rrugës?”.

I kapur gafil me pyetjen time të drejtpërdrejtë, ai buzëqeshi duke thënë: “Pse ma bën këtë pyetje?”.

“Sepse kur jam rrugës, unë tundohem dhe pyes nëse tundoresh edhe ti”.

“Unë nuk ia dal mirë” – tha ai – “por dua t’ia dal”.

Javën tjetër ai erdhi të takohej me mua dhe dy burra të tjerë për një takim të martave në mëngjes. Përgjatë viteve kemi bërë një listë me gjashtë zotime që janë vendimtare për një grup të shëndetshëm. Ata përshkruajnë karakteristikat e një burri me të cilin dua të kaloj kohën. Mendoj se ata do të jenë ata lloj burrash që dëshiron t'i kesh miq dhe gjithashtu shokë për kokë. Ndërsa kam menduar për gjashtë zotime, mendoj se zbulojnë një qëllim të thellë që na tërheq: *t'i lejosh Krishtit të jetojë jetën e tij përmes nesh.*

Një burrë i merr ato zotime sepse dëshiron që identiteti i tij i ri në Krishtin të pasqyrohet në jetën e tij. Ja cilat janë:

1. I zotuar Krishtit, familjes dhe një jete seksuale të pastër.
2. I zotuar burrave në grup dhe realitetit që çdo burrë është po aq i katranosur dhe i cenueshëm sa edhe burrat e tjerë në grup. Ky zotim krijon siguri për çdo burrë dhe i jep atij dinjitet.
3. I zotuar të ruajë fshehtësinë. Çdo burrë premton se nuk do të diskutojë kurrë me dikë tjetër jashtë grupit për atë që flitet brenda grupit, përveç rastit kur dhunohet një fëmijë apo po planifikohet një krim.
4. I zotuar për të treguar të vërtetën kur i bën pyetje të veçanta. Asnjë burrë nuk do të gënjejë një anëtar tjetër të grupit.
5. I zotuar ndaj realitetit që çdo burrë në grup, përfshi veten, dëshiron të fshehë mëkatën e tij. Për shkak të kësaj, çdo burrë i jep të tjerëve të bëjnë pyetje të veçanta rreth sjelljes së tij mëkatore, pyetje që nuk mund t'i dredhosh. Dhe ata presin të njëjtën gjë nga pjesa tjetër e grupit.
6. I zotuar të identifikojë rituale që ndodhin para akteve dhe t'ia tregojnë grupit në mënyrë që edhe ata të kontrollojnë se si po veprojnë.

Duke pasur këto zotime në mendje, fillo të kërkosh një mik ose dy

me të cilin mund të takohesh. Identifiko dikë për të cilin mendon se ke të njëjtën devotshmëri ndaj Krishtit. Zgjidh dikë që mendon se dëshiron të jetë i pastër. Pyet nëse është i interesuar të takohet rregullisht për mbështetje dhe inkurajim të dyanshëm.

Gjatë takimit të parë bëji të ditur se je i interesuar të kesh një miqësi që do të të ndihmojë të mbash premtimet ndaj Perëndisë, gruas dhe fëmijëve të tu. Bëji të ditur se ke nevojë për mbështetjen e një miku për të qenë i pastër dhe se mendon që ai mund të mendojë të njëjtën gjë.

Ki kujdes të hedhësh hapat një e nga një. Nuk duhet të çlirohesh nga të gjitha sikletet që në takimin e parë. Ndërsa hapesh dhe tregon betejat e tua, lejoji atij të ndihet i sigurt në mënyrë që ai të tregojë të tija. Ndërsa flet për tundimet me të cilat përballësh, kujto që qëllimi yt nuk është të mbështesnin njëri-tjetrin kur dështoni. Qëllimi yt është të sfidoni njëri-tjetrin drejt perëndishmërisë.

Kur të diskutosh zotimet që kam përmendur më sipër, bëje të qartë se asnjë prej jush nuk duhet t'i përdorë ato për të kontrolluar tjetrin. Diskutojini. Renditini ndryshe. Përvetësojini. Sa më shpejt ta bëni një gjë të tillë, aq më mirë. Sapo t'i keni pranuar, ke lejën të jesh më i hapur dhe të shqyrtosh me më agresivitet.

Mund të mos kalojë shumë kohë dhe diçka shkon gabim. Ai mund të fillojë të justifikohet për mungesat gjatë takimeve apo që nuk kap telefonatat. Kur të ndodhë diçka e tillë, mbase mund të pyesësh: “Çfarë ka ndodhur? Gjërat po shkonin aq mirë”.

TIPARI I KATËRT I MIQËSISË: Një gatishmëri për të kaluar fazën e pyetjes: “Çfarë ndodhi?”

Është e lehtë ndonjëherë të vazhdosh përpara pa të. Por kujto, një krizë në miqësi mund të jetë mënyra e Perëndisë për të kthyer një mik në një shok për kokë. Prandaj është vendimtare që ti të ndjekësh shembullin e Jezusit me Pjetrin.

Pjetri, pas mohimit të tij ndaj Zotit, u mbush me trishtim. Pasi dëgjoi për ringjalljen dhe pasi pa varrin bosh, çfarë mendon se po kalonte

në mendjen e tij? Ai do të ketë pyetur veten nëse Zoti do të donte ta takonte më.

Jezusi nuk harxhoi kohën. Pas ringjalljes ai iu shfaq vetëm Pjetrit dhe ndërsa nuk e dimë se çfarë diskutuan ata të dy, nuk është e vështirë ta gjejmë (Luka 24:34). Në një takim të mëvonshëm në breg të detit Jezusi i siguroi Pjetrit rolin e tij strategjik në mbretërinë e Perëndisë (Gjoni 21:15-18).

Pjetri pranoi faljen e Zotit dhe mësoi nga gabimi i tij. Dyshoj që kjo është arsyeja se pse shprehu dhembshuri të vërtetë ndaj të tjerëve. Ai na nxit “Dhe më në fund jini të gjithë të një mendjeje, të dhembshur, plot dashuri vëllazërore, të mëshirshëm dhe dashamirës” (1 Pjetrit 3:8). Pjetri kishte mësuar në radhë të parë për vlerën e atyre tipareve dhe e mësoi nga një mëkat që kreu, i cili krijoi një krizë në marrëdhënien e tij me Jezusin. Një krizë që Jezusi refuzoi ta injoronte. Një krizë që Zoti e trajtoi duke u takuar me Pjetrin.

Nëse një mik pengohet, ai mund të vihet në siklet kur të shikon ty. Është përgjegjësia jote t’i shkosh pas. Kujto, që të dy bëtë një zotim ndaj realitetit që çdo burrë kërkon të fshihet dhe për shkak të atij zotimi ai ka rënë dakord të flasë të vërtetën kur i bëjnë pyetje të veçanta. Duhet të takohesh me të për t’i bërë këto pyetje. Duke i shkuar pas, ti po vërteton seriozitetin e zotimit tënd ndaj tij.

Sapo të lidheni më në fund ju të dy, siguroji atij pranimin tënd. Kujtoji që çdo njeri në grup ra dakord që të gjithë keni probleme. Nuk është askush i përsosur. Të gjithë janë pjesë e procesit.

Pasi të ndjesh që ai ndihet i sigurt, pyete: “A ke bërë diçka që nuk duhet ta kishe bërë që nga takimi ynë i fundit?”.

Nëse pranon fajin, mirato sinqeritetin e tij dhe pastaj përpiqu të gjurmosh burimin e rënies së tij. Pyete se cili ritual e çoi në “rrepirën e rrëshqitshme”. Përpiqu të përpilosh një strategji për të shmangur përsëritjen. Jepi shpresë që nëse mund të rrisë hendekun midis rënieve, do të reshtë përfundimisht së rëni. Por ai nuk mund të heqë dorë thjesht ngaqë e ka katranosur.

Kujto, kyçi drejt pastërtisë është eliminimi i epshit në fazat e

shqetësimit dhe ritualizimit. Është puna jote të ndihmosh shokun tënd të bëjë një gjë të tillë dhe kur të pengohet, është puna jote ta ndihmosh të çohet. Puna e tij është të jetë aty për ty.

Mos hiq dorë

Pyeta një herë grupin tim të vëllezërve: “Çfarë mendoni se do të bënit nëse nuk do të ishim ne këtu për ju?”.

“Nuk mund ta imagjinoj” – tha njëri prej tyre.

“E di që kam rënë në mëkat serioz tani” – komentoi një tjetër.

Është e pamundur për mua të shpreh me fjalë se sa shumë i dua ata burra. Nuk mund të shpreh se si ngushëllimi dhe përballja e tyre janë përdorur nga Perëndia në jetën time. Dua të njëjtën gjë për ty. Dhe dua që të dish që nuk do të ndodhë lehtë, sepse burrat i bëjnë ballë miqësisë së ngushtë. Duhet të këmbëngulësh ndërsa miqësia rritet dhe gjatë kësaj kohe mbase do të ankohesh dhe do të lëndohesh.

Më kujtohet një histori e një burri që pa një qen labrador të zi dy muajsh që ishte shtrirë në llucë nën një urë. Kishte një plagë në kokë dhe këmbët e përparme ishin të zhvoshkura dhe të ënjtura në vendin ku e kishin lidhur me litar.

Burri iu afrua me kujdes qenushit. Kur ishte vetëm disa hapa larg, qeni nxorri dhëmbët dhe lehu. Burri futi dorën në xhep dhe nxorri një copë mishi të tharë. Ai u ul galiç para qenit, i foli me butësi dhe i hodhi një copë mishi.

Pas disa minutash po përkëdhelte qenin në kokë dhe po i zgjidhte litarin nga këmbët e tij të plagosura. Pastaj e mori qenin e pisët në shtëpi, i mjekoi plagët dhe i dha ushqim, ujë dhe e vuri në një shtrat të butë.

Të nesërmen në mëngjes, kur ai burrë iu afrua qenit, i lehu dhe iu sul. I vendosur të bëhej mik me kafshën, ai i foli me butësi dhe i dha një copë proshutë. Ditë pas dite ai punoi me durim me qenin. Në fund, pas disa javësh, ndërsa burri po shikonte televizor, qeni hipi në karrigen e tij dhe lëpiu dorën e tij. Burri hodhi vështrimin dhe pa qenin duke buzëqeshur dhe tundur bishtin.

Besoj se shumë burra janë si ai qeni. Ata janë plagosur dhe lidhur nga bota. Ata janë dyshues ndaj të tjerëve dhe përpiqen t'i mbajnë në distancë. Ne jemi përgjegjës për të treguar dashuri dhe mirësi të vazhdueshme. Nëse duam një shok për kokë, ne duhet të zotohemi një jetë besnikërie dhe besimi. Duhet të jemi gati të durojmë ankesat dhe kafshimet e tij. Por nëse durojmë, një ditë do të kuptojmë që kemi një shok për kokë, dikë që ndihet i sigurt me ne dhe me të cilin ne ndihemi të sigurt, dikë që na ndihmon të jemi moralisht të pastër ndërsa i ndihmojmë të bëjnë të njëjtën gjë.

*Dua të them që jam provë e gjallë
që ajo që bëjnë miqtë si shokë,
e bëjmë mirë.*

Dhe shpresoj që edhe ata të mendojnë të njëjtën gjë për mua.

Sigurisht, ka një marrëdhënie tjetër që është vendimtare nëse duam të jemi të pastër dhe kjo është marrëdhënia që kemi me gruan tonë. Ne do të diskutojmë këtë marrëdhënie në kapitullin vijues.

PËR DISKUTIM

1. Pse zotimi ndaj Perëndisë është një tipar i rëndësishëm i një mik?
2. Si e tregoi Jonathani zotimin e tij ndaj Davidit?
3. Çfarë gjëje mund t'i japësh një mik për të treguar zotimin tënd? Si e kë bërë këtë në të shkuarën? Si do ta bësh këtë në të ardhmen?
4. Cilat janë dy gjërat që bëri Jonathani për të treguar mbështetjen e tij për Davidin? Si mund ta bësh këtë për një mik?
5. Shqyrto zotimet e bëra nga një grup burrash të përkushtuar për të ndihmuar njëri-tjetrin për ruajtjen e pastërtisë. Cili është më i rëndësishmi për ty? Pse?

Vetëm për burrat e martuar

Përrjashta bën nxehtë, sepse është muaji shtator në Ostin. Nuk është aq nxehtë sa në Feniks në verë, por ka më tepër lagështirë. Unë dhe Sindi po pastrojmë apartamentin tonë sa një kuti shkrepseje që ndodhet në Rugën Sidar ngjitur me konviktin e Universitetit të Teksasit. Bie telefoni. Është si ato kutitë plastike me numra që ngjan si orë me vrima mbi numrat. Ngre receptorin.

“Përrshëndetje!” – them.

“Përrshëndetje! Jam Dajen Dousën”. Telefonuesja flet me një zgjatje të ëmbël të fjalëve me theks jugor. “Jemi takuar në një mbrëmje në shtëpinë e Xho Glikmenit në Dallas. Të thashë që do të të telefonoja kur të vija në Ostin. Shiko, unë jam këtu dhe shpresoj që të takohemi”.

E kujtoj Dajanën. Ajo është e gjatë dhe elegante me flokë të zeza dhe pamje të bukur. “Jam i gëzuar që më telefonove, por sapo u martova muajin që shkoj”.

“Oh” – bëri ajo e zhgënjyer. “Mendoj se kjo do të thotë që nuk je më i lirë, apo jo?”.

E ndjej nga mënyra si tha “apo jo?” se mbase mendon që pas katër javë martese jam gati për një pushim. “Po, vërtetë” – i thashë. “Por faleminderit që more”.

Mbyll telefonin dhe më bie në kokë realiteti i thellë që për pjesën tjetër të jetës nuk do të dal më, nuk do të puth, nuk do të përqafoj apo nuk bëj seks me një grua tjetër përveç gruas time. Me zor kapërdihem.

“Kush ishte?” – pyeti Sindi.

“Dajen Dousën”.

“Kush është ajo?”.

“Një vajzë që takova te shtëpia e Xhosë”.

“Çfarë donte?”.

“Të dilnim”.

“Të dilnit?”.

“Pikërisht. I thashë që jam i martuar dhe marrëzisht i dashuruar me gruan time e cila është gruaja më e bukur dhe më seksi e botës”.

“Nuk të dëgjova të thoshe diçka të tillë”.

“Shiko, mbase nuk e thashë, por kjo është arsyeja se pse jam martuar me ty”.

Sindi buzëqesh, hedh krahët rreth meje dhe më shtrëngon.

Po, ndjeva se isha martuar me gruan më të bukur dhe më seksi të botës. Por ruajtja e gjallërisë në jetën seksuale ka qenë një sfidë e gjatë. Ashtu si shumica e burrave kam hasur që seksi në martesë mund të bëhet i mërzhitshëm. Shumë burra i merr malli për eksitimin e gjuajtjes së gruas dhe zbulimit të territorit të virgjër. Ata lodhen duke bërë gjithmonë të njëjtën gjë me të njëjtën grua. Kur mërziya infekton jetën seksuale të burrit në shtëpi, ai mund të kërkojë gjetiu eksitimin.

Deri tani kemi folur se si të mos kryesh mëkate seksuale. Kjo është gjysma e betejës. Gjysma tjetër përfshin gjetjen e kënaqësisë seksuale në shtëpi me gruan tënde. Në këtë kapitull do të të tregoj disa ide që do të kthejnë pasionin në martesën tënde. Nëse je beqar shpresoj që këto mendime të jenë gjëra të cilat mezi t’i presësh kur të martohesh.

Udhëzimet e Perëndisë për seksin dinamik

Shumica e burrave nuk i drejtohen kurrë Biblës si një manual trajnimi për seksin e mirë. Dhe në pamje të parë udhëzimet e Palit

rreth seksit mund të duken sipërfaqësore. Por pas një shqyrtimi të imët ato paraqesin katër udhëzime praktike që do të gjallërojnë jetën tënde seksuale në shtëpi.

UDHËZIMI I PARË: **Trupi yt i përket gruas tënde**

Pali tha: “Burri le të kryejë detyrën martesore ndaj gruas, po ashtu edhe gruaja ndaj burrit. Gruaja nuk ka pushtet mbi trupin e vet, por burri; gjithashtu burri nuk ka pushtet mbi trupin e vet, por gruaja” (1 Korintasve 7:3-4).

Mund të lexosh këtë pjesë dhe të thuash: “Po! Trupi i gruas time është i imi. Ajo duhet të bëjë çfarëdo llojë gjëje t’i kërkoj dhe sa herë të dua. Kjo është një pjesë që ajo duhet ta mësojë me patjetër përmendësh. Është një pjesë për të cilën do ta ndihmoj ta vendosë në praktikë”.

Hëm... nuk më pëlqen të ta prish qejfin, por nuk po e kap fare idenë. Pali po i drejtohet gruas tënde, jo ty. Ai tha që ajo duhet ta konsiderojë trupin e saj si tëndin, që i takon burrit të saj.

Por ai gjithashtu ka diçka për të të thënë edhe ty. Pra, ti duhet ta konsiderosh trupin tënd si i saj.

Ti dhe gruaja jote duhet të kujtoni që jeni këtu për njëri-tjetrin. Ajo duhet ta konsiderojë veten si shërbëtoren tënde seksuale. Dhe ti duhet ta konsiderosh veten si të sajën. Pali po përshkruan një qëndrim seksual që përqendrohet te personi tjetër.

Duke pasur parasysh faktin që nuk duhet t’i thuash kurrë gruas tënde: “Perëndia thotë që je këtu për mua”.

Por duhet t’i thuash: “Perëndia thotë se unë jam këtu për ty”.

Ky është një koncept thelbësor. Nënkupton që energjitë e tua seksuale nuk janë për tjetër njeri. Ato i përkasin vetëm gruas tënde dhe duhet të përqendrohen vetëm tek ajo, jo një grua tjetër apo shëmbëlltyra e një gruaje tjetër.

Siç e pamë në kapitullin e parë, është normale që ti të tërhiqesh seksualisht nga gratë e tjera. Perëndia të ka programuar në atë mënyrë. Por ti duhet të ushtrosh disiplinë. Herën tjetër që shikon një grua dhe

shikon që të rrok epshi, thuaji vetes: “Jam i gëzuar që Perëndia krijoi gratë e bukura dhe më dha aftësinë për t’i shijuar. Por unë i përkas gruas time”. Kujto që njeriu i ri në ty, njeriu i mirë, gjen kënaqësi te Perëndia dhe te gruaja e tij.

Në vend që të fantazosh për një grua tjetër, përdor momentin e interesit seksual për të përqendruar vëmendjen tënde te gruaja jote. Kujto që trupi yt i përket asaj dhe kjo përfshin mendjen dhe sytë e tu.

UDHËZIMI I DYTË: Plotëso nevojat seksuale të gruas tënde

Ky udhëzues rrjedh logjikshëm nga i mëparshmi. Nëse jam këtu për gruan time, ka kuptim që është përgjegjësia ime të plotësoj nevojat e saj seksuale. Ajo që më mahnit është se asgjë tjetër nuk eksiton një burrë se sa një bashkëshorte e ndezur. Ne marrim kënaqësi duke u pëlqyer bashkëshorteve tona.

Problemi është se shumica e burrave harrojnë që bashkëshortet e tyre janë gra. Sigurisht nuk dua të them nga ana anatomike. E kam fjalën për ato gjëra që i eksitojnë. Ne priremi të bëjmë për bashkëshortet tona atë që duam për veten tonë.

Sigurisht, bashkëshortet tona bëjnë të njëjtën gjë. Nëse do ta marrim seriozisht këshillën e Palit, ne duhet të zbulojmë çfarë ndez gratë tona dhe të bëjmë atë gjë për to. Meqë nuk mund të trajtoj në një kapitull gjithçka që pëlqejnë gratë, le të shikojmë disa nga gjërat më të rëndësishme që mund të bëjmë për të stimuluar seksualisht bashkëshortet tona dhe rrugës t’u shtojmë ca oktan pasionit në martesat tona.

Mbaje në marsh të parë!

Nuk do të harroj kurrë kur kam mësuar djalin tim të vogël, Polin, t’i japë Porshit tim të ri të zi e shumë të shpejtë. Në fakt ishte një Mazda Miata me pesë marshe jo shumë e fuqishme të cilën do të doja të ishte një Porsh. Nejse, duke e parë atë që po përpiqej të gjente kohën e duhur midis shtypjes së freksionit dhe gazit ishte po aq gallatë sa të isha në karnavale. E kisha harruar se sa gër-gër-gër mund të ishte ngarja e

makinës kur shoferi nuk koordinonte lëshimin e freksionit me shtypjen e pedales së gazit.

Kisha harruar gjithashtu vështirësinë që ka hequr shoferi i ri *kur* ndërron marshet. Fillimisht Poli ndërronte marshin nga i pari tek i dyti dhe pastaj tek i treti pa pasur motorri xhiro të mjaftueshme për të shtyrë makinën përpara. Ndërsa po i ngjiteshim Overlukut, një kodër e pjerrët disa lagje nga shtëpia jonë, makina ngeci para se të arrinte në majë. Kur ndodhi kjo, ai hasi sfidën shtesë të koordinimit të pedales së gazit me freksionin ndërkohë që makina po ecte tatëpjetë... mbrapsht.

Dhe unë u përballa me sfidën për të mos u zemëruar. Oh, gëzimet e të qenit baba!

Sigurisht, nuk kaloi shumë që të mësonte kohën e duhur. Fatkeqësisht shumë burra nuk arrijnë të njëjtin nivel suksesi me gratë e tyre. Shumë burra duan të kalojnë nga marshi i parë në të pestin me një grua para se ajo të ketë mjaftueshëm energji seksuale për të arritur majën. Arsyeja se pse sillemi kështu është se takometri ynë seksual kalon në superxhiro pas pesë minutash dhe ne duam të ndërrojmë marshet.

Një pasdite unë me Sindin po përkëdheleshim dhe ajo po më fërkonte ngadalë shpatullat, kurrizin, qafën, krahët dhe duart. Kur i përkëdheli tërë ato pjesë të trupit, filloi t'i përkëdhelte përsëri. Ndërsa duroja intimitetin e saj mendova: "Po të doja një fërkim, do të kisha shkuar te një masazhistë". Fatmirësisht e mbajta atë mendim për vete.

Pse po më përkëdhelte në atë mënyrë? Sepse këtë do prej meje. Meqë motorri i saj tregonte 1000 xhiro për minutë, ajo kishte nevojë që unë të vazhdoja ngadalë me të dhe jo të ndërroja marshet derisa ajo të ishte afër xhirove maksimale.

Nëse dëshiron të plotësosh nevojat seksuale të gruas, rri në marshin e parë derisa të ndjesh që ajo është gati që ti të ndërrosh marsh. Ec ngadalë. Lëri kohë të ngrohët.

Kujto:
ecja ngadalë = seks i mirë.

Do të jetë një ndihmë nëse e di se çfarë i pëlqen. Mos bëj gabimin e hamendësimit që ajo pëlqen diçka thejsht se e ke përsëritur dhjetë mijë herë. Zbulo se çfarë e ndez. Mëso saktësisht ku dhe si pëlqen të preket dhe zbulo se sa shpejt dëshiron që ti të vazhdosh me hapin tjetër.

Mund të përpiqesh të bësh një lojë që unë dhe Sindi bëjmë herë pas here. Gruaja jote do të pëlqejë shumë. Zgjidh një mbrëmje kur të mos ju shqetësojnë. Thuaji gruas më përpara që do të bëni dashuri sipas udhëzimeve të saj. Çdo prekje dhe lëvizje do të jetë sipas kohës dhe vendit që do të zgjedhë ajo. Ndërsa intimiteti rritet, kujto: qëllimi nuk është kënaqësia jote, por e saja. Zbulo se si pëlqen t'i përkëdhelet gjoksi, barku, kofshët e brendshme dhe klitori.

Ndiq udhëzimet e saj

Mbase do të zbulosh që asaj i pëlqen të rrish në secilin marsh më gjatë nga ç'të pëlqen ty. Por bëje. Merre shtruar. Ji i hapur ndaj udhëzimeve se si të stimulosh klitorin e saj: kjo është pika e saj e kënaqësisë dhe duhet të stimulohet që ajo të arrijë orgazmën. Një dështim për të bërë një gjë të tillë do t'i japë asaj po atë kënaqësi që do të kesh ti nga seksi nëse penisi yt nuk është fërkuar.

Perëndia, kur krijoi klitorin, mori tërë pjesët fundore të nervave të ndjeshëm të penisit, i ngjeshi në një pikë të vogël dhe i mbështolli me një ind të butë. Klitori është shumë më i ndjeshëm se sa penisi dhe duhet të preket me butësi. E megjithatë, në shumicën e rasteve sapo klitori i gruas është stimuluar, përmes raportit seksual, me dorën tënde apo me dorën e saj ose me një objekt, duhet përsëri më tepër kohë që ajo të arrijë orgazmën në krahasim me ty.

Me shumë gjasa do të zbulosh që gruaja jote nuk do të dojë stimulim të drejtpërdrejtë të klitorit të saj derisa të jetë lagur. Është e parehatshme që klitori i saj të përkëdhelet kur është i thatë. Lagështira rreth vaginës së gruas është shenjë e eksitimit të saj seksual (nëse është e thatë, përdor lubrifikant apo vaj masazhi).

Çuditërisht edhe Salomoni iu referua në mënyrë poetike eksitimit të nuses së tij dhe nxjerrjes së lëngjeve. Ai shkruan: "Ti je një burim

lulishtesh, një pus ujërash të freskëta, rrëkesh që dalin nga Libani” (Kantiku i kantikëve 4:15). Është për t’u mahnitur që nën frymëzimin hyjnor ai të ngrejë lart bukurinë dhe aromën e nuses së tij të eksituar (Kantiku i kantikëve 4:13-14).

Ndërsa bëhesh më i zoti në stimulimin seksual të gruas tënde, ajo do të ndiqet më tepër. Ndërsa ndodh diçka e tillë, niveli yt i kënaqësisë do të rritet. Siç e thashë më parë, nuk ka asgjë tjetër që t’i eksitojë më tepër burrat se sa një bashkëshorte e eksituar. Atëherë, nëse dëshiron të përjetosh qejfin e një gruaje të ndezur, zbulo se çfarë e eksiton atë.

Orgazma emocionale?

Mund të çuditesh po të dëgjosh që një grua nuk ka pse të arrijë orgazmën për t’u ndjerë e kënaqur. Kur isha në seminar, gratë e studentëve të seminarit takoheshin periodikisht për të dëgjuar folës frymëzues. Një herë iu dha mundësia grave për të dhënë para mikrofonit dëshmitë e tyre të shkurtra.

Pas takimit Sindi u kthye në shtëpi dhe mezi priste të më tregonte se çfarë kishte ndodhur. Ajo tha që një grua e re doli para mikrofonit dhe shpalli se do të thoshte diçka që do t’u hiqte një barrë të madhe disa prej grave. Ajo, duke folur me entuziazmin e një shkencëtareje që sapo kishte gjetur ilaçin për kancerin, tha: “Mendoja gjithmonë që orgazma ishte diçka fizike. Mbrëmë pata një orgazëm emocionale dhe tani e di që ato nuk janë fizike por emocionale”.

Unë dhe Sindi qeshëm, sepse e dinim që një ditë ajo grua do të kalonte një ditë një orgazëm të zgjatur fizike dhe do të vihej në siklet nga ajo që shpalli. Por kur e menduam mirë, kuptuam që ajo pohoi një mësim me vend. Është e mundur që gratë të kenë kënaqësi reale nga seksi pa pasur gjithmonë orgazëm.

Si burra ne nuk mund ta imagjinojmë këtë. Pse? Sepse për ne seksi siguron një shkarkim të energjisë seksuale. Nëse angazhohemi në përkëdhelje para seksit dhe nuk kalojmë në orgazëm, na lëndon. Nga ana tjetër, nëse tensioni seksual te gruaja nuk arrin pikën ku ajo të ndjejë nevojën për një orgazëm, mos i bëj presion për të kaluar.

Seksi i poçes

Sapo të zbulosh kohën dhe vendin për të eksituar gruan tënde, përpiku të mos bësh të njëjtën rrugë sa herë që rrini bashkë. Si burra priremi të gjejmë një teknikë dhe e përsërisim pafundimisht. Kjo mirë, por sigurohu të kesh disa teknika që t'i përdorësh.

Njëra prej tyre është “seksi i poçes”. Ky është ai lloj seksi që duhet tërë dita e tërë nata për t'u gatuar. Fillon në mëngjes me një përqaftim dhe puthje shumë të gjatë ndërsa largohesh, bashkë me një premtim për t'i dhënë një darkë. Vijon me një telefonatë që i shpreh dashuri. Pastaj një kartolinë apo lule.

Kujto:

një përqaftim në mëngjes = seks i mirë në darkë.

Vër re që përdora fjalën “lule”. E bëra këtë sepse disa vjet më parë zbulova që për çdo akt romantik fitoj një pikë me gruan time. Si një trëndafil i vetëm ashtu edhe dhjetra trëndafila njëherësh vlejnë një pikë. Sapo e mësova këtë, vendosa të shtoj pikë më shpesh dhe më pak dhurata të shtrenjta.

Sido që të jetë, sill në shtëpi një lule apo një tufë lulësh. Vendosi në një vazo dhe jepi një puthje. Kam mësuar përgjatë viteve që Sindi pëlqen të ecë me mua. Nëse gruaja jote ka qejf të ecë me ty, dil një xhiro.

Kujto:

ecjet e gjata në park = seks i mirë në dhomën e gjumit.

Nëse ke fëmijë, gjej një kujdestare për ta në mbrëmje. Kujto, që të ngrohet lëngu seksual i gruas, ajo duhet të jetë e ç'tensionuar. Gjatë darkës thuaji se sa shumë e do, se sa e rëndësishme është ajo për ty. Nëse je një burrë me pak fjalë, thuaja gjithsesi.

Kujto:

ffjalët e dashurisë gjithë ditën = seks i mirë natën.

Edhe një lexim rastësor i Kantikut të kantikëve zbulon shprehjet e shpeshta të dashurisë dhe vlerësimit të Salomonit për nusen e tij. Nëse nuk e di se çfarë të thuash, ja disa sugjerime.

“Ti je e bukur”.

“Jam i gëzuar që po e kalojmë jetën bashkë”.

“Ke sy të mrekullueshëm”.

“Më pëlqen të të puth buzët”.

“Puthja jote është e ëmbël për mua”.

“Më pëlqen t’i shikoj dhe përkëdhel këmbët e tua”.

“Mezi pres të të prek në çdo cep”.

“Mezi pres të ndjej trupin tënd ngjitur me timin”.

(Meqë ra fjala, do të ishte më e mira të mësoje përmendësh shprehjet e mësipërme apo të krijosh të tuat. Të lexosh një listë nga një libër nuk funksionon me shumicën e grave. Sidomos kur është përballë teje).

Kur të mbërrish në shtëpi, lahuni në vaskë apo në dush së bashku. Pasi të jeni tharë, bëji një masazh dhe lejoje që edhe ajo të të bëjë një. Kur të shkoni në shtrat, kujto: jepi ngadalë. Prit derisa xhirot e saj të arrijnë maksimumin para se të ndërrosh marshet.

Sigurisht, seksi i poçes nuk është diçka që mund ta bësh përditë apo përvajë. Por një herë në muaj do të fitosh shumë pikë me gruan.

Kujto:
ecja ngadalë = seks i mirë.

Në rregull, e kuptoj që formulat e seksit që pohova më sipër nuk do të garantojnë seks fantastik. Por ajo që po kërkoj të ngulis në mendjen tënde është që për gruan seksi nuk është thjesht orgazëm. Ai përfshin përqaftime, ecje të gjata, fjalë dashurie dhe përkëdhelje të ngadalta. Ne priremi t’i konsiderojmë këto aktivitete si çmimi që paguajmë për seksin. Kjo ngaqë e konsiderojmë seksin si një akt. Gratë tona e konsiderojnë si vallëzim dhe tërë këto akte janë hapa thelbësorë.

Seksi gustator

Edhe pse seksi i poçes është fantastik, ai ndodh në shtëpi. Me raste duhet të planifikosh një udhëtim me gruan tënde në një vend romantik. Nuk ka pse të jetë i shtrenjtë. Por duhet të jetë një vend që e bën atë të ndihet e veçantë.

Kur Sindi kishte një herë datëlindjen i bëra një surprizë duke e çuar për një natë në një suitë të veçantë në një hotel të zonës. Para se të dilnim për darkë, i thashë të përgatiste valixhen e vogël të rrobave. Bleva një tufë lulesh jo shumë të shtrenjta në një dyqan ushqimoreje të zonës (ato prapëseparë një pikë vlenin) dhe i thashë një miku t’i çonte në hotel para se të mbërrinin ne. Kur Sindi u fut në dhomë, tufa me luleve mbi një tavolinë të vogël e përshëndeti atë.

Që nga ai çast e vetmja gjë që duhej të bëja ishte të ecja ngadaaaaaalë. Pjesa tjetër e mbrëmjes iu kushtua kujdesit për të.

Seksi i mikrovalës

Nëse je gati të bësh rregullisht me gruan tënde seksin e poçes dhe seksin gustator, ajo mbase do të jetë gati të sigurojë për ty “seksin e mikrovalës”. Në fakt, mund të jetë një gjellë që ajo mund ta pëlqejë edhe vetë me raste. Në ato raste kur koha është e shkurtër, thuaji që nuk ke kohë për të bërë gati poçen, por me siguri do t’i pëlqejë nëse do të jetë gati të fusë diçka në sobën me mikrovalë.

Sigurisht, seksi i mikrovalës ka disa variante. Përfshin raportin fizik, stimulimin manual të burrit nga e shoqja, stimulimin e dyanshëm manual, seksin oral apo seksin me një lodër. Ti me gruan duhet të ndiheni të lirë të bëni çfarëdo lloj gjëje që ju eksiton, për aq kohë sa nuk stimulon epshe mëkatore apo vret ndërgegjen tuaj.

Nëse ky është ushqimi i vetëm në menu, gruaja jote nuk do të jetë shumë e gëzuar. Por nëse ajo e di se zotohesh t’i japësh atë që ka nevojë, ajo me gëzim do të kujdeset për nevojat e tua në këtë mënyrë. Dhe nëse bëhesh ekspert i përkëdheljes së klitorit të saj, ajo mund të kalojë një orgazëm sa herë që bën diçka të tillë. Në fakt ajo mund të kalojë disa të tilla.

UDHËZIMI I TRETË: Mos e mohoj gruan tënde

Xhon Grey, në librin e tij të shkëlqyer *Marsi dhe Afërdita në shtrat*, vëzhgon: “Burrat nga ana biologjike dhe hormonale priren të jenë më tepër seksualë se gratë. Është e natyrshme që të jetë më tepër në mendjen e tyre. Ngaqë burri e dëshiron fort, ai do të ndihet i refuzuar shumicën e kohës kur nuk e merr”¹¹.

Përgjigjja instiktive kur një burrë ndihet i refuzuar është tërheqja. Fryma e burrit më kujton iriqtat e detit që gjenden në vaskat detare në bregun e Oregonit. Këto krijesa të bukura duken si një lule e hapur. Por në çastin kur një shkop prek mesin e tyre të butë, iriqi i detit mbyllet në vetvete.

Gratë tona mund të bëjnë shumë gjëra për të komunikuar nëse janë ose jo të interesuara për seks; dhe ne dimë se si të lexojmë çdo sinjal. A kthehen nga ne apo na kthejnë kurrizin kur vijnë në shtrat? A ankohen se janë të lodhura apo thonë se ndihen të dashura? A veshin rroba seksi në shtrat apo xhyben e tyre prej pambuku? A na thonë se duhet të çohen herët në mëngjes apo ndihen të rehatuara? A e mbyllin derën dhe ndezin muzikë romantike para se të shkojnë në shtrat apo vënë zilen e alarmit? Sapo fillojmë t’i përkëdhelim, a thonë: “Kjo më gudulis”, “E kam lëkurën të ndjeshme sot”, “Nuk ndihem mirë”, ose “Mos!”?

Ngaqë burri është i ndjeshëm ndaj seksit, çdo mungesë interesi nga gruaja e tij është si një goditje në shpirt; kjo mund të fikë. Kur ndodh diçka e tillë, burri do të ngurrojë të bëjë më përparime. Me kalimin e kohës ai mund të mos dëshirojë seks me të shoqen. Ashtu siç tha Xheji në zyrën time: “E kam më të lehtë të masturboj”.

Ne duhet të kuptojmë që veprimet e gruas tonë nuk janë zakonisht shenjë e refuzimit personal. Ato mund të mos nënkuptojnë gjithashtu që ajo nuk është e interesuar të bëjë dashuri.

Ndonjëherë kur e pyes Sindin nëse “ia ka qejfi”, ajo thotë: “Nuk e

1. John Gray, *Marsi dhe Afërdita në dhomën e gjumit* (Nju Jork: HarperCollins, 1995), f. 86.

di”. Kur u martuam në fillim unë mendoja që kjo përgjigje do të thoshte “Jo!”. Më vonë zbulova se donte të thoshte që nuk e dinte. Sapo e kuptova këtë, e plotësoja mungesën e saj të interesit me një përqafim të ngrohtë.

E dini çfarë? Në shumicën e rasteve kur ishte në neutro thjesht donte që unë ta çoja me durim në marshin e parë.

Mbase prirja jote për seks është më e madhe se sa e gruas. Ti mund të duash seks tri herë në ditë, ndërsa dy herë në ditë është e mjaftueshme për të (sikur të ishte kështu?). Por të flasim seriozisht, ndryshimet në oreksin tënd mund të bëjnë që të ndihesh vazhdimisht i refuzuar. Është e rëndësishme të kuptosh që gruaja jote mbase nuk po të refuzon. Nevoja e saj thjesht nuk është po aq e madhe sa edhe e jotja. Është e rëndësishme të kuptosh që Perëndia mund t’ju ketë bashkuar sepse e dinte që gruaja jote kishte nevojë për dashurinë plotësuese që mund t’i jepje asaj për shkak të energjisë tënde shtesë seksuale.

Pavarësisht arsyes se pse ndihemi të refuzuar dhe të lënduar, ne nuk duhet të refuzojmë seksualisht gratë tona. Të bësh një gjë të tillë do të thotë të mëkatosh. Ne duhet të gjejmë kohën për të plotësuar nevojat e tyre seksuale, edhe kur ndihemi sikur na refuzojnë.

UDHËZIMI I KATËRT: Mbaj një lidhje frymërore

Pali tha: “Mos ia privoni njëri-tjetrit, veç në qoftë se jeni marrë vesh, për një farë kohe, që t’i kushtoheni agjërimit dhe lutjes, dhe përsëri ejani bashkë që të mos ju tundojë Satani për shkak të mungesës së vetkontrollit tuaj” (1 Korintasve 7:5).

Kam lexuar shumë libra rreth seksit dhe nuk kam lexuar diçka rreth këtij vargu të veçantë. Megjithatë mendoj se është vendimtare për shëndetin seksual të burrit dhe gruas. Pse? Sepse marrëdhënia jote fizike ka si qëllim nga Perëndia të jetë një figurë e bashkimit tënd frymëror. Nuk ka gjë tjetër që e afron një çift me njëri-tjetrin se sa lutja. Perëndia, meqë e di këtë, thotë se hera e vetme që nuk duhet të bëni seks është kur të dy bini dakord t’i kushtoheni lutjes në mënyrë individuale dhe si çift.

E vërteta e hidhur është se shumica e burrave luten rrallë me gratë e tyre. Nuk jam i sigurt pse. Mbase ndihen më poshtë frymërisht se sa gratë e tyre. Mbase nuk mendojnë se lutjet e tyre duken aq frymërore. Mbase janë të zënë dhe nuk mendojnë se kanë kohë.

E ke apo nuk e ke zakon të lutesh me gruan tënde, dua të të sfidoj të bësh një eksperiment për një muaj. Çdo mbrëmje para se të shkosh të flesh, lutu me të. Nuk ka pse të jetë një lutje e gjatë, por le të jetë reale. Me fjalë të tjera, mos recito një lutje që e ke mësuar përmendësh kur ke qenë fëmijë. Foli Perëndisë me gruan tënde. Foli për nevojat në jetën, martesën dhe familjen tënde.

Dyshoj se mund të çuditesh me dobitë e menjëhershme që do të përfitojë martesa jote, sepse ju të dy do të ndiheni shumë më afër njëri-tjetrit.

Pastaj, cakto një kohë për të mos pasur seks në mënyrë që të luteni së bashku. Periudha e të qenët i përkorë ka të bëjë me shpeshësinë e të bërit seks. Nëse bëni seks çdo ditë, ndërprerja për disa ditë do të jetë një kohë domethënëse. Nëse bëni seks një herë në javë, dy javë do të jetë një sfidë. Mos e ndërprit për një kohë të gjatë saqë të tundohesh të kënaqësh veten apo të shikosh gjetiu për t’u kënaqur.

Kjo kohë lutjeje do të përqendrojnë jetën tënde te Zoti, do t’u afrojë ju të dy dhe do të rrisë oreksin tënd seksual. Do të pastrojë nga çdo hidhërim dhe do të përtërijë dashurinë tënde. Kur të bashkoheni përsëri, do të ndiheni si të porsamartuar.

Shijo dhuratën e Perëndisë

Për njëzet e pesë vjetorin e martesës unë dhe Sindi kaluam dhjetë ditë në Hauai. Kur ishim atje pamë shumë të porsamartuar. Ishte e thjeshtë t’i dalloje, nga mënyra se si kapeshin për dorë, ecnin krah për krah dhe shikonin njëri-tjetrin në sy.

Ndërsa po shikoja një çift në hollin e hotelit thashë: “Le të hiqemi sikur jemi të porsamartuar”.

“Si do t’ia bëjmë?” – pyeti Sindi.

“Është e lehtë, e vetmja gjë që duhet të bëjmë është të mbështetemi te njëri-tjetri ashtu siç bënim kur ishim të fejuar”.

Kështu me Sinden u ngjitëm së bashku gjatë “muajit tonë të mjaltit” në Hauai. Dhe pse jo? Pas njëzet e pesë vjet ne ishim me siguri më të dashuruar me njëri-tjetrin se çdo çift tjetër në Hauai.

Ja çelësi... sa më tepër shprehim dashuri fizike, aq më të dashur ndihemi. Sa më tepër shprehim dashurinë tonë me fjalë, aq më tepër dashuri ndjejmë.

Jam i bindur se nuk mund të bësh asgjë për të ruajtur pastërtinë seksuale që është më e rëndësishme se sa të duash gruan tënde. Trajtoje atë siç bëje gjatë kohës kur i shkoje nga pas dhe do të zbulosh se do të të kenë mbetur shkëndijat e vjetra: ato thjesht duhen ngacmuar... dua të them ndezur.

Kujto, kur zjarri në shtëpi është i ndezur fort, zjarri i kampit nuk është dhe aq tërheqës. Puna jote është të mbash zjarrin e shtëpisë ndezur.

PËR DISKUTIM

1. Cilat janë katër udhëzimet që jep Pali te 1 Korintasve 7 për seksin dinamik?
2. Cilat janë tre llojet e seksit që kam përshkruar? Cilat janë ato gjëra që duhet të bëjë një burrë për të plotësuar nevojat seksuale të gruas?
3. Si mund të zbulosh atë që pëlqen gruaja jote?
4. Çfarë mund të bësh për të forcuar anën frymërore të marrëdhënies tënde martesore?
5. Për mendime të tjera shtesë rreth anës fizike të martesës, të rekomandoj librin e Xhon Grei, *Marsi dhe Afërdita në dhomën e gjumit*, botuar nga HarperCollins.

Fjala M

Një prej pyetjeve që më bëjnë më shpesh burrat është kjo: “A beson tek jashtëtokësorët?”. “A mendon se qentë shkojnë në parajsë?”. Ose “Sa nxehtë është në ferr?”. Askush nuk më bën pyetje të rëndësishme si këto.

Ajo që duan të dinë burrat është pikëpamja ime rreth masturbimit. Për të qenë më specifik, ata duan të dinë se çfarë thotë Bibla për këtë temë.

Nëse kërkon fjalën *masturboj* (apo ndonjë nga sinonimet e saj) në një *Fjalor Analitik Biblik* (*Young Analytic Dictionary of the Bible*), nuk do të gjesh asnjë referencë. E dini pse? Sepse Bibla nuk thotë asnjë fjalë për këtë temë.

Është e rëndësishme të kujtojmë që kur Perëndia dha Ligjin, ai dha disa rregulla të veçanta për të identifikuar mëkatet seksuale (Ligji i Përtërirë 22:13-30). Ai e bëri këtë për të mbrojtur popullin e tij dhe për të siguruar për nevojat e tyre në mënyrë të shëndetshme.

Meqë Perëndia pa djemtë dhe burrat judenj duke u masturbuar, mendoj se është domethënëse që ai zgjodhi të mos i dënonte. E di që ka disa shkrimtarë të krishterë që nuk bien dakord me mua. Disa përpiqen të vërtetojnë se masturbimi është i gabuar duke iu referuar Onanit,

personazhit në Dhiatën e Vjetër. Pas vdekjes së vëllait të Onanit, ai pati përgjegjësinë për t'i dhënë pasardhës vejjshës së vëllait, Tamarës (Zanafilla 38:8-10; Ligji i Përtërirë 25:5-6). Me sa duket Onani donte të bënte seks me Tamarën, por nuk donte të bënte fëmijë. Që ajo të mos mbeste shtatzënë, “kur bashkohej me gruan e të vëllait, e hidhte farën e tij përtokë për të mos i dhënë pasardhës vëllait të tij” (Zanafilla 38:9). Sjellja e Onanit nuk i pëlqeu fare Zotit saqë i mori jetën (Zanafilla 38:10).

Edhe me një lexim të shpejtë të kësaj pjese zbulojmë se kjo nuk ka të bëjë me masturbimin. Perëndia nuk e dënoi Onanin se masturboi. Në fakt ai kryente marrëdhënie. Perëndia e ndëshkoi se përdorte Tamarën për të kënaqur dëshirën e tij seksuale pa përmbushur përgjegjësinë e tij ndaj të vëllait.

Testi me katër pjesë i masturbimit

Meqë Bibla nuk flet asnjë fjalë për këtë temë si mund të dijë dikush nëse është e gabuar që ai të masturbojë? Mendoj se mënyra më e mirë për t'iu përgjigjur pyetjes që Bibla nuk e trajton në mënyrë të veçantë është të shikojmë se çfarë thotë rreth temave që kanë lidhje me të. Fatmirësisht Bibla flet qartë për pastërtinë seksuale. Kam shqyrtuar Shkrimin dhe kam identifikuar katër teste që kanë si synim të ndihmojnë një burrë për të përcaktuar nëse sjellja e tij është e pastër apo jo.

TESTI I PARË: **Mendimet e tua**

Te Mateu 5:28 Jezusi tha: “Por unë po ju them se kushdo që shikon një grua për ta dëshiruar, ka shkelur kurorën me të në zemrën e vet”. Ndërsa akti i masturbimit mund të jetë amoral, fantazia duke bërë seks me dikë tjetër veç gruas tënde është plotësisht e qartë.

Fjalët e Jezusit tregojnë që masturbimi është i gabuar kur shoqërohet me leximin e materialeve

*pornografike, shikimin e figurave pornografike apo mendimin
rreth imazheve të shkuara erotike që ke parë.*

Meqë ra fjala, kam kërkuar në Bibël për ndonjë shteg, por nuk kam gjetur. Nëse ushqen epshin tënd me porno apo kujtesa të grave përveç gruas tënde, është e gabuar.

Nuk është se masturbimi është i gabuar. Por ajo që bën me mendimet dhe sytë e tu është e gabuar. A mund të masturbosh dhe të ruash mendime të pastra? Apo a është kjo e pamundur për ty? Vetëm ti e di përgjigjen ndaj asaj pyetjeje.

TESTI I DYTË: **Vetëkontrolli**

Disa vjet më parë një burrë i ri më tha që masturbohej katër-pesë herë në ditë. Tërë jeta e tij kishte të bënte se kur dhe ku do të masturbohej. Edhe pse rasti i tij është një shembull i pazakontë, ka burra të tjerë që nuk mund t'i bëjnë ballë shtysës për të masturbuar. Te 1 Korintasve 6:12 Pali shkruan: “Çdo gjë më lejohet, por jo gjithçka është e dobishme; çdo gjë më lejohet, por unë nuk do t'i nënshtrohem asnjërës”. Ndërsa masturbimi mund të mos jetë i gabuar, është e gabuar që jeta jonë të kontrollohet nga masturbimi i shpeshtë apo kompulsiv. Nëse nuk mund të kontrollosh nxitjen për të masturbuar, atëherë nuk po kontrollohesh nga njeriu i ri që ka krijuar Perëndia brenda teje. Ti po kontrollohesh nga mishi yt.

TESTI I TRETË: **Dashuria**

Ashtu siç pamë në kapitullin e fundit Pali e bëri të qartë se burri duhet të plotësojë nevojat seksuale të gruas së tij (1 Korintasve 7:3). Nëse dështon në këtë pikë, atëherë mëkaton dhe tregon mungesë dashurie për të. Kur masturbimi than energjitë seksuale të burrit për t'u kujdesur për gruan e tij, është e gabuar.

TESTI I KATËRT: Ndërgjegjja jote

Pali foli me romakët se si duhet të konsideronin disa praktika që nuk dënoheshin nga Perëndia, por nga disa besimtarë. Ai tha: “A ke besim ti? Mbaje besimin për veten tënde përpara Perëndisë; lum ai që nuk dënon veten e tij në atë që miraton. Por ai që është me dy mendje, edhe sikur të hajë, është dënuar, sepse nuk ha me besim; dhe çdo gjë që nuk bëhet me besim, është mëkat” (Romakëve 14:22-23).

Nëse zbaton tre testet e para në praktikën tënde të masturbimit, por ndërgjegjja jote të mundon, atëherë Pali të nxit të ndalosh këtë sjellje. Hamendësimi im është se ti ke mashtruar veten duke besuar se sjellja jote nuk bie ndesh me një prej testeve të para dhe prandaj ndërgjegjja jote të dënon.

Ose mbase ndërgjegjja jote është tepër e ndjeshme dhe duhet të edukohet. Nëse ndihesh fajtor për sjelljet që nuk janë të gabuara, atëherë duhet të shqyrtosh burimin e fajit tënd.

Kur nuk ka problem të masturbohesh?

Ka shumë situata unike për çdo njeri. Do të ishte e pamundur dhe e marrë që të përpiqem t’i trajtoj të gjitha. Besoj se katër testet që përmenda sigurojnë një udhëzues që mund të zbatohet në shumicën e situatave.

Pyet veten:

1. “A përfshin sjellja ime mendime të papastra?”
2. “A e kam nën kontroll sjelljen time apo kontrollohem nga epsi?”
3. “A më pengon sjellja ime të plotësoj nevojat seksuale të gruas time?”
4. “A është ndërgjegjja ime e pastër? A po veprojmë me besim?”

Secili prej nesh duhet të përcaktojë para Perëndisë nëse qëndrimet dhe veprimet tona i pëlqejnë atij. Përfundimisht ky është një vendim që duhet ta marrësh ti. Nuk do të përpiqem t’i zë vendin e Perëndisë

duke dënuar një sjellje për të cilën ai refuzon të trajtojë. Nëse Perëndia e konsideron mëkat, atëherë do ta kishte thënë.

Por le të supozojmë se nuk mund të masturbohesh pa shkelur një apo të gjitha rregullat më sipër. Si mund ta kontrollosh veten?

Si mund të kontrollojmë dëshirën e fortë?

Mesazhi i këtij libri është që sjellja jote seksuale rrjedh nga identiteti yt. Kur mishi yt kërkon kënaqësi, kjo nxitet nga epshi pastaj sjellja nuk rrjedh nga njeriu i ri që është në ty. Po rrjedh nga orekset e tua mëkatore. Është ventimtare të trajtosh tundimin siç paraqitet në kapitujt 12-15. Lexoji përsëri dhe vendosi në praktikë. Sa më tepër jeton sipas identitetit tënd të ri, aq më tepër kontroll do të ushtrosh ndaj mendjes, syve dhe orekseve të tua seksuale.

Mendimi im

Nëse një djalë nuk masturbohet në mënyrë kompulsive, duke mos mohuar gruan e tij apo duke mos përdorur porno për të ndezur epshin e tij, nuk do ta konsideroja gjë të madhe masturbimin. Siç e thashë më sipër, t'i thuash një burri të mos masturbohet është si t'i thuash një qeni të mos lehtë. Ose mbase është njësoj sikur t'i thuash rosës të mos bëjë guak. Sido që të jetë, shikoj shumë djem e burra që duken të pushtuar nga faji ngaqë masturbojnë. Këshilla ime është të kërkojnë Perëndinë, të kërkojnë pastërtinë dhe të lehtësohen nga kjo. Pasi ke lexuar këtë paragraf, kthehu dhe lexo përsëri fjalinë e parë.

PËR DISKUTIM

1. Pse mendon se Bibla nuk flet për masturbimin?
2. Cilat janë katër testet për pastërtinë që duhet të drejtojnë sjelljen e një burri?
3. Kur do të ishte në rregull për një burrë të masturbojë?
4. Pse identiteti i një burri është i rëndësishëm për një jetë pastërtie seksuale?
5. Çfarë këshille do t'i jepje një burri që të ka pyetur nëse duhet apo nuk duhet të masturbojë? Pse?

Vetëm për gratë

Nëse je një grua dhe burri yt po e lexon këtë libër, apo nëse e ke blerë për të, dua të të jap pak inkurajim. Meqë nuk i njoh të veçantat e situatës së burrit tënd, po të drejtohem duke supozuar se ka folur, apo ka nevojë të flasë, me ty rreth dëshirës së tij për të pasur një jetë të pastër seksuale. Mbase nuk ka kryer asnjëherë një mëkat serioz seksual dhe po ndërmerr veprim parandalues. Ose mund ta ketë kaluar cakun. Cilatdo qofshin rrethanat e tij, ky kapitull i shkurtër ka qëllim të të ndihmojë që të mbështesësh burrin tënd. E kuptoj që ky mund të jetë një prej kapitujve më të shkurtër që ke lexuar, por shtatë pikat e tij janë vendimtare.

Së pari, të nxis të lexosh pjesën tjetër të këtij libri pasi të kesh lexuar këtë kapitull, nëse nuk e ke bërë tashmë. Besoj se është e rëndësishme sepse do të të ndihmojë të kuptosh më mirë burrin tënd dhe betejet me të cilat ndeshet. Do të të japë gjithashtu mendjemprehtësi për identitetin tënd në Krishtin që të jetosh sipas një mënyre që pasqyron njeriun tënd të ri. Ndërsa lexon librin të lutem kujto që e kam shkruar për burrat, jo për gratë. Një pjesë e mirë e gjuhës që përdor dhe historitë që tregoj kanë si synim të komunikoj më mirë me burrat. Mos lejo që ‘diskutimet e burrave’ të të ndalojnë që të përfitosh disa ide nga libri.

Së dyti, ti mund të jesh aleatja më e rëndësishme e burrit tënd. Them

“mund të jesh”, sepse shumica e çifteve rrallë, për të mos thënë kurrë, diskutojnë betejat e burrave me epshin seksual. Ashtu siç diskutojnë ata rrallë betejat e grave me të ngrënët kompulsiv (sondazhi im tregon se 55 për qind e burrave vënë në dyshim ndonjëherë betejën me sjelljen kompulsive seksuale dhe 55 për qind e grave ndonjëherë betejën me të ngrënët kompulsiv). Ajo që dua të them është kjo: si burrat ashtu edhe gratë kanë pika të dobëta për të cilat nuk preferojnë të flasin.

Kjo është arsyeja se pse ka shumë turp në lidhje me mëkatet sekrete që duam t’i mbajmë të fshehura sa më tepër të jetë e mundur. Kush dëshiron të flasë për diçka për të cilën ka turp?

Atëherë, nëse ju të dy diskutoni betejën e tij, do të jesh në gjendje t’i sigurosh atij më tepër lutje dhe inkurajim të nevojshëm. Ndërsa procesi mund të jetë i dhimbshëm, rezultati mund të jetë një martesë më e fortë dhe një bashkim që nderon Perëndinë.

***Mendoj se është domethënëse që të dish
që nëse po flet për betejën e tij për pastërti,
kjo është një paraqitje pozitive e martesës tënde.***

Së treti, nëse ai po has vështirësi me pastërtinë seksuale, duhet të dish që beteja e tij nuk ka të bëjë me ty. Është e kuptueshme që një grua të ndihet e refuzuar kur zbulon që burrit të saj i duken gratë e tjera tërheqëse. Kjo ndjenjë refuzimi mund të shtohet nëse ajo zbulon që ai ka parë porno në internet apo ka bërë diçka më të keqe.

Është e rëndësishme të dimë që tërë burrat hasin vështirësi me epshin seksual herët apo vonë, pavarësisht bukurisë së grave të tyre. Në fakt disa burra luftojnë për të ruajtur pastërtinë edhe pse kanë një martesë të mrekullueshme. Siç e thashë në dy kapitujt e parë, burrat janë të programuar t’u duken gratë tërheqëse. Kjo nuk është gjë e keqe, meqë Perëndia na ka bërë në këtë mënyrë. Por problemi qëndron se është e lehtë që epshi i burrit të rrokë atë tërheqje natyrore dhe ta përdorë për të ushqyer mendimet dhe veprimet mëkatore.

Së katërti, të inkurajoj ty dhe burrin tënd të flisni hapur me njëri-

tjetrin për betejën e tij për pastërti. E them këtë me pak ngurrim sepse e di se ekziston mundësia për lëndim dhe dëm të madh. Idealja do të ishte sikur çiftet të flisnin hapur dhe me sinqeritet për çdo gjë.

Atëherë, ti mund të pyesësh se çfarë e pengon burrin tënd që të flasë me ty, përveç turpit që përmenda më sipër. Edhe pse nuk e njoh personalisht burrin tënd, mund të them që shumica e burrave kanë frikë se nëse i rrëfëhen gruas që kanë parë një faqe pornografike në internet apo janë penguar në ndonjë mënyrë tjetër, ajo do të kundërpërgjigjet me një shpërthim emocional. Ndonjëherë shpërthimi fillestar do të pasohet nga tërheqja. Pastaj do të pendohet që ia ka treguar asaj.

Duke pasur këtë parasysh, është vendimtare për ty që të bësh gjithçka mundesh për t'u mbështetur te Zoti dhe jo të kundërpërgjigjesh me një shpërthim emocional. Nuk po të sugjeroj që të mos përgjigjesh emocionalisht. Duhet të lësh mënjatë anën tënde njerëzore për të bërë diçka të tillë. Por po të nxis të kontrollosh se si të shprehësh emocionet e tua. Mund të jesh e lënduar... dhe ky mund të jetë fakt. Mund të ndihesh e tradhtuar... mbase je tradhtuar. Por lutu për hirin që ke nevojë për të shprehur ato ndjenja në mënyrë që ta inkurajosh që të vazhdojë të flasë me ty.

Nëse hapet me ty, tregon se të do dhe ka nevojë për mbështetjen tënde. Nëse kundërpërgjigjesh me një shpërthim emocional, mund të të garantoj që do të tërhiqet dhe nuk do të trajtojë më me ty këtë temë. Shumica e burrave do të preferonin të jetonin me një gënjeshtër se sa me një grua të zemëruar dhe emocionale. E di që kjo mund të duket e vrazhdë dhe ky nuk është qëllimi im, por duhet të vendosësh se çfarë do: dhimbjen e sinqeritetit apo të kalosh pa dhimbje por me gënjeshtër o padituri.

Unë dhe Sindi vendosëm shumë kohë më parë që do të preferonim dhimbjen e sinqeritetit. Pse? Sepse e vërteta është diçka që mund ta zhvillojmë dhe me të cilën mund të punojmë. Gënjeshtra është si xhelatina, mund të duket e mirë kur e shikon, por nuk ka atë lloj substance pa të cilën nuk jeton dot.

***E vërteta në martesë është më e mirë
se sa gënjeshtra apo padituria.***

Së pesti, tregoji atij se si të ka lënduar, por miratoje që të ka thënë të vërtetën. Nëse ndihesh e zhgënjyer dhe e tradhtuar, tregoji atij. Por bëji të ditur se je e gëzuar që ai vlerëson sa duhet çiltërsinë për të treguar ty. Nëse të kërkon falje, gjë të cilën do ta kërkojë, fale. Por bëji të ditur se dëshiron të dish se çfarë hapash specifike do të ndërmarrë për të parandaluar që të mos ndodhë më. Bëji të ditur se duhet të kalojë pak kohë që t'i besosh përsëri, por se je gati të arrish në këtë pikë.

Së gjashti, kujto se nuk është puna jote si grua të rregullosh burrin tënd. Kjo është puna e Perëndisë. Shmang kurthin e kontrollit të vazhdueshëm të burrit tënd. Perëndia do të bëjë më të mirën në jetën e tij nëse lejon atë ta bëjë këtë dhe mbështete me lutjet e tua. Dhe mos kërko hollësi specifike për mëkatin e tij. Hollësitë nuk do të të ndihmojnë dhe nuk do të ndihmojnë atë të të tregojë.

Së shtati, gjej dikë që mund të të ndihmojë për të kontrolluar emocionet dhe mbështetur ndërsa inkurajon burrin tënd. Pasi ke folur me burrin, nëse dëshiron të shfreshe emocionet, hapja zemrën Perëndisë. Fol me një pastor apo miq të besueshëm. Mbase ju të dy keni nevojë për ndihmën e një këshilltari ndërsa punoni për këtë.

Jam mirënjohës që ime shoqe, Sindi, më ka ofruar gjithmonë mbështetjen e saj. I kërkoja një herë se pse nuk mërzhitej kurrë kur i rrëfeja një vendim të keq që kisha bërë dhe ajo më thoshte: “Nuk u mërzhita sepse e di që ti do të gjeje një zgjidhje për të. Kisha besim në zotimin tënd ndaj Krishtit dhe kam besim te ty”.

Sigurisht, mbase ti mund të mos kesh këtë lloj besimi te burri yt. Dhe mbase ajo që ka bërë ka qenë aq serioze sa që ti nuk duhet t'i besosh, të paktën jo derisa të vërtetojë që ia vlen t'i besosh. Por gjithmonë është një ide e mirë që ti të shpresosh për ndryshim dhe t'i besosh Perëndisë që ta sjellë këtë ndryshim në jetën e tij ndërsa e mbështet atë me lutjet e tua.

Nëse ky proces është pështjellues e i dhimbshëm dhe mendon se ke nevojë për mendim dhe mbështetje shtesë, të inkurajoj të lexosh një prej

librave të mëposhtëm:

Të jetosh me betejat sekrete të burrit tënd nga Marsha Means

Një lidhje e palejueshme e mendjes nga Laurie Hall

Kur mëkati i tij sekret të copëton zemrën nga Kathy Gallagher

Mendoj se fjalët e këtyre grave do të të ndihmojnë të shërosh plagët dhe do të të forcojnë në mënyrë që të mbështesësh më mirë burrin tënd.

Duke shpresuar që ndërsa ju të dy punoni për këtë sfidë, linjat e komunikimit të jenë më të hapura dhe martesë juaj më e fortë. Duke shpresuar që burri yt të bëjë një jetë të pastër që të siguron dashurinë dhe sigurinë që ke nevojë. Gjatë kohëve të tilla sfiduese është e rëndësishme të kujtosh që Perëndia gëzohet duke përdorur dobësitë tona si një enë për forcën e tij (2 Korintasve 12:9). Ndërsa burri yt përjeton fuqinë e Perëndisë në vendin e tij të dobësisë, jeta e tij do të jetë një burim apo inkurajim për të tjerët dhe gatishmëria jote për të qenë aleatja e tij mund të të aftësojë të inkurajosh gratë e tjera kur hasin një sfidë të tillë të ngjashme.

PËR DISKUTIM

1. Pse është e rëndësishme që burrat dhe gratë të diskutojnë betejet e tyre frymërore me njëri-tjetrin?
2. Cilat janë dy arsytet që shkaktojnë burrat të shmangin diskutimin e hapur me gratë e tyre rreth betejës së tyre me pastërtinë seksuale?
3. Si duhet t'i qaset një burrë gruas së tij nëse duhet të flasë me të rreth kësaj? Si duhet të përgjigjet ai nëse ajo është lënduar?
4. Nga çfarë duhet të heqë dorë një njeri për të rikthyer besimin e gruas së tij? Pse është kjo e rëndësishme?
5. Çfarë plani duhet të ketë një burrë para se të flasë me gruan e tij? A e ke ti një plan të tillë? Nëse jo, cili është?

Mjete për situata të vështira

Kam pasur një komshi, Erni Bellon, i cil blinte vegla të cilat nuk i përdorte asnjëherë. Mbërrinte një kuti me vegla të cilat i kishte blerë dhe as që e hapte fare. Vetëm sa vinte mbi të kutitë e tjera në fund të garazhit të tij.

Një ditë e pyeta për praktikën e tij të tepruar dhe ai më tha: “I dua ato mjete vetëm në rast se më duhen”.

Nuk jam zanatçi, dhe ndryshe nga Erni, nuk mbledh vegla. Megjithatë, mund të çmontoj çdo gjë dhe ta montoj përsëri. Fatkeqësisht ka gjithmonë pjesë që dalin tepër dhe mjete nuk funksionon. Duke pasur parasysh aftësitë e mia e dobta të riparimit, gruaja ime u çudit kur i thashë që do të heq rubinetin e vjetër të kuzhinës për të vënë një të ri.

“A je i sigurt që do ta bësh këtë?” – pyeti ajo. “Mbaj mend që herën e fundit që u përpoqe të riparosh diçka, na kushtoi shumë”.

Fjalët e saj më bënë të ndihesha pa vlerë; kështu që mora qëndrim dhe thashë: “Jam më i mençur se një rubinet”. Thjesht për ta bërë të qartë se sa pozitivisht ndihesha për punën e ardhshme, thashë: “Nuk është se po bëj diçka të ndërlikuar si të ngre cepin e tapetit që të vendos një fije teli të sterjos nën të”. Kjo ishte puna e fundit që kisha katandisur.

Sido që të jetë, kërkova në një kuti të vjetër kartoni ku kisha hedhur

disa vegla me graso. Gjeta një çelësh dadosh dhe i vendosa një përshtatës në fund. Ndërsa u zvarrita poshtë lavamanit, Sindi më pyeti: “Sa kohë do të zgjasë?”.

Nga brenda dollapit i thashë: “Tridhjetë minuta. Me siguri tridhjetë minuta. Jo më shumë”.

Një orë më pas ajo u kthye dhe më pyeti nëse kisha mbaruar punën e parë dhe po merresha me punën tjetër. Nuk e kisha menduar kurrë që ajo përdorte atë lloj sarkazme.

Në fakt do të kisha mbaruar për tridhjetë minuta përveç një problemi të vogël: çelësi nuk futej në hapësirën e ngushtë midis fundit të lavamanit dhe murit. Përdora çdo cep të mundshëm, por nuk mund të vendosja fundin e çelësit mbi dado. Megjithatë arrita të dërrmoja kyçin e dorës së djathtë.

Në çastin që isha gati të hiqja dorë dhe të dëgjoja Sindin që të merrja në telefon një hidraulik, m’u kujtua Erni. Disa minuta më pas e gjeta mikun tim në garazhin e tij.

I shpjegova problemin tim dhe Erni u mendua për një çast. Pastaj i punoi truri, fytyra iu ndriçua dhe tha: “Kam ca vegla të hidraulikut apostafat për atë punë”. Pastaj tërhoqi një kuti të pahapur nga maja e një kutie tjetër në një raft në garazhin e tij dhe m’i dha mua. “Janë zgjatues çelësash për dado. Ti je i pari që do t’i përdorësh”.

Buzëqeshja e tij nënkuptonte: “Jam më i zgjuar se sa ty, sepse i blej veglat para se të më duhen”.

Buzëqeshja ime nënkuptonte: “Do të hiqem sikur je me të vërtetë i zgjuar, sepse nëse nuk hiqem, do të m’i marrësh veglat”.

Disa minuta më vonë e hoqa dadon e parë ndërsa Erni më rrinte mbi kokë. Papritur një punë e pamundur shkoi vaj dhe u ndjeva si hidrauliku më i mirë... një zanatçi i talentuar... çmimi i merituar i një burri. E tërë kjo ngaqë kisha një mjet të planifikuar dhe prodhuar për t’u futur në një qoshe të ngushtë. Gëzimi im qe aq i madh saqë Sindi nuk u përpoq ta prishte duke më kujtuar se sa kohë më hëngri.

Mjete që janë të lehta për t’u përdorur

Ndërsa vazhdon me jetën tënd të pastërtisë seksuale, do të gjendesh me raste në një çast të vështirë. Përpiqu sa të duash, nuk do të arrish të dalësh me forcat e tua. Tundimi, zhgënjimi apo përsëritja do të të shtyjnë të kesh frikë se nuk do t'ia dalësh. Në momente të tilla do të ndihesh sikur do të heqësh dorë.

*Lajmi i mirë është
se ke marrë disa mjete në një kuti
që do të jetë atje
kur të të duhen.*

Mund të mos të të duhen ato mjete tani, por kur të ndodhesh në një çast të vështirë, do të jesh i gëzuar që ato ndodhen aty. Lexo me kujdes këtë kapitull në mënyrë që të dish se ku ndodhet çdo mjet. Shëno në fillim ato mjete që të duhen, në mënyrë që t'i gjesh menjëherë.

Tregoji gruas

Burrat zakonisht më pyesin nëse duhet t'u tregojnë grave për betejat e tyre me epshin seksual. Do të ishte ideale sikur një burrë të diskutonte gjithçka me gruan e tij. Sinqeriteti forcon marrëdhëniet dhe pandershmëria i dobëson. Natyrisht, disa mëkate janë më serioze se të tjerat dhe duhet të ushtrosh urtësi ndërsa shqyrton çështjen.

Të sugjeroj që ta lejosh atë të lexojë këtë libër para se të flasësh me të. Siç mund ta kesh vënë re, kapitulli i mëparshëm është shkruar për të. Nëse e lexon tërë librin, ajo do të kuptojë më mirë situatën tënde. Kjo do të rrisë gjithashtu gjasat që ajo të jetë si aleat për ty dhe do ta bindë atë se e ke seriozisht dëshirën tënde për pastërti.

Nëse flet me gruan, të inkurajoj ta sigurosh atë për dashurinë dhe zotimin tënd. Ji i përgatitur që mund të reagojë emocionalisht, sepse mbase do të ndihet e tradhtuar dhe e kërcënuar. Duhet ta pranosh këtë pa u tërhequr apo mbuluar gjurmët për të qetësuar zemërimin e saj.

Do të jetë ndihmë për të nëse ke një plan specifik për pastërtinë. Ajo do të ndihet më e sigurt nëse e di që po ndërmerr hapa agresivë për t'u

mbrojtur nga tundimi. Për të fituar besimin e saj ka gjasa të humbasësh një farë lirie për pak kohë. Me këtë dua të them që ajo mund të dojë të dijë se ku po shkon dhe sa kohë ke ndërmend të qëndrosh atje. Ajo mund të dojë të ketë një ide më të mirë se si i harxhon paratë. Të nxist' i përshtatesh nevojës së saj për më tepër informacion se si e harxhon kohën tënde.

Nëse duhet të kërkosh falje, ji i sigurt dhe lexo mjetin për kërkimin e faljes më poshtë. Me shpresë, ndërsa vazhdon rrugën e pastërtisë, martesë jote do të dalë më e fortë se më parë.

Një mbrojtje e sigurt kundër zakoneve

Një sharrë elektrike e mirë ka një siguresë për të mbrojtur duart dhe të mundësojë prerjen e drurit pa prerë gishtat. Për të mposhtur sjelljen kompulsive seksuale duhet një mbrojtje e sigurt. Është vendimtare që të identifikosh rrethanat, bisedat dhe marrëdhëniet që të nxisin të veprësh keq. Tërë objektet apo ndodhitë nxitëse duhet të kenë një siguresë përqark.

Ti mund të ndërtosh një mburojë të tillë duke identifikuar zakonet që nxisin sjelljen tënde kompulsive dhe seksuale dhe duke i hequr ato nga jeta jote. Merr një copë letër dhe përdor formatin e mëposhtëm për të ndërtuar një mbrojtje për zakonet e tua.

Zakonet

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____

Si do t'i shmang

1. _____

2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____

Shpresa e duruar

Mos u çudit nëse pas disa ditësh apo javësh mungese, epshi yt del si luan vrumbullues. Epshi seksual ka rrënjë të thella dhe duhet kohë për ta mposhtur. Fjalët e Isaisë shërbejnë si inkurajim: “Por ata që shpresojnë te Zoti fitojnë forca të reja, ngrihen me krahë si shqiponja, vrapojnë pa u lodhur dhe ecin pa u lodhur” (Isaia 40:31).

Dhimbja

Ndërsa rritesh në lirinë tënde nga epshi seksual, është e rëndësishme të kujtosh që dhimbja nuk është armiku yt. Dhimbja është një mjet që do të të bëjë më të fortë. Mos u largo prej saj ose mos u përpiq ta zbusësh me mëkate seksuale.

Përfundimisht ajo që zbut dhimbjen krijon më tepër vuajtje se sa e eliminon.

Në vend që të largohesh nga dhimbja, kapërceje si një ortek. Përfundimisht dëshirat e tyre epshore do të bien ndërsa njeriu yt i ri do të fitojë kontroll mbi ty.

Askush nuk ka një jetë të lehtë. Edhe apostulli Pal përjetoi dhimbje të thellë të shkaktuar nga një “gjemb në mish” (2 Korintasve 12:7-9). Edhe pse nuk e dimë burimin e dhimbjes së tij, ne e dimë që ai ka vuajtur shumë. Tri herë e refuzoi Perëndia. Në vend që të hiqte shkakun e vuajtjes së tij, Perëndia i dha Palit një masë shtesë të hirit të tij.

Pali, në vend që të zemërohej me Perëndinë, shkroi: “Prandaj me kënaqësi të madhe do të krenohem më tepër për dobësitë e mia, që fuqia e Krishtit të rrijë tek unë. Prandaj unë kënaqem në dobësi, në fyerje, në nevoja, në përndjekje, në ngushtica për shkak të Krishtit, sepse, kur jam

i dobët, atëherë jam i fortë” (2 Korintasve 12:9-10).

Pali mësoi se si të mbështetej në hirin e Perëndisë gjatë kohës së vuajtjes. Edhe pse dhimbja nuk u hoq, ai përjetoi forcën e duhur për ta duruar me dinjitet.

Fatmirësisht i njëjti hir është në dispozicionin tënd. Kur je i lënduar, kërkoji Perëndisë të të japë hirin e nevojshëm për të duruar. Kërkoji atij që ta bëjë hirin e tij të dukshëm përmes dobësive të tua.

Është e rëndësishme të dish se vendi i dhimbjes më të madhe do të jetë gjithashtu vendi i veprës më të madhe të Perëndisë në jetën tënde dhe do të jetë gjithashtu vepra më e madhe e Perëndisë përmes jetës tënde. Ndërsa të tjerët shikojnë se si Perëndia po të udhëheq në çastet e vështira, ata do të duan që të vihen në provë nga ai. Parashikimi i Perëndisë në pikën tënde të dobësisë dhe dhimbjes është përgatitja e tij për shërbesën tënde të ardhshme.

Kujto, ky libër ka rrjedhur si rezultat i ndihmës së Perëndisë në betejën time me epshin.

Një listë me pasojat dhe dobitë

Zakonisht kërnaqësia e kryerjes së aktit është e kufizuar me disa minuta apo orë, por pasojat mund të jenë të përhershme. Shumë burra që një herë e një kohë kanë qenë të varur, kanë parë që krahasimi i pasojave të kryerjes së aktit me dobitë e përmbajtjes i ka ndihmuar të shmangin atë akt. Kthehu periodikisht te kapitulli 10, duke filluar nga faqja 25 dhe plotëso apo përsëriti ushtrimet e paraqitura atje nën titullin “Bëj një listë”.

Lotët

Të qarët nuk është diçka që burrat e bëjnë publikisht. Megjithatë lotët janë mjete që na ndihmojnë të shërohemi. Kam lexuar një herë që lotët janë mënyra e trupit për të pastruar kimikatet toksike të tij. Lotët pastrojnë trupin dhe shpirtin. Kur i mbajmë, ne pengojmë një rrëke emocionale që duhet të rrjedhë nga zemra për të qëndruar e pastër.

Edhe Jezusi qau. Kur mikeshat e tij Marta dhe Maria qanë për

vdekjen e vëllait të tyre, Lazarit, Jezusi qau me to (Gjoni 11:35). Duart e tij të ashpra prej zdrukhtari fshinë lotët që rridhnin nëpër faqet e tij.

Ndërsa shikon lëndimin që ke pësuar, mund të kesh nevojë të qash. Mund të jesh mbërthyer nga zhgënjimi. Vazhdo dhe qaj. Nuk ka problem. Vajto për zhgënjimet dhe humbjet e tua. Perëndia kupton. Ndërsa qan, imagjino Jezusin duke të të përqaftuar. Perëndia të do dhe dëshiron të shërojë plagët e tua.

Falja

Falja është një mjet i paçmuar për të gjetur shërim dhe çlirim nga epshi yt. Ka tre dimensione të faljes që duhet të përdorësh.

Dimensioni i parë: Gjetja e faljes. Pavarësisht se çfarë ke bërë, Perëndia të ofron faljen. Pavarësisht se sa i tmerrshëm faji yt dhe i madh faji, duhet të përdorësh faljen.

Nuk ka nevojë të vazhdosh të ndëshkosh veten për gabimet e shkuara. Jezusi vdiq në kryq dhe u ndëshkua në vendin tënd. Ai mori mbi vete tërë fajet e tua dhe vuajti ndëshkimin që meritoje ti (2 Korintasve 5:21; Romakëve 5:8). Tri ditë më pas ai u ngjall prej së vdekurish, duke varrosur përgjithmonë fajin dhe turpin tënd.

Falja e tij është në dispozicion. Thjesht shprehi atij dëshirën tënde për të pranuar atë dhe faljen e tij (Gjoni 3:16). Sapo të jesh falur nga Perëndia, nuk ka pse të dënosh veten. Kur të dëgjosh zërat e dënimit të vetes, thuaj me vete: “Perëndia më fal dhe unë e fal veten”.

Dimensioni i dytë: Dhënia e faljes. Ashtu siç të ka falur Perëndia, po kështu ti duhet të falësh ata që të lëndojnë. Kjo nuk është e lehtë, sidomos nëse plagët e tua janë të thella dhe të qelbëzuara. Por shërimi kërkon pastrim të tyre duke falur ata që të kanë lënduar.

“Por nuk mund t’i fal” – mund të thuash. “Ti nuk e kupton se çfarë më kanë bërë”.

Ke të drejtë, nuk e kuptoj. Më vjen keq që të kanë lënduar. Por me siguri nuk të kanë rrahur më tepër se sa Jezusin kur romakët e gozhduan

në kryq. Megjithatë Biri i Perëndisë u dha faljen atyre që e vranë (Luka 23:34).

“Por unë nuk jam Biri i Perëndisë” – mund të argumentosh.

E kuptoj këtë. Por nëse kthehesh te Perëndia, Biri i tij do të të japë forcën që ke nevojë për të falur. Kujto, ti je një njeri i ri: një njeri i mirë në Krishtin. Kur fal, je duke vepruar në bazë të identitetit tënd të ri, jo të atij të vjetër.

Por duhet të jesh i vetëdijshëm që ka një ndryshim midis faljes dhe pajtimit. Pajtimi mund të ndodhë vetëm kur personi që ofendon kupton thellësinë e lëndimit që kanë shkaktuar dhe kërkon falje. Mund të falësh një faj, por nëse personi që ka bërë fajin minimizon atë që ka bërë, nuk ka gjasa të pajtohesh. Megjithatë, edhe kur *nuk* ndodh pajtimi, ti duhet të falësh.

Kur i ke thënë Perëndisë që ke falur ata që të kanë lënduar, sa herë që do të kujtosh lëndimin, në vend që të shqyrtosh fajin, lutu për ta. Lutja është antidota më e madhe për hidhërimin dhe zemërimin. Në fakt nuk besoj se është e mundur të ruash hidhërim kundër dikujt për të cilin lutesh vazhdimisht.

Dimensioni i tretë: Kërkimi i faljes. Mbase ke lënduar të tjerët me anë të një akti seksual. Ndërsa mendohesh thellë për të shkuarën tënde, mund të të vijnë ndërmend njerëzit që ke lënduar. Duhet që t’u kërkosh falje këtyre njerëzve.

Para se të kontaktosh me ta, mendo për atë që do të thuash. Mos i fajëso për veprimet e tyre. Askush nuk dëshiron të dëgjojë nga dikush që e ka lënduar diçka të tillë: “Pasi më gënjeve dhe mashtrove me paratë e mia, u zemërova dhe thashë disa fjalë jo të mira. A do të më falësh?”.

Ji i sinqertë dhe i drejtpërdrejtë. Kur shkoj tek ata që i kam lënduar, them diçka të tillë: “Tani e kuptoj që të kam lënduar duke [them fyerjen]. Më vjen shumë keq. A do të më falësh?”. Të sugjeroj që të përdorësh një qasje të tillë.

Inkurajoj njerëzit të kenë këto kontakte personalisht apo me telefon. Të shkruash kërkesën për falje në një e-mail apo letër nuk është një ide

e mirë përveç rastit kur është mënyra e vetme e komunikimit me atë person. Një letër apo e-mail mund të bjerë në duart e gabuara dhe mund të shkaktojë dhimbje më të madhe.

Njerëzit e plagosur janë ndonjëherë dyshues me përpjekjet për t'u pajtuar. Ata mund të mos e japin faljen. Mos argumento me ta apo mos u përpiq t'i bindësh. Thuaju që e kupton situatën dhe kërkohet që të luten për ty. Nëse luten për ty, do të vijë koha që do të të falin.

Është e rëndësishme të kuptosh që njerëzit që të falin nuk janë të detyruar të kenë të njëjtën miqësi më pas. Ti nuk po kërkon rikthim total të miqësisë. Ti thjesht po kërkon falje. Nëse ndodh diçka tjetër, është fantastike. Por ji i kujdesshëm të mos vendosësh pritshmëri ndaj personit tjetër.

Gjithashtu, sigurohu të peshosh dobitë e kërkimit të faljes nga një person të cilit i ke bërë faj kundrejt dëmit që mund t'i shkaktohet atij personi me mënyrën se si i afrosh për atë faj. Ndonjëherë gjëja më e dashur për t'u bërë është të pranosh faljen e Perëndisë dhe të kënaqesh me atë.

Meditimi i Biblës

Nuk ka gjë tjetër të më ruaj të pastër seksualisht se sa mësimi përmendësh dhe meditimi i vargjeve biblike që trajtojnë nevojat e mia. Ashtu siç përpiqet mëkati të të karakterizojë, meditimi i Shkrimit të ushqen ty si njeri i ri në Krishtin, personin tënd të vërtetë.

Pjesët e mëposhtme kanë qenë të dobishme për mua. Sa herë që jam i shkruar apo i tunduar, i shikoj dhe fitoj udhëheqje dhe forcë.

Tundimi

Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t'ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t'ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni (1 Korintasve 10:13).

Lum njeriu që ngulmon në provë, sepse kur del i aprovuar, do të

marrë kurorën e jetës, të cilën Zoti ua premtoi atyre që e duan. Askush kur tundohet të mos thotë: “Jam tunduar nga Perëndia, sepse Perëndia nuk mund të tundohet nga e keqja, dhe ai vet nuk tundon asnjëri. Por secili tundohet i udhëhequr dhe i mashtruar nga lakmia e vet. Pastaj lakmia, pasi mbarset, pjell mëkatin dhe mëkati, si të kryhet, ngjiz vdekjen (Jakobi 1:12-15).

Ankthi

Mos u shqetësoni për asgjë, por, në çdo gjë, ia parashtroni kërkesat tuaja Perëndisë me anë lutjesh dhe përgjërimesh, me falënderim. Dhe paqja e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarësie, do të ruajë zemrat tuaja dhe mendjet tuaja në Krishtin Jezus (Filipianëve 4:6-7)

Mendimet e pastra

Së fundi, vëllezër, të gjitha gjërat që janë të vërteta, të gjitha gjërat që janë të ndershme, të gjitha gjërat që janë të drejta, të gjitha gjërat që janë të pastra, të gjitha gjërat që janë të dashura, të gjitha gjërat që janë me famë të mirë, nëse ka ndonjë virtyt dhe nëse ka ndonjë lëvdim, këto mendoni (Filipianëve 4:8).

Epsi

Largohuni nga kurvëria! Çdo mëkat që kryen njeriu është jashtë trupit, po ai që kurvëron mëkaton kundër trupit të vet (1 Korintasve 6:18).

Përmbajtja

Sjellja juaj të jetë pa lakmi paraje dhe kënaquni me atë që keni, sepse vetë Perëndia ka thënë: “Nuk do të të lë, nuk do të të braktis” (Hebrenjve 13:5).

Falja

Atëherë Pjetri iu afrua dhe tha: “Zot, në se vëllai im mëkaton kundër meje, sa herë duhet ta fal? Deri shtatë herë?”. Jezusi i tha: “Unë nuk të

them deri shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë” (Mateu 18:21-22).

Po t’i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi (1 Gjonit 1:9).

Lum ai të cilit i kanë falur shkeljen, ai të cilit i kanë mbuluar mëkatit! (Psalmi 32:1).

Lutja

Zoti është pranë gjithë atyre që kërkojnë, pranë gjithë atyre që e kërkojnë në të vërtetë (Psalmi 145:18).

Lypni dhe do t’ju jepet; kërkonit dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju çelet. Sepse kush lyp merr, kush kërkon gjen dhe do t’i çelet atij që troket (Mateu 7:7-8).

Njeriu i ri

Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja (2 Korintasve 5:17).

Unë u kryqëzova bashkë me Krishtin dhe nuk rroj më unë, po Krishti rron në mua; dhe ajo jetë që tani jetoj në mish, e jetoj në besimin e Birit të Perëndisë, që më deshi dhe dha veten për mua (Galatasve 2:20).

Në qoftë se ju jeni ringjallur me Krishtin, kërkonit ato që janë lart, ku Krishti është ulur në të djathtë të Perëndisë. Kini në mend gjërat që janë atje lart, jo ato që janë mbi tokë, sepse ju keni vdekur dhe jeta juaj është fshehur bashkë me Krishtin në Perëndinë (Kolosianëve 3:1-3).

Lutja

Lutje do të thotë të flasësh me Perëndinë. Është mënyra se si qëndron

i lidhur me atë që të jep dashurinë dhe pranimin e tij së bashku me fuqinë e nevojshme për të jetuar si njeri i ri.

Nëse lutja nuk është diçka që e zbaton në bazë të një orari, të inkurajoj të lutesh ndërsa i jep makinës. Fik radion dhe bëj një bisedë me Perëndinë. Bëje më zë të lartë. Sapo ta bësh zakon, përpiqu të gjesh një moment çdo ditë për të qëndruar me Perëndinë dhe të lutesh.

Kujto, objekti i epshit tënd të jep iluzionin e intimitetit. Vetëm intimiteti autentik me Perëndinë do të nxjerrë në shesh iluzionin. Jezusi e bëri të qartë se ne qëndrojmë në të përmes lutjes dhe meditimit të Biblës (Gjoni 15:7). Perëndia dëshiron që të gëzohesh me të në mënyrë që nevoja jote për iluzionin e intimitetit të mos ekzistojë. Shqyrto kohën e lutjes dhe leximin e Biblës si mundësi për t'iu afruar Perëndisë.

Mbajtja e një ditari

Përpiqem rregullisht të mbaj një ditar. Kjo nuk do të thotë që shkruaj poezi. Kjo përfshin regjistrimin e ndodhive kyçe të ditës dhe matjen e temperaturës time frymërore. Përpiqem gjithashtu të shkruaj një lutje ose dy në mënyrë që të kem diçka për t'iu referuar kur të marrin përgjigje lutjet e mia.

Mbajtja e një ditari është një mënyrë e prekshme e përforcimit të njeriut tënd të ri. Kujto, mëkati përpiqet të të vjedhë identitetin tënd dhe të dobësojë njeriun e ri në ty. Meditimi i Biblës, lutja dhe mbajtja e ditarit forcon frymën tënde duke rrënjësuar miqësinë tënde me Perëndinë dhe duke ushqyer njeriun tënd të ri.

Përsëritja

Është thelbësore të kesh një strategji në rast përsëritjeje. Do të ishte fantastike sikur të mos bie më, por mund të biesh. Nëse bie, çohu menjëherë.

Mbase mund të mendosh: “Tani që e kam shkelur, po ashtu mund të resht së përpjekuri”. Si mendon, nga vjen një mendim i tillë? Nga mëkati yt apo nga njeriu yt i ri? Shmang një mendim të tillë të marrë dhe shkatërrimtar. Nëse e përsërit, ngrihu në këmbë. Nuk po ia nis nga

fillimi.

Përqendrohu në faktin që ece për pak kohë pa rënë në mëkat. Lejo që zhgënjimi yt të jetë një kujtesë e cenueshmërisë tënde dhe nevojë për t'u varur nga Perëndia dhe shmang disa situata.

Perëndia të ka falur. Prano faljen e tij dhe ec përpara.

PËR DISKUTIM

1. Lexo përsëri këtë kapitull dhe shëno mjetet të cilat mendon se do të të duhen në të ardhmen. Pse i zgjedhe ato?
2. Gjej një varg të Shkrimit që të ndihmon më tepër dhe mendohu thellë për të për një javë, duke i kërkuar Perëndisë të të ndihmojë të përjetosh realitetin që paraqet. Përpiqu të mësosh përmendësh pjesën. Tregoja grupit.
3. Cilat nga idetë në këtë kapitull do të vësh të parën në praktikë? Pse?
4. Cila është gjëja më e rëndësishme që ke përfituar nga ky libër? Si mund ta krahasosh me atë që ke shpresuar se do të përfitosh nga libri në fund të kapitullit 1?

Një histori (shumë e shkurtër) përfundimtare

Do të doja që ne të dy të flisnim personalisht. Mbase një ditë do të flasim.

Por para se të ndahemi, dua të të kujtoj që një jetë pastërie rrjedh nga identiteti yt i vërtetë si bir i Perëndisë. Ndërsa rritesh në njohjen tënde të këtij realiteti, mendimet dhe veprimet e tua do të shndërrohen. Do të shohësh që po vepron ngadalë në mënyrë të përputhshme me njeriun e ri, me njeriun e mirë, siç të ka bërë Perëndisë.

Më kujtohet historia e një studenti që peshonte rreth pesë kilogram më tepër, nuk bënte asnjëherë sport dhe shijonte më tepër të ngrënët se sa garën me djemtë e tjerë. Ai nuk e mendonte veten atlet dhe nuk dëshironte kurrë të merrej me sport.

Një ditë, ndërsa po ecte përgjatë universitetit, trajneri i atletikës iu afrua dhe e pyeti: “Si e ke emrin?”

“Xheremia Xhonson”.

“A të ka thënë ndonjë që je vrapues?”

“Jo. Asnjëherë”.

“Shiko, është e vërtetë” – tha trajneri. “Mund ta them këtë në bazë

të mënyrës se si ecën. Si thua të të mas kohën e një vrapit sot pasdite?”.

“Nuk mendoj ashtu” – tha Xheremia.

Trajneri, duke mos dashur të merrte një përgjigje negative, nguli këmbë derisa Xheremia pranoi të bënte një xhiro vrapit. Ai, ndërsa po futej në dhomën e zhveshjes pas shkolle, u ndje jo si në vendin e duhur, ashtu si gomari në garën e kuajve. Duke sharë veten që kishte pranuar kërkesën e trajnerit, veshi një palë pantallona të shkurtra dhe atlete dhe doli jashtë për te pista. Pasi bëri tendosjen e muskujve dhe disa xhiro nxemjeje, trajneri e thirri.

Xheremia, ndërsa po e shikonin disa vrapues të tjerë, u çudit dhe gjithë të tjerët, përveç trajnerit, duke shënuar kohë mbresëlënëse nga vrapit i tij. Trajneri e thirri mënjandë dhe i tha: “Hej, çfarë të thashë, Xheremia? Nëse më lejon të punoj me ty, besoj se ti mund të bëhesh një prej vrapuesve më të mirë në vend”.

“Në vend?” – pyeti Xheremia.

“Vërtetë” – tha trajneri. “Ti ke hap të madh dhe muskuj të shpejtë që askush nuk mund t’i stërvisë. Thjesht mjafton të rrih në formë dhe të mësosh se si të shkëputesh”.

Vitin tjetër Xheremia punoi fort. Në fakt ai punoi më fort nga ç’kishte punuar në jetën e tij. Dhe i vlejti, sepse fitoi kampionatin e universiteteve në 100 metërsh.

Një javë para takimit kombëtar ai ishte në një mbrëmje miqësie kur vajza më e bukur e shtëpisë iu afrua dhe i ofroi Xheremisë një pjatë patatina dhe një birrë të ftohtë. “Kjo është për ty” – tha ajo.

Në atë çast ai mori një vendim të shpejtë dhe vendimi do të mbështetej në faktin se si e konsideronte veten. Nëse e konsideronte veten si një deng me nerva dhe orekse të pakënaqura, ai do të pinte birrë dhe do të zinte edhe vajzën. Por ai nuk e konsideronte veten në atë mënyrë dhe kështu pa vajzën, buzëqeshi dhe refuzoi ofertën.

“Pse? Nuk beson te pija?” – pyeti ajo.

“Oh, nuk është kjo arsyeja se pse po them jo”.

“Atëherë cila është arsyeja?”.

“Unë jam vrapues” – tha ai¹.

Kur një burrë e konsideron veten si vrapues, është e lehtë të refuzosh një pjatë patatina dhe një birrë të ftohtë. Pse? Sepse vrapuesit nuk hanë apo pijnë diçka që do t’i bënte më të ngadaltë. Nuk është në natyrën e tyre.

Në mënyrë të ngjashme sa më tepër e konsideron veten si bir të Perëndisë, një njeri të ri, një njeri të mirë, një njeri ku banon Fryma e Perëndisë, aq më tepër do të mendosh dhe veprësh si një krijim i ri. Aq më pak do të jesh i tërhequr nga qëndrimet dhe veprimet që nuk janë në përputhje me identitetin tënd të ri. Por gjithsesi, si një njeri i mirë do të tundohesh. Dhe tani ti e di se si të trajtosh tundimin në mënyrë të atillë që të të sjellë fitoren: tundim pas tundimi. Nëse pengohesh, ti e di se si të ngrihesh prapë, me ndihmën e një mikut dhe të ecësh përpara si bir i Perëndisë.

Nuk të njoh, por jam i gëzuar për veprën që Perëndia do të bëjë në ty dhe përmes teje ndërsa kupton identitetin tënd të ri.

Meqë ra fjala, molla te kapaku nuk është fruti me të cilin u tundua Adami në Kopsht. Ajo është një shëmbëlltyrë e njeriut të ri, njeriut të mirë, që të ka bërë Perëndia: molla golden e shijshme.

1. I jam mirënjohës David Nidhemit për këtë ilustrim të madh, të cilin e kam ndryshuar pak. Është marrë nga faqet 91-92 nga libri i tij *E drejta e birmisë*, përmendur më herët.

Falënderime

Dua të falënderoj grupin tim të vëllezërve. Përgjatë viteve më keni trajnuar, ndrequr, ngushëlluar dhe sfiduar. Falënderoj Perëndinë për miqësinë tuaj. Urrej mendimin se kush do të isha pa ju. Bob Boboski, Deju Kerr, Rod Kuper, Lejn Kegi dhe Bob Nok.

Falënderoj tërë ekipin e Zondervan për besimin e tyre në këtë libër dhe Bob Hjudsën që ka korrigjuar ribotimin. Të falënderoj Bob që më ndihmove të zbus pjesët e sarta.

Zgjo drejtuesin që është brenda teje

Si mund të çlirojë dituria e Jezusit potencialin tënd

Bill Perkins

Vizioni dhe shtysa për t'u bërë drejtuesi që dëshiron Perëndia: nëse drejton familjen, kishën, bashkëpunëtorët apo një ndër 500 kompanitë më të mira.

Ti je një drejtues! Në fakt, sa herë që përpiqesh t'i thuash dikujt të bëjë diçka, je duke ushtruar udhëheqje. Ky libër do të të ndihmojë të zbulosh nga Jezusi se si të jesh më efektiv në drejtim ndërsa kupton tiparet e karakterit dhe aftësitë praktike të drejtuesit të vërtetë. Një udhëzues diskutimi në fund të librit do të të ndihmojë të integrosh parimet në jetën tënde ndërsa i lejon Jezusit të të ndihmojë për të mësuar se si të lëvrosh dhe formosh një vizion, të marrësh vendime të mençura, të ndërtosh një skuadër, të mprehësh forcat kundërshtare, lehtësosh risinë dhe të vendosësh të tjerët në fillim.

Merr një kopje sot në librarinë tënde të preferuar!

Kur tundohen të rinjtë

Pastërtia seksuale për djemtë në botën reale

Bill Perkins dhe Rendi Sauthern

Ky vështrim praktik ndaj pastërtisë seksuale është shkruar drejtpërdrejt për adoleshentët në një stil të hapur, të aksesueshëm dhe tërësisht të sinqertë për t'i ndihmur ata të marrin vendime për integritetin seksual. *Kur tundohen të rinjtë* diskuton faktorët rreth tundimit seksual dhe paraqet një strategji për të inkurajuar dhe ndihmuar të rinjtë të bëjnë një jetë të pastër morale. Autori Bill Perkins paraqet histori suksesi po ashtu edhe dëshmi të zgjidhjeve të rreme. Lexuesit do të:

Kuptojnë se pse gjërat “e gabuara” duken aq “të drejta” dhe se si orekset seksuale dalin jashtë kontrolli

Mësojnë të filtrojnë dhe trajtojnë elementët e punës kulturore popullore të adoleshentëve

Gjejnë liri për të ballafaquar dhe mundur demonët e kompromisit seksual, zakoneve të këqija dhe ndjenjave të fajit, duke prishur ciklet e varësisë

Përdorin mënyra miqësore për të marrë vendime të shëndetshme dhe të veprojnë në bazë të tyre

Zbulojnë strategji për fitore të vazhdueshme

Kokëposhtë. I kthyer mbrapsht. Duket si një ditë e zakonshme për ty? Librat me figura që lëvizin vijnë atje ku je: në vendet e përdredhura, e shfletuara në jetën tënde. Ke shumë marrëdhënie tek të cilat përqendrohesh: Perëndia, të tjerët dhe madje vetvetja, librat me figura që lëvizin do të të ndihmojnë të zbulosh se si t'u kushtohesh plotësisht atyre. Librat me figura të lëvizshme përballin temat e vështira që janë të rëndësishme për ty dhe do të të ndihmojnë të kthesh përqendrimin te Perëndia në mënyrë më të qartë.

Ne duam të dimë për ty. Të lutem na dërgo komentet rreth këtij libri te zreview@zondervan.com. Faleminderit

Për më tepër informacion rreth Million Mighty Men apo për të kontaktuar Bill Perkins për të folur, shko te www.billperkins.com

